



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 11 NËNTOR 2024**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. NOVEMBRA 2024. GODINE**

**NËNTOR - OVEMBAR
2024**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025

Dnevni red

1. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-332 o budžetskim izdvajanjima za budžet Republike Kosovo za 2025. godinu

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se erdhët në këtë seancë, e cila u caktua në njërin nga mbledhjet e Kryesisë. Është seancë vetëm me një pikë të rendit të ditës, trajtohet sot buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2025.

Shohim fillimisht se sa deputetë jemi të pranishëm. Votojmë për prani, votojmë tash.

53 në mënyrë elektronike dhe, me sa po shoh, edhe gati nja 20 në formë fizike të deputetëve të pranishëm. Kështu që e fillojmë këtë seancë.

Rendin, me materialet e kësaj seance, besoj që i keni marrë me kohë.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025

Të nderuar deputetë,

Komisionit Funkcional për Buxhet e ka shqyrtuar Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin. Abelard Tahiri ma ka kërkuar fjalën para se të fillojmë këtë seancë. Urdhëro, zoti Tahiri!

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në pajtim edhe me shefat e tjerë të grupeve parlamentare në Kuvendin e Kosovës jemi dakorduar që ta nderojmë me një minutë heshtje veteranin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesëtarin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, i cili ndërroi jetë para dy ditësh në mënyrë tragjike, ish-veterani i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Niman Musliu.

(Një minutë heshtje)

KRYETARI: E nderojmë! Lavdi!

Komisioni për Buxhet, të nderuar deputetë, e ka shqyrtuar Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin e ardhshëm dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftojme kryeministrin e Republikës, Albin Kurti, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI ALBIN KURTI: I nderuar kryetar i Kuvendit, Glauk Konjufca!
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës,
Të dashur qytetarë të Kosovës,

Kam nderin dhe kënaqësinë që sot para jush të bëhem kryeministri i parë që prezanton buxhetin e katërt të mandatit, për ta shënuar kështu edhe qeverinë e parë që e çon mandatin deri në fund.

Siç tashmë edhe e dini, buxheti për vitin 2025 është projektuar të jetë 3.6 miliardë euro, apo rreth 9% më i lartë sesa buxheti i vitit 2024, ose 60% më i lartë sesa buxheti i vitit 2020.

Për të arritur deri këtu, këto katër vjet kaluam nëpër shumë sfida, globale dhe të brendshme. Por njëkohësisht, e për dallim nga të tjerët para nesh, u siguroam që buxheti të orientohej aty ku kthimi ishte më i larti, te qytetarët tanë. Duke bërë këtë, vit pas viti, rritej edhe buxheti, pa ndryshuar asnjë politikë tatimore, sepse investimi në qytetarët tanë vazhdonte të kthente rritje të qëndrueshme.

Buxheti i vitit 2025 është buxheti i katërt me radhë që po e prezantojmë si qeveri në këtë mandat. Miratimin në Qeveri dhe prezantimin e buxhetit në Kuvend çdoherë e kemi bërë sipas rregullave të përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Buxhetin për vitin 2022 në Kuvend e kemi prezantuar më 25 nëntor 2021. Buxhetin për vitin 2023 e kemi prezantuar më 17 nëntor 2022. Buxhetin për vitin 2024 më 16 nëntor 2023 dhe sot, buxhetin për vitin 2025 përsëri po e prezantojmë në muajin nëntor, madje kësaj radhe në gjysmën e parë të këtij muaji. Më i madh buxheti i shtetit secilin vit, aq më i hershëm edhe prezantimi i tij në Kuvend secilën herë.

Karakteristikat e tjera të buxhetit 2025 janë me sa vijon:

- Buxheti për paga dhe shtesa është 13,85% më i lartë se në vitin 2024 ose 111,5 milionë euro;
- Buxheti për mallra dhe shërbime (duke përfshirë edhe shërbimet komunale) është 3,2% më i lartë se në vitin 2024;
- Buxheti për subvencione dhe transfere është 8,75% më i lartë se në vitin 2024 e këtu luajnë rol masat e reja, si pensionet, shtesa për fëmijët, rimëkëmbja ekonomike, etj.;
- Buxheti për investime kapitale është 8,3% më i lartë se në vitin 2024.

Për këto katër vjetët e qeverisjes, Bruto Produkti Vendor është rritur aq sa për herë të parë sivjet do ta kalojë shifrën prej 10 miliardë eurosh, kurse për vitin e ardhshëm pritet të shkojë përtej 11 miliardë euro. Sivjet do të kemi Bruto Produkt Vendor afër shtatë herë më të lartë sesa në vitin 2000, që është viti i parë pas çlirimit, apo afër tri herë më i lartë sesa në vitin 2008, që është viti i shpalljes së pavarësisë dhe gati 50% më i lartë sesa në vitin 2019, apo viti i parë parapandemik.

Kur e shikojmë në distancë kohore, të nderuar deputetë, pandemia globale COVID-19 duket si një ëndërr e keqe, e cila uroj të mos na bie ta harrojmë kurrë, sepse ishte një kohë me shumë vuajtje, e shumë familje humbën më të dashurit e tyre. Ne si qeveri, u ballafaquam me këtë sfidë qysh në ditën e parë. Siç edhe kishim premtuar, u mobilizuam shpejt, siguruam vaksinat dhe arritëm që për pak muaj të vaksinonim shumicën e popullsisë.

Si rezultat i vaksinimit të shpejtë, u mundësua hapja e ekonomisë sonë, por më e rëndësishmja, u mundësua futja e Kosovës si destinacion i sigurt në listat e shteteve të tjera. Kjo hapi rrugën që mërgata jonë të vinte si kurrë më parë, pas pamundësisë që të vinin në vitin 2020, kur kufijtë ishin të mbyllur. Kjo ardhje e mërgatës në numra rekord, i dha edhe ekonomisë sonë infuzionin aq të nevojshëm financiar, për të arritur rritjen rekorde që e kemi gëzuar si shtet prej 10,7% të Bruto Produktit Vendor.

Por kjo etapë, siç e dimë nuk zgjati shumë, sepse porsa nisëm trajektoren e rritjes pas pandemisë, kontinentin evropian e goditi kriza energjetike, ku as Kosova nuk kishte se si të shpëtonte pa pasoja.

Si qeveri e përgjegjshme, ndërmorëm veprimet e nevojshme dhe ndamë pakon më të madhe mbështetëse për qytetarët, ashtu që çmimet stratosferike nga bursat ndërkombëtare të importit të energjisë elektrike të mos barteshin edhe te qytetarët e bizneset. Mijëra familje i mbështetëm në renovimin dhe izolimin e shtëpive, ashtu që të ulej konsumi i energjisë elektrike dhe kjo vazhdon edhe tani kur po afrohen javët e muajt e fundit të mandatit tonë.

Subvencionuam edhe mijëra familje të tjera për të blerë pajisje eficiente, përfshirë edhe kondicionerët me ngrohje që shpenzojnë pak, ashtu që faturat e energjisë elektrike të peshonin sa më pak në arkën e familjes. I mbështetëm edhe ata që kursyen energjinë elektrike, ku mbi 208 mijë familje për gjashtë muaj me radhë përfituan nga mbulimi i një pjese apo komplet faturës, varësisht se sa kishin kursyer. Pra ata që kursejnë, i shpërblejmë. Si rezultat i këtyre masave, Kosova vazhdon ta ketë çmimin më të lirë të energjisë elektrike në rajon, sipas Eurostat, dhe kjo është një karakteristikë tejet e rëndësishme për investimet e huaja dhe riinvestimin që bëhen në Kosovë.

Sikur të mos mjaftonte kriza energjetike në Evropë, Federata Ruse hapi front duke sulmuar Ukrainën, gjë që çregulloi të gjitha bursat botërore të çmimeve, e sidomos ato të ushqimeve bazë. Pasojat u vërejtën në tërë kontinentin, edhe kësaj radhe Kosova nuk kishte se si të evitonte pasojat njësoj sikurse shtetet që janë shumë më të fuqishme ekonomikisht sesa ne. Edhe për këtë sfidë, ndërmorëm masat e nevojshme, duke miratuar Pakon për Përballje me Inflacionin, përmes së cilës mbështetëm punëtorët e sektorit privat e publik, pensionistët, dhe studentët dhe kjo pako si përqindje e Bruto Produktit Vendor është më e madhja në rajonin tonë sipas Bankës Botërore.

Si pjesë të pakos miratuar edhe Ligjin për Pagën Minimale për të mundësuar rritjen e pagës minimale në sektorin privat, si dhe Ligjin për çmime tavan që të parandalohet abuzimi i tregtarëve të papërgjegjshëm që manipulonin me çmime.

Siç edhe e dini, të nderuar deputetë, që të dyja ligjet, deputetët opozitarë i bllokuan duke i dërguar në Gjykatë Kushtetuese. Eventualisht, Gjykata që më shpesh bën bilanc politik sesa që ndan drejtësi, njërin ligj na e rrëzoi - atë për çmime tavan, kurse tjetrin e miratoi - atë për pagën minimale. Dëm gjithsesi. Për të parin, sepse nuk hyri kurrë në fuqi, kurse për të dytin, sepse u vonua një vit zbatimi i tij.

Pra, qytetarë të dashur, përveç problemeve e krizave globale, neve na u desh të navigonim edhe nëpër sfidat, pengesat, e vonesat e brendshme, që na u shkaktuan.

Edhe pse në shumicën e ekonomive në botë, një prej shqetësimeve kryesore ka qenë niveli i lartë i çmimeve të konsumit, ne kemi arritur që ta stabilizojmë inflacionin përmes masave mbështetëse për qytetarët. Mesatarja deri në shtator 2024 ka shënuar vlerën 1,9%, duke shfaqur një tendencë rënëse të inflacionit dhe pritjet të mbajë trend të ulët rritjeje edhe për pjesën e mbetur të vitit.

Dhe, megjithatë, ia dolëm bashkërisht, që të gjitha këto sfida globale t'i tejkalonim me shumë më pak dëme sesa plot shtete të tjera që janë shumë herë më të fuqishme se ne ekonomikisht. E përkundër sfidave, arritëm që ta rritim edhe punësimin e bashkë me të edhe ekonominë e vendit duke ndihmuar kështu që fuqia blerëse e gërryer nga sfidat globale, të rikuperohej përmes zhvillimit e punësimit brenda.

Për katër vjet me radhë, numri i të punësuarve u rrit në mënyrë konsistente, gjë që nuk ka ndodhur në asnjë ekzekutiv, në asnjë mandat qeveri para nesh. Prandaj, edhe jemi qeveria me numrin më të madh të vendeve të punës të shtuar brenda mandatit, që aktualisht ende pa e përfunduar, po arrin në 78 mijë vende pune më shumë sesa kur e kemi marrë mandatin në pranverën e vitit 2021.

Për katër vjet me radhë, rritja ekonomike mesatare ishte 6%, dhe në asnjë vit të vetëm nuk ka rënë nën 4%, ani se u ballafaquam me kriza globale që ndodhin, madje edhe vetëm një herë në shekull. Në qeverisjet e kaluara, qoftë edhe kriza më e vogël e jashtme, sikur kriza greke në vitin 2012, e ngadalësonte rritjen ekonomike në 1,7%.

Për katër vjet me radhë, rritëm të hyrat buxhetore dhe tani me buxhetin e vitit 2025 i bie të jenë dyfishuar në krahasim me të hyrat buxhetore që i gjetëm kur e morëm mandatin. Të hyrat buxhetore, ashtu si edhe në vitin e mëparshëm, kanë vazhduar performancën e tyre tejet të kënaqshme dhe gjatë periudhës janar - shtator të vitit që ndodhemi, 2024, kanë shënuar një rritje të konsiderueshme prej më shumë se 7,1% apo rritje me rreth 150 milionë euro, krahasuar me të

njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Rritja e punësimit, rritja e qëndrueshme e ekonomisë edhe përballë sfidave më të rënda, e rritja e të hyrave, na ka mundësuar që të kemi edhe këtë buxhet historik prej 3,6 miliardë eurove, që po e prezantojmë sot para jush, të nderuar deputetë.

Ky është buxhet për familjen, sepse secila familje duhet e do të përfitojë.

Në një familje të re që ka tre fëmijë, nëna lehonë përfiton gjashtë muaj nga 170 euro apo 1,020 euro gjithsej, ndërkaq për fëmijët i marrin nga 90 euro në muaj, apo 1 080 euro në vit. Asnjë qeveri para nesh nuk ka mbështetur gratë dhe fëmijët. Për këtë kemi buxhetuar 145 milionë euro, që shkojnë direkt në arkat familjare të mbi 200 mijë familjeve të Kosovës.

Në një familje që i ka dy studentë, djali që studion dizajnin grafik, e ka semestrin falas dhe është pranuar në punë përmes platformës SuperPuna, ku për gjashtë muaj do të marrë nga 350 euro apo 2,100 euro gjithsej, ndërkaq vajza që studion shkencat kompjuterike, e ka po ashtu semestrin falas, por merr edhe bursë STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri e Matematikë) në vlerë prej 1 000 euro.

Pra, mbi 3 100 euro mbështetje direkte dhe semestri pa pagesë. Asnjë qeveri para nesh nuk ka mbështetur të rinjtë kaq shumë. Për këtë kemi buxhetuar mbi 30 milionë euro, të cilat lehtësojnë barrën e familjeve që kanë studentë apo fëmijë apo edhe të rinj të moshës 18-29 vjeç.

Një familje dëshmor, e ku djali është pranuar në punë si polic, do të marrë pensionin e rritur për 20% për prindin dëshmor dhe polici pagën e rritur për 55 euro nga janari dhe pastaj për 110 euro nga korriku e tutje i vitit 2025. Për rritjen e pagave në sektorin publik kemi buxhetuar 110 milionë euro shtesë.

Në një familje, ku kryefamiljari punon me pagë minimale dhe me dy pensionistë në shtëpi, që marrin ta zëmë njëri pensionin bazik e tjetri atë kontributpages, do të përfitojnë nga rritja e pagës minimale nga 170 euro në 350 euro, dhe pensionistët do ta marrin pensionin me 20% rritje. Për këtë kemi buxhetuar 100 milionë euro tjera shtesë për pensionet e rritura.

Ka shumë kombinime të familjeve të ndryshme: familje me pensionistë, familje me fëmijë nën 16 vjeç, familje të kategorive të luftës çlirimtare, familje me punonjës në sektorin publik e privat, por e përbashkëta e tyre është se secila do të përfitojë nga buxheti i përbashkët i shtetit tonë, si asnjëherë më parë, e si me asnjë qeveri tjetër.

Kemi ofruar mbështetje edhe për ato familje që nuk kishin asnjë të punësuar përmes masës Qeveria për Familje, duke subvencionuar 70% të pagës për gjashtë muaj, ku deri më tani janë rreth 4 mijë familje që kanë përfituar, e shumica dërrmuese janë nga familjet që më parë ishin të varura nga asistenca e pakët sociale.

Në këtë buxhet kemi edhe kompletimin e reformës sociale, e cila tashmë ka filluar zbatimin përmes pilotimit, ku për familjet që marrin asistencë sociale është paraparë të hiqen kriteret diskriminuese, por edhe të inkurajohet punësimi i qëndrueshëm, ashtu që familjet të krijojnë pavarësi ekonomike afatgjate.

Pra, me fjalë të tjera, ky buxhet e shikon familjen si tërësi dhe si njësi, dhe parasheh rritjen e fuqisë blerëse për secilën familje, duke u siguruar që të mirat që vijnë nga rritja ekonomike të shpërndahen te të gjithë, e jo vetëm te grupe të caktuara interesi.

Me këtë buxhet, të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës, përfitojnë edhe bizneset dhe ekonomia.

Së pari, përfitojnë nga rritja e fuqisë blerëse të familjes, për të cilën porsa fola, sepse sa më shumë para në llogarinë e familjes, aq më shumë aktivitet ekonomik për bizneset, aq më e madhe kërkesa agregate në ekonomi. Kjo vërtetohet kur e shohim qarkullimin e bizneseve ndër vite: nga 12 miliardë euro sa ishte në vitin para qeverisjes sonë, për vitin 2024 pritet ta tejkalojë vlerën prej 22 miliardë eurosh. Me mandatin tonë ndërmjet, qarkullimi i bizneseve kalon nga 12 miliardë në 22 miliardë euro, pra pothuajse dyfishim i qarkullimit të bizneseve përgjatë katër vjetëve të kësaj qeverisje demokratike e të mirë.

Së dyti, bizneset përfitojnë nga mirëqenia dhe pagesa me kohë e faturave për punën e kryer. Nëse e marrim fundin e vitit 2020, niveli qendror i qeverisjes, pra pa i përfshirë komunat këtu, u kishte borxh bizneseve 143 milionë euro fatura të papaguara. Bizneset tona kryejë punë, shteti mos i paguaj ato. Një shumë kaq e lartë e papaguar nënkupton që biznesi që ka kryer punën për shtetin nuk po paguhej dhe kështu fillonte të kishte probleme me likuiditet, edhe me pagesë të detyrimeve ndaj furnitorëve apo me pagat e punëtorëve të tyre.

Prandaj e kemi marrë me prioritet ndryshimin e kësaj situatë, të nderuar deputetë, dhe në fund të vitit 2023 niveli qendror ka pasur vetëm 33 milionë euro fatura të papaguara, sepse një pjesë patjetër është çdoherë në qarkullim. Pra, me një veprim të vetëm, kemi shtuar likuiditetin e bizneseve që kryejnë punë për qeverinë me 110 milionë euro. Nga 143 milionë sa ishte borxhi, në vetëm 33 milionë euro.

Ngjashëm është situata edhe me pagesat për shpronësimet për pronat private, ku nga 103 milionë euro sa e kemi gjetur, kjo shifër tani ka rënë në vetëm 17 milionë euro, që nënkupton se 86 milionë euro më shumë janë në duart e qytetarëve dhe të bizneseve.

Së treti, bizneset si me asnjë qeveri tjetër, mbështeten në mënyrë të drejtpërdrejtë në hapjen e vendeve të reja të punës, ku shteti subvencionon një pjesë apo pagën e plotë për një periudhë të caktuar. Masat si Qeveria për Familje, platforma SuperPuna, programi Kosovo Generation

Unlimited, bashkë me UNICEF-in, apo praktika në punë përmes Agjencisë së Punës, janë disa nga mekanizmat zbatues të kësaj mbështetjeje.

Së katërti, buxhet të shtuar ka edhe mbështetja përmes granteve dhe subvencioneve që shpërndahen nga ministrinë e linjës, si ta zëmë mbështetja rekord për sektorin e bujqësisë, ose mbështetja për prodhues e start-up-e nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë apo edhe Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Së pesti, ky buxhet parasheh mbështetje të bizneseve edhe për qasje në financa, duke shtuar kapitalin dhe dritaret në Fondin për Garanci Kreditore, apo përmes masave mbështetëse që subvencionojnë kreditë investuese.

Kjo mbështetje vjen si vijim i mbështetjes së realizuar gjatë këtyre viteve që lamë pas, ku subvencionuam koston e energjisë elektrike, ashtu që bizneset dhe prodhuesit tanë të vazhdonin të kishin energjinë elektrike më të lirën në rajon, apo kur subvencionuam kreditë investuese deri në nivelin prej 100 milionë euro, vetëm për pajisje apo linja të prodhimit.

Kontributi kryesor në rritjen ekonomike gjatë periudhës së ardhshme afatmesme 2025-2027 pritet të vijë nga konsumi, investimet publike dhe ato private. Konsumi do të rritet nga katër lloj rritjesh:

- Rritja e pensioneve, në masën prej 20% për të gjitha kategoritë e pensioneve të moshës dhe pensionet e përcaktuara me Ligjin për kategoritë e luftës;
- Rritja e shtesave të fëmijëve, jo çfarëdo rritje, por dyfishim e trefishim;
- Rritja e koeficientit për të gjithë të punësuarit në sektorin publik, një herë rritja e vlerës së koeficientit e tash së fundmi edhe rritja e numrit të koeficienteve; si dhe
- Rritja e pagës minimale që ndodh pas më shumë se një dekade stagnimi.

Të dashur qytetarë,

Në këtë buxhet e kemi prioritet arsimin e shëndetësinë, por edhe infrastrukturën e mbrojtjen. Ky buxhet ka edhe shumë detaje e specifika të tjera, por që po besoj në vijim ato do të keni mundësinë t'i dëgjoni nga vetë ministrat e linjës.

Me këtë buxhet, e kemi prioritet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, vazhdimin e krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjen e mirëqenies për të gjithë. Për vitin e ardhshëm presim që rritja ekonomike të arrijë në 5,6% të Bruto Produktit Vendor në terma realë, dhe synimi ynë

është që këtë rritje ta bëjmë duke i përfshirë të gjithë, ashtu siç na takon, ashtu siç e meritojnë qytetarët, duke mos e lënë asnjëri anash.

Prandaj, edhe ju ftoj ta votoni Buxhetin 2025. Ju faleminderit për kontributin dhe vëmendjen!

KRYETARI: Kjo ishte paraqitja nga ana e kryeministrit të buxhetit për vitin e ardhshëm. Tash e ka fjalën komisioni ynë. Kryetari i komisionit, Armend Muja, në emër të komisionit.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë të vendit tonë,

Po filloj, sepse do t'i kem dy fjalime një pas një. Fillimisht do të flas në emër të Komisionit për Buxhet, por pastaj do të flas edhe në emër të grupit parlamentar.

Atëherë, të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e ka shqyrtuar Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2025 dhe pas diskutimeve e sqarimeve me Ministrinë e Financave, e ka proceduar për shqyrtim në seancë.

Të nderuar deputetë,

Shpenzimet e propozuara buxhetore, të propozuara në kuadër të ligjit përfshijnë vlerën prej 3 miliardë e 607 milionë euro. Këto shpenzime mbështeten në të hyra buxhetore në vlerë prej 3,3 miliardë euro. Nevoja për financim përfshin një bilanc negativ prej treqind milionë euro.

Borxhi i përgjithshëm, bazuar në propozimin e Ligjit për ndarjet buxhetore 2025, deri në fund të vitit 2025 parashihet të jetë 21,1 për qind në raport me GDP-në.

Gjykuar sipas klasifikimit ekonomik, projektligji parasheh 1.2 miliardë euro shpenzime në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, 916 milionë euro shpenzime në paga dhe mëditje, 930 milionë euro për investime kapitale dhe 536 milionë euro për mallra dhe shërbime.

Gjykuar sipas nivelit të qeverisjes, projektligji parasheh që buxheti për nivelin qendror të jetë 2,8 miliardë euro, në ndërkohë që 788 milionë euro i dedikohen nivelit lokal, komunave.

Projektligji për ndarjet buxhetore u është dërguar deputetëve me kohë. Qeveria po ashtu e ka proceduar në Kuvend me kohë dhe ne si Komision i kemi rekomanduar deputetëve që ta miratojnë këtë projektligj në parim, në mënyrë që të hapen afatet për shqyrtim dhe trajtim të projektligjit.

Deputetë të nderuar,

Në emër të Komisionit për Buxhet, ju lus që ta votoni këtë projektligj në parim.

Atëherë, në emër të grupit parlamentar...

KRYETARI: Po, urdhëroni!

ARMEND MUJA: Të nderuar deputetë,

Sot po e paraqesim buxhetin e vitit 2025 dhe janë katër orientime kryesore se ku do të kontribuojë ky buxhet. E para është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, e dyta është zhvillimi i barabartë njerëzor, e treta është siguria dhe sundimi i ligjit dhe në fund qeverisja e mirë. Këto janë katër prioritetet që ky buxhet i trajton me themel.

Në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, ajo që është e rëndësishme të potencohet është që do të shpenzohen mbi pesëqind milionë euro në kategori të ndryshme të Ministrisë së Infrastrukturës, Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Ndërmarrësisë.

Në kuadër të trajtimit të këtij prioriteti të rëndësishëm, përfshihen investime thelbësore në infrastrukturën rrugore, hekurudhore, por edhe përmirësimin e komunikimit me rrjetet panevropiane të transportit.

Autostrada Prishtinë-Mitrovicë, autostrada Prishtinë-Podujevë, autostrada Prishtinë-Pejë, autostrada Prishtinë-Gjilan, lidhja Prizren-Tetovë, po edhe lidhjet Plavë-Deçan-Plavë dhe Pejë-Rozhajë parashihen të jenë prioritetet e rëndësishme në kuadër të investimeve infrastukture.

Të nderuar qytetarë,

Ajo që është po ashtu e rëndësishme është që buxheti prioritetizon energjinë e ripërtëritshme dhe investimet për t'i bërë bizneset tona më konkurruese dhe për ta përsheptuar transformimin digjital si formë e rritjes së konkurrueshmërisë së industrive të ndryshme në Kosovë.

Në lidhje me prioritetin e dytë është zhvillimi i barabartë njerëzor. Janë katër aspekte themelore që trajtohen këtu. E para është përmirësimi dhe zgjerimi i qasjes në arsim cilësor. Janë pesëdhjetë milionë euro investime të rëndësishme kapitale në arsimin parauniversitar, që kryesisht dedikohen për çerdhe të reja. Gjithashtu, projektbuxheti parasheh 25 milionë euro për punësim të garantuar për ata që kyçen për herë të parë në tregun e punës.

Ajo që është e rëndësishme është që në kuadër të prioritetëve për përmirësim të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, buxheti parasheh buxhet rekord për shëndetësinë, e tejkalon 370 milionë euro, që është diku rreth 160 milionë euro më shumë shpenzime në shëndetësi, krahasuar me

kohën kur ne nuk ishim në pushtet. Në kuadër të buxhetit për shëndetësi, për herë të parë përfshihen shpenzime mbi njëqind milionë euro për barna esenciale.

Të nderuar qytetarë,

Te transferet sociale, një nga skemat e reja sociale që është miratuar pas ardhjes së Qeverisë Kurti janë shtesat për fëmijë dhe lehonat dhe këtë vit e kapin vlerën prej 145 milionë euro.

Qëllimi i buxhetit po ashtu është që të promovojë një shoqëri më aktive dhe shpenzimet për Ministrinë e Kulturës dhe Sportin arrijnë vlerën prej njëqind milionë euro dhe kryesisht përqendrohen në ndërtimin dhe renovimin e dhjetë stadiumeve, dy pishinave, Teatrit Kombëtar dhe renovimin e Pallatit të Rinisë.

Qytetarë të nderuar,

Te prioriteti i tretë: përmirësimi i sigurisë dhe sundimit të ligjit, për herë të parë buxheti i Ministrisë së Drejtësisë dhe të gjitha institucioneve të pavarura që i shërbejnë sektori, arrijnë vlerën prej 120 milionë euro.

Ajo që është e rëndësishme, është që buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes kalon shifrën prej dyqind milionë euro, në ndërkohë që buxheti për Ministrinë e Punëve të Brendshme tejkalon shifrën prej 230 milionë euro. Më shumë se pesëqind milionë euro për një siguri dhe sundim të ligjit të përmirësuar.

Në fund është sa i përket qeverisjes së mirë si prioritet i katërt, është prioritetizimi i komunave. Komunitat këtë vit po ashtu përfitojnë dyzet milionë euro shtesë, duke e shpënë buxhetin për komuna në 788 milionë euro, që është rreth 250 milionë euro më i lartë krahasuar me vitin 2020.

Po ashtu, buxheti parasheh edhe rritje të rëndësishme mbi njëqind milionë euro shpenzime për paga dhe shtesa, që përfshin rritje të ndjeshme të pagave për rreth 82 mijë shërbyes të sektorit publik.

Qytetarë të nderuar,

Më lejoni të konkludoj këtë fjalim, duke theksuar zhvillimet e rëndësishme sa u përket të hyrave dhe shpenzimeve.

Është evidente që të hyrat në katër vitet e fundit janë rritur përrreth mbi 85 për qind, sikur edhe shpenzimet dhe është vazhdimi i zbatimit të këtij projektligji, sikurse edhe votimi i Qeverisë Kurti 3 nënkupton rritje dhe prioritetizim më të madh të këtyre sektorëve. Ju faleminderit!

KRYETARI: Tash, radha e Partisë Demokratike. Deputeti Mërgim Lushtaku e mban fjalën në emër të grupit.

MËRGIM LUSHTAKU: Të nderuar qytetarë që po na ndiqni!

Të nderuar kolegë,

Sot po paraqesim qëndrimin e Partisë Demokratike të Kosovës për Projektbuxhetin e vitit 2025. D.m.th. po mbajmë një ndër seancat më të rëndësishme të këtij viti, duke qenë se ligji i buxhetit ka rëndësinë pa dyshim të veçantë dhe ndikim të drejtpërdrejtë te qytetarët e vendit tonë.

Mirëpo, sot, para se të flas për planifikimin tuaj buxhetor për vitin 2025, dua t'u them qytetarëve të Kosovës, se juve që po ju kalojnë katër vjet prejse jeni në pushtet, e keni të planifikuar deri më sot mbi trembëdhjetë miliardë euro shpenzime, as edhe një projekt madhor i rëndësishëm nuk mbahet mend për këtë kohë sa ju qeverisni dhe së paku që qytetarët do të ndjeheshin krenarë.

Në fushatat tuaja zgjedhore kryeministri i tanishëm i Kosovës, duke u munduar që ta trashë zërin dhe ta gjerrë, ka premtuar që do ta forcojë ekonominë e vendit, do të ulë importin, do të rrisë eksportin, do ta heqë TVSH-në për produktet elementare. Ka premtuar që arka e shtetit të Kosovës, pra buxheti i shtetit nuk do të mbushte nëpër kufi, nëpër Dogana. Këtë me shkas e ka bërë për të manipuluar edhe diasporën.

Sido që të jetë, kjo humbje e madhe flet për manipulimin që e ka bërë për njerëzit dhe për të gjithë qytetarët e vendit. Po humbje më e madhe po i bëhet vetë Kosovës, po u bëhet bizneseve, po u bëhet financave, ekonomisë, diplomacisë e mbi të gjitha po i bëhet Kosovës.

Këta besimin e qytetarit e kanë marrë si privilegj, edhe po mundohen që në karriget e pushtetit të qëndrojnë përgjithmonë. Vetëbesimin e kanë të lartë, ndërsa dijen të ulët, prandaj edhe e kanë arrogancën e madhe.

Fjalimet populliste fatkeqësisht nuk po i ngopin qytetarët. Fatkeqësisht, nuk e parandalojnë migrimin. Por, fatmirësisht, po i del fytyra e vërtetë, po i del fytyra në pah. Thoshte “nuk jemi të varfër, por jemi të vjedhur”. Para një viti kishte thënë se nuk mund t'i rritim pagat se jemi të varfër, këtë vit iu kujtua që janë zgjedhjet dhe paraprakisht mundohet të rrisë pagat dhe në njëfarë forme, mundohet t'ia qesë për votë edhe çmimin e qytetarët t'i mashtrojë.

Por, e kanë parë edhe qytetarët se me një Qeveri të tillë, e cila është vetëm fjalëmadhe, është demagoge, nuk shkohet përpara. Secili qytetar duhet ta pyesë veten: a është më mirë, apo më vështirë të jetohet sot apo para katër-pesë vjetësh? Besoj se qytetarët e vendit vazhdimisht po e tregojnë se është më e vështirë të jetohet sot.

Sot ne flasim për një planifikim buxhetor, i cili nuk ndikon asgjë, nuk promovon asgjë, një planifikim prej të cilit ky shtet e ky popull nuk sheh kurrfarë hairi, sepse e kemi parë edhe që nga fillimi i kësaj Qeverie, çdo planifikim shihet që është i dobët, sepse në realizueshmëri të çdo

projekti ishte i keq dhe s'ka sjellë asnjë produkt, asnjë investim kapital që qytetarët e mbajnë mend.

Një planifikim i mirëfilltë i buxhetit do të kontribuonte në përmbushjen e nevojave të qytetarëve, gjë që nuk po ndodh me këtë Qeveri që ju e udhëhiqni. Për këtë arsye, buxheti mbetet instrument fundamental e financiar, me planifikim të duhur të cilin Qeveria e ka mundësinë më të madhe për të ndihmuar drejtpërdrejt popullin, ashtu edhe zhvillimin shtetëror në aspektin e përgjithshëm. Por, kjo gjë nuk po ndodh.

Buxheti i shtetit nuk është haigare. Nëse nuk hartohet siç duhet, i njëjti lëre që nuk ndihmon, por ka fuqinë edhe të përkeqësojë gjendjen deri në nivele ekstreme, ashtu siç pritet të ndodhë edhe me zbatimin e këtij buxheti.

Në fakt, tash e katër vjet ne e kemi një buxhet të mbijetesës, aspak zhvillimor. Pse e përmenda shifrën e rritjes së buxhetit, kjo ka ndodhur për shkak të krizave të mëdha ekonomike, inflacionit, që i ka rritur edhe të gjitha produktet, edhe ndërtime, edhe ushqimore dhe mbi zullumin e bizneseve, mbi zullumin e qytetarëve, kjo Qeveri krenohet se është rritur edhe buxheti dhe të hyrat e vendit.

Por, planifikimi i shpenzimeve është i keq, pa kurrfarë efekti në zhvillimin ekonomik dhe në përmirësimin e jetës së qytetarëve në përgjithësi.

Në këtë projektligj parashihet se do të ketë rritje të buxhetit të shtetit, por duhet theksuar se në çdo vit ka pasur rritje ekonomike, sidomos në këto dhjetë vjetët e fundit. Vetëm në kohën e pandemisë nuk ka pasur rritje, prandaj këto mashtrime qytetarët më nuk i besojnë.

Buxheti që nga viti i para luftës i përpunuar nga Qeveria e Kosovës është rritur nga viti në vit siç e theksova. Rritja e buxhetit te pjesa e të hyrave nuk paraqet ndonjë risi, e sidomos në këto rrethana të ngritjes së çmimeve që po e rëndon çdo ditë e më shumë koston e jetesës së qytetarëve.

Sa ka qenë në opozitë, ky grup politik në krye me Albinin ka zhurmuar dhe ka mashtruar shumë, se do të ndërrojë strukturën e të hyrave, se nuk do të vjelin të hyrat në Doganat, të TVSH-së. Asnjë përmirësim nuk është bërë dhe përkundrazi, këto katër vjet të inflacionit të rritur, bizneset kanë vazhduar të paguajnë TVSH-në në Dogana dhe nuk kanë paguar ato në brendi, siç ishte premtuar dhe në këtë aspekt Kosova ka paguar edhe një çmim te kufijtë, të cilët nuk ka arritur kjo Qeveri t'i përmirësojë.

Në Projektligjin për buxhet janë planifikuar të shpenzohen rreth 3,6 miliardë euro, në shpenzime rrjedhëse është planifikuar të shpenzohen rreth 72 për qind e buxhetit pa kurrfarë efekti në

zhvillimin ekonomik, kurse vetëm 25 për qind janë planifikuar për shpenzim kapital, ku përfitojnë qytetarët dhe duhet të zhvillohen bizneset. Mbi 1 miliard e 100 milionë janë planifikuar të shpërndahen si ndihma të shërbimeve sociale, pra mbi 32 për qind, ndërsa Ministria e Tregtisë, Ndërmarrësisë nuk ka buxhet as 25 milionë euro, pra as një për qind nuk tregon se do të ketë rritje të kërkesës, andaj çmimet mund të shkojnë edhe më lart, sepse nuk ka investim në rritje të aktivitetit prodhues, nuk ka subvencione të ndërmarrësisë, por qytetarëve u jepet lëmoshë, me qëllim për të blerë heshtjen momentale ose një grusht votash për 9 shkurt 2025.

Si përfundim, mbi 32 për qind e buxhetit do të investohet për të thelluar inflacionin dhe importin. 32 për qind e buxhetit do të shpenzohet për shkatërrimin e zinxhirit dhe biznesit prodhues, për më pak vende pune.

Investimet kapitale të planifikuara të buxhetit për vitin 2025 në nivelin qeveritar janë në vlerë 623 milionë euro. Prej tyre, vetëm 46 milionë euro është vlera e projekteve të reja. Pra, vetëm 7.38 për qind e vlerës së projekteve të reja që e parashihet Qeveria të shpenzimet kapitale. Investimet kapitale në klauzolën e investimeve janë 75 milionë euro, prej tyre vetëm 3.5 milionë euro projekte të reja. Pra, vetëm 4,6 për qind e mjeteve të parapara të klauzola e investimeve janë projekte të reja.

Qeveria nuk ka ndonjë vizion zhvillimor. Kjo më së miri shihet te planifikimi i investimeve kapitale. Kjo Qeveri ka dhënë shembullin më të keq në realizimin e investimeve kapitale nëpër vite, e këtë edhe në vitin e fundit, sidomos në nëntëmujorin e fundit që shihet se ka realizuar vetëm 36 për qind të investimeve kapitale. Për këto dhe shumë arsye të tjera që i theksova unë dhe besoj edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, përmes deputetëve, ne nuk do ta votojmë këtë Projektligj të buxhetit të Kosovës.

Pa dyshim, duhet të theksojmë që ky buxhet dhe ky planifikim i keq nuk do të zgjatë shumë. Do të zgjatë vetëm dy-tre muaj, sepse pas 9 shkurtit do të vijë një Qeveri e re, e cila është e përgjegjshme, e cila do të përbëhet me profesionistë të dëshmuar dhe sigurisht pas një pauze të madhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, ia shtoni një pjesë të kohës fjalës së z. Lushtaku.

MËRGIM LUSHTAKU: ...pas një pauze të madhe që ka ndodhur në zhvillimin ekonomik dhe në jetën e qytetarëve, në mirëqenien e qytetarëve, do të rikthehet dhe do të lindë dielli përsëri. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, në emër të Lidhjes Demokratike, fjalën në emër të grupit e mban deputeti Avdullah Hoti.

Urdhëro, z. Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Anëtarë të Qeverisë,

Kolegë deputetë,

Sot po e diskutojmë dokumentin më të rëndësishëm qeverisë. Besoj që këtë duhet ta shqyrtojmë sot si një dokument të përkohshëm, pasi që është e sigurt se Qeveria e ardhshme do ta ndryshojë. Kjo nuk është asgjë e jashtëzakonshme. Gjithmonë në fund të mandatit qeverisë kur përgatitet një buxhet që shkon përtej mandatit të Qeverisë aktuale është i natyrës së përkohshme.

Besoj që analiza e këtij dokumenti duhet të bëhet në kontekst të premtimeve gjatë mandatit katërvjeçar, jo vetëm si shifra për buxhetin e vitit 2025.

Cilat kanë qenë këto premtime? Kryeministri u zgjat këtu në foltore për elemente të caktuara të këtij buxheti, por nuk i përmendi fare premtimet e dhëna në dokumentin bazik të Qeverisë, në programin e Qeverisë, që lidhen për fusha specifike.

Unë po shkoj nëpër disa prej tyre. Në arsim, 160 çerdhe, shujta për nxënës, digjitalizim i shkollave, biblioteka për mësimdhënës, banim i përballueshëm për mësimdhënës, shpërblim i mësimdhënësve bazuar në performansë. Asnjëra nga këto nuk është realizuar gjatë këtij mandati.

Në shëndetësi, plot projekte të tjera, por sigurimet shëndetësore dhe sistemi informatik shëndetësor, asnjëra nga këto dy projekte madhore të shëndetësisë nuk është realizuar.

Mandej, banim social me kushte të përballueshme. Tek tash është miratuar një marrëveshje.

Te privatizimi, rishikimi i privatizimeve dhe mbyllja e AKP-së dhe kthimi i saj në Agjenci brenda Qeverisë së Kosovës. Fondi sovran dhe Banka zhvillimore, asnjëra nuk janë as në rrugë për t'u realizuar.

Në bujqësi, çmime referente, sigurim të prodhimit bujqësor, kredi bujqësore me kushte të volitshme, caktim i çmimit minimal për produkte bujqësore, nën të cilin shteti i blen produktet bujqësore për rezerva shtetërore. Këto kanë qenë premtimet.

Në infrastrukturë, plot projekte, por disa kryesore, aeroporti i Gjakovës, rruga për Plavë, rruga për Tetovë, hekurudha për Durrës, e plot projekte të tjera nëpër sektorë të tjerë.

Le ta analizojmë tani performansën buxhetore në kontekst të realizimit të këtyre premtiveve.

Të nderuar kolegë,

Buxheti gjatë këtij mandati qeverisës ka qenë 11,4 miliardë euro, buxheti katërvjeçar. Ndikimi në ekonomi dhe shoqëri është pothuajse zero, në kontekst të ndryshimit të strukturës ekonomike dhe shoqërore të vendit. Pse ka ndodhur kështu?

E para, për shkak se është përkeqësuar struktura e buxhetit. Kanë ndërruar raportet mes subvencioneve dhe investimeve kapitale. Gjithkush që ka njohur elementare të ekonomisë, e di që me subvencione mbahen familjet në nevojë, mbahen njerëzit që kanë nevojë, por nuk zhvillohet ekonomia. Janë rreth 520 milionë euro subvencione të paguara për entitetet publike gjatë këtij mandati, 520 milionë euro. 113 milionë euro subvencione për energjinë në veri, me të cilat jam i sigurt që do të ishte financuar plotësisht projekti i gazit për energji, edhe ato investime kapitale që janë planifikuar, nuk janë realizuar. Unë po jua jap shifrat nga buxheti për mandatin 2021-2024, për 2024 janë vetëm nëntë muaj, ta keni parasysh. Kanë qenë të planifikuara 3 miliardë euro për investime kapitale, janë realizuar vetëm 1,2 miliard euro. Janë 1,8 miliard euro të planifikuara për investime kapitale për 4 vjet që nuk kanë hyrë në ekonomi.

Normalisht, asnjë Qeveri nuk i realizon qind për qind investimet kapitale, por norma e realizimit të investimeve kapitale në të gjitha qeveritë e kaluara ka qenë 65-70 deri 75. Në këtë Qeveri është vetëm 40%. Atëherë, si mund të ketë ndikim ky buxhet në ekonomi kur realizimi i investimeve kapitale si përqindje e buxhetit ka rënë në 10% nga rreth 18% sa ka qenë më herët. Po ju jap shifra konkrete, mandej e merrni fjalën, zonja deputete.

Në Qeverinë Mustafa realizimi i investimeve kapitale si përqindje e buxhetit, realizim ka qenë 19%. Në Qeverinë Haradinja 18%. Gjatë kohës së pandemisë sa ne kemi qenë në Qeveri 9,7% për shkak të pandemisë. Në këtë Qeveri në katër vjet ka rënë në 10%.

Plus kësaj, edhe këto investime kapitale që janë bërë, nuk e dimë se ku kanë shkuar. Ose, i keni paguar investimet e ndryshme kapitale dyfish më shtrenjtë, sepse kontratat njëburimore kanë shkuar në 240-250 milionë euro. Dhe, për këtë ju garantoj që do të ketë auditim të plotë në të ardhmen.

Përtej kësaj, kemi shumë punë me këto investimet kapitale, keni paguar 165 milionë euro avance për investime kapitale, si asnjëherë më parë. Edhe këtu nëse i marrim parasysh pjesën e avanceve që shkon për fushën e sigurisë, prapë pjesa e avanceve për investime kapitale është tejet e lartë. E plot-plot probleme të tjera. Ta zëmë, vetëm 9% e investimeve kapitale janë investime të reja. Ose, mungesa e plotë e projekteve kapitale për kryeqytetin për katër vjet me radhë. Ose, bllokimi i projekteve kapitale për komunat për 2 vjet me radhë.

Ose, problemi i bllokimit të projekteve nga huamarrja edhe nga grantet në të kaluarën. Edhe problemi i kësaj kredisë që tani doli në shesh për blerjen e vaksinave. Pranohet granti 7 milionë euro, vjen në buxhet. Merret kredi për blerjen e vaksinave dhe detyrohet Qeveria ta kthejë grandin te Komisioni Evropian.

E tash, për shkak të kësaj performanse të dobët buxhetore, korniza makroekonomike është përkeqësuar. Norma e rritjes ekonomike gjatë këtij mandati qeverisës, mesatare për mandatin qeverisës, është më e ulët krahasuar me të gjitha qeveritë paraprake, hiç vitin e pandemisë dhe vitet e krizës ekonomike në të kaluarën.

Disa marrëveshje që i kemi pasur me Shqipërinë për të shfrytëzuar komplementaritetet ekonomike, fillimisht në turizëm, bujqësi dhe energjetikë, nuk janë shfrytëzuar. Në fakt, ka dy vjet që nuk mbajmë mbledhje të përbashkëta me Shqipërinë.

Nuk ka politika të reja fiskale. Rregullatorët ekonomikë që janë shumë të rëndësishëm për të mbikëqyrur mbarëvajtjen e ekonomisë, edhe të funksionimit të shoqërisë në tërësi ose mungojnë ose janë pasiv. Banka Qendrore e Kosovës ka mbetur me menaxhment emergjent për një kohë të caktuar. Trusti Pensional ka funksionuar një kohë me mungesë bordi, edhe ka pasur humbje.

OSHP-ja ka qenë e bllokuar dhe si rezultat qindra-miliona euro të investimeve kapitale kanë qenë të bllokuar. Komisioni i Ndihmës Shtetërore nuk është themeluar fare gjatë këtij mandati qeverisës. Bordet e ndërmarrjeve publike funksionojnë në vete. Unë besoj që duhet të dihet publikisht që është rritur edhe tarifa për ujitjen e tokave bujqësore, pa asnjë politikë shtetërore në këtë drejtim.

Mungesë totale e dialogut social edhe me sektorin privat. Odat ekonomike janë përjashtuar plotësisht nga përgatitja e legjislacionit që prek fushat ekonomike, ndërkaq, sindikatat luftohen në mënyrë aktive nga Qeveria. E si rezultat i kësaj është përkeqësuar ambienti i të bërit biznes në Kosovë.

Unë e kam tabelën këtu përpara që i vlerëson barrierat e të bërit biznes në vitin 2017 dhe në vitin 2023 të bërë nga organizata ndërkombëtare. Të gjitha barrierat pa përjashtim janë përkeqësuar në vitin 2023 krahasuar me vitin 2017. Dhe, barrierë e parë, tash ka dalë, mërgimi i punëtorëve. Ajo që po ndodh, të nderuar kolegë, është zbrazja e vendit.

Kosova është duke pësuar kolapsin demografik të cilin e kemi paralajmëruar tash e një kohë. Të gjitha pengesat e tjera, pa asnjë përjashtim, tek evazioni fiskal, te kostoja e financimit, te ngarkesat administrative, te doganat, te qasja në kredi, pa përjashtim, janë përkeqësuar në vitin 2023 krahasuar me vitin 2017.

Dhe si rezultat sot kemi në 2023-tën krahasuar më 2019 nja 4 900 biznese më pak, biznese aktive të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve.

Më tutje, unë mendoj që ka një keqinterpretim me qëllim dhe shtrembërim të shifrave. Deficiti tregtar në Kosovë gjatë këtij mandati qeverisës gjatë katër viteve është thelluar edhe me 2 miliardë euro shtesë. Nëse i shihni shifrat, për 10 vitet e fundit deri në vitin 2020, pra 2010-2020, deficiti tregtar është thelluar me 1 miliard, në katër vite është thelluar me 2 miliardë.

Çka tregon kjo? Tregon mungesën e aktivitetit ekonomik në vend. Tregon mungesën e prodhimit vendor. Rreziqet fiskale janë duke u rritur. Nuk ka asnjë indikator të përmirësuar të performansës së ndërmarrjeve publike.

E tash, kur i ke parasysh krejt këto, është e logjikshme, është e kuptueshme që standardi i jetës në Kosovë është përkeqësuar pavarësisht disa skemave që janë implementuar nga Qeveria gjatë këtij mandati.

Shihni barrën që është rënduar e buxhetit të familjeve. Inflacioni gjatë këtyre viteve mesatar ka qenë rreth 20%, por inflacioni i shportës bazike të konsumit ka shkuar mbi 50%. Si rezultat, është përkeqësuar, ka rënë vlera reale e të ardhurave të 85 mijë shërbyesve publikë, e asistencës sociale, e pensioneve dhe të gjitha përfitimeve të tjera që merren nga qytetarët nga ana e shtetit.

Është shtrenjtuar energjia rreth 117%. Është dyfishuar tatimi në pronë. Janë rritur çmimet e të gjitha shërbimeve publike që ofrohen nga ana e shtetit. Nëse doni ne mund të shkojmë performancën sipas sektorëve, të shohim si kanë performuar sektorë të caktuar. Merreni fushën e energjetikës. Asnjë projekt i ri energjetik. Asnjë shtim i kapacitetit të energjisë.

Në bujqësi, përveç subvencioneve, nuk është shtuar as për një ari të vetëm ujitja e tokave bujqësore. Por, është rritur pagesa për ujitje të tokave bujqësore nga 120 në 150 euro për hektar.

Në arsim nuk ka investime për modernizim të arsimit. Në arsim, ne duhet të shpenzojmë rreth 6% të produktit të brendshëm bruto. Në bazë të të dhënave zyrtare, ne shpenzojmë gjatë këtij mandati 3,87% mesatarisht.

Në shëndetësi, ku duhet të shpenzojmë prapë rreth 6% të produktit të brendshëm bruto, ne shpenzojmë rreth 2,3%, 2,4%, sa ka qenë mesatarja e shpenzimeve gjatë këtij mandati.

Në mbrojtje ne shpenzojmë, ne vitin 2023, po i marrë shifrat, realizimin e shpenzimeve në fushën e mbrojtjes janë 1,25% të produktit të brendshëm bruto, prej atij pragut që është së paku 2%.

Te pjesa tekstuale... (Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: A e doni pjesën tuaj si deputet? Vazhdoni!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Te pjesa tekstuale e projektligjit, në nenin 11, pavarësisht premtimeve për t'i rishikuar marrëveshjet paraprake, vazhdon mbledhja e të hyrave veçmas për katër komunat në veri.

Mandej janë ndarë 4 milionë euro edhe për Sanxhakun. Përveç për Luginën e Preshevës, edhe pse vendimi i qeverisë së kaluar ka qenë për themelim të Zyrës për Luginë të Preshevës dhe shpërndarje të buxhetit për të mbështetur Luginën e Preshevës nëpër ministrinë përkatëse të linjës, tash janë 4 milionë euro për mbështetje të Sanxhakut dhe të Luginës së Preshevës. Në një paku Sanxhaku dhe Lugina e Preshevës.

Te pjesa tekstuale ka edhe shkelje ligjore. Me nenin 33 ndryshohet Ligji i pagave. Kur është miratuar Ligji i pagave jemi dakorduar pavarësisht disa problemeve që kanë mbetur në atë ligj, është miratuar hierarkia e pagave në sektorin publik sipas shtyllave të sektorit publik, në arsim e në shëndetësi, e në mbrojtje dhe në fusha të tjera.

Mandej, ligji thotë përmes Ligjit të buxhetit caktohet vlera në euro e koeficientit të pagave. Tash, shtrembërohet komplet struktura e pagave, duke e ndërruar nivelin e koeficientit. Përveç kësaj, në nenin 35 mandej, ndryshohet Ligji i tatimit në pronë.

E dinë që kanë bërë një gabim me futjen e normës progresive të tatimit në pronë, e cila normë progresive e dyfishin dhe e trefishon ngarkesën e tatimit në pronë për qytetarë edhe për biznese.

Logjika elementare e përcaktimit të tatimit në pronë në atë ligj është gabim. E kemi bërë të qartë atëherë. Ne jemi të gatshëm që t'i mbështesim që të ndryshohet Ligji i tatimit në pronë, menjëherë që të hiqet ky nen dhe të kthehet ashtu siç ka qenë, duke qenë se e rrit këtë normë nga 0,17 deri në 0.50% të vlerës së pronës.

Nëse i shihni treguesit e performansës së buxhetit në pjesën tekstuale të ligjit, ju garantoj se do të çuditeni aty. Janë bërë pa vëmendjen elementare dhe mungesën elementare të të kuptuarit të këtyre problemeve.

Ta zëmë, te reduktimi i ngarkesë administrative. Nuk ka asnjë tregues se si do të arrihet kjo. Ose, thotë, te numri i organizatave ndërkombëtare, ku Kosova është anëtare. Do të rritet numri i organizatave ndërkombëtare, ku Kosova është anëtare.

Merret edhe indikator takomi i diplomacisë ekonomike. Indikator i performansës së buxhetit, sa takime mbahen. Ose, indikatorë të tjerë.

Të nderuar kolegë,

Për të përfunduar fjalën time. Ky buxhet ka së paku dy shkelje ligjore të cilat i përmenda; tek tatimi në pronë dhe te Ligji i pagave. Ky buxhet tregon abuzimin e Qeverisë me autorizimet e veta ligjore, në veçanti duke lënë zëra të specifikuar në buxhet, te subvencionet dhe te zërat e tjerë.

Por, e mira është që buxhet është tranzitor dhe besoj që të gjithë dakordohemi në këtë pjesë.

Qeveria e ardhshme do të ketë prioritet ndryshimin e këtij buxheti, fillimisht për të rritur pagat, pensionet dhe skemat sociale, për normën e inflacionin. Pastaj për të buxhetuar plotësisht projektet kapitale dhe për t'i shpërndarë ato nëpër sektorë dhe komuna sipas nevojës. Për të buxhetuar skemën e sigurimeve shëndetësore. Për të buxhetuar siç duhet arsimin edhe shëndetësinë.

Për të buxhetuar siç duhet Kontratën kolektive për të cilën është bërë kaos i plotë në buxhet. Për të buxhetuar siç duhet ushtrinë e Kosovës edhe plot institucione të pavarura që funksionojnë brenda shtetit të Kosovës. Për të kthyer, para së gjithash, ligjshmërinë në shfrytëzimin e buxhetit të Kosovës. Dhe, mbi të gjitha, për të mbledhur buxhet i cili kthehet pastaj te qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Tash është radha e Aleancës. Kryetari i grupit, Besnik Tahiri flet.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, në këtë seancë ndoshta e fundit për këtë vit, po e diskutojmë dokumentin, respektivisht letërnjoftimin e Qeverisë të kryeministrit Albin Kurti dhe të Kabinetit të tij.

Po ndoshta para se të hyjë e t'i them disa çështje që për mua janë më të rëndësishme, më të shkoqitura, se s'kemi mundësi të flasim gjatë. Do ta nisja fjalën time, duke iu referuar pak kryeministrit Kurti, i cili në fjalën e tij hyrëse filloi edhe po lavdërohet se si ky është buxheti i tij i katërt në mandatin e tij të katërt, mirëpo për vlerësimin e qytetarëve ky është buxheti më i dështuar... Mandati i tij i parë. A u kënaqët, a! A u gëzuat, a!

Po më vjen keq, të fundit e keni.

KRYETARI: Të mos na ndjellësh kështu, Besnik, se s'di a mundemi katër bash ashtu!

BESNIK TAHIRI: Valla ti s'mund ta çosh. Ajo që dua të them është që të lavdërohesh si kryeministër për mandatin 4-vjeçar të një buxheti 4-vjeçar, e krejt Kosova ta di që është buxheti dhe Qeveria më e dështuar, është paradoksi më i madh, dhe është një paradoks të cilin tash duhet unë ta argumentoj me qëndrimet dhe të dhënat që janë empirike dhe që janë në terren.

Po e nisim me pikën e parë.

Të nderuar deputetë,

Ne po flasim për këto katër vjet për një buxhet të planifikuar në shumë prej 12 miliardë eurosh. Në këto katër vjet me këto 12 miliardë euro, unë po ju pyes juve dhe po e pyes Kabinetin qeveritar: a ka ndonjë projekt që u nis e u përfundua përveç urës në Saradran?

Veç një projekt, le të më dalë kryeministri dhe të thotë, e kam nis një rrugë prej një pike në një pikë dhe ka përfunduar në këto katër vjet. A e kuptoni se magjistratja për Gjilan, për Gjakovë, për Pejë, për Mitrovicë, ende është duke punuar. Pra, për katër vjet, 12 miliardë, asnjë projekt i vetëm nuk është përfunduar.

Atëherë, për çka po flasim? Po flasim për një koncept, një logjikë dhe një qeverisje të dështuar.

Është tepër interesant ta dëgjosh kryeministrin se si ai po e fillon një rrugë Tetovë-Prizren, e cila ende nuk është ratifikuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe nuk është në gjendje të buxhetojë urat, asfaltin për rrugën për Gjakovë.

Nuk është në gjendje ta buxhetojë buxhetin e shpejtë për urën në Gjilan, e po hap edhe një rrugë tjetër, e rrugët që i ka hapur e i ka mbyllur i ka të papërfunduar dhe i ka në situatë të dështuar.

Kryeministri duhet të na tregojë, tash po flas te pika e dytë, ky buxhet 12 miliardësh për katër vjet, e në këtë kohë 3,6 miliardë, çka ka bërë për shtetin e Kosovës, dhe a e dinë këta kush e përbën shtetin e Kosovës. Shtetin e Kosovës e përbëjnë 80 mijë njerëz në administratë shtetërore që sot janë duke na dëgjuar, e të cilët për katër vjet kanë pritur që të rriten pagat me Ligjin për paga që ka ardhur katër herë në agjendë legislative dhe në fund e ka bërë 110 euro koeficientin, dhe tani po mundohet ta rrisë në formë të kundërligjshme, duke thënë se s'po më le opozita.

A e kuptoni? Duhet të dalë ministri i Financave, Hekuran Murati t'iu tregojë 80 mijë njerëzve që e përbëjnë shtetin e Kosovës, pse nuk po e rrit vlerën e koeficientit në këtë buxhet pasi që është rritur, po thotë që ka zhvillim ekonomik dhe është rritur 5% apo sa është rritur.

Duhet të dalë e të tregojë. Është llogaridhënie e thjeshtë. Ky ministër duhet të thotë nuk po i rris për këtë arsye. Absolutisht për këtë arsye duhet të thotë. Pra, shikoni ku është. Vitin e kaluar në dhjetor e kam pyetur i kam thënë, si rritet buxheti, si rritet vlera. Ka thënë, çdo vit në buxhetin e konsoliduar të Kosovës vlera e koeficientit rritet në bazë të zhvillimit ekonomik.

A bën të dalësh e të tregosh se pse nuk e keni rritur pagën. Po thoni, e kemi prekur listën hierarkike të koeficienteve, e cila rregullohet me Ligjin e pagave dhe ajo shtojcë mund të ndryshohet vetëm në qoftë se ndryshohet ligji, e ne s'po flasim për ndryshimin e ligjit. Ju lutem!

Çështja e tretë. Po u drejtohem prindërve tanë, nënave, baballarëve, gjyshes, gjyshërve që jeni pensionistë. A është ky njeri, ky kryeministër dhe a është ky Kabinet që vinte para katër viteve na pati lodhur duke thënë që do t'i rrisë pensionet, do të bëjë skema sociale, mw këto sociale do ta luftojë varfërinë. A bën ta di, sa ua ka rritur vëlla? 20 euro!

Për një ditë nuk mundet dikush që i ka 14 vjet e 11 muaj e 29 ditë nuk mund ta marrë pensionin për shkak se ministri i Financave po thotë, kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese nuk e transferon këtë.

A po kuptoni ku është kjo Qeveri me 12 miliardë euro, e me 3.6 miliardë. 20 euro pensionit.

Çështja tjetër, pika e katërt. Po flasim pak për ekonominë. Po, është rritur ekonomia. Është e vërtetë. 240 milionë euro ua keni dhënë dostave tuaj përmes tenderëve njëburimorë. Krejt çka mund të flasim për këtë vit, për këtë mandat, është që kjo Qeveria në histori të Kosovës me më së shumti tenderë njëburimorë.

Le të dalin e të na tregojnë ministrat, po dua bash t'i dëgjoj se si i kanë dhënë këta tenderë njëburimorë dhe pse i kanë ikur konkurrencës së hapjes publike.

Çështja tjetër, te politika e punësimit. Tash këtu e kam një vlerësim pak pozitiv. Kam pasur shumë besim në këtë projektin SuperPuna. Thënë të drejtën, edhe si koncept edhe si ide më ka pëlqyer dhe e kam thënë 2-3 herë edhe publikisht.

Kjo jo që është SuperPuna, por ky është super-dështimi i Qeverisë 4-vjeçare. SuperPuna ka ndodhur në diasporë. 70 mijë njerëz janë punësuar që e kanë lëshuar Kosovën, e përmes SuperPuna janë bërë disa veprime që i di, se kam informacione, por këto janë tepër, tepër, pra, punësimi është rritur, jo në Kosovë, është rritur në diasporë.

Një çështje tjetër, dhe po mundohem ta përfundoj, çështja e arsimit. Ajo që na dhemb më së shumti është që një Qeveri që ka pretenduar me programin krejt dhe drejt ta ketë platformën më të mirë, kurrikulën më të fuqishme, investimet më të mëdha në atë që quhet Brain Drain, ta kthejë trurin prej diaspore. A bën ta di vëlla, a bën të m'i numërosh 5 njerëz, s'po i lyp 50, ministrja e Arsimit apo dikush, 5 gra apo burra të cilët përmes një programi të Qeverisë janë kthyer në Kosovë e kanë dhënë një kontribut ose ua kanë bërë një program.

A e dini që ky shteti që ka më së paku investime buxhet për hulumtime shkencore në një Qeveri që krejt ia rrahin PHD. Ju lutem, a po kuptoni, katër vjet!

Do të thotë, çka kanë bërë për arsim? Le të dalë, veç le të dalë, hajde çerdhet që s'kanë mundur t'i bëjnë s'i kanë lënë komunat, ja po e lënë; a bën vëlla të më tregoni në shkolla, a bën të më tregoni, a s'keni mundur ta bëni një projekt për katër vjet t'i rregulloni banjot në secilën shkollë publike. WC-të t'i rregulloni. Atë keni mundur ta bëni.

Ju thoni, komunat. Po, ju t'ua jepni paratë komunave që të investojnë, e një vepër të mbetet në arsim.

Për çka do të mbahet mend kjo Qeveri me 12 miliardë euro në këtë mandat. E para, po, investime infrastrukturore, ura e Saradranit që e lidh katundin e Arben Gashit dhe Bekë Berishës, ajo është një.

E dyta, sa i përket rritjes së pagave. Na e kanë rritur edhe neve, se s'po flisni. Edhe deputetëve ua kanë rritur pagat, por më së shumti ia ka rritur kryeministrit. Merreni dhe këqyreni në përqindje rritjen e pagave të të emëruarve politikë, më së shumti i është rritur rroga kryeministrit, e rrogën më të madhe prej shtetit e ka Gani Jakupi, 7 500 euro. Kështu janë rritur pagat. Për të tjerat, në shërbim civil ju tregoj.

Çështja tjetër dhe e fundit. E kisha fjalën për Gani Jakupin, se na janë përzier emrat diçka.

Dhe, e fundit. Unë e kuptoj që sot është dita kur Qeveria këqyrë të lavdërohet e ne ta godasim. Por, kisha pasur dëshirë krejt këto që i thashë të dalë kryeministri apo ndonjë ministër të mund të m'i kundërshtojë, por me argumente, jo me përralla. Me argumente, të thonë, këta njerëz i kemi sjellë prej diasporë. Këta shirita i kemi prerë. Këtë punë e kemi bërë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Tash kryetari i Grupit Parlamentar Multietnik e ka fjalën. Enis Kervan flet.

ENIS KERVAN: Sayın Meclis Başkanı. Sayın Başbakan, bakanlar, değerli milletvekilleri, medya mensupları ve siz değerli vatandaşlarımız, hepinizi saygıyla selamlıyorum.

Kosova Cumhuriyeti 2025 yili Bütçesinin hazırlanmasında emeği geçenlere teşekkür ederek, konuşmama başlamak istiyorum.

Kosova'da yaşayan tüm toplulukların çıkarlarıyla birlikte, temsilcisi olduğumuz toplulukların yaşam şartlarının iyileştirilmesi ve ihtiyaçlarına cevap verebilmek adına yaptığımız girişimler

neticesinde, bütçe taslağında yer almasını talep ettiğimiz projelerin eklenmesi bizleri memnun etmiştir.

Bu çerçevede, Bölgesel Kalkınma Bakanımız ve KDTP Milletvekilleri olarak işbirliği ve çalışmalarımız neticesinde, Kültür Bakanımızın desteği ile Prizren'de çalışmaları başlatılan Türk Kültür Merkezi için bütçede 600 bin Avronun öngörülmesi vatandaşlarımıza bir hizmetimizin daha somut göstergesidir.

Multietnik parlamento grubu olarak, topluluk mensubu ihtiyaç sahibi vatandaşlara yönelik başlatılan ev yapımı ve tadilat desteği projesinin önümüzdeki yıl da devam etmesi için Yerel Yönetimler Bakanlığına 3 milyon Avro bütçenin eklenerek, devam etmesini, yine toplulukların altyapı çalışmaları için aynı bakanlığa 1 milyon bütçe eklenmesini de talep etmişizdir.

Mamuşamızda içme suyu ve Kültür Merkezi projeleri çalışmalarımızın başarılı bir şekilde neticelendirilerek, çalışmaların başlamasıyla birlikte, ek olarak Mamuşamızda daha iyi, daha kaliteli bir eğitim alınabilmesi için ek okul binasının ve spor sahasının ve yine Mamuşa'daki yavrularımız için anaokul binasının önümüzdeki senede tamamlanması için bütçenin ayrılması teleplerimiz arasındadır.

Yine Mamuşa Aile Sağlık merkezinde hem bölgeye, hem de Mamuşa vatandaşlarına daha iyi hizmet sunabilmek adına ek 10 personelin alınması için bütçenin sağlanması taleplerimiz arasındadır.

Ve tabii ki olmazsa olmaz Mamuşamıza sera ve diğer alanlarda bugüne kadar sağlamış olduğumuz gibi bundan sonra da Tarım Bakanlığı tarafından desteğin devamı, Kosova genelinde medyalarımıza, eğitimimize, gençlerimize ve kadınlarımıza yönelik bütçelerin artırılması yine bu bütçedeki taleplerimiz ve beklentilerimiz arasındadır.

Emeklilere ve maaşların düzenlenmesine yönelik hükümet tarafından yapılan çalışmaları selamlarken, emeklilik maaşlarının günümüz beklentileri karşılayacak düzeyde artmasını talep etmekteyiz.

Öğretmen, polis, asker, sağlık, itfaiye ve diğer alanlarda vatandaşlarımızın maaşlarının yine günümüzdeki ihtiyaçlar ve gelirlerini göz önünde bulundurarak artmasını da talep etmekteyiz.

Topluluk vatandaşlarına ait işletmelerin kapasitelerini arttırmaya yönelik destekler sunulması, orta, küçük ölçekli ve tüm topluluk iş insanlarımızın ekonomik kalkınmalarında daha fazla destek sunabilmek için de desteklerin artarak devam etmesini talep etmekteyiz.

Ayrıca 2025 yılı bütçesinde Topluluklar Bakanlığı ve Başbakanlık Topluluklar Ofisi aracılığıyla topluluk mensubu ve ihtiyaç sahibi vatandaşlarımıza maddi desteğin sağlanması, sağlık, kültürel ve sportif faaliyetlere destek sağlanarak, sivil toplum kuruluşlarımızın ulusal ve uluslararası

organizasyonlarda yer almasının sađlanmasi, ulkemizin ekonomik kalkinma hedeflerini desteklemek iwin bu butwewyle gerekenin yapilmasini talep etmekteyiz.

Son olarak eđitim sów konusu olunca, eksik olan ve var olan ders kitaplarinn tekrardan daha fazla ve kaliteli bir duzeve ulařtirilmasi iwin ek bir butwewenin ayrilmasi ve topluluk mensubu bařarılı ođrencilere ayrim yapmadan burs verilmesi konusunda butwew ayrilmasi taleplerimiz arasından yer almaktadır.

Bu taleplerimiz dođrultusunda, 2025 Butwew Tasarisinn ilk okunuřunu destekleyeceđimizi belirterek, sayđlarımı sunarım.

KRYETARI: Kewto ishin fjalwt e grupeve parlamentare. Tash po ia jap fjalwn ministrit tw Financave.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Tw nderuar deputetw,

E mora fjalwn per t'u pergjigjur ne disa prej wshetjeve qe ngriten deputetet parafolws ne emwr tw grupeve parlamentare. Fillimisht, sa i perket asaj qe tha deputeti Lushtaku ne lidhje me premtimet qe Qeveria Kurti ka pasur qe do te ulet importi, rritet eksporti, kurse taksat do te fillojne te mblidhen brenda me shumw qe mos te varemi aq shumw nga dogana dhe tha qe asnjera nga keto nuk eshte bere.

Po i shkojmw ne nga ne: pra, a eshte synim i Qeverise qe te ulet importi? Patjetwr qe po, ne per ketw dhe kemi bere mbeshitetjen per herw te pare te prodhuesve vendorw duke subvencionuar kreditw investuese. Gjithashtu, kemi marrw edhe shumw masa te tjera mbeshitetese permes ministrive te linjes, duke i mbeshitetur qoftw ne certifikim, pjesemarrje ne panaire, apo edhe rritje te kapaciteteve njerzore, por gjithsesi, i nderuar deputet Lushtaku, nuk mund te ulet importi ne neje ekonomi, te cilwn e kemi trasheguar ku te gjitha fabrikat qe kanw qene prodhuese ne ketw vend ju i keni shitur per skrap, normalisht qe merr kohw derisa te rindertoht kapaciteti prodhues ne menyre qe te ulet importi.

Pra, deri atehere ne do te vazhdojmw te punojmw, mirepo dicka qe eshte shkaterruar per 20 vjet, nuk mund te rikuperohet brenda neje mandati, merr pak me tepwr kohw.

Sa i perket eksportit, kur e kemi marrw qeverisjen, eksporti ka qene 474 milionw euro, sivjet pritet te shkoje ne 950 milionw euro. Pra, kemi dyfishim te eksportit ne ketw mandat, nuk e di se ku po e shihni ketw mosrritje.

Sa u perket taksave qe mblidhen ne dogane dhe taksave qe mblidhen brenda nga ATK-ja, me lejoni te theksoj qe kur e kemi marrw mandatin proporcioni i taksave qe jane mbledhur nga

Administrata Tatimore, pra në brendi të vendit, në raport me taksat që janë mbledhur në kufi ka qenë 44%. Pra, brenda janë mbledhur më pak se sa gjysma e taksave që ka mbledhur Dogana. Aktualisht, pra teksa po flasim ky proporcion ka shënuar rritje dhe është 57%.

Pra, ka rritje të theksuar mbi 13 pikë % që mblidhen brenda vendit më shumë se sa që janë mbledhur më herët, e ky trend do të vazhdojë, sepse në vazhdimësi kemi normën më të lartë të rritjes së të hyrave që mblidhen nga Administrata Tatimore në raport me hyrat që mblidhen në kufi.

Thatë gjithashtu që nuk ka pasur rritje të të hyrave, ose nuk është diçka e veçantë, sepse rritja e buxhetit dhe të hyrave ka ndodhur për çdo vit me radhë. Më lejoni të theksoj që në qeverisjen tonë për katër vjet me radhë, pra në vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024 ka rritje dyshifrore të të hyrave buxhetore. Në vitin 2021 rritja ka qenë 27% krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2022 rritja ka qenë 14% në krahasim me vitin paraprak, pra me qeverisjen tonë se krahasohemi edhe me vetveten. Në vitin 2023 rritja ka qenë 14% përsëri në krahasim me vitin paraprak dhe në vitin 2024 deri më tani rritja e të hyrave tatimore është 10% në krahasim me vitin paraprak. Pra, katër vjet radhazi, rritje dyshifrore e të hyrave buxhetore pa e prekur asnjë politikë fiskale.

Nëse e shikojmë gjithë dekadën kur keni qeverisur ju dhe partitë e tjera opozitare, janë vetëm dy raste, pra vetëm dy vjet kur rritja e të hyrave buxhetore ka shënuar nivel dyshifror. Ka qenë viti 2011, kur ju keni rritur akcizën në naftë dhe ka qenë viti 2016 kur qeveria pati rritur TVSH-në nga 16 në 18%. Pra, të vetmet raste kur ju keni pasur rritje dyshifrore të të hyrave buxhetore ka qenë kur keni rritur tatimet dhe barrën për qytetarët. Prandaj, edhe një herë po e theksoj, jemi qeveria e vetme ku katër vite radhazi kemi rritje dyshifrore të të hyrave tatimore.

Sa i përket asaj që tha deputeti Avdullah Hoti: I përmendi disa premtime që nuk janë përmbushur, ndër to e tha edhe Fondin sovran dhe Bankën Zhvillimore. Kjo ngjason me atë fabulën apo me tregimin për lotët e krokodilit që pasi e hanë prenë, ulet dhe qan, loton se i dhimbset. Të gjithë e dimë që Fondin sovran në Gjykatë Kushtetuese e ka dërguar pikërisht opozita. Pikërisht ju e keni dërguar dhe nuk është rrëzuar, po pret ende verdiktin, po nuk është rrëzuar. Po, prandaj shihe, domethënë këta e paragjykojnë edhe çka do të ndodhë, sepse aty është qëllimi. Domethënë, po e di, ke informata nga brenda, kjo është skandaloze. Nëse keni informata nga brenda Gjykatës Kushtetuese që do të rrëzohet Fondi Sovran, është skandal më vete.

Prandaj, edhe një herë ju vetë e keni dërguar, e keni bllokuar në Gjykatë Kushtetuese dhe tash del këtu thua “nuk e keni bo Fondin Sovran”. Jo, ne e kemi bërë ligjin, por ju po qitni zall në rrota, ju po pengoni, sikur të mos mjaftonin krizat globale, duhet të merremi edhe me ju.

Sa u përket çështjeve të tjera, pra u tha që buxheti ka qenë 11.4 miliardë, por ndikimi ka qenë 0, sepse janë rritur subvencionet. Tani vetëm një qeveri, një ministër apo ish-kryeministër që më

herët nuk ka bërë asgjë për shumë shtresa të qytetarëve, mund t'i quajë “ndikim zero” shtesat për fëmijë. Pra, subvencionet dhe transferet janë rritur, sepse janë 145 milionë euro shtesa për fëmijë dhe lehona. Subvencionet janë rritur sepse janë edhe 100 milionë euro shtesë për pensione. Subvencionet janë rritur, sepse është dyfishuar niveli i subvencioneve në bujqësi. Kjo është arsyeja pse janë rritur subvencionet dhe unë nuk ndaj mendimin me ju, i nderuar deputet, që ndikimi i këtyre masave është zero. Pyetni ato familje, ato gra që çdo muaj marrin shtesat e fëmijëve dhe e ndiejnë dorën e shtetit për herë të parë nga ky shtet, pyetni ato se a është ndikimi zero.

Sa u përket shpenzimeve kapitale, u tha një dezinformatë, sepse u bë krahasimi i buxhetit 2021 deri në fund të 2024, mirëpo te shpenzimi 2024 ende nuk ka përfunduar, prandaj është e padrejtë të bëhet një krahasim i tillë dhe është manipulim me numra dhe nuk përkon edhe me postin që mbani si deputet i Kuvendit të Republikës. Po, nëse veç duam të ndalemi tek investimet kapitale, sepse e kam parë që shpeshherë i merrni për bazë investimet e nivelit qendror, thuajse për të krahasuar se ja si ka performuar, ani pse në njërin anë ju ankoheni që komunat nuk po mbështeten, kurse kur i tregoni grafikonet tuaja, del që kur ju keni qenë në qeveri komunat kanë pasur 100 milionë euro buxhet për investime kapitale, kurse kur ne jemi në qeveri, komunat kanë dyfish më shumë, pra 200 milionë euro.

Por, të ndalemi te niveli qendror. A e shikojmë nëse veç po duam ta krahasojmë nivelin qendror me nivel qendror, a e shohim sa investime kapitale keni bërë ju nëse e përjashtojmë autostradën, se ka qenë vetëm një projekt i vetëm. Çfarë investimesh ka bërë qeveria në të kaluarën në shkollë, spitale, në mirëqenie, kulturë, infrastrukturë sportive? Asnjë vit përmbi 200 milionë euro s'ka kaluar. Domethënë, asnjë vit për mbi 200 milionë euro s'keni mundur t'i ekzekutoni në infrastrukturë, e cila u shërben mirëqenies së qytetarëve, po kjo është turp. Kurse sa i përket autostradës, vetë deputeti Hoti ka qenë në gjykatë kur ka dëshmuar për njërin prej kolegëve të tij që tregon qysh s'ka qenë as e buxhetuar. Domethënë ju e keni nisur projektin pa buxhet. U tha që ndoshta edhe investimet kapitale figurojnë më të larta se që janë, jo hajnia, jo kjo.

Po ju vetë e keni në raport financiar që 90 milionë euro dëme që i janë paguar kompanisë janë regjistruar si investime kapitale. Domethënë, 90 milionë euro, 53 dhe ai 43-shi tjetër, 96 a sa bëjnë, janë të regjistruara investime kapitale, kur e sheh s'ka investim, ajo është penallti. Domethënë, juve ju figuron që 96 milionë euro janë bërë investime, por në fakt investim s'ka, është penallti. Këso raporte kemi, edhe këso shifra krahasohen në krahasim me çfarë po bëjmë ne.

U përmend edhe çështja e avancave. U tha që është e rritur avanca si kurrë më parë, pikërisht pra, dhe jam munduar t'ia sqaroj deputetit Hoti disa herë edhe në komision dhe normalisht që për ta është befasi, sepse si qeveri të kaluara, meqenëse nuk kanë investuar asnjëherë në armatosje dhe mbrojtje, mund edhe të mos e dinë se si prokurohen sisteme të tilla. Sistemet e

mbrojtjes, e sigurisë, e sidomos edhe për kontratat e klasifikuara, pra paguhen 100% avancë dhe Ligji i buxhetit e lejon këtë gjë, sepse parashihet që porosia të bëhet në fillim në avancë dhe tek pastaj duhet të porositen pajisjet dhe tek pastaj vijnë pajisjet. Kjo është forma se si funksionon blerja e armatimit. Por, nëse nuk keni blerë asnjëherë në qeverisjet e kaluara, nuk mund t'ju fajësoj edhe nëse nuk e dini.

Sa i përket rritjes ekonomike. U tha që ka qenë e dobët, zhgënjyese e fjalë të tjera të ngjashme. Më lejoni të them që përkundër të gjitha sfidave globale, pra kemi pasur sfida që ndodhin ndoshta një herë në një shekull, siç është pandemia, e ndodhin një herë në 50 vjet, siç ka qenë kriza energjetike. Përkundër këtyre sfidave globale, ekonomia asnjëherë nuk ka rënë nën 4% rritje, asnjëherë. Për juve 4% ka qenë mesatarja në kushte normale, për neve në krizë është 4%. E për më tepër, pra e theksoi edhe kryeministri, ka qenë një rast ta zëmë në vitin 2012 kur vetëm një shtet i vetëm në Evropë, pra Greqia ka pasur krizë interne për shkak të borxhit publik, rritja në Kosovë ka rënë në 1,7%.

Dhe, edhe kjo rritje që e keni pasur gjatë qeverisjeve të kaluara, ka qenë rritje e paqëndrueshme, pse? Rritja 3-4% që e keni pasur ju ka ardhur kryesisht si rezultat i deficitit të lartë. Domethënë janë marrë para borxh, 1%, e 2%, 3% e GDP-së, janë shfrytëzuar edhe parat e Fondit të AKP-së, pra nga privatizimet që janë bërë, janë shfrytëzuar mjetet e AKP-së, në mënyrë që të mbahet “zjarri i kashtës”, siç thotë populli. Domethënë, aq sa ka para dhe deficit, është rritur ekonomia, por në momentin kur ndalet deficitin pra nuk hyn borxh për ta stimuluar ekonominë, rritja e paqëndrueshme bie.

Kurse tek ne ka ndodhur e kundërta, tek ne rritja ekonomike vjen si rezultat i investimeve të qëndrueshme dhe nëse e shihni për tre vjetët e kaluar deficitin është nën 1% të GJDP-së. Kurrë më i ulët s'ka qenë deficitin, kurse ekonomia përkundër krizave globale, asnjëherë nën 4% s'ka ra, e për juve 4% ka qenë mesatarja në kohë normale.

Sa u përket çështjeve të tjera, u përmend deficitin tregtar dhe thellimi i deficitit tregtar. Më lejoni ta theksoj edhe një herë, unë dje e postova një të dhënë, një grafikun...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ia shtoni edhe një minutë, nëse keni mundësi ta përmbyllni, zoti ministër. Ti në emër të replikave ma kërkove këtë, po ne jse, është fjalimi yt 10 minuta, i kalove, edhe nja 2 t'i shtova më herët, po s'e ke vërejtur.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Edhe sa i përket deficitit tregtar u tha që ka pasur thellim, në fakt, krejt çka po ndodh po regjistrohet...

KRYETARI: Po i ke edhe kundër-replikat, zoti ministër, kur të përgjigjen këta, i ke edhe kundër-replikat pastaj, kështu që e ke edhe një kohë tjetër.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Pra, krejt çfarë po ndodh është që po regjistrohet malli i importuar që dikur më parë hynte kontrabandë dhe çka është e çuditshme madje dhe befasuese është që pikërisht në kohën kur ju keni qenë ministër i Financave, i nderuar deputet, kur deputetja Bajrami ka qenë ministre e Tregtisë, kur Bedri Hamza ka qenë Guvernator në Bankë Qendrore, pikërisht në atë kohë figuron që ka qenë niveli më i lartë i kontrabandës.

Pra, pikërisht në atë kohë kur PDK-LDK kanë qenë bashkë në qeverisje, edhe me Listën serbe. Domethënë, niveli i kontrabandës pikërisht atëherë del më i larti.

KRYETARI: Tash replika kanë kërkuar, mirëpo dy deputetë me sa e kam mbajtur unë shënim janë përmendur me emër: Mërgim Lushtaku dhe Avdullah Hoti nëse duan të replikojnë.

MËRGIM LUSHTAKU: Ministër, është zhgënjyese me të vërtetë se si po mundoheni të arsyetoni prapë dështimet tuaja. Sigurisht që çdo ekspert i ekonomisë e sheh këtë debat dhe me siguri edhe po qesh me argumentet tuaja.

Edhe qeveritë e kaluara, në aspektin e rritjes ekonomike, thashë dhe e potencova dhe është fakt se ka pasur çdoherë rritje dyshifrore dhe nuk është arsyetim. Por, më e rëndësishme për çdo qytetar të vendit është si implementohet ky buxhet? Dhe, dëshminë më të madhe sigurisht që e kanë qytetarët, të cilët i vuajnë pasojat e mosimplementimit të buxhetit të Republikës së Kosovës. Kemi tre të rinj që kanë vdekur për shkak të mosimplementimit të projekteve të investimeve kapitale, mosinjalizimit të rrugëve që ka punime në Badovc. A është e turpshme? Sigurisht që duhet t'ju vijë marre juve, sepse po flisni për shifra të mëdha, ndërsa në realitet nuk ka implementim dhe në këtë aspekt kush po vuan, më së shumti po vuajnë qytetarët e vendit.

Është e vërtetë që ka import të madh dhe ne si Kuvend i Kosovës e mbikëqyrim edhe pjesën ekonomike dhe deri dje keni thënë dhe keni rrotulluar edhe kamionë, i keni hapur prapë dyert me Serbinë, ku tash shihen qartë sa shumë importojnë mallrat serbe. E keni bërë për pazare politike dhe ju po tregoni për parimet e juaja. Me të vërtetë është e turpshme se si keni bërë edhe kontrata njëburimore apo tenderë njëburimor. Jeni ulur në tavolinë ministrat me biznese...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Një minutë, urdhëro!

MËRGIM LUSHTAKU: Keni premtuar që do t'ju ulni çmimet për produktet elementare, janë rritur çmimet, i arsyetojmë te pjesa e inflacionit, por te pjesa ku duhej të ishte largimi i TVSH-së, se ishte premtim juaji, nuk i arsyeton as qytetari, sepse ishin premtime tuaja elektorale.

Ne jua afruam Ligjin për largimin e TVSH-së, ju ishit arrogantë, edhe pse ne e patëm të njëjtin premtim dhe të njëjtin propozim, ju nuk e realizuat dhe nuk e mbështetët vetëm pse ishte propozim yni, përkundër nevojës së qytetarëve që kishin nevojë të ulëshin çmimet e produkteve elementare.

KRYETARI: Ia japim tash replikën deputetit Avdullah Hoti me ministrin Murati. Urdhëroni, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Tash, të debatohet me këtë person është problematike, sepse ky debaton me fanatizëm, ky nuk është i interesuar për të vërtetat dhe për të argumentuar mbi faktet për të dalë tek e vërteta. Ky me fanatizëm i mbron pozicionet e veta, edhe vazhdon me atë propagandën e poshtër, të ulët. Po me sa fytyrë del në foltore...

KRYETARI: Kujdes me fjalorin, zoti Hoti!

AVDULLAH HOTI: ...dhe u thua njerëzve që është shkatërruar Kosova për 20 vjet? Me 13 mijë njerëz të vrarë, e me njerëz pa gjymtyrë, e me krejt shtëpitë e shkollat e shkatërruara, krejt rrugët e shkatërruara, ti thua është shkatërruar Kosova gjatë këtyre 20 vjetëve.

Kur i shtron këto në foltore të Kuvendit, nuk ka vend për debat aty mandej, sepse humbet argumenti ekonomik ose politik, s'ka më vend për debat atje. Hajde po i lëmë këto, po tregoju njerëzve, tregoju qytetarëve po si mundesh ti t'i quash krejt bizneset e Kosovës që kanë bërë kontrabandë në të kaluarën, se i paskan kontrabanduar 2 miliardë euro në të kaluarën, që s'qenkan regjistruar në të kaluarën, ti tash po i regjistron.

Po si mund t'ju thuash njerëzve kështu? Me sa moral njerëzor e politik flet kështu? Hajde lëri krejt këto, lëri anash këto, të paskemi penguar te Fondi Sovran, e kemi dërguar në Gjykatë Kushtetuese, po pse s'e bërë Bankën zhvillimore? Pse nuk e ndërtoat aeroportin në Gjakovë, të fluturojnë njerëzit prej Gjakove, po bëhen telashe në aeroportin e Prishtinës.

Pse s'po e ndërtoni atë urën 20-30 metra tek Badovci? Pse s'i keni ndërtuar 160 çerdhe? Kush ju ka ndalur? Pse s'i keni bërë këto punë?

KRYETARI: Edhe Besnik Tahiri ka kërkuar replikë me ministrin Murati.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Kështu, ministër, tri çështje janë që mendoj meritojnë argumentimin tim. E para, po t'i numëroj pak, se ju folët për rritjen e të hyrave në buxhet. Rritja e të hyrave në buxhet ka ardhur për shkak të rritjes së çmimeve. Çmimi i miellit në vitin 2021 ka qenë 0,51 centë, në vitin 2022 është bërë

0,66, 29%, sot është mbi 0,70. Buka ka qenë 0,36, është bërë 0,42, tash është 0,50, 25%. Qumështi 0,86, në 2022 ka qenë 0,94, tash është mbi 1 euro. A kuptoni? Rritja e çmimeve i ka rritur të hyrat që i shkojnë shtetit prej tatimit në vlerën e shtuar dhe janë rritur të hyrat.

Pra, duke u rritur çmimet, e ju keni ardhur me premtimin që i zvogëloni çmimet, janë rritur edhe të hyrat.

Çështja e dytë: Po pajtohem plotësisht me ministrin Murati, do të thotë kur thotë se kanë efekt shtesat në popull, edhe kanë efekt paratë, po qe unë po e marr një shembull personal për qytetarët e Kosovës. Unë i kam tre djem, vëllai im i ka tri vajza dhe i kam dy pensionistë, i kemi marrë 800 euro.

Më fal, unë me bashkëshorten time i kemi pagat të larta për standardin e jetesës, pse është dashur të na jepni neve? Ku është barazia e juaj? Pse është dashur familja ime t'i marrë 800 euro, në vend se t'ia jepni një rrobaqepësi, të bëjë një investim e të shtyjë edhe një punë? Pra, a kuptoni, nuk ka drejtësi, ju i keni shpërndarë me pullë, edhe tek njerëzit që janë me rroga të mira, edhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, edhe një minutë zotit Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Domethënë, i keni shpërndarë paratë jo me indikatorin e barazisë, por i keni shpërndarë për efekte elektorale dhe në fund sa i përket Ministrisë së FSK-së. Çfarë investimi keni bërë? Të dalësh në këtë foltore fillimisht duhet njohur vlerën e qeverive të kaluara, Qeverisë Haradinaj që e ka bërë ushtrinë, ju ushtrinë e keni lënë pa bukë, ky është rezultati juaj, ky është letërnjoftimi juaj.

KRYETARI: Ministri Murati i ka tri kundërreplika, ia japim fjalën. T'ua japim në të vërtetë vetëm atyre, të cilëve u përmendet emri, kështu s'kryhet kurrë sot. Nëse doni të reagoni veç pse po mendoni që u përmend pozicioni politik i partisë tuaj, ashtu secili atëherë... A ia ke përmendur emrin Hykmete Bajramit? S'po më kujtohet. Ia japim edhe asaj fjalën, ama të shkojmë vërtet vetëm me emra, se nuk kryhet kështu kurrë. Për fjalime, po i lëmë veç shefat e grupeve.

HYKMETE BAJRAMI: Kryetar!

Unë isha shumë e interesuar ta kem fjalën e plotë. Por, meqenëse nga ministri i Financave u thanë shumë të pavërteta, më duhet edhe të replikoj.

Për investimet kapitale, qysh ministër mund të thuash përjashton autostradën. Pse, a e ka marrë Qeveria me vete në shpi autostradën? Qysh ta përjashtojë autostradën? A nuk i bie për Shkup në

autostradë kur të shkosh? Kur të shkosh për Shqipëri, a nuk i bie nëpër autostradë? Si mund të thuash, përjashton autostradën dhe u mbeten investimet kapitale dyqind milionë. Po nuk është në rregull kjo. A e di ku ke ngelur? Te ura e Badocit 34 metra? Kush është duke të penguar? Cila Gjykatë Kushtetuese?

Edhe tjetra që je duke thënë, ka pasur me gjasa kontrabandë. Inflacionin e kësaj Qeverie ti po e shet si kontrabandë. Si luftë kundër kontrabandës. A e di që asnjëherë, as ju dhe as Kryeministri nuk e përmendët ngritjen e çmimeve. 22 për qind u janë rritur çmimet qytetarëve në mesatare. Po çmimi i bukës është rritur pesëdhjetë për qind. A e di që ke ardhur në pushtet duke premtuar që do të lirosh faturat e energjisë elektrike? Tarifën e ulët e ke rritur prej tre centë në shtatë centë, tarifën e lartë e ke rritur prej shtatë në katërbëdhjetë centë. Pastaj, çka ke bërë? Ke thënë, eja po i subvencionoj disave disa fatura.

Keni dështuar. Nuk mund sot të shesësh propagandë. Për secilin argument që e thua: qëndro 24 orë në foltore, me referenca, me dokumente tuaja të demantoj. Po, mjaft propagandës.

KRYETARI: Tash, ia japim katër replikat të cilat ndodhën më herët, katër kundër-replika ministri Murati.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

U thanë shumë çështje në këto kundër-replika, po mundohem që t'i përmbledh.

Deputeti Lushtaku tha që importi nga Serbia po rritet apo është rritur. Është e pavërtetë. Në kohën kur ju keni qenë në Qeveri bashkë me LDK-në, p.sh. po i marr këto pesë shtetet prej nga importuar Kosova. Vendi i parë ka qenë Serbia me 450 milionë euro. Vendi i dytë ka qenë Gjermania me 378 milionë euro. Vendi i tretë Turqia me 292 milionë, Kina me 275 dhe Italia me 194 milionë euro. Kjo është top-pesëshja kur ju keni qeverisur. A e shohim top-pesëshen e shteteve prej nga ka importuar Kosova vitin e kaluar, se sivjet ende nuk ka përfunduar. Vitin e kaluar, top-një, po pritni tash, mos t'ju vijë inat. Pse po ju vjen inat? Top-një është Turqia.

KRYETARI: Qetësi, ju lutem!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Në vendin e dytë është Gjermania, në vendin e tretë është Kina, e katërta Greqia, e pesta Shqipëri. As në top-pesëshe nuk e keni Serbinë. Kërkoj ndjesë. Prej vendit të parë, as në top-pesëshe nuk është.

Sa i përket asaj që tha deputeti Hoti, vetëm u mundua që me disa argumente të rrejshme, pra të vendosë fjalë të cilat nuk i thashë. Unë as nuk thashë është shkatërruar Kosova, thashë i keni shkatërruar fabrikat duke i privatizuar, janë shitur për skrap. As nuk thashë që kanë bërë

kontrabandë të gjitha bizneset. Përkundrazi, dëmi u është bërë të gjitha bizneseve, sepse disa biznese të lidhura me juve kanë bërë kontrabandë. Ky është problemi.

KRYETARI: Qetësi, ju lutem!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Çështja tjetër. Deputeti Tahiri tha që të hyrat janë rritur sepse ka pasur inflacion. Inflacioni siç u konfirmua edhe nga deputetja Bajrami ka qenë 22 për qind. Të hyrat janë rritur qind për qind. Janë dyfishuar, i nderuar deputet, pesëfish më shumë. Kështu që, po një pjesë mund të jetë prej inflacionit, po tetëdhjetë për qind të tjera janë rritur se është luftuar kontrabanda dhe nuk po vidhet më buxheti.

Te shtesat, mua më vjen mirë që politikat tona qeveritare pra ndihmojnë edhe deputetët. Nëse mendoni që s'keni nevojë, mjafton që të mos i merrni. Pra, është në vullnetin tuaj. Me zor askujt nuk ia japim. Mirëpo, për hir të menaxhimit më të lehtë, e kemi të qasshme dhe universale për të gjithë.

Kurse, te deputetja Bajrami, pajtohem që argumenti që të largohen pjesë të investimeve kapitale është absurd dhe s'ka logjikë, por është logjika juaj që u mundova ta replikoj. D.m.th. unë thjesht po e marr logjikën tuaj absurde për të treguar sa absurde është dhe si do të dukej nëse fillojmë ta heqim. Pse? A shkollat që investon komuna e që i çon fëmijët aty, nuk qenka investim kapital? Me logjikën e njëjtë tash.

D.m.th. investimi në një rrugë që e bën komuna, a nuk është investim kapital që po i heq investimet komunale. E shihni sa absurde është kjo logjikë? Prandaj, e përdora dhe ratë në kurth, çka të bëj?

Kurse, sa i përket çmimeve të ushqimeve, çmimi i grurit është 20 cent/kg, edhe në bursa botërore merreni shikojeni 'wheat price' në bursat ndërkombëtare është sikurse para pandemisë, niveli i njëjtë. Çmimi i vajit, ASK tash e ka qitur, është 1,40 euro/l.

Pra, çmimet bazë për bukën ta zëmë kanë rënë. Produktet, lëndë e parë për bukën kanë rënë çmimet. Po çmimi i bukës nuk po bie, e as çmimi i miellit jo. A thua pse? Se Ligjin për çmimet tavan e keni bllokuar në Gjykatë Kushtetuese. Qytetarët vazhdojnë të paguajnë më shtrenjtë bukën për shkak tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: U kthehem deputetëve tash. Kundër-replika ishin këto.

Replikë, dy minuta. Edhe pastaj Hekurani një minutë, pastaj kalojmë te deputetët nëse ka mundësi.

Replikë, Arben Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

E dëgjova me kureshtje ministrin, edhe më bëri përshtypje, tha: çmimi i grurit në bursë sot është i njëjtë sikur para pandemisë. Ministër, qytetarët e Kosovës nuk e blejnë grurin në bursë, as vajin, e blejnë në market, e në market është dyfishuar. Miellin e blejnë në market, nuk e blejnë në bursë. Edhe mielli është dyfishuar.

Nuk është problemi aty hiç o zotëri, po politikat tuaja, veprimet tuaja, masat tuaja, e kanë dyfishuar çmimin. Ky është problemi që e ke ti. Ti pretendon se në ekonominë e tregut mund të ndërhysh në çmime të tregut me vendime qeveritare. S'mund ta bësh, ta ka treguar Gjykata Kushtetuese se nuk mund ta bësh. Është antikushtetuese, është kundër parimeve se si është ndërtuar ekonomia e Kosovës. ekonomia e Kosovës, ta ka argumentuar Gjykata Kushtetuese, veç mund ta marrësh e ta lexosh. Të kemi thënë edhe këtu se s'mund ta bësh.

Ti mund të ndërhysh në çmime, a e di kur mund të ndërhysh, ta kemi thënë, ta kemi propozuar këtu, ke refuzuar. Ndërhysh në çmim edhe në treg, kur e shpall gjendjen e jashtëzakonshme, ose gjendjen emergjente, atëherë mund të ndërhysh, atëherë mund të kufizosh edhe të drejtat dhe liritë e njeriut, atëherë mund të kufizosh edhe të drejtat e biznesit, atëherë mund t'ua marrësh edhe biznesin krejt. Po jo ti me vendime qeveritare të thuash, hajde tash t'ju tregoj sa ta shisni miellin që e ke blerë. Ti mund të ndërhysh aty duke e liberalizuar tregun, ti mund të ndërhysh aty duke i ulur taksat, ti mund të ndërhysh aty në forma të tjera, po jo në mënyrë arbitrare.

Ta ka treguar Gjykata Kushtetuese në mënyrë eksplicite se nuk mund ta bësh atë punë. Të kemi thënë këtu se s'mund ta bësh. Për ta bërë atë ndërhyrje, është dashur të shpallet ose gjendje emergjente, ose gjendje të jashtëzakonshme, edhe mund ta bësh. Po doje ti t'i caktoje çmimet.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti Murati, a doni një minutë? Urdhëro një minutë, shpejt.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit!

Tash unë qëllimisht e përmenda çmimin e bursës, pra që të kemi një pikurë edhe më të gjerë çka po ndodh edhe përtej Kosovës. Por, nëse doni ta dini se sa hyn çmimi i grurit në kufi edhe në Kosovë, e kemi këtë informatë, është 21 cent/kg.

Por, problemi nuk është te gruri, se çmimi i grurit ka rënë. Problemi është te marrëveshjet dhe te monopolet që kompani të caktuara e kanë e që ju keni dashur t'ua ruani. Këtu është problemi. D.m.th. këtu është problemi. Ligji për çmimet tavan nuk ka asgjë kundërkushtetuese. E kemi masën ta zëmë për vendosjen e çmimit tavan te nafta, funksionon. Sa herë që ka çrregullime, funksionon.

Nëse ju keni qenë aq ihtarë të tregut, pra të ekonomisë së tregut të lirë, pse vëlla nuk e çonit në Gjykatë Kushtetuese homologimin që ka qenë monopol. Pse nuk çonit në Gjykatë Kushtetuese homologimin? Për mbi dhjetë vjet ka qenë, kurrë s'e keni çuar, po lëreni pushë Zotin!

KRYETARI: Fatmire Kollçakut ia japim fjalën dhe vazhdojmë rendi i deputetëve sipas grupeve parlamentare.

FATMIRE KOLLÇAKU: Ju falënderoj i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Të dashur qytetarë,

Unë vetëm një fjali po e them, atë çfarë tha Kryeministri, asnjëherë deri më tani, në të gjitha këto legjislatura dhe Qeveri që i mbaj mend, nuk ka pasur kthim më të madh të të hyrave të qytetarët. Pra, nuk ka pasur asnjë shpërndarje të tillë të buxhetit në mënyrë të barabartë dhe më së shumti te ata që kanë nevojë. Këtë do ta them edhe përmes buxhetit për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

Vetëm ta cek që shëndeti publik është përkufizuar si shkenca dhe arti i parandalimit të sëmundjes, zgjatja e përmirësimi i cilësisë së jetës përmes përpjekjeve të organizuara dhe zgjedhjeve të informuara të shoqërisë organizative publike dhe private, komunitetit dhe individëve. Analizimi i përcaktuesve të shëndetit të një popullate dhe kërcënimet me të cilat përballet është baza e shëndetit publik. Pra, për ne, shëndeti në të gjitha politikat si dhe me pacientin në qendër të vëmendjes dhe sot mbulim shëndetësor universal që është pra qëllimi afatgjatë i programit tonë qeverisës dhe një sistem i integruar përkundër atij që e kemi trashëguar, komplet të fragmentuar.

Pra, qysh e filluam ne? Pra, dua ta cek edhe njëherë se si e gjetëm ne sektorin e shëndetësisë, se për sistem as nuk bëhet fjalë. Pikërisht e gjetëm ashtu aq të fragmentuar dhe në kohën kur u ballafaqua jo vetëm Kosova, por edhe e tërë bota me një pandemi, deri atëherë e pa mbajtur mend një shekull përpara ishte ballafaquar bota me diçka të tillë, edhe ne ia dolëm.

Dua të them edhe një herë, Kosova vërtet është storie e suksesit sa i përket menaxhimit të pandemisë COVID-19. Qysh vazhduan? Vazhduam me rritjen e përfshirjes, qasjes universale dhe të përballueshme në shërbimet shëndetësore, me fuqizim të sistemit publik shëndetësor, me përmirësim të menaxhimit dhe efikasitetit në sektorin e shëndetësisë dhe rritjen e financimit dhe ndërtimin e kapaciteteve njerëzore.

Pra, të gjitha këto hallka janë të patejkalueshme në krijimin e një sistemi të mirëfilltë shëndetësor. Çka ndodhi me buxhet? I lirisht mund të themi, nga buxheti që ne e gjetëm kur erdhëm në qeverisje, sot kemi dyfishim të buxhetit për shëndetësi. Nga 198 milionë euro që i gjetëm, sot buxheti për shëndetësi është 361 milionë euro. Çfarë është buxheti për SHSKUK-në? P.sh. nëse e krahasojmë veç me vitin 2022, ka një rritje enorme. Sot komplet SHSKUK-ja ka një buxhet prej 190 milionë.

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Kjo po tregohet që secili qytetar e vëren çfarë transformimi ka ndodhur në klinikat në Qendrën Klinike Universitare, por mos të them edhe në spitalet regjionale që vazhdon edhe me grantin për komunat që është rritur dukshëm dhe do të jetë për vitin 2025, 82 milionë euro.

Sa i përket Ministrisë së Shëndetësisë vetë, po ashtu do ta ketë një grant prej 82 milionë euro, që ka të bëjë me shpenzimet dhe kategoritë që u dedikohen politikave dhe programeve qendrore të Ministrisë së Shëndetësisë.

Nëse flasim për atë që ka qenë shqetësimi më i madh i qytetarëve, pra Ligji për sigurim shëndetësor publik, përkundër faktit që ne e kemi tash e sa vite një ligj të pazbatueshëm, nuk ka pasur vullnet nga qeveritë paraprake, sepse nuk e kanë krijuar fondin. Pikërisht me Ligjin e ri për sigurim shëndetësor që është votuar në Komisionin parlamentar për Shëndetësi dhe pritet ta marrë votën edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ligji i ri do të krijojë fondin që është parakusht për fillimin e mirëfilltë, si dhe po ndodh një digjitalizim, përkundër atij pilot-projekti të dështuar dhe gjashtë milionë të avulluar, e për të cilat ende është duke u zhvilluar procedura në Prokurori, tani me ndarjen prej shtatë milionë euro për digjitalizim në vitin 2024 dhe deri në dhjetë milionë për këto dy vjet, përfshirë vitin 2025, do të kemi dukshëm lëvizje në digjitalizim dhe krijimin e parakushteve për krijimin e një SISH të integruar, që përfshin prej nivelit parësor deri te SHSKUK-ja.

Çfarë duhet thënë tjetër? Po e nënvizoj atë që është me rëndësi, sepse është folur shumë për punëtorët shëndetësorë. Duhet nënvizuar rritjen e pagave në sektorin publik shëndetësor, për mbi 13 mijë punëtorë shëndetësorë paga bazë e mjekëve e trashëguar prej 659 euro, pra një sektor shëndetësor i nënfinancuar, i nënvlerësuar dikur, sot me një pagë prej 1430 euro, në vitin 2025, pa i përfshirë kujdestaritë dhe shtesat për vitet e punës, si dhe shtesën që e marrin të gjithë mjekët që përcaktohen të punojnë vetëm në sektor publik. Mos të flasim, besoj që e bind çdokënd se a është shëndetësia prioritet për këtë Qeveri.

Po ashtu, kemi një rritje të dukshme edhe për infermierët, të cilët i gjetëm me 425 euro pagë, e kjo shkoi në 715 euro. Rritje do të ketë në vazhdimësi. Kjo po tregon jo vetëm që do të ketë në dy faza vitin e ardhshëm, por rritja do të vazhdojë, sepse kemi rritje të zhvillimit ekonomik. Pa një punëtor të shëndetshëm, nuk ka zhvillim ekonomik. Po e ritheksoj edhe një herë, një Qeveri e

mençur siç është kjo, e kupton që vetëm me punëtorë të shëndetshëm ka zhvillim ekonomik, prandaj duhet pasur kujdes, se është qasje multisektorale kur flasim për shëndetin dhe nuk i bëjmë barra vetëm Ministrisë së Shëndetësisë.

Te barnat esenciale, a duhet thënë diçka më shumë sesa që kemi nga njëzet milionë të trashëguara për barnat esenciale, sot mbi 65 milionë euro ndahen për barnat esenciale, si dhe 15 milionë për sëmundjet e rralla, e për sëmundjet e rënda, siç është ajo që njihet si sëmundja e shekullit, që është kanceri. Mandej, do t'i kthehem pak çfarë ka ndodhur në klinikat tona.

Unë do të them vetëm diçka çka kemi bërë më gjerë, që është nga viti 2021, 155 mijë vizita në shtëpi për gratë shtatzëna dhe fëmijët deri 3-vjeç, që ende s'po i marrin përmes Qendrës për Mjekësi Familjare në Mamushë dhe Ferizaj, qendrat në Drenas, Shtime e Istog janë në ndërtim e sipër. Vendimi për mbulim të plotë të shpenzimeve nga trajtimi mjekësor i invalidëve të luftës, për qëllime të ndërtimit apo mirëmbajtjes e vendosjes së protezave jashtë institucioneve shëndetësore dhe të gjitha shërbimet nëse nuk ofrohen në sistem publik.

Zgjerimi i shërbimeve shëndetësore, gjithë kjo çfarë ka ndodhur në klinikat tona dhe spitale tregon sipas shërbimit statistikor, Agjencisë për Statistika nënvizon rritje të dukshme të shërbimeve në sektorin publik, sidomos sa i përket shërbimeve radiologjike, kardiologjike, kardiokirurgjike, laboratorike, stomatologjike dhe në raport me periudhat paraprake. Shërbimet në qendrën stomatologjike janë rritur mbi 60 mijë, pra 16,1 për qind. Numri i CT-ve për dyzet për qind, numri i rezonancave magnetike për 77 për qind, numri angiografive është rritur mbi 77 për qind, numri i shërbimeve laboratorike vetëm në SHSKUK është rritur për gati 31,5 për qind, koronografite janë rritur mbi shtatëqind, ose 21,5 për qind, stentimet janë rritur mbi 4 400 raste, shtesë pra 272 për qind, mos harroni, një shërbim aq i përfolur, dikur me afera sa kryhet, tash me një përparësi të madhe në sektorin publik. 'Pacemakers' të cilat dikur ishin vetëm 142 raste, kemi një ngritje të dukshme deri në treqind raste që kryhen edhe në valvula etj.

Të flas vetëm për disa prej investimeve të klinikave të QKUK-së. Më falni që po flas me një tempo kaq të shpejtë, sepse vërtet pa dashur të them që çdo gjë është kryer, se ne jemi të stërkënaqur, por është e pamohueshme që shumë punë është bërë dhe duhet prezantuar para publikut, gjë që për të cilën besoj shumë prej tyre edhe e dinë.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme janë investimet në klinikat e QKUK-së: Klinika e Onkologjisë, e Gjinekologjisë, Urologjisë, Kardiokirurgjisë dhe Klinika Emergjente që besoj për çdo shtet duhet të jetë prioritet mbi prioritete.

Gjithnjë kur i kemi dëgjuar ambulancat që ikin për QKUK, kemi thënë a thua në çfarë shërbimi do të hasin. Tani, besoni është shumë më e lehtë për një pacient kur i drejtohet nivelit terciar,

sepse ne fillimisht të gjitha rastet që mund të zgjidhen, duhet të zgjidhen në nivel të kujdesit parësor dhe atij dytësor.

Me investime të rëndësishme në aparatura moderne, të gjitha spitalet, vlen të përmendet rezonanca magnetike, që ishin vetëm dy kur erdhëm ne, dhe sot rezonanca magnetike është në Spitalin Regjional të Pejës, në Prizren, në Klinikën e Pediatriisë dhe kështu do të vazhdojmë me të gjitha komunat, qendrat më të mëdha, qendrat rajonale.

Ka përfunduar riparimi i objektit të Pediatriisë në Mitrovicë. Ka përfunduar riparimi i objektit të Institutit Special në Shtime, renovimi i përgjithshëm i objektit ekzistues të Transfuzionit të Gjakut, njësia regjionale Gjilan, adaptimi i infrastrukturës për fertilizim të asistuar mjekësor në vlerë prej 1.5 milionë euro investime. Janë bërë investime edhe në institutet paraklinike dhe në morg. Kemi investuar në aparatura moderne në të gjitha spitalet e QKUK-së.

Nuk e di sa do të kem kohë, duhet të përmend një udhëzim më të ri administrativ, krahas ligjeve për çmimet tavan të barnave që së shpejti me listën e çmimores do të jetë unik në gjithë Kosovën dhe do të kursejë shumë nga xhepi i qytetarëve. Nga ligjet e tjera që i përmenda, Ligji për sigurim shëndetësor, Ligji për shëndet mendor, për duhan, për Inspektorat.

KRYETARI: Nuk kryhen kurrë këto doktoreshë. Edhe ministrave lejojuni pak kohë, se s' di çka do të prezantojnë pastaj.

Kush prej PDK-së? Ferat Shala, urdhëro!

FERAT SHALA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Media,

Qytetarë të nderuar,

Sot shpresova që kabineti qeveritar do të elaborojë në detaje projektbuxhetin, por paska ardhur si gjithmonë në praktikë të akuzojë dhe të lavdërojë punën e vet. Ç'është e vërteta, gjithçka është, por buxhet zhvillimor nuk është, sepse vetë kategoria e parë e strukturës buxhetore, kur 44,9 për qind është në subvencione, d.m.th. këtu nuk ka zhvillim, këtu ka ndihma sociale, këtu ka mbijetesë ekonomike jo, por sociale, për kategoritë të cilat realisht edhe i meritojnë, por fatkeqësisht do të duhej ta meritonin zhvillimin ekonomik dhe investimet kapitale, vendet e reja të punës, mosikjen e qytetarëve, mosikjen e profesionistëve dhe ky buxhet vetëm se do të vazhdojë largimin e të rinjve.

Por, pa e elaboruar shumë buxhetin, po i kthehem fjalëve të fundit të kabinetit qeveritar që i dëgjova për çmimin e grurit dhe për pagën minimale. U lavdëruan për pagën minimale të cilën kanë arritur ta miratojnë me strukturat më kriminale të mundshme dhe terroriste, me Radojçiqin, dhe i kanë lënë jashtë kategoritë e dala nga lufta, pikërisht ky ministër dhe ky kabinet qeveritar. Tashmë kjo është e njohur publikisht. Po e dëgjova edhe çmimin e bursës së grurit.

Ju lutem, Kryeministër, na trego, nëse është kështu siç tha ministri, se çmimi i grurit në bursë është që nga pandemia deri më sot i pandryshuar 21 centë, si ka mundësi që ju gjatë mandatit tuaj, në 2022, gjatë pandemisë e keni blerë çmimin e grurit 48 centë minimalisht, me siglën sekret shtetëror? Pra, ju lutem, tregomë a është 21 cent, a është 48 centë çmimi i grurit? Nëse po është bursa kështu, pse atëherë e bletë 48 centë çmimin e grurit e i cili kurrë nuk erdhi në Kosovë, as në sasi as në cilësi, e nuk e dimë as sot si ka përfunduar kjo aferë. Besoj, Kryeministër, duhet të na jepni sqarim, së paku për çmimin, se për sasinë e cilësinë, tash dihet, organet e tjera po merren me këtë punë.

Pra, cili është çmimi i grurit që e keni blerë atëherë dhe sot po blini? Apo Kryeministër, pse nuk erdhën rezervat as në 2023, as në 2024 nuk e ke blerë asnjë kilogram grurë? I ke paraparë në buxhet dhe je lavdëruar tash një vit kur e ke sjellë buxhetin, që e ke dyfishuar buxhetin e rezervave shtetërore? Pse nuk e ke blerë asnjë kilogram, pse nuk të ka ardhur vaji Kryeministër, pse nuk të ka ardhur sheqeri Kryeministër? Pse Kryeministër, rezerva shtetërore nuk të kanë ardhur asnjë dhe sot nuk na raportove. Dhe nuk e përmende a e ke në linjë buxhetore për vitin 2025.

Kryeministër, fole për energjinë. Nuk do të doja të të dëgjoj duke folur ju për energjinë, sepse ka harxhuar mbi gjysmë miliard euro mjete minimalisht për subvencionim dhe mbështetje të strukturave më joprofesionale dhe keq ta them, deri te strukturat korruptive që të rrethojnë. Kanë dalë dhe vazhdojnë të dalin rrjedhje parash për energji kryeministër, në dy linja. Një e ke ngritur çmimin 120 për qind, dy je kthyer përsëri në buxhet të konsoliduar të shtetit i ke subvencionuar.

Kryeministër, ky nuk është zhvillim ekonomik. Asnjë megavat orë energji elektrike për katër vite nuk e ke rritur kapacitetin prodhues. Ke harxhuar afër miliardin nëse i fusim edhe ato të tjerat që i ke paguar për veriun e pjesën tjetër. Kryeministër, këto janë shifra reale që i ke të shkruara dhe i di dhe një ditë është mirë të na raportosh.

Kryeministër, sot nuk e dëgjova asnjë fjalë, gjysma e qytetarëve të Prishtinës nuk kanë ujë të pijes nga Badoci i helmuar dhe ju sot nuk e keni paraparë asnjë cent. Kryeministër, je përgjegjës juridik me Ligjin për ujërat. Je udhëheqës i Sekretariatit dhe Këshillit ndërmintor për ujërat. E ke obligim të raportosh minimalisht njëherë në vit se e kryeson sekretariatin. Nuk e kemi pasur një reagim tëndin për ujërat, nuk e kemi parë asnjë cent të ndarë, nuk e dimë ku po furnizohen qytetarët, përveç që e dimë po furnizohen te kompanitë që i ke subvencionuar dhe në fund ua ke

falur borxhet qind për qind dhe sot aferat korruptive të ujit i hesht, nuk vjen asnjëherë të raportosh.

Me Ligjin për ujërat e ke obligim minimalisht njëherë në vit të vish dhe jo katër vjet mandat nuk keni raportuar asnjëherë si kryesues i Këshillit ndërmintor për ujërat. Prandaj, bëhu serioz dhe eja fol për realitetin të cilin jemi sot këtu, fol për buxhetin. Nuk dëgjuam për asnjë projekt kapital që ke planifikuar. E thanë disa kolegë, pak të hynë në hak. Thanë, s'ka ndërtuar infrastrukturë. Jo, e ka ndërtuar edhe një urë 6 km në Park Nacional "Sharri", dhe ka vallëzuar.

Ky ministri që thoshte, qeveritë e asfaltit, i shtroi 6 km në Park Nacional, dhe e keni parë të gjithë duke vallëzuar. Dhe, ju them me përgjegjësi të plotë, ja ku është, ndoshta s'i kanë treguar këtij, e ka shkelur ligjin puro. Sepse në Park Nacional nuk guxon të prek dorën e njeriut pa vlerësim strategjik mjedisor. Pa ligj. Pa e trajtuar. Ky s'ka vlerësim strategjik mjedisor për Parkun Nacional.

Ky e ka shkelur ligjin dhe vallëzonte duke e shkelur ligjin, edhe pse qytetarët e meritojnë rrugën. Pra, shkeljet e tilla flagrante, kryeministër, nuk të kanë hije dhe nuk do të duhej t'i kishe, sepse je shembull i keq në këtë relacion. Por, kur i kujtojmë edhe shkeljet kushtetuese, kur i kujtojmë edhe veprimet e tjera, domosdoshmërisht që ligji nuk duket asgjë, të shkelet Ligji i Parkut Nacional dhe të shkelen të gjitha parimet dhe etiket.

Përkundrazi, në atë ligj, kryeministër, ka edhe shkelje të tjera, sepse i njëjti dikaster ministror i yti edhe ka projektuar, edhe e ka ndërtuar, edhe e ka financuar, edhe i ka dhënë vetes leje, edhe e ka pranuar punën bashkë me ty. Pra, kryeministër, këto janë shkelje të mëdha.

Kryeministër, nuk ke qenë këtu, kemi diskutuar. E ke nis rrugën për Tetovë jashtë çdo norme juridike dhe kushtetuese. I ke ndarë mjetet, këtu e kanë votuar deputetët tuaj, t'i ndani mjetet e buxhetit dhe t'i shkojnë një organizate publike të një shtetit tjetër, në Maqedoni. Ta ndërtojë, ta projektojë, ta hartojë projektin e tunelit, të cilin, kryeministër, as ti sot nuk e di ku fillon tuneli dhe ku mbaron tuneli. Por, e di që mjetet do të shkojnë në Maqedoni një herë, e pastaj kthehen rikoshetë prapë te kategoritë e tua.

Pra, këto janë shkelje të mëdha të cilat po të përcjellin dhe fatkeqësisht nuk po e dëgjojmë asnjëherë llogaridhënien e as atë pjesën tënde etike, apo vërtet të janë përzier numrat shumë se as matematika nuk po të del, sepse përndryshe do të duhej të reflektoje dhe të flisje mbi bazën reale të projekteve.

Pra, të na thuash se cilat projekte kapitale i ke paraparë në mandatin e ardhshëm. Cilat i ke paraparë.

Merreni ministrinë të cilën unë e mbuloj nga komisioni, 1,6% e ka buxhetin Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, ndërsa ajo e Zhvillimit Ekonomik e ka 2,3%. Zhvillim ekonomik, ekonomi e vendit me 2,3 buxhet. I harroi ministri, faktikisht edhe kryeministri, ndërmarrjet publike.

E harroi që këtu para një viti keni miratuar 20 milionë euro për Trepçën që të ndërtohen kapacitete e reja prodhuese për flotacionin. Ende s'e ke nisur. I ke harxhuar paratë në paga dhe mëditje. Asnjë cent në Trepçë në investime kapitale. Asnjë cent në KEK nuk e ke bërë.

Të është ndalur dhe prishur lopata disa herë dhe dita po të kushton kur po të bien bllloqet, 1,5 deri në 5 milionë euro energji, dhe këto po i importon. Sot Kosova është kthyer në importues të energjisë që s'ka qenë. E dëgjova kryeministrin, tha e kemi ulur konsumin. Qysh ka mundësi të thotë kryeministri e kemi ulur konsumin kur realiteti dhe faktet flasin ndryshe.

Ke blerë pajisje eficiente për ta rritur importin e kompanive të dëgjueshme, e praktikisht e ke rritur konsumin, nuk e ke zvogëluar konsumin. Nuk ka shifër logjike, reale që sot Kosova shpenzon më pak energji. Pra, qysh e zvogëlove konsumin?

Në këtë relacion, kryeministër, dëgjuam shumë gjëra që nuk janë kurrkund as ekonomikisht, as politikisht e as në aspektin etike. As në aspektin etik. Përveç populizmit dhe retorikës që ka filluar.

U tha këtu, janë shitur fabrikat. Cilën fabrikë e ndërtuat ju? Çfarë fabrike bëtë ju? Sa investuat ju? Çka bëtë me sektorin e bujqësisë? 45 mijë hektarë toke buke i ka sot në regjistra AKP. Çka ke bërë me to? Që katër vjet je në pushtet. Çka ke bërë me sektorin e bujqësisë, përveç subvencioneve të meritueshme? Çka ke bërë me pronën publike?

Vazhdon AKP të shesë me të njëjtin trend, bile edhe më të zi se sa që ka qenë në qeveritë e kaluara. Vazhdon të shiten pronat parqe nacionale, kryeministër, kemi diskutuar edhe në komision. Dhe, ke vendosur struktura atje krejtësisht politike dhe të dëgjueshme ndaj jush.

Prandaj, reflekto sepse vendi nuk ta ka borxh ta katandisësh kështu ekonomikisht, se politikisht po shihet çfarë i ke bërë.

KYRETARI: Replikë? Po, ka mundësi nëse doni. Jo, nuk mund të flasësh, përpos replikë nëse doni. E nëse e përmendi, ama vetëm 2 minuta i ke. Jo, pa e bërë nga një cikël të deputetëve, nuk do t'jua jap ministrave kështu fjalën.

Kryhet cikli i grupeve parlamentare, pastaj secili ministër sipas radhës. Tash, replikë nëse do me zotin Shala.

MINISTRI FATON PEÇI: Jo vetëm me zotin Shala, por edhe me deputetin Hoti, i cili deklaroi... Kam të drejtë se e përmendi bujqësinë. Për shkak se mes tjerash ai deklaroi që ndikimi i subvencioneve edhe në procesin e ujitjes është zero nga Qeveria dhe Ministria e Bujqësisë.

E pavërtetë e madhe. Vetëm një element po e marrë parasysht kur flasim për efektin zero në sektorin e bujqësisë, vetëm po flas për një artikull që po përmendet shumë, në këtë rast, për grurin.

Në periudhën kohore janar-tetor 2023 me periudhën janar-tetor 2024, Kosova ka importuar 28 milionë kg më pak, apo në vlerë monetare 8,1 milionë euro. Kush janë ata që deklarojnë që efekti i përkrahjes në bujqësi është zero, kur vetëm një produkt rënia e sasisë së importi në vlerë monetare i është kthyer Kosovës në 8,1 milionë euro.

Mes tjerash, deklaroi zoti Hoti se zero është investimi në hektarët e ujitjes. Unë po i përmend komunat në të cilat ka investuar Ministria e Bujqësisë. Në Komunën e Deçanit, në Isniq vlera investimit ose hektarët e përfshirë në tokë bujqësore janë 1 mijë hektarë. Në Klinë janë 100 hektarë. Në Pejë janë 200 hektarë. Në Gjakovë janë 200 hektarë. Në Suharekë janë në proces 1 mijë hektarë, 6 km proces i ujitjes. Në Vushtrri janë 150 hektarë.

Në Mitrovicë janë 200 hektarë. Në Junik janë 200 hektarë. Në Shtime janë 200 hektarë. Edhe e ftoj më datë 25 bashkë me kryeministrin do të jemi te Radoniqi, ku do të investojmë projektin grandin prej 9.2 milionë euro procesin e ujitjes, e ku hektarët e përfshirë në tokë ose në sistemin e ujitjes do të jenë 11 mijë e 750 hektarë të tjerë shtesë. Shumë është e vërtetë.

Mandej kur flasim për çështjen e pronës. Kur flasim për numrin ose sipërfaqet e mbjella me grurë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Më vonë do ta keni fjalën dhe mundësinë 10 minutëshe që t'i adresoheni Kuvendit. Po ia jap fjalën tash Hykmete Bajramit. Nuk e paskemi këtu.

Nuk mund t'ia ndaloj një ministri apo një deputeti vetëm se tjetri fizikisht nuk është këtu. Mirë. Ia japim zotit Hoti kur të vijë.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sa i përket buxhetit, e thamë që nga fillimi që nuk do të flasim rreth këtij planifikimi për buxhet, sepse është vetëm një buxhet transitor. Më 9 shkurt, Republika e Kosovës do ta ketë qeverinë e re dhe qeveria e re do ta bëjë buxhetin për të reflektuar programin dhe premtimet e saj.

Por, fjalimin po e nis me gjuhën e kryeministrit. Kryeministri na i përmendi disa familje të cilave iu ka ndihmuar gjatë viteve të kaluara. Por, edhe unë dua t'i përmend disa familje.

Kryeministër, një familje, çift bashkëshortor, të cilët punojnë në sektorin privat dhe është nga Komuna e Podujevës, udhëtojnë për çdo ditë për të ardhur në punë. Më 14 shkurt të vitit 2021 a e di pse ta kanë dhënë votën. Sepse ju ke premtuar që e rregullon rrugën për Podujevë. Ju ke premtuar që do t'ua lirosh produktet bazë. Ju ke premtuar që do t'u ndërtohet çerdhe publike për fëmijë.

Ju ke premtuar që do t'ua zvogëlosh faturat e energjisë elektrike. I ke premtuar këtij çifti që do t'i mundësosh të blejë banesë me këst 120 herë 120, respektivisht 150 herë 150. Cilin nga këto premtime, kryeministër, e ke përmbushur? Cilin, ma thuaj?

Kjo familje udhëton nga Podujeva në Prishtinë për të ardhur në punë për çdo ditë dhe e bën një orë më tepër në rrugë për shkak të punimeve të cilat nuk po përfundojnë kurrë. Dhe, sot kur unë ministrit të Financave ia krahasoj investimet e nivelit qendror të vitit 2017 e 2018 me nivelin qendror të vitit 2023 edhe 2022, ky thotë përjashto autostradën. Shikoje çfarë logjike. Thua ti që ministri i Infrastrukturës kur e ka kryer mandatin atëherë e ka marrë autostradën edhe ka shkuar në shtëpi. Veç kështu debati nuk bëhet.

Asnjë prej premtimeve, kryeministër, nuk e ke përmbushu. Të mos flasim që ka pensionistë të cilëve çmimet e produkteve bazike në mandatin u janë rritur për 50%. Po a e di çfarë ke bërë me paga, kryeministër. Me të ardhur në Qeveri i ke rritur pagat. E ke rritur pagën tënde, të ministrave, të zëvendësministrave, të këshilltarëve politikë, të shoferëve, të asistentëve. I ke rritur me rreth 45%. Ndërkohë, 83 mijë shërbyesve civilë ua rrite pagën 6,8 euro. 6,8 euro dhe më vonë ua ke shtuar komplet në mënyrë joligjore një gjysmë koeficienti, sepse për t'u bërë ligjore ajo, duhet ta sjellësh Ligjin e pagave.

Numri i koeficienteve, sasia e koeficienteve që po e quani, është shtojcë të Ligji i pagave dhe nuk mundesh me Ligj të buxhetit ta ndërrosh Ligjin e pagave. Mund ta rrisësh vlerën e koeficientit, por jo ta rrisësh sasinë e koeficienteve. Domethënë, edhe këtu po e bëni një shkelje ligjore. Ndërkohë që nuk e keni mbajtur asnjërin prej premtimeve.

Kryeministër, të mos harrojmë, ne jemi nën masa ndëshkuese të BE-së. Askush këtu s'po i përmend që janë 293 milionë euro projekte në trajtim të ujërave të zeza, në bujqësi, në ujëra të pijshëm, të cilat sot nuk fillojnë, sot e dy vite për shkak të masave ndëshkuese të BE-së.

Dhe çka po e shisni, rritjen e deficitit tregtar, në terma absolut që është rreth 2 miliardë euro, po thoni që është luftë kundër kontrabandës. Edhe po del ministri po thotë Avdullah Hoti e Hykmete Bajrami, Bedri Hamza kur kanë qenë në pushtet kontrabanda ka qenë 2 milionë. Domethënë, ky po i di përgjegjësit, tha edhe i di kompanitë që kanë qenë të lidhura edhe po rri s'po i çon në prokurori. Është duke bërë vepër penale. Është duke bërë vepër penale. Urdhëro! Urdhëro, i nderuar! Me emra qiti kush me kënd ka lidhje, sepse ne po e dimë me kë keni lidhje ju. Mafia energjetike prej kryeministrit e deri tek i fundit e mbroni Martin Berishajn.

Pse e mbroni? Sepse ju ka financuar, jeni të lidhur me të. Ju e mbroni Nagip Krasniqin, sepse ju ka financuar, jeni të lidhur me të. Duhet të flisni me fakte. Urdhëroni, sillni faktet! Duhet të flisni me fakte. Nuk bën të flitet ndryshe.

Rritja e çmimeve tash po na shitet si luftë kundër propagandës. Edhe po thotë, rritja ekonomike në kohën e juaj kur ka qenë në vitin 2015 - 5,9%. në vitin 2016 - 5,6%, në vitin 2017 - 4,8%, po thotë, atëherë s'ka qenë e qëndrueshme. Tash rritja ekonomike e këtyre që në vitin 2023 ka qenë 3,3%, tash kjo është e qëndrueshme. Kjo e tyrja është e qëndrueshme, e jona nuk ka qenë e qëndrueshme.

A e dini edhe çka tha, tha i keni shitur fabrikat për skrap. Cilat fabrika? Pse s'i keni blerë bre ju pasi që paskan qenë me vlerë. A e dini more që e keni dërguar menaxhmentin në AKP. Është duke fjetur prokuroria në AKP për shkak të keqmenaxhimit që po e bëni.

Privatizimet e negociuara kurrë më të larta nuk kanë qenë. Kurrë më të larta nuk kanë qenë. Po gjysmën e Kabinetit i keni nën hetime. 2 mijë e 123 tenderë njëburimorë i keni.

Kryetar, kryeministër, do t'ju lusja që ta lini ndonjëherë Mirlindën që të flasë, se gjynah bre! T'i shkojnë katër vjet mandat duke folur prej vendit. Sinqerisht. Kjo është edhe kundër të drejtave të njeriut. A po din, u a jepni fjalën. Po më vjen keq, sinqerisht a. Shiko, edhe Halili. Ua jepni ndonjëherë fjalën se tepër gjynah po më vjen!

KRYEATARI: S'besoj që e ka për atë arsye, se është njëra prej deputeteve që ka folur më së shumti, Mirlinda. Edhe unë gjithnjë ia jap fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Ama, respekt pak.

KRYETARI: Qetësi, ju lutem!

HYKMETE BAJRAMIU: 2 123 tenderë njëburimorë në vlerë prej 273 milionë euro. Ky është korrupsion, këto janë fakte. Nuk bën të dilet e të thuhet e keni pasur kontrabandën. Ju po mbërrini tash ta dini sa ka qenë kontrabanda atëherë.

Kush? Ministri i Financave, i cili që 2 vjet jashtëligjshëm e mban drejtorin e Administratës Tatimore që e ka zgjedhur Qeveria PAN. Kanë çështje kontestimore. Më duket ende e merr gjysmën e pagës për shkak se s'po mund ta ecë konkursin. Imagjinojeni, gjysmën e pagës e merr ky, gjysmën e pagës e marr ai, por të dytë janë të lumtur duke qenë në pozitat e tyre. Ndërkohë, që edhe kontrabanda dhe korrupsioni po lulëzojnë. Edhe kontrabanda edhe korrupsioni po lulëzojnë. Gjithkund.

Më trego ti mua kur po e largon. Qysh ka mundësi që e mban një drejtor. Ai definitivisht është duke të shantazhuar, se përndryshe pa mandat një drejtor të ATK-së nuk ka logjikë tjetër ta mbash. Nuk ka asnjë logjikë tjetër që ta mbash.

Te shpenzimet, edhe një herë po e them. Te investimet kapitale kanë qenë më të ulëtat në historinë e këtij vendi. As s'i keni ndërtuar çerdhet. As s'i keni ndërtuar rrugët. As s'i keni ndërtuar urat dhe as nuk keni ndërtuar asgjë. Një projekt të vetëm nuk keni mbërritur ta përfundoni.

E keni lënë Organin Shqyrtues të Prokurimit gati 2 vjet jofunksional. Autoriteti i Konkurrencës që duhet ta luaj rolin e atij ligjit të famshëm që ua ka ndërruar Gjykata Kushtetuese, gjithashtu nuk ka qenë funksional. 3 miliardë subvencione i keni shpërndarë. Nuk ka Komision të Ndhmës Shtetërore, sepse keni dashur t'i shpërndani pa kritere.

500 e sa milionë i keni dhënë subvencione për entitetet publike. 580 milionë subvencione për entitete publike. A e dini, deputetë, çka ka aty. Thotë është Fondi për eficiency të energjisë, partitë politike, RTK-ja dhe kështu me radhë. 100 milionë nuk janë të shpalosura.

Hekuran Murati që është këtu, në raportin financiar të Qeverisë, te subvencionimi i entiteteve publike, rreth 100 milionë nuk tregon kah i ka dërguar. Pyetni Armend Mujën për shpenzimet e energjisë elektrike në veri. Nuk tregon. A e dini cilat janë shpenzimet e energjisë elektrike në veri për mandatin e këtyre.

Në 2019-tën humbja e energjisë elektrike ka qenë 4.5 milionë. Në 2020-ën 8,7 milionë. Në 2021, Leart Hoxha më dëgjo, 52,6 milionë. Në vitin 2022, 78 milionë. Në vitin 2023, 35,7 milionë. KOSTT-i po vazhdon t'i paguajë humbjet. Këta neve na shesin patriotizëm, na thonë që janë duke paguar. As 10% e energjisë elektrike që është duke u shpenzuar nuk është duke na u paguar. Mjaft me propagandë.

Këto janë të dhëna të pasqyrave financiare të KOSTT-it që Armend Muja i ka e hezitonte t'i përgjigjej Leart Hoxhës. Kështu që, ja ku jemi këtu, jemi me fakte, me referenca. Faleminderit!

KRYETARI: A doni replika? Kush prej ministrave do të replikojë? Ministri i Financave fillimisht. Jo, kryeministri shkoi për shkak që në orën 13:00 e ka një aktivitet të paraparë më herët në Institutin për Dokumentimin e Krimeve të Luftës, së bashku me ministren e Drejtësisë edhe Saranda Bogujevci, nënkryetaren tonë.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Për rrugën e Podujevës, të ngritët tash si temë pas sa e sa viteve që ju s'e keni bërë, po besoj që është më tepër si simptomë e dhembjes së madhe që ka shkaktuar humbja e thellë në Podujeve që e keni pasur si LDK. Përndryshe, rruga është duke u bërë. Rruga është duke ecur.

Çifti i Podujevës që e përmend deputetja Bajrami, a e dini pse i bën një orë derisa të vjen në vend të punës. Se 40 minuta i bën në Prishtinë prej kaosit të trafikut që e keni bërë ju. Kaos total është bërë Prishtina për shkak të vendimeve që i keni marrë ju. Hej, një qytet nuk mund ta menaxhoni qysh duhet, e po pretendoni shtetin.

Tjetra, tha, s'ka bërë çerdhe. Podujeva qysh e di, ka bërë çerdhe. Mundet edhe ministrja të na njoftojë sa për shkak se kryetari Bulliqi ka qenë konstruktiv i ka përmbushur kushtet e ka ofruar tokën, lokacionin dhe çerdhja është përruar e janë hapur madje më shumë se një.

Çifti i Podujevës i merr shtesat për herë të parë pas 20 vjetësh. Me juve kurrë s'kanë marrë mbështetje fëmijët. Çifti i Podujevës për herë të parë me këtë Qeveri merr shtesa të fëmijëve. Çiftit të Podujevës i është subvencionuar edhe energjia elektrike. Çiftit të Podujevës ka mundësi që edhe izolimi i shtëpisë i është mundësuar përmes grantit.

Çiftit të Podujevës ka mundësi që i është subvencionuar edhe rritja e pagës kur e kemi masën për mbështetje dhe për subvencionim të rritjes së pagave në sektor privat, ku mbi 17 mijë të punësuar kanë përfituar. E shumë, e shumë masa e përfitime të tjera.

Pra, kur përmendi raste të tilla, siç e tha edhe kryeministri, ka pa numër shumë kombinime se si Qeveria jonë u ka dalë në ndihmë këtyre familjarëve.

Sa i përket rritjes së pagave. Më duhet të të them që po gënjeni kur thoni që ne i paskemi rritur pagat në fillim të mandatit vetes. Është e pavërtetë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë!

MINISTRI HEKURAN MURATI: Kjo është e pavërtetë edhe shpifje. Pagat për të gjithë punëtorët e sektorit publik janë rritur me Ligjin e pagave në vitin 2023. Ka qenë viti i tretë i

mandatit tonë qeverisë. Pra, është e pavërtetë dhe gënjeshtër kur thoni që Qeveria ia ka rritur vetes pagat. E pavërtetë.

Ne tri herë madje i kemi rritur pagat për shërbyesit publikë. Janë rritur në vitin 2023, 2024 edhe në vitin 2025. Brenda mandatit tri herë. Kur keni qenë ju në qeveri, sa herë i keni rritur pagat? Sa herë i keni rritur pagat? Urdhëroni, përgjigjuni! Është shumë e thjeshtë, sa herë i keni rritur pagat kur ju jeni qenë në qeveri. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Bajrami, a po do t'i bësh replikat bashkë apo t'i qasësh secilës veç e veç? Se edhe Artane Rizvanolli po do të replikojë.

Veç e veç. Një ose dy minuta. Urdhëroni!

HYKMETE BAJRAMI: Kur iu referove rrugës në Podujevë, thatë ju referove humbjes që e kemi pasur në Podujevë, edhe paradoksalisht e lidhe me fitoren e madhe që e kemi pasur në Prishtinë. Këto nuk po të shkojnë diqysh njëjtë a po kupton?! Se po, ti ke fituar në Podujevë, por ke humbur në Prishtinë. Ke humbur. A po kupton edhe këto nuk shkojnë njëjtë.

Ndërkohë, prapë po e them, ai çifti në Podujevë të ka votuar për atë banesën 120 herë 120 euro kësti. Nuk ia ke bërë. Atij çiftit ia ke ngritur energjinë elektrike prej 3,5 në 7 centë tarifën e ulët dhe prej 7 në 14 tarifën e lartë.

E tani je ulur, ke thënë hajt ta subvencionoj një pjesë të faturës së energjisë elektrike. Atij çifti i ke mundësuar qasje në çerdhe publike, pro ato 2-3 çerdhe a sa i ka bërë kryetari Bulliqi, apo 1 a, nuk po e di sa, nuk ka vend për krejt fëmijët e Podujevës. Jo nuk ka. Absolutisht. Vetëm për fëmijët e militantëve tuaj.

Edhe ministër, më trego sa e ke pagën. Të tregoj sa e kam pasur pagën. Nuk është gënjeshtër more. 45% ia ke rritur pagën vetes, Kabinetit qeveritar dhe të gjithë të tjerëve. A e di kur e rrite gjysme koeficienti. Në kohë fushate. Në kohë fushate.

Domethënë, e ke marrë buxhetin. Je duke e shfrytëzuar duke blerë vota dhe kjo absolutisht nuk është e drejtë. E ke rritur pagën. Krejt Kosova e di që e ke rritur pagën tënde me Ligjin e pagave.

KRYETARI: Ia japim një replikë me zonjën Bajrami, ministres Rizvanolli, ministres së Ekonomisë. Urdhëroni, zonja Rizvanolli!

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Ju faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!
Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,

Një ndër temat që u përmend shumë sot është rritja e subvencioneve, dhe rritja e subvencioneve për entitetet publike. Dua t'i cek disa prej rezultateve shumë të prekshme për qytetarët që kanë ardhur si rezultat i rritjes së këtyre subvencioneve.

Me një fond prej 11 milionë euro, 3 121 familje kanë investuar në investim të shtëpive për herë të parë në Kosovë, duke e pasur një ndikim të jashtëzakonshëm në jetën e tyre, mirëpo gjithashtu edhe në konsumin e energjisë elektrike te këto familje.

15 milionë të tjera janë ndarë për 28 ndërtesa shumë-banesore për investime që nga izolimi, dyer, dritaret, kulmi, interfonia, pajisjet kundër zjarrit e të tjera, ku do të përfitojnë 758 familje në nevojë në ndërtesa shumë-banesore, në ndërtesa sociale në tetë komuna të ndryshme të Kosovës, shtesa të cilat kurrë më parë nuk janë prekur nga dora e shtetit.

Investimet në ujëra që figurojnë si subvencione në buxhetin e Ministrisë së Ekonomisë, mirëpo në fakt janë subvencione për investime kapitale që zbatohen nga ndërmarrje publike janë rritur në 5,5 milionë në vitin 2023 dhe në këtë vit nga 500 mijë sa kanë qenë në vitet paraprake, që do të thotë njëmbëdhjetë fish. Sa i përket energjisë elektrike dhe subvencionimit të energjisë elektrike, u thanë aq shumë të pavërteta sa nuk po di nga t'ia filloj, si dhe për çmimin e energjisë elektrike, siç janë thënë edhe shumë herë të tjera. Sa i përket atij gjysmë miliardit të subvencionimit të energjisë elektrike i keni përzier me gjysmë miliardin që janë siguruar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Kundër-replikë, zonja ministre, pse s'po e ndani kohën tuaj, i keni fjalimet tuaja të plota.

Ani, mirë, edhe një minutë ministres.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Ok-ej!

KRYETARI: Vetëm pak, ta kryejmë me Hykmeten. Një minutë, Hykmete!

HYKMETE BAJRAMI: Kryetar, faleminderit!

Ministre Rizvanolli, nëse u thanë shumë të pavërteta, pse bre s'po e thua të vërtetën tënde. Dil, trego të lutem sa të ka kushtuar energjia elektrike në Veri. Unë po e them këtë, kush është e pavërtetë këtu, po them sipas pasqyrave financiare të KOSTT-it 4,5 milionë 2019, 8,7 në 2020, 2021 - 52,6 milionë, 2022 - 78 milionë, 2023 - 35,7 milionë, cila është e pavërteta? Dil, thuaje! E thërrasim KOSTT-in, ata i raportojnë Kuvendit dhe i themi pse po thoni të pavërteta. Kaq!

Domethënë, thuaje të vërtetën tënde. Asnjëherë nuk ke qenë në gjendje të thuash kaq ka kushtuar energjia në Veri. Dil thuaje të vërtetën, mos e lë askënd të spekulojë, kaq është, shumë e thjeshtë, por po thoni të pavërteta, po unë s'kam të vërtetë.

KRYETARI: Zoti Shala, veç duhet lajmëruar më herët, mos e le kështu kaq vonë. Vetëm kundërreplikë është. Jo, jo se ministri Peci ka pasur replikë, tash veç një minutë e ke, urdhëro.

FERAT SHALA: Në vend të replikës, veç po ju rikujtoj që nga kategoria dhe nga struktura buxhetore e këtij vendi te subvencionet e pashë një artikull në media para pak ditësh, i kërkoj falje medias që s'po e di te cila e lexova që, nga subvencionet e të dy ministrave ndahen diku rreth 80 mijë euro dhe ndërtohen tri vila diku afër vijës së kufirit të parkut nacional. Nga Ministria e Bujqësisë tri vila ndërtohen me 80 mijë euro nga kategoria e subvencioneve. Bash kisha pas qejf të di kush është pronar? Kush i ka ndërtuar? Pse me subvencione në Park Nacional? Të kujt janë tri vilat e kështu me radhë.

Pra, nuk kemi marrë përgjigje, edhe pse mediat e kanë dhënë, i falënderoj shumë.

KRYETARI: Mirë, ia japim fjalën Pal Lekajt. Po vazhdojmë me deputetët, pastaj replikat i organizojmë sipas radhës.

PAL LEKAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Para nesh kemi projektbuxhetin për vitin 2025, një dokument që do të duhej të përfaqësonte shpresat dhe aspiratat e qytetarëve tanë. Por, në vend të një plani që të na jep besim dhe qëndrueshmëri, ky buxhet paraqet një sërë dështimesh të Qeverisë, të cilat po na çojnë drejt rrezikut dhe papërgjegjshmërisë financiare.

Së pari, ky buxhet e injoron krizën energjetike që po përjetojmë. Në vend që të përqendrohet në investime strategjike për stabilizimin e furnizimit dhe zvogëlimin e varësisë nga importi, shohim vetëm shpenzime të mëdha operative që nuk prodhojnë asgjë konkrete për të ardhmen energjetike të vendit. Duke e injoruar nevojën për investime në burime të reja dhe të qëndrueshme, kjo qeveri po vazhdon të luajë me sigurinë energjetike dhe ne mund të shohim që do të përshkallëzohet furnizimi me energji elektrike në vend.

Së dyti, nuk mund të injorojmë strukturimet e mëdha që janë bërë për projekte kyçe infrastrukturore. Qytetarët tanë meritojnë rrugë të sigurta dhe shkolla moderne, por ky buxhet na lë në projekte të papërfunduara dhe të financuara shumë dobët. Nga ana tjetër, janë rritur shpenzimet për pozitat administrative, duke krijuar më shumë vende të panevojshme për

militantët e partisë dhe duke thelluar nepotizmin. Kjo nuk është as përfaqësuese e vlerave të transparencës dhe as e llogaridhënies.

Së treti, jemi dëshmitarë të rritjes së shpenzimeve të panevojshme për zyrtarët qeveritarë në një kohë kur qytetarët po përballen me inflacion të lartë dhe kosto në rritje të jetesës. Ndërkohë që familjet e Kosovës përpiqen të sigurojnë ushqimin bazik, Qeveria vazhdon të shpenzojë në luks dhe përfitime për zyrtarët e saj. Kjo është një mungesë e thellë e ndjeshmërisë ndaj situatës së popullit që Qeveria është zgjedhur dhe ta përfaqësojë. Kur jemi te buxheti, ky buxhet nuk përmban asnjë projekt të madh kapital që do të krenohet shteti dhe qytetarët e Kosovës. Ky buxhet i ka lënë veteranët e UÇK-së me 204 euro pagë mujore, ky buxhet i ka lënë qytetarët me pagë minimale 320 euro. Ky buxhet është edhe ofendues, sepse nuk ka të buxhetuar asnjë vijë buxhetore për padinë ndaj Serbisë, për gjenocidin që e ka bërë ndaj Kosovës.

Ky buxhet është edhe gënjeshtër për rininë e Kosovës, sepse nuk përfshin ndërtimin e 4 mijë shtëpive për çiftet e reja që ka qenë bukur e bujshme dhe njerëzit patën filluar edhe të martoheshin shpejt. Ky buxhet është edhe fyerje e shpresës për familjet e të zhdukurve të Kosovës, sepse nuk përfshin as vija buxhetore, e plan strategjik për gjetjen e të zhdukurve të Kosovës, për të cilët shkroi edhe Raporti i Progresit këtë vit, duke thënë që shteti i Kosovës që tre vjet s'ka lëvizur me asnjë veprim drejt zbardhjes së fatit të të zhdukurve. Ky buxhet është edhe qesharak ku për ndërtimin e mbikalimeve edhe nënkalimeve që rrezikojnë qytetarët kanë ndarë vetëm 1 milion euro.

Po kthehem te projektet me infrastrukturë. Kemi këtu, më falni, që do t'ua përmendi emrin, që jeni të mazhorancës, e kemi Batushën, profesor Kokën, Ardian Golën, kemi Mimoza Kusari Lilën që nuk është këtu i dëshiroj shërim të shpejtë, dhe kemi ministren, zëvendësministra dhe paramendojeni që katër vjet ku e kanë lënë rrugën Gjakovë-Dollc. Dhe, çka bëjnë? Për tre vjet të tjera të ardhshme, për 2025, 2026 dhe 2027 kanë ndarë 15 milionë euro.

Domethënë, qytetarët e Gjakovës mbesin pa infrastrukturë dhe thuajse të izoluar nga kjo qeveri. Si do dikush të shkojë dhe ta lypë votën? Edhe sa i përket rrugës Kijevë-Zahaq, kemi Agushollin, kemi zonjën Fatmire, kemi ministra dhe çka? Çka duhen thënë në Pejë? Çka keni premtuar? Cilat janë projektet? Të mos flasim për Gjilan, nuk di deputetët nga Anamorava çka do t'u thonë atyre qytetarëve që kanë humbur jetën.

Ku është dora e Qeverisë? Më besoni që nuk dua fort të zgjatem, por keni ardhur me një shkëlqim ju qeveria vetë me Kurtin dhe sot po ju shoh të zbehur shumë, sepse asnjë ministër nuk ka me çka të krenohet. Me çka të krenohet për vitin 2025 apo për këtë mandat katërvjeçar? Pse? Ku janë 160 çerdhe? A keni bërë haigare, a? Ku janë katër shtëpi të pleqve, bre? Pesë qenkan, a keni bërë haigare, a? Më besoni që kjo Qeveri, po ju them me plot kuptimin e fjalës, e ka humbur busullën, dhe është qeveri që i ka mashtruar në vite qytetarët. Prandaj, qytetarët me të drejtë

thonë “e kemi humbur shpresën në Kosovë dhe po ia mësyjmë Perëndimit”. Ja ku e keni sjellë qytetarin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Tash flet deputeti, a po do replikë? Replikë, ministri Murati.

MINISTRI HEKURAN MURATI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Më lejoni të them që shumica e deputetëve të opozitës, në fakt, janë shndërruar në aktivistët më të zellshëm të qeverisjes sonë, duke na i rikujtuar vazhdimisht premtimet që ende duhet t'i përmbushim.

Pra, po, e vërtetë, ka disa që jemi në proces duke i përmbushur, sepse na kanë ndodhur sfida të jashtëzakonshme përgjatë këtyre katër vjetëve, po çfarë mund të them është që megjithatë rezultatet janë impesive: 78 mijë vende pune janë të krijuara përkundër sfidave globale, rritja ekonomike është mbi 4% në secilin vit e mesatarja është 6, po ju pyes juve që tregoni me të dhëna të referuara saktë, pra të ndonjë agjencie kredibile në qeverisjet e juaja përgjatë tërë mandatit, me sa e keni marrë e me sa e keni dorëzuar qeverisjen? Urdhëroni, lirisht po ju sfidoj publikisht. Pra, më tregoni sa vende pune janë krijuar në qeverisjet e juaja?

Sa i përket deputetit Lekaj, është problematike kur shihet që në të gjitha projektet që janë nisur në këtë qeveri po ecën dinamika, pra dinamika po ecën e përshpejtuar. Të vetmet projekte ku ka ngecje janë ato projekte ku shenjat e gishtërinjve i keni ju. Pra, ato projekte kanë probleme dhe s'po ecin. Pse? Duhet ta dini ju më mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Lekaj! Jo, zoti Lekaj edhe kalojmë te deputeti tjetër, Eman Rrahmani.

PAL LEKAJ: Ministër,

Me të vërtetë unë kam një vlerësim për ju, por ajo që mund t'ju them, ju kam thënë edhe atë ditë në komision, mos qofsha në lëkurën tuaj, sepse s'ke çka të mbrosh. S'ke çka të mbrosh, mospunën, mos u merr me të kaluarën, por çka ke bërë që katër vjet? Paramendoje asnjë rrugë nuk e ke përfunduar, janë ministrat tu dhe për Gjakovë prapë po të them, 6 milionë euro i keni ndarë për vitin 2025, a nuk është marre? Dhe unë jam krenar me çdo projekt që e kam filluar dhe që e kemi përfunduar.

KRYETARI: Mirë, Eman Rrahmani.

EMAN RRAHMANI: Faleminderit, kryetar!

Unë sot dola këtu t'i prezantoj disa projekte, të cilat as prej qeverisë, as prej deputetëve nuk u prezantuan, se si janë shpenzuar disa mjete të taksapaguesve qytetarë, për shkak që kritikantët të cilat i kam pasur për mënyrën dhe orientimin i kam dhënë gjatë kohës sa kam qenë pjesë e

Vetëvendosjes dhe tash nuk besoj që kam të drejtë të jap kritika rreth mënyrës së orientimit të buxhetit që e kanë vendosur Lëvizja Vetëvendosje ta shpërndajë.

Unë besoj që do të duhej këtu që të tregohej se sa mjete, sa janë shpenzuar për kalimin e ligjit ku lejohen martesat ose bashkëjetesat e burrit me burrë? Këtu do të duhej të dilnin të tregojë ministri i Kulturës se sa mjete i ka dhënë dhe në secilin projekt deri sot prioritet i jepet mbrojtjes së komunitetit LGBT. Këtu sot do të duhej të tregonte edhe ministri i Shëndetësisë se sa mjete ka dhënë për t'u lejuar surrogacia, për t'u lejuar fëmija të mos ketë të drejtë ta njohë kë e ka babë e kë e ka nënë, këtu sot do të duhej të fliste dhe të tregonte ministrja Nagavci se çka ka bërë me kurrikulën për arsim në edukatën seksuale dhe shëndetin riprodhues. Nuk e di, deputetë të nderuar, a ju ka rënë ta lexoni atë pjesë dhe të shihni çka ka ndodhur me atë.

Në fatkeqësisht, meqenëse nuk ka qenë pjesë e Kuvendit, ajo literaturë ka tri ditë që kam filluar dhe po merrem seriozisht ta shoh përmbajtjen e saj. Me atë kurrikulë mësohen se si mësimdhënësit t'u tregojnë fëmijëve prej klasës së parë deri në klasën e 12-të se si i kryejnë marrëdhëniet e tyre seksuale në shtëpitë e tyre. Në atë kurrikulë ministrja Nagavci e ka miratuar dhe e ka prezantuar në vitin 2023 që fëmijët prej klasës së parë deri në klasën e 12-të të marrin shembuj një vajzë dhe një djalë, ku i qesin para gjithë shokëve dhe shoqeve të klasës dhe njëri t'i mbyllë sytë për pesë minuta e nxënësi tjetër e prek me dorën e tij gjithë trupin me symbyllur dhe pastaj do t'i ndërrojnë rolet, e ku pastaj vajza do ta prekë fëmijën tjetër për 5 minuta gjithë trupin dhe para gjithë klasës do të tregojnë se çka kanë ndier, çfarë organi kanë prekur dhe si janë ndier ata fëmijë.

Kjo është kurrikula e publikuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës në vitin 2023. Këtu janë shpenzuar një pjesë e mjeteve të mëdha financiare për t'i edukuar dhe për të ndikuar te fëmijët dhe te e ardhmja jonë. Këto besoj do të duhej që të dilnin këtu dhe të na tregonin edhe për këto shpenzime, ku i kanë marrë ato mjete? Pse angazhohen në gjithë këtë zell e gjithë këtë mund? Çka ju pengon familja? Çfarë familje duan? Ku duan të orientohen? A është ky angazhimi jonë politik, të cilin kemi kërkuar para njerëzve? Pse kemi ardhur në këtë situatë? Kush i monitoron këto çështje? Kujt i japin llogari? Pse nuk vjen ministrja asnjëherë në raportimet para komisioneve për këto çështje? Pse s'janë publikuar, meqenëse janë suksese të kësaj qeverisje, të kësaj ministrie pse s'janë publikuar asnjëherë para njerëzve t'u tregohet se çka po u ofrojnë fëmijëve të tyre. Në disa diskutime që i kam pasur me deputetë kolegë që vijnë pikërisht prej kësaj fushe, kanë thënë që unë merrem me fëmijën tim, te fëmijët e mi nuk mund të ndikojnë këto agjenda, edhe fëmijën tënd, timin dhe secilin e para që ka për ta prekur është kjo çështje.

Unë e di se sot rrinë me kokë ulur këtu, me ata që kam diskutuar privatisht me ta për këto çështje, për shkak se është përgjegjësi e tyre direkte se çka u ofrojnë fëmijëve. Absolutisht po, është përgjegjësi e tyre direkte dhe do të vijë koha edhe me emra do t'i përmend, mirëpo duhet të

angazhoheni dhe deklaroheni publikisht, se kjo është agjendë publike, është agjendë kundër familjes, kundër të ardhmes së njerëzve, vendit dhe kombit tonë.

Andaj, për mua pak rëndësi ka se kah shkon ky buxhet. Për mua ka rëndësi mbrojtja e fëmijëve të secilit, dijeni mirë që fëmijët e parë do të jenë fëmijët e juaj që do të cenohen prej kësaj të drejte, nuk do të mund t'i mbronni dhe t'i ruani kurrë, ashtu qysh deklaroheni privatisht. Mund t'i dërgoni edhe në shkolla të tjera, edhe jashtë vendit, edhe gjithkrah, mirëpo këtu kanë për të jetuar, e këtu kanë për t'u prekur prej këtyre gjërave. Nuk ka të ardhme të tillë, është fat i mirë që po i vjen fundi në qasje të tillë, edhe globale dhe do t'i vijë fundi dhe nuk do të guxonin as t'i përmendni këto, siç nuk guxonin as nuk keni guxim të dilni këtu dhe të flisni, këto i bëni fshehurazi. Madje kur identifikohen prej neve, ju bëni vërejtje se nga u morën vesh, nga u kuptua, kush ju informoi, pse?

Ne do të vazhdojmë të mbrojmë vlerat tona, vlerat e familjes, vlerat të cilat sot jemi këtu secili prej jush e prej nesh, andaj nuk do të mundni kurrë asnjëherë që këto vlera t'i shkatërroni, sepse janë vlera njerëzore, janë vlera që kanë luftuar dhe kanë dhënë jetën shumë familje. Janë vlera, të cilat secili është angazhuar me mund e me zell në secilën kohë, edhe në këtë kohë do t'ia dalim dhe nuk do të kalohen.

Unë kisha kërkuar prej ministres Nagavci të dalë dhe të shpjegojë se sa mjete financiare ka shpenzuar gjatë gjithë mandatit të saj për degjenerim, për rrezikim të qenies edhe të jetës së fëmijëve. Ajo të çon edhe në pedofili, në seksualitet edhe në shkollat fillore, ai material, unë i bëj thirrje secilit prej jush, lexojeni, kuptojeni dhe shihni se çka ka ndodhur në Ministrinë e Arsimit me atë kurrikulë.

KRYETARI: Tash, po ia jap fjalën drejt ministres së Arsimit, meqenëse u ngritën këto çështje. Ministrja ka nevojë pikërisht të replikojë me këto që u thanë nga deputeti Rrahmani.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetar!

Unë ju kisha lutur që të kem fjalën time të plotë, por fillimisht po i referohem diskutimit të deputetit Rrahmani, duke iu adresuar fillimisht që është për keqardhje që të keqpërdoret kjo foltore siç keni bërë gjithmonë për interesat personale ose të një grupi.

Thjesht dhe shkurt, deputet Rrahmani, kurrikulat tona, të cilat i kemi miratuar, kanë të bëjnë me edukimin dhe miredukimin e të gjitha vajzave dhe djemve, në mënyrë që asnjë vajzë e asnjë djalë të mos keqpërdoret ashtu siç keni bërë deri më tani. Pse nuk folët sot për udhëzimin administrativ? Sepse, sot që po flasim deputetët ne nuk kemi asnjë vajzë që nuk vjen...

KRYETARI: Merreni kohën tuaj të nevojshme, e nderuar ministre.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Deputet, ti mund të vazhdosh të sillesh kështu si sillesh gjithmonë, por unë nuk do të merrem me ju. Pra, deputet Rrahmani në vazhdimësi e keni keqpërdorur këtë foltore për të thënë se vajzat nuk shkojnë në shkollë për shkak të mbulesës. Sot që po flasim, sado që ju jeni munduar të manipuloni me vajza e me familje, nuk kemi asnjë vajzë që nuk e vijon shkollimin dhe sot e çdo ditë, si ministre e Arsimit do të angazhohem maksimalisht që të ketë një edukim të plotë për secilën vajzë e secilin djalë, për shoqërinë tonë.

Andaj, kurrikulat janë dokumente publike në ueb faqen e Ministrisë së Arsimit dhe ne i kemi promovuar disa herë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Nuk ka nevojë t'i ndalet fjala ministres, regjia, ju lutem!

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Shumë mirë që e përmendët dhe unë ju inkurajoj që t'i lexoni edhe më shumë dhe të angazhohemi e të punojmë të gjithë, prindërit, shkollat, mësimdhënësit dhe të tjerët në miredukimin e fëmijëve tanë.

Dhe, tani kryetar, po vazhdoj me fjalimin tim, sepse pati edhe çështje të tjera nga deputetët që u parashtruan sa i përket arsimit.

Të nderuar deputetë, siç mund të keni parë, buxheti për arsimin për vitin 2025 është 417 681 002 euro.

KRYETARI: Po, pas fjalimit zoti Rrahmani, ka të drejtë për replikë.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Buxheti për arsim në komuna është 283 566 630 euro, buxheti për arsim në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit është 99 963 750 euro dhe buxheti për Universitetin e Prishtinës është 34 150 641 euro.

Pra, siç mund të shihni, edhe këtë vit sikurse për çdo vit buxheti për arsim është rritur në mënyrë progresive nga viti në vit. Nëse e marrim për referencë vitin 2021, kur ne kemi filluar qeverisjen dhe e kemi pasur buxhetin e miratuar nga qeveria paraprake, kemi një rritje prej 28,47% të buxhetit vetëm në arsim, apo në vlerë reale 92 551 788 euro. Pra, prej buxhetit prej 325 129 233 euro që ishte në vitin 2021, në vitin 2025 do të kemi një buxhet prej 417 681 021 euro, apo një buxhet për 28,47% më të madh për arsimin.

U fol këtu nga disa prej deputetëve për çerdhet. Në vazhdimësi, nga marrja e mandatit kemi ndarë buxhetin e mjaftueshëm për të ndërtuar të gjitha çerdhet dhe kopshtet që i kemi

planifikuar. Për herë të parë kemi bërë një analizë të fizibilitetit, e cila e ka konfirmuar nevojën dhe domosdoshmërinë për ndërtimin e çerdheve dhe kopshteve.

Për herë të parë kemi planifikuar projektet modulare, të cilat i kemi ndarë edhe me komunat. Dhe, po është e vërtetë dhe ju inkurajoj përsëri, deputetë të nderuar, të flisni me kryetarët e komunave që qeverisin nga partitë tuaja, në mënyrë që të mos pamundësojë ndërtimin e kopshteve dhe të çerdheve dhe të mos privojë nga të drejtat e tyre kushtetuese fëmijët vetëm për t'u adresuar me fjalime këtu në Kuvend dhe në forume të tjera.

Për informatën tuaj, më 21. 1. 2024, ne kemi ndarë CD-të dhe kemi përsëritur edhe një herë kërkesën për të gjitha komunat që t'i sjellin dokumentet e nevojshme, në mënyrë që ne të mund t'i ndërtojmë kopshtet dhe çerdhet.

Më 19 prill 2024 unë kam dërguar një shkresë formale zyrtare edhe një herë te të gjithë kryetarët e komunave që të sjellin kërkesat me dokumentacionin e nevojshëm, në mënyrë që ne të mund të ndërtojmë kopshtet dhe çerdhet.

Kemi pasur takim përveç disa takimeve me drejtorët komunalë të arsimit, personalisht bashkë me kryeministrin Kurti kemi takuar kryetarët e komunave më 15.05.2023 dhe më 21 shkurt 2024, dhe kemi kërkuar nga kryetarët e komunave që të gjejnë lokacionet, të japin lejet e ndërtimit, në mënyrë që ne të mund të ndërtojmë çerdhet.

Pra, kemi ndarë buxhetin, kemi ndërmarrë gjithë çka është në mandatin tonë. Unë personalisht vetëm në Komunën e Prishtinës kam shkuar vetë me të marrë mandatin kryetari i Komunës dhe i kam thënë që kemi buxhetin e nevojshëm dhe të na i sillni kërkesat në mënyrë që të vazhdojmë me çerdhe. Vetëm në Komunën e Prishtinës unë i kam dërguar dy letra formale drejtoreshës komunale të Arsimit dhe kryetarit të Komunës. Na e kanë pamundësuar dhe sot që po flasim, nuk ka asnjë kërkesë të asnjë komune të cilat ne nuk i kemi adresuar.

Përveç kësaj, nëse dëshirojmë të krahasojmë prej vitit 2003 deri në vitin 2021, Ministria e Arsimit për tetëmbëdhjetë vjet ka ndërtuar vetëm katër çerdhe. Në këtë moment që po flasim, i kemi 59 çerdhe të cilat janë në proces, të përfunduara, në proces të ndërtimit, adaptimit të shkollave me çerdhe, apo edhe me proces të tenderimit.

U fol për shujtat. Me të marrë mandatin, dhe u adresuan, dhe mua më vjen keq, sepse unë pres që shumica e deputetëve edhe mund të flasin për arsye politike këtu, por unë pres që një ish-ministër i Financave, një ish-Kryeministër, kur analizon buxhetin dhe kur drejton akuza e di pak a shumë se si planifikohet dhe realizohet buxheti.

Me të marrë mandatin në vitin 2022, ne kemi ndarë buxhetin për komunat për shujta për fëmijët prej klasës I-V. Katër milionë euro kanë qenë të ndara nga komunat. Vetëm Komuna e Podujevës e ka adresuar. Komunat e tjera edhe këtë premtim, pra kanë qenë në gjendje të mos ofrojnë shujta për fëmijët I-V vetëm që sot këtu të thonë që Qeveria Kurti nuk e mbajti premtimin. Njëherësh e kemi ndarë buxhetin për shujta edhe në vitin 2023. Për herë të parë kemi filluar politika të reja në realizimin jo vetëm të premtimeve tona, por edhe adresimit të domosdoshmërive për të bërë më të mirën për fëmijët tanë.

Kemi ndarë buxhetin për asistentë të fëmijëve me nevoja të veçanta, për pesëqind asistentë kemi ndarë buxhetin. Nuk janë të punësuar, janë nga komunat, shumica e atyre akoma edhe sot privojnë familjet dhe fëmijët me nevoja të veçanta nga e drejta e përfitimit të shërbimeve, me qëllim që të flitet këtu dhe të thuhet që Qeveria nuk mbajti premtimin.

Kemi ndarë për herë të parë buxhetin për punësimin e specialistëve të IT-së për t'i rritur punësimet, kanë obligim ta bëjnë komunat sipas Ligjit për arsimin nga komunat. Si Qeveri u kemi ndarë buxhetin.

Për herë të parë kemi ndarë buxhetin për punësimin e këshilltarëve të karrierës prej klasës VI-IX, 59 këshilltarë të karrierës janë të buxhetuar nga Qeveria. Shumica e komunave nuk i kanë punësuar.

Kemi ndarë buxhetin për punësimin e 550 pedagogëve dhe psikologëve. Komunat që qeverisen nga kryetarët që ju sot bëni zhurmë këtu, kryetarët e partive tuaja, nuk kanë punësuar pedagogë dhe psikologë, paçka se e kanë buxhetin e ndarë edhe për punësimin e tyre.

Kemi ndarë buxhetin për mbështetje të mësimdhënësve me probleme shëndetësore. Shumica e komunave nuk e kanë shfrytëzuar as këtë buxhet. kemi bërë gjithë atë që është në mandatin tonë që mësimdhënësit që kanë probleme me sëmundje serioze të mos obligohen e të brengosen edhe për aspektin financiar. Komunat as këtë buxhet nuk e kanë përdorur në mbështetje të nevojave të mësimdhënësve.

U fol këtu për projektet për kthimin e bashkatdhetarëve në punësim. Po është e vërtetë, na është dashur shumë punë që të ndryshojmë legjislacionin në fuqi. Tash, p.sh. në statutin e ri të miratuar të Universitetit të Prishtinës, të gjithë profesorët të cilët janë të punësuar në top-pesëshen e universiteteve më të mira botërore, mund të kthehen pa procedura dhe pa pengesa formale, të cilat i kemi gjetur dhe është dashur t'i adresoj më tutje.

Nëse po flasim me shifra, çfarë kemi bërë, sepse u përmend disa herë. U përmend nevoja dhe premtimet tona dhe mbështetja që kemi bërë për të rinjtë dhe studentët. Përveç që kemi bërë lirim nga pagesa për të gjithë të rinjtë që vijojnë studimet në universitetet publike, për këtë

mandat kemi ofruar bursa për 5175 studentë që kanë përfituar nga bursat elitare. Kemi ndarë 4883 bursa për studentët e fushave STEM, shumica dërmuese e tyre vajza dhe gra, nga një mijë euro për secilën prej tyre për tre vjetët e mandatit tonë.

Nga viti 2022 kemi ndarë dhe kemi filluar për herë parë politikën për mbështetje të studentëve nga radhët e komuniteteve. Kemi ndarë dhe kemi filluar për herë të parë politikën e ndarjes së bursave për studentët me nevoja të veçanta, në vlerë prej 61.712 euro për secilin student me nevoja të veçanta. Kemi ndarë bursa për studentët që studiojnë në top 150 universitetet më të mira botërore. Kemi filluar si politikë e re për herë të parë, kemi filluar me këtë politikë dhe kemi mbështetur 93 djem e vajza që studiojnë në top-universitetet më të mira botërore.

Kemi ndarë bursa për studentët e nivelit të doktoratës që studiojnë në top 500 universitetet më të mira në botë, gjithsej 110 bursa.

Kemi përkrahur 52 projekte shkencore, 86 publikime në revista me impakt-faktor, kemi përkrahur shtatë botime dhe monografi shkencor, kemi përkrahur 129 hulumtues, profesorë nga skema e programit kombëtar të shkencës për mobilitet afatshkurtër të shkencëtarëve. Kemi realizuar financimin e gjashtëmbëdhjetë projekteve të përbashkëta.

KRYETARI: Urdhëro edhe një minutë, zonja ministre, nëse ke mundësi ta përmbyllësh, ndoshta shumë të gjata janë këto.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Kemi ndarë për herë të parë kuponët në vlerë prej 574.200 euro për maturantët e shkollës së mesme të lartë, për të ndjekur kurse të profilit të teknologjisë informative. Kemi mbështetur fëmijët me talente dhe ata me nevoja të veçanta dhe organizata që punojnë me këta fëmijë. Kemi ndarë për herë të parë bursa për vajzat që studiojnë e ndjekin mësimin në profile deficitare me vlerë prej 500 euro në vit dhe që vijon për tre vjetët e shkollimit. Kemi ndarë 496.690 euro për qendrat mësimore të fëmijëve rom, ashkalinj e egjiptian dhe vazhdojmë me mbështetje në arsimin e lartë, në përmirësim të infrastrukturës shkollore për ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve, sallave të edukatës fizike, furnizimit të shkollave me pajisje dhe laboratorë dhe politika të tjera.

KRYETARI: Zoti Rrahmani ka kërkuar replikë me ministren Nagavci.

EMAN RRAHMANI: Unë ministres i kërkova t'i tregojë popullit se sa para i ka shpenzuar për një agjendë të tillë, po ministrja doli te udhëzimi administrativ, të cilin edhe pas katër vjetësh nuk e ka hequr, përmes të cilit një muaj një vajzë në Pejë është ndaluar të shkojë në shkollë, që përgjegjëse direkte për të gjitha pasojat që ajo vajzë dhe secila i ka pasur përgjatë këtyre katër vjetëve, janë tuajat personale dhe të askujt tjetër.

Meqë u bëri thirrje edhe e promovoi që ajo kurrikulë është e dobishme për fëmijët, për nxënësit, për mësimdhënësit, unë po ju tregoj edhe pak çka shkruan në atë kurrikulë. Në atë kurrikulë thotë që organi gjenital nuk është ashtu siç duket në pornografi. Në atë kurrikulë shkruan që fëmija mund t'i ketë dy nëna dhe dy baballarë. Në atë kurrikulë shkruan që gjininë që ia kanë treguar prindërit, mund të mos jetë e vërtetë, atë do ta kuptoni pas moshës 16 ose 18-vjeçare. Kjo është ajo kurrikulë që ti e ke pranuar prej ministrisë. Dil prezantoje këtu, nëse është sukses, në detaje. Shpjegoje, mos më lë mua të flas prej këndit tim. Nëse unë po manipuloj, nëse unë kam interes personal, ti shpjegoje, është punë e jotja kjo. Ti e ke miratuar atë dhe e ke prezantuar në faqen e Ministrisë. Atëherë, dil e tregoji popullit se çka ke bërë. Urdhërohen mësimdhënësit t'i tregojnë përvojat e tyre seksuale fëmijëve, prej shtatë vjeç deri në moshën dymbëdhjetë vjeç është kjo kurrikulë, të cilën e ka prezantuar ministrja.

Thjesht po ju them, mos u fsheh, dil, tregoji popullit që populli të vlerësojë për punën që e ke bërë. Është kaq e thjeshtë, kaq e ndershme. Po nuk mundeni më. Fshehurazi e ke bërë, fshehurazi ke provuar ta bësh këtë punë dhe nuk ke a mundësi të dalësh e ta shpjegosh këtu. Prandaj, sillesh kështu si sillesh.

KRYETARI: Ministrja Nagavci. Jo, jo, fjalimin e pati kjo, edhe ne e përmirësua kohën. Nuk ishte kohë e replikës, po ishte kohë e fjalimit. Kështu që, edhe një kundër-replikë ia japim. Urdhëro ministre. Një minutë ministre.

MINISTRJA ARBËRIE NAGAVCI: Shkurt,

Deputeti Rrahmani vazhdon që për interesin e vet të thotë të pavërteta në këtë foltore. Pra, e ke filluar me atë duke thënë që vajzave po u pamundësohet shkollimi, nuk qëndron. Nuk kemi asnjë vajzë që nuk vijon shkollën. Tani vazhdon si gjithmonë me të pavërteta të tjera.

KRYETARI: Kë e kemi tash në rend? Më duket që e kemi Lëvizjen Vetëvendosje. A shkojmë me Vetëvendosjen ashtu siç grupi parlamentar i ka caktuar këtu fjalimet apo si? Ardian Gola.

Ardian Gola është sipas radhës që ma ka sjellë grupi parlamentar.

ARDIAN GOLA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë,

S'ka dyshim, ky është projektligj jashtëzakonisht i rëndësishëm që përcakton edhe dinamikat jo vetëm politike, por edhe shoqërore në përgjithësi të vitit vijues.

E kuptoj luftën politike. Nganjëherë, misioni, poenta e retorikës së diskursit politik është që t'i interpretojë faktet konform një pozicionimi të caktuar ideologjik e politik dhe në këtë kontekst më pastaj edhe qytetarët mund të lajthiten në mënyrë se si duhet të kuptohen faktet në terren.

Për mënyrën e rritjes progresive të buxhetit në fushën e arsimit foli edhe ministrja. Aty nuk ka shumë çka për t'u komentuar, për shkak se është krejtësisht e dukshme. Normalisht, përgjatë këtij mandati është bërë, unë mendoj ajo çfarë ka qenë e mundshme të bëhet. Arsimi është një çështje, për të cilën po vazhdoj ta ritheksoj nevojën për një konsensus politik në nivelin nacional.

Ato që i tha ministrja Nagavci ishin tepër shqetësuese për sa i përket mënyrës se si komunat e Republikës së Kosovës kanë reaguar në kërkesat e pandalshme të ministrisë për të shfrytëzuar buxhetin e ndarë për çerdhe, për shkolla, për punësimin e asistentëve, për fëmijët me nevoja të veçanta e kështu me radhë. Pra, kjo është një fakt që na jep të kuptojmë se nuk është duke u perceptuar dhe nuk është duke u përjetuar arsimi në Kosovë si çështje me prioritet nacional. Pa arritur një konsensus politik të nivelit nacional, është shumë vështirë të arrihet më shumë sesa ka arritur të mbërritët.

U përmend rikthimi i trurit, disa intervenime strukturore tashmë janë bërë. Statuti i UP-së, për të cilin unë publikisht kam shprehur rezerva, normalisht që ka shumë gjëra të mira, të cilat duhet përkrahur në implementim e sipër. Pikërisht njëra nga këto është edhe lehtësimi i procedurave të rikthimit të trurit dhe eventualisht pranimit të profesorëve të cilët kanë bagazh shkencor e ndërkombëtar, ashtu që të bëhen pjesë e universitetit. Statuti ka kaluar në korrik, normalisht tash kemi një menaxhment të ri, i cili ka marrë mandatin më 1 tetor. Ne presim që këto dispozita të cilat e lehtësojnë angazhimin e trurit jashtë Kosovës të shfrytëzohen dhe të pasurojnë jetën akademike dhe profesionale të Universitetit.

Normalisht, është mirë që të ketë një fond ndoshta shkencor në nivel nacional, prej të cilit do të mund të përfitonin të gjitha universitetet. Sido që të jetë, kjo mund të jetë një çështje që meriton trajtim më subtil. Po besoj që gjatë mandatit të ardhshëm, mendoj që duhet të bëhet diçka në këtë drejtim.

Sido që të jetë, statistikën që tregojnë dhe pjesërisht u përmendën nga ministrja, flasin që ka një përkrahje të shkencës nga Qeveria Kurti 2, pasi që janë përkrahur me dhjetëra e mijëra projekte të vogla dhe relativisht të mëdha në fushën e shkencës në Republikën e Kosovës. Është mundësuar po ashtu edhe participimi në Horizont 2020, një program masiv në të cilin duhet investuar shumë kapacitete për të mundësuar përthithjen e fondeve që i mundëson ky projekt i BE-së që shkon në dhjetëra miliarda euro.

Arsimi dual është një fushë në të cilën mendoj se janë krijuar fakte të prekshme, të cilat na bëjnë të kuptojmë që kemi një lëvizje kualitative për sa i përket lidhjes ndërmjet tregut të punës dhe arsimit.

Aktualisht kemi dymbëdhjetë profile në njëzet e tri shkolla profesionale dhe katërbëdhjetë komuna me gjithsej 1 588 nxënës. Janë futur në zbatim gjashtë kurrikula të reja dhe janë miratuar e pritet të hyjnë të zbatim edhe tri kurrikula të reja.

Kështu që, janë vetëm disa fakte të cilat është mirë të thuhet dhe të pranohen, përtej çfarëdo pozicionimi politik që mund të kemi, sepse kjo ndikon edhe në perceptimin sa më të drejtë të këtyre fakteve në perceptcionin publik.

Është mirë të përmendim edhe një fakt tjetër, e që është futja e Kosovës në binarë të duhur sa i përket rikthimit në dy organizatat shumë të rëndësishme të cilësisë në arsimin e lartë, në ENQA dhe EQUAR. Ne aktualisht jemi rrugës për të përmbushur edhe një kriter që është shumë i rëndësishëm për rikthim të Kosovës, respektivisht Agjencisë së Akreditimit në EQAUR, e që është përzgjedhja, respektivisht emërimi i anëtarit student në Këshillin Shtetëror të Cilësisë. Për aq sa ne kemi informata, krejt procesi i rikthimit po menaxhohet jashtëzakonisht mirë, në mënyrë profesionale nga agjencia dhe si asnjëherë më parë, kjo agjenci është komplet immune në raport me intervenimet politike, që kanë qenë pjesë e një praktike të mëhershme në raport me këtë institucion.

Nëse e sheh mozaikun në tërësi, mendoj që janë bërë intervenime jashtëzakonisht të duhura në përforcimin e sistemit, por nganjëherë, për shkak se duken minore, sepse mund të duken edhe si pjesë amvisërie, kjo e bën që pastaj të vijojë larg perceptcionit publik.

Megjithatë, këto ndërhyrje strukturore sistematike janë duke e përforcuar sistemin në atë mënyrë që efektet më pastaj t'i shohim normalisht pas një kohe. Sepse, ashtu sikurse edhe e kam thënë, intervenimet në arsim nuk prodhojnë efekte të atypëratyshme, sepse nuk është asfalt. Kështu, p.sh. ta zëmë bursat që janë dhënë në fushën e STEM-it (Science, Technology, Engineering and Math).

STEM është fusha të cilat do të përkthehen edhe në përfitim ekonomik pas një dekade, dy e kështu me radhë, sepse jemi duke ndërtuar kualifikime që do t'i ndihmojnë shumë jo vetëm sistemit arsimor, po edhe sistemit social dhe politik në përgjithësi në Kosovë.

Andaj, marrë gjërat nga kjo perspektivë, mendoj që të paktën çështjet e arsimit është mirë që të mos interpretohen politikisht, por të interpretohen larg çdo ngjyrimi dhe pozicionimi politik, ashtu që qytetari të jetë i informuar drejtpërdrejt dhe të mos vihet në lajthitje për sa i përket perceptimit të këtyre fakteve. Faleminderit!

KRYETARI: Tash është radha e Partisë Demokratike, deputeti Bekim Haxhiu është në rend këtu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në vija të trasha të jap opinionin tim për këtë buxhet, të cilin e ka dërguar Qeveria, që në fakt ka një rritje prej 8,8 për qind krahasuar me vitin paraprak. Kjo rritje është edhe si pasojë e rritjes së çmimit dhe inkasimit të TVSH-së, por nëse e krahasojmë këtë rritje të buxhetit me buxhetet e kaluara nga viti 2007 deri në 2023, ka pasur një projeksion të rritjes së buxhetit çdoherë në shumën mbi 24 për qind, ndërsa kjo është Qeveria që këtë rritje të buxhetit e bie në 8.8 për qind dhe lavdërohet me këtë.

Nëse e analizojmë buxhetin për paga, mëditje, subvencione, transfere dhe shërbime të tjera, dhe bartje të investimeve kapitale nga viti në vit, pa i përfunduar ato, konkludojmë se përveç gjakderdhjes financiare, kemi masakrim të buxhetit për nevoja të pushtetarëve në dëm të qytetarëve.

Flasim me fakte dhe me gjuhën e numrave. Po filloj nga Kuvendi i Kosovës, që për paga e mëditje ka planifikuar të shpenzojë 9,1 milionë euro për 528 të punësuar, e ku përfshihen pagat për 120 deputetë, disa edhe që s'vijnë hiç, do edhe që s'flasin asnjëherë, edhe për këta paguhet, edhe 182 asistentë e këshilltarë staf politik. Pjesa tjetër janë administrata e Kuvendit. Nëse e krahasojmë këtë buxhet me pagat në vitin 2016, në kohën kur në Kuvend kryetar ishte Kadri Veseli, kishte 357 të punësuar dhe bashkë me deputetë për paga e mëditje shpenzoheshin 6,2 milionë euro. Tani me Lëvizjen Vetëvendosje në pushtet si parti majtiste, kemi 171 të punësuar më shumë staf politik dhe mbi tre milionë euro shpenzime për paga e mëditje më shumë. Derisa pagat e politikanëve dhe stafit të tyre politik janë rritur me Vetëvendosjen në pushtet, ato të punëtorëve...

KRYETARI: Pse nuk e ke refuzuar asistentin, pra z. Haxhiu?

BEKIM HAXHIU: ...ato të punëtorëve nuk kanë pësuar ndryshim. Prandaj e kemi grevën e punëtorëve të mirëmbajtjes së Kuvendit e që Lëvizja Vetëvendosje nuk e qan hallin për to.

Zyra e Presidentes në vitin 2016 kishte shtatëdhjetë të punësuar, në total për paga e mëditje 770 mijë euro. Sot në buxhetin e vitit 2025, Zyra e Presidentes ka 83 të punësuar me 1,4 milionë euro paga e mëditje, qind për qind më shumë.

Për mallra e shërbime në 2016 ishin 1 189 000 euro, tash në vitin 2025 janë dy milionë e gjysmë.

Zyra e Kryeministrit, besoni apo jo, i ka 609 të punësuar, ndërsa vetëm kabineti i ngushtë i Kryeministrit i ka 109 të punësuar. Këta që i kanë kritikuar krejt qeveritë e kaluara për megalomani në kabinete qeveritare, i kanë rritur numrat në kabinetin e tyre me këshilltarë e staf politik deri aty sa që kemi dyfishim të vlerës për paga dhe mëditje në Zyrën e Kryeministrit. 5

314 000 euro për paga e mëditje, 6 050 000 euro për subvencione e transfere. Nëse i krahasojmë me pagat e vitit 2014, kur Kryeministër ishte Hashim Thaçi, atëherë ishin 3 600 000 euro, dyfish më pak për paga e mëditje e sot me Kurtin paga e mëditje, mallra e shërbime, subvencione e transfere, besoni apo jo, janë 19 170 000 euro shpenzime në Zyrën e Kryeministrit.

Kjo pra është ajo që ju thashë, jo vetëm gjakderdhje financiare, po është vërtet masakrim i buxhetit për nevojat e politikanëve që e rritin luksin për vete, e nuk e qajnë hallin për qytetarët. Kjo nuk është vetëm zhvatje, po edhe hajni drejtpërdrejt në Zyrën e Kryeministrit, për çka do të duhej të merrej prokuroria.

Të kthehemi te shëndetësia. Për 5 vjet të Qeverisë Kurti 1 dhe 2, dështim në reformimin e sistemit shëndetësor. Dështimin në miratimin e Strategjisë për shëndetësi. Dështim në miratimin e legjislacionit. Dështim në funksionalizim të sistemit të informimit shëndetësor. Dështim në funksionalizim dhe implementim të sigurimeve shëndetësore. Dështim i Qeverisë në menaxhimin e sektorit të shëndetësisë.

Për listat e pritjes po i referohem raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit i publikuar më 27 gusht 2024. Ai thotë: “Klinikat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës kanë këtë listës të pritjes për pacientë. Klinika e Kirurgjisë Vaskulare mbi 2 mijë pacientë në listë të pritjes. Mesatarisht 2,8 vjet pritje. Klinika e Ortopedisë 1 mijë e 300 pacientë, 2 vjet pritje. Klinika e Oftalmologjisë 1 120 pacientë, 6-7 muaj pritje. Klinika e Kardiologjisë rreth 3 mijë në listë të pritjes. Dhe, lista e pritjes prej 6 muaj deri në 1 vit. Klinika e Radiologjisë 2 500 pacientë në pritje, 6 muaj. Klinika e Kardiokirurgjisë 50 pacientë, 2-3 muaj dhe kohëve të fundit është rritur nga 4-6 muaj”.

Pra, nëse e kemi këtë raport të Zyrës Kombëtare të Auditimit për listat e pritjes dhe në anën tjetër pushteti po mburret se i ka rritur shërbimet, atëherë diçka nuk është në rregull këtu. Ose kemi rritje aq të madhe të sëmundjeshmërisë edhe pushteti po mburret me rritjen e sëmundjeshmërisë. A është kjo pasojë e manganit, ujit, kushteve higjienike të tjera, është çështje e cila duhet të analizohet, por nuk mund të manipulohet. Se nuk mund të shkojnë të dyja, edhe të mburresh me sëmundjeshmërinë edhe të mos e përmendësh manganin, se tani kur ta përmendësh manganin të asocion te uji, kur e përmend ujin, uji asocion te korrupsioni edhe te arrestimi i Nazif Hafizit për korrupsion të ambalazhuesit e ujit.

Për Projektbuxhetin e SISH-ti, për zhvillimin e SISH-it kanë qenë 4 milionë e 50 mijë euro të planifikuar. Nuk janë shpenzuar. Ky projekt deri në 2027-tën parasheh të shpenzojë 17 461 000 euro. Pyetja sot është: ku do t'i çoni këto para? A është projekt i ri? A po vazhdohet i vjetri? A jeni ju ata që e keni kritikuar atë projektin e zhvillimit të SISH-it, ku nuk e dinë kah kanë shkuar 22 milionë euro dhe nuk i kemi funksional? A duhet tash edhe 17,5 milionë t'i fusim edhe prapë të mos jetë funksional? Ky është keqpërdorim dhe keqmenaxhim.

Te investimet kapitale në shëndetësi vërtet ndjej keqardhje. Projektet të reja të shëndetësi. Të mburrësh, 360 milionë euro buxhet. A e dini sa është vlera e projekteve të reja në 2025-tën. 990 mijë euro. Krejt të tjerat tek investimet kapitale janë projekte të bartura të papërfunduara e që qytetarët detyrohen t'i paguajnë shërbimet nga xhepi i tyre në mungesë të aparaturave, në mungesë të kujdesi shëndetësor për shkak të listave të pritjes e problemeve të tjera të cilat janë.

T'i quash projekte si modernizimi i infrastrukturës në spitalet tona; për çfarë modernizimi po flasim, të nderuar kolegë deputetë. Po për modernizim flet Japonia, flet Amerika, flet Anglia, flet Gjermania. Po bëji funksionale nyjat sanitare, se po hyre në WC nëpër spitalet tona kundërmon era. Të mos vidhni në projektet. Të mos paguani 32 euro largimin e një tepisoni. Të mos e paguani 85 euro largimin e një dere. Të mos e paguani 20 euro demolimin e një amstrongu.

Ato investo që të përmirësohen qysh duhet kushtet, e në veçanti aty kur luftohet për jetën, në salla të operacionit edhe në kujdesin intensiv.

Zero investime kapitale të reja në Qendrën Klinike Universitare. Zero investime të reja në Qendrën Klinik Stomatologjike. Dhe, zero investime të tjera në sektorin e administratës.

Tani, krejt ministrat i kam pyetur, si është mundur që të rritet buxheti për barna, e mungesa për barna të jenë të vazhdueshme, e pacientët t'i blenë vet? Nëse e shikojmë raportin e SHSKUK-së për vitin 2023 i publikuar në gusht të këtij viti, rezulton se për barna furnizimi ka qenë i dobët.

Kjo është kështu: produkte farmaceutike 53%, ndërsa material shpenzues 67%, e këtu neve na janë mburrur nga Qeveria që me 90% ka qenë ky furnizim. Pse po ndodh kjo që po rritet buxheti për barna, mungesat po janë të vazhdueshme? Sepse ka hajni të madhe në këtë sektor, e në veçanti kur përpilohet lista esenciale e barnave...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Kjo ndodh, sepse lista esenciale e barnave nuk bëhet për interesa të pacientëve, por atë po e determinojnë grupet e interesit të lidhura ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, e që sektorin e farmacisë e kanë shndërruar në një vrimë të zezë, ku vetëm hidhen mjete e të tjerët i vjedhin, e pacientët detyrohen t'i blejnë këto vetë.

Nuk po dua ta zgjas më shumë, sepse edhe koha është e limituar, por mijëra punëtorë shëndetësorë, punëtorë të administratës kanë kërkuar t'u ndryshohet koeficienti, e kjo nuk është bërë, sepse u është thënë se është shkelje ligjore.

Tash, me Ligjin për buxhetin ndërhyhet në koeficient. Pra, për interesa elektorale ka pasur mundësi të ndryshohet koeficienti, por për interesa të punëtorëve shëndetësorë, për stafin mbështetës, stafin administrativ, stafin teknik nuk është bërë një gjë e tillë.

Dhe, i kemi edhe specialistët që po paguajnë nga 500 euro në muaj. Në vend se të inkurajohen e të stimulohen ata po penalizohen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Tash flet deputetja Doarsa Kica-Xhelili. Po do replikë, ministër? Replikë, Arben Vitia, ministër i Shëndetësisë. Replikën e ka me deputetin Haxhiu.

MINISTRI ARBEN VITIA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë

I nderuar deputet Haxhiu,

Si zakonisht me shpifje, me manipulime dhe me çdo gjë tjetër që vetëm ju dini të bëni në këtë mënyrë.

E para, zoti Haxhiu, listat e pritjes pas pandemisë, siç e dini gjatë kohës së pandemisë e gjithë infrastruktura shëndetësore ka qenë në shërbim të pandemisë. Dhe, juve kur po ju përshtatet po thoni në kohën e pandemisë ka ndodhur kështu, kur s'po ju përshtatet, po harroni që ka ekzistuar pandemia krejt.

Dhe, po është e vërtetë që pas kësaj ka pasur lista të gjata të pritjes, të cilat tani me investimet që janë bërë në infrastrukturë me aparatura të reja janë shkurtuar dukshëm nga 20-30 deri në 80 e 90 për qind.

E përmendët ju si ishin, çka do të bëjmë deri më 2027 me 13 milionë euro. Ju garantoj që nuk do t'ia bëjmë si ju që ia keni bërë nga viti 2010, 2011 deri në vitin 2020, ku janë harxhuar miliona e miliona euro për SISH-in dhe sot jemi në pikën zero.

Çdo pikë është ndërtuar plani i veprimit me studim fizibiliteti dhe çdo cent është i përcaktuar se ku do të shkojë dhe ka hyrë në rrugë, ka hyrë në binarë më në fund zoti Haxhiu, sepse ju s'keni dashur ta shtini në binar. Tash ne e kemi shti në binarë dhe ajo do të bëhet patjetër.

E përmendët, zoti Haxhiu, listën e barnave esenciale. Për besë për keqardhje. Më së miri, lista e barnave esenciale ka qenë në vitin 2015-2016, diku me 50%, por me shumë më pak produkte dhe me shumë më pak vlerë monetare për këtë listë të barnave esenciale.

Sot që po flasim, zoti Haxhiu, për barna është diku rreth 70%. Për materiale shpenzuese e kalon 80%...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Urdhëro edhe një minutë, po e ke edhe fjalën e plotë nëse do. Urdhëro!

MINISTRI ARBEN VITIA: Kurrë nuk ka qenë kjo më herët. Që t'jua jap veç një pasqyrë. Në vitin 2015-2016, 4.2 milionë euro për Onkologji. Niveli i furnizimit në përqindje, 29 për qind. Në vitin 2019, 8,2 milionë euro për Onkologji. Niveli i furnizimit, mesatar po flasim, ka qenë diku rreth 40%.

Në vitin 2024 janë mbi 13 milionë euro, ku niveli i furnizimit në mesatare është mbi 92%. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Haxhiut, kundër-replikë!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër, më duket që keni problem me të dëgjuarit! Unë iu referova dy raporteve zyrtare, njëri i Zyrës Kombëtare të Auditimit i publikuar më 27 gusht 2024 për listat e pritjes. Nuk e thashë timin.

Dhe e dyta, thashë raporti i punës së SHSKUK-së i përpiluar nga bordi të cilin ju e keni miratuar. Përnjëmend je bërë bajat, po shpifni, po shpifni, po shpifni.

Shiko! Unë ju flas në bazë të raporteve zyrtare të publikuara. Ju keni problem kur flisni për SISH-in, SISH-i nuk ka filluar më 2010-2012, ka filluar më 2006, por atëherë ke qenë duke u marrë me tjetër punë. Ke qenë duke u marrë me tregti të barnave. Prandaj, as nuk pres që do ta ndreqësh këtë sektor.

Referoju, nëse këto janë raporte të rreme, shkarkoje bordin se bordin që e ke emëruar ti e ka bërë këtë raport.

KRYETARI: Deputetja Doarsa Kica-Xhelili e ka fjalën.

DOARSA KICA-XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Natyrisht që sot prapëseprapë dëgjuam sulme ndaj Gjykatës Kushtetuese se s'kishte si të ishte ndryshe. Dhe, unë nuk mund të mos e them një thënie që thotë që sulmi ndaj Gjykatës Kushtetuese nga qeveritë është sikurse sulmi që hajni ia bën drynit dhe ankohet pse vendi që do ta vjedhë ka dry. Kjo është logjika e njëjtë.

Logjika e sulmeve të Gjykatës Kushtetuese. Madje-madje, kryeministri dhe natyrisht ministrat, sepse këta s'mund të mendojnë ndryshe nga kryeministri, sepse këta nuk mendojnë, filluan të flasin edhe për atë se si Gjykata Kushtetuese paska balancuar vendime për ta krijuar njëfarë balance mes pushteteve, mes pozitës e opozitës.

Janë dy gjëra që këta interesant nuk i thonë asnjëherë kur flasin për çështjen e Gjykatës Kushtetuese. E para, është fakti që harrojnë që Gjykata Kushtetuese ka rrëzuar qeveri që u ka ndihmuar këtyre të vijnë në pushtet. E dyta është që harrojnë të shpjegojnë që në ato ligjet që po i sjellin në Kuvend e po ua rrëzon Gjykata Kushtetuese, janë disa fjali që mundohen ta shtrojnë kontrollin politik të kësaj Qeverie në drejtësi.

Çudi e madhe pse s'i përmendin këto çështje. Dhe, asnjëherë nuk vijnë të analizojnë se cilat janë ato elemente që ua rrëzojnë këto ligje në Gjykatë Kushtetuese. Flasin për çështje të çmimeve tavan. Flasin për reforma të tjera në drejtësi, e dy elemente që prapë i harrojnë është të shpjegojnë që ne jemi ekonomi e lirë, konkurrencë e lirë dhe jemi shtet demokratik.

Çështja tjetër. Më vjen shumë interesant meqë dorën në zëmër, kryeministrin e kam konsideruar dhe në një masë e konsideroj si një person mjaft inteligjent dhe e kam problem ta konceptoj... Hala... Dhe, e kam problem ta konceptoj që ai nuk e di kur një ligj është kundër-kushtetues. Shanse s'ka që të mos e dijë.

Dhe, kjo e konfirmon vetëm një gjë, që ai duke e ditur që ligjet i ka kundër-kushtetuese i sjell, sepse duke dështuar të bëjë çfarëdo ndryshimi në këtë mandat 4-vjeçar, është mjaftueshëm inteligjent që t'i bëjë ligjet asisoj që t'ia rrëzojnë në Gjykatë Kushtetuese, që mandej faji t'i mbetet opozitës pse s'po bëhet asnjë ndryshim në këtë vend.

Kështu që, është mjaft inteligjent në këtë aspekt, të them të drejtën. Sepse duhet të kesh goxha kreativitet të arrish t'i bësh 10 ligje kundër-kushtetues e për të dhjetat t'ia lësh fajin Gjykatës Kushtetuese dhe të thuash, balancim. Ta quash balancim. Balancim që Gjykata Kushtetuese po ia bën, ndër të tjera, një partie opozitare sikurse është LDK-ja të cilës ia ka rrëzuar Gjykata edhe një kryeministër edhe një president. Ja për cilën Gjykatë Kushtetuese ju flisni që po bën balancim politik. Balancimi i vetëm që ju vyen juve është i logjikës, sepse diku ka humbur fija.

Po dua ta përmend veç edhe një element tjetër. A e dini në cilat shtete në botë qeveritë e kanë këtë qasje sikurse që e ka kjo Qeveri ndaj Gjykatës Kushtetuese. E ka Rusia, e ka Bjellorusia, e ka Kamboxhia, e ka Irani, e ka Kina, e ka Venezuela, edhe Kosova.

Kryeministri foli, ndër të tjera, me njëfarë krenarie, tha, sot e kemi një familje që ka një djalë me bursë e vajzë në STEM, po harroi ta përmend që familjet e njëjta sot kanë vajza e djem, të cilët duhet t'i nxjerrin produktet prej shportave ushqimore në dyqan. Familjet e njëjta.

Për më tepër, prapë foli për çmimet tavan, thujse krejt Kosova ka mbetur veç në disa produkte bazë. Domethënë, krejt jeta në Kosovë sot është shndërruar në produkte bazë. Buka që ka shkuar nga 35 centë në 50 e 60 në vende të caktuara është gjëra e vetme për të cilën këta mendojnë, se lëre më të flasim për pushime një herë në vit dhe për jetë të mirëfilltë.

Lavdërohen për subvencione, sepse ky është konceptimi i shtetit social, ndihma, sepse nuk janë në gjendje të zhvillojnë dhe duhet të ndihmojnë.

Çka ishte edhe më interesant, foli për familje që e ka të birin polic me krenari, e si policit i është rritur paga dhe duhet të ketë dinjitet, por harroi ta përmendë atë policin tjetër që duhet ta qep vet shiritin e pantallonave. Harroi ta përmend. Harroi, sepse nuk është temë me të cilën ndjehet edhe shumë krenar, sikurse nuk është temë që ndjehet krenar, edhe ai zyrtari tjetër i FSK-së, ish-ushtar i UÇK-së që duhet t'i bëjë dy punë që të mund të mbijetojë. Dhe, duke tentuar të mbijetojë, vdes në vendin e punës.

Nuk po them që po ndodh për herë të parë në Kosovë që dikush vdes në vendin e punës, por për çka po lavdëroheni, për çfarë ndryshimi po lavdëroheni.

Foli për miliarda në buxhet, por nuk ju foli se si këto miliarda të taksave tuaja janë zhvlerësuar teksa këta i kanë bllokuar në buxhet. Foli për buxhetin më të madh ndonjëherë, e flasin me terma milionë, e miliardë etj., etj., por edhe diçka tjetër harrojnë të përmendin, ato të holla janë tuaja, qytetarë të Republikës së Kosovës, sepse ju keni paguar dyfish. Nuk i kanë pikur prej qiellit. Nuk ia ka falur askush. Përkundrazi, plot mjete që është dashur dikush t'ia falë, sot bllokohen për shkak të sanksioneve. E këto mjete për të cilat këta krenohen që qenkan dyfishuar janë të xhepave tuaj që keni paguar dyfish në këto katër vjet.

Ju sot, derisa dikur e keni shpenzuar 30% të pagës suaj për të mbijetuar me këto produkte bazë, sot duhet t'i paguani 60%.

Diçka tjetër. Nuk folën fort mirë edhe për subvencionet që i kanë dhënë për energji elektrike, sepse natyrisht e përmenden vetëm pjesë e vetë-subvencionimit, por harruan të tregojnë që energjia elektrike u dyfishua në kohën e tyre, dhe ju e dini saktësisht emrin e personit i cili e ka negociuar energjinë elektrike, e ai quhet Martin Berishaj.

Dhe, për më tepër, juve ju kujtohet që kur kemi qenë duke diskutuar për Martin Berishajn, ka pasur deputetë të pushtetit që thoshin, po janë përçarë bre në Komision Hetimor Parlamentar, pse s'keni zbuluar asgjë. A e dini pse? Sepse ka gënjer në Komision Hetimor Parlamentar për tërheqjet që i ka bërë në Kosovë, dhe asnjëri prej jush nuk keni guxuar ta shpërfaqni këtë të vërtetë.

Për më tepër, Ministria e Punëve të Jashtme ka kontraktuar kontrata për postë, gjashtëfish vlerën në fillim. I ka dështuar ajo kontratë, e tash me çmim të negociuar ka shkuar ka marrë kontratë me çmim nëntëfish prej çmimit që i është ofertuar në fillim.

Gani Jakupin me 7 mijë euro vlerë. Ka pasur deputetë që thoshin, ka lobuar në Spanjë. Domethënë, s'e kanë ditur as deputetët e pushtetit as çka bën ai, sepse askush nuk i ka njoftuar. S'i ka informuar askush.

Qeveria e cila pretendonte të udhëheqtë me duar të pastra, i ka avulluar miliona euro të ambalazhuesve të ujit, e askush prej jush nuk keni mbërri ta kuptoni pse dhe ku shkuan ato miliona euro. E derisa miliona euro janë avulluar të ambalazhuesve të ujit, ju sot s'keni ujë të pijshëm fare, e duhet të shkoni tek ato kompani të cilave ua kanë falë borxhet, që të blini ujë.

Të mos harroni që gjatë krejt kësaj periudhe, disa zyrtarë të afërm me kryeministrin e partinë e tij, i kanë bërë nga 4 banesa pa kredi me paga goxha modeste.

Ministri i Financave më herët foli për një deklaratë të një deputeti të LDK-së, tha, a keni parë çka tha në foltore në gjykatë, nuk e di për cilin rast, por nuk e përmendi edhe një rast tjetër ku ministrja e tij, Rozeta Hajdari shkon në gjykatë dhe mbrohet në heshtje për rastin e rezervave shtetërore.

Dhe, meqë e vërteta juaj qenka kaq e fuqishme, pse s'po e thoni atë të vërtetë? Pse po heshtni kur po ju pyesin? Kur po ju fton gjykata të shkoni të raportoni të dëshmoni, meqë e vërteta juaj është e fuqishme e jona e pavërtetë, pse s'po e thoni të vërtetën aty te vendi. Ndërkaq, deputetët tuaj dalin e thonë nëpër debate politike, hajde të ballafaqohemi, hajdeni këtu të ballafaqohemi. Hajdeni këtu të ballafaqohemi ku i keni rezervat shtetërore. Ky është ballafaqim. S'keni ditur ta justifikoni asnjërin nga ato.

Dhe për fund dhe po e përmbyll. Po dua t'jua lexoj një prej dhjetëra mesazheve që e kam pranuar sot teksa fliste kryeministri dhe ministri Murati, dhe me këtë po e përmbyll. Ja ku e ke, nëse s'besoni që e kam pranuar. Thotë kështu: "Në fjalimin tënd pyete ministrin Murati, e kryeministri Kurti se ku është ky vendi për të cilin po flasim, se qenka shumë i zhvilluar. E kësmet familjarisht po shpërngulemi krejt atje, se qartazi për Kosovë nuk janë duke folur".

Ju mund të flisni çka të doni, po e mira e krejt kësaj pune është që qytetarët e Republikës së Kosovës, veçanërisht ata që jetojnë në Kosovë, e dinë saktë si e kemi gjendjen sot. E ju mund t'iu ofroni ëndrra e përralla në familjet tuaja çdo ditë, po ëndrrat e tyre të shkatërruara ne përjetojmë në lëkurën tonë secilën ditë kur i shohim duke i hequr produktet prej shportave të ushqimit.

KRYETARI: Tash është Aleanca në radhë. Replikë? S'ta ka përmendur emrin. Apo po do të flasësh kështu në përgjithësi? Nëse e bëjmë precedent, ta dini që pastaj hapet shumë kjo mundësi. S'po e bëjmë më mirë. Time Kadrijaj flet.

Kështu, për pozicione politike e kam sqaruar edhe më herët, vetëm shefat e grupeve kanë të drejtë të flasin kur përmendet partia.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetët,

Të nderuara media,

Qytetarë të Kosovës,

Besoje se nga këto ekspozetë që i bën partia në pushtet dhe Albin Kurti, shumica prej jush ndoshta edhe që s'kanë shtetësi shqiptare, do të lakmojnë të vijnë të kthehen në Kosovë edhe të jetojnë prej mrekullive që ka bërë kjo Qeveri.

Albin Kurti prej Vladimirit ka ardhur në pushtet me rrena. Dhe, tash në fund të mandatit po vazhdon të na rrejë prapë. Por, s'i hanë më kush këto fore tuaja e këto rrena tuaja. Se s'po di bile çka është ajo thënie, këta ministrat tuaj aq shumë po rrejën, saqë gati t'iu bëhet hunda si Pinokios prej rrenave të shumta e prej mashtrimeve të shumta.

E vetmja gjë e vërtetë është që e tha Albin Kurti, për herë të parë Qeveria 4-vjeçare edhe që po e prezanton buxhetin për të katërtën herë me radhë. Po, është e vërtetë. Por, kur u ballafaqove me problemet e kur e pate punën ngushtë, fort na pate lutur krejt partive politike që të rrezojmë bre, se ishte ngushtë.

Por, kemi dashur të lëmë të sharrosh kështu e të dalin krejt hajnitë e krejt dallaveret sikurse janë duke të dalë për çdo ditë edhe prej mediave, por edhe prej të gjithëve që po e ballafaqojnë këtë Qeveri.

Shihni këtu prapa, kemi aktakuza. Dhe, një president që kam dëgjuar që asnjëherë s'ka ndodhur këta ministra në objektet e Qeverisë nuk prezantojnë, por shkojnë raportojnë në Lëvizjen Vetëvendosje, se aty i bëjnë politikat. Aty bashkë me Dejonën i marrin politikat, i marrin udhëzimet edhe vendosin qysh të qeverisin. Po, Adnan, ashtu është. Po të qeshet. Dil e fol kur të vijë radha.

Ti je i trajnuari dhe i preferuari i Dejonës edhe ti më së miri e qet kanunin në rend të parë. E mbanë këtë do, re, mi, fa, sol, se për besë jenë bërë shumë qesharak, edhe po më dhimbseni sa qesharakë jeni bërë.

E keni bërë, e keni instaluar një diktaturë. Shihni çfarë po bëni. Mediumet dhe gazetarët të cilët po ju kritikojnë po u vendosni edhe përgjues që t'i përcillni ka po shkojnë, e çka po bëjnë edhe çka po flasin. Por, ju gojën s'mund të na e ndalni. Nuk mund të na e ndalni gojën, se ne to flasim edhe do të vazhdojmë të flasim, sepse ne jemi ata që i kemi dalë zot këtij vendi dhe do t'i dalim.

U fol edhe paraprakisht. Do të ishte mirë dikush të dalë e të thotë se sa njohje na i sollli Gani Jakupi me pagë 7 500 euro? Sa anëtarësime ndërkombëtare, sepse një person që paguhet 7 500 euro është dashur të na sillni ndonjë rezultat, të sillnit ndonjë njohje të re, ndonjë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, po na s'kemi, ose vetë këto para që i ka përdorur Gani Jakupi ndoshta na i sollën sanksionet, se këto sanksione na i keni sjellë ju si qeveri, sepse jemi vend i sanksionuar, e ju sot këtu po na flisni për rezultate e për suksese. Po çfarë rezultatesh e për çfarë suksesesh?

E thanë shumë ekspertë të ekonomisë me shifra, por po e shoh po duan ta elaborojnë për disa kategori: personat me aftësi të kufizuar, pensionet, si shifra, sepse kur merren në total qoftë për veteranët, invalidët apo për pensionistët, kur merret si shumë totale rritja që i është bërë buxhetit, ndoshta duket, edhe mund të mashtroni se qenka bërë kiameti, se na qenkemi bërë çirak, por një pensionist që e merr pensionin 100 euro, çka keni bërë, po u rritët 20%, sa para u rritet pensioni? A me këtë duhet gëzuar ai pensionisti apo veterani, të cilët i keni sanksionuar e keni dashur t'i nënshtroni e t'i përlulni, por nuk ia keni arritur. S'keni arritur as t'i nënshtroni, as t'i përlulni, sepse ata kanë qenë dem baba a do të jenë dem baba dem në këtë vend, se ata janë të dalëzotës të këtij shteti, e jo ju që po mundoheni të shkatërroni gjithçka çka është ndërtuar në këtë shtet.

S'ka filluar historia e Kosovës me juve, po ju do të shkoni prej këtij pushteti, të turpëruar. Po unë nuk e di do që po flasin këtu që po ulërijnë këtu në këtë sallë, çka kanë më shumë t'u thonë nënave gjakovare që i keni keqpërdorur, çka do t'u thoni familjeve të të pagjeturve që i keni keqpërdorur? Shko, thuaju, na jemi koordinuar me Radojçiqin edhe për Gjykatë Kushtetuese, e tha Doarsa, po e përsëris, ndoshta krejt këtë luftë e paskeni pasur që edhe Gjykatën Kushtetuese ta kapni që keni lobuar me Listën serbe që të kooptoni edhe një anëtar të Gjykatës Kushtetuese që të bëni ju çka të doni, që edhe të bëni ligje antikushtetuese, që nuk janë në frymën evropiane, po që i bëni ju në interes tuaj individual, e në interes të Lëvizjes Vetëvendosje.

Po, me turp keni për të shkuar dhe mirë që po shkoni e kurrë më mos u kthefshi në këtë pushtet, se dem e keni çuar këtë vend!

KRYETARI: Zoti Abazi, a e keni kërkuar fjalën? Deputeti Haki Abazi flet.

HAKI ABAZI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara media,

Qytetarë!

Vetë prania e disa ministrave sot këtu tregon që këta e njohin demokracinë veç atëherë kur u duhen paratë. Domethënë, kemi sabotim të punës së Kuvendit për më shumë se një vit, kemi ministra që kanë refuzuar publikisht të japin përgjigje në pyetje të deputetëve, që është mungesë e kulturës bazike e demokratike në një vend demokratik, shtet parlamentar.

Po, po duket që turpi nuk e ka mbytur askënd, sot kur duhet të kërkojnë aprovim të buxhetit, ndodh që ata janë prezentë këtu ose disa prej tyre janë prezentë këtu. Po kjo nuk ndryshon fare prej mentalitetit qeverisës që është adoptuar për katër vjet, një gjë e mirë është që është vendosur një standard i ri. Nuk mundet më retorika të përdoret që na kanë rrëzuar para kohës dhe s'kemi pasur kohë për t'i përmbushur premtimet. Është mandat i plotë katërvjeçar, mendoj që është gjë shumë e mirë, qytetarët e kanë përballë e për bazë matjen. Qytetari e ka kutin e vet, me të cilin i mat arritjet, sukseset, dështimet e secilës qeveri.

Unë e fillova fjalimin sot me brengosjen kryesore të sabotimit të demokracisë, i cili ndërton pabesi ndaj klasës politike. Aq më keq është puna kur kjo vjen prej atyre, të cilët kanë kritikuar për më shumë se dy dekada formën e veprimit të qeverive të tjera. Do të thotë, këtu pabesisë i shtohet edhe hipokrizia. Shpenzime enorme për udhëtime, shpenzime enorme të kota, përdorim i aseteve të shtetit për nevoja personale, përdorim të automjeteve të qeverisë e ekzekutivit për nevoja personale, punësim familjar, shikoni sa deputetë kanë punësuar bashkëshortët ose bashkëshortet e tyre pasi janë hy në pozitën e deputetit që është edhe më keq sa se qeveritë e tjera.

Po nuk është kërkesa për aprovim të buxhetit lavdërim. Unë e thërras ministrin e Financave të tregojë cilat veprime, masa, vendime, politika janë aprovuar në katër vjetët e fundit që kanë shënuar rezultat direkt në rritjen e buxhetit, sepse ky është shtet i tregut të lirë. Buxheti shtohet prej pagesave të sektorit privat, shteti nuk gjeneron fonde, kjo është rren, gënjeshtër. Shteti nuk gjeneron, përkundrazi të gjitha ndërmarrjet publike punojnë me humbje, të gjitha, në një formë ose tjetër të gjitha ndërmarrjet publike janë shpenzues të buxhetit publik. Shumica e ndërmarrjeve publike janë me vonesa në pagesat e punëtorëve, përfshirë Trepçën, minatorët, ata të cilët ne i konsiderojmë si pjesa më e shenjtë e punëtorisë publike në vendin tonë. Po, hajde shkojmë së paku në çështjet të cilat janë premtuar, punësimi dhe drejtësia.

Po flitet për numra enorm të punësimit, ky është mashtrim. Duhet të flitet për numrin e njerëzve të fuqisë punëtore që e kanë lëshuar Kosovën katër vjetët e fundit dhe të bëhet krahasimi se sa vende të punës janë liruuar prej atyre, të cilët janë larguar prej Kosovës. Kjo është forma qysh shtrohet çështja. Nuk janë ata njerëz në vendet e tyre të punës e që janë krijuar vende të reja të punës, për të cilat ne mund të krenohemi sot, është numri i madh. Nuk po luaj me shifra, me siguri mbi 150 mijë që e kanë lëshuar Kosovën në katër vjetët e fundit si rezultat i mungesës së perspektivës. Si rezultat i gënjeshtres që do kemi inspektorë për të drejtën e punëtorit.

Dhe, në fakt, e drejta e punëtorëve edhe në sektorin privat, edhe në sektorin publik është degraduar pikërisht nga mungesa e dijes se si duhet zbatuar politikat e mençura për ta mbrojtur të drejtën e punëtorit. Pikërisht për shkak të anashkalimit të sindikatave të pavarura të secilit sektor nga dialogu social.

Kush është aty për ta mbrojtur të drejtën e punëtorit në Kosovë? Përveçse ndonjë pronar i ndërgjegjshëm i kompanisë, ose ngritje e vetëdijes së atyre të cilët e konsiderojnë punëtorin si të rëndësishëm, ose punëtoreshën si të rëndësishme për kompaninë. Përndryshe, nuk ka mbrojtje.

Ndërsa, të drejtësia janë dy elemente shumë të rëndësishme: një është që policia hetuese që e kryen punën e parë në rastin e krimit, korrupsionit, është e ndikuar politikisht, e kontrolluar politikisht, e diskriminuar politikisht. Nëse vepron si profesionistë në polici hetimore, ndëshkoheni nga Qeveria, nga ekzekutivi që është e paparë, e papremtuar. Do të thotë, vihen në funksion njerëzit që subordinohen politikisht.

Dhe, e dyta, e vërtetë që prokuroria nuk është aty ku duhet, gjyqësia mund të mos jetë aty ku s' duhet, por përmirësimi nuk ndodh me përplasje, as me fragmentim, as me sharje nga ministrja e Drejtësisë, por bëhet me orientimin e mençur për një drejtësi të pavarur, jo të kapur politikisht. Nëse është sot e kapur nga strukturat e atyre që i kanë vendosur gjatë 20 vjetëve të kaluara, tentimi i kësaj qeverie ka qenë që ta marrë nën kontroll gjyqësinë dhe prokurorinë, edhe atë në mënyra të ndyta, metoda të ndyta, duke përfshirë edhe koordinimin me Radojçiqin.

Do të thotë, as punë, as drejtësi. Por, çfarë ka ndodhur, ministër i Financave, kanë ndodhur tri projekte kulturore në Ferizaj prej nga vjen ministri aty, edhe ka ndodhur që i gjithë buxheti i shtetit është vendosur në instrument të mëshirës, sadakasë, të manipulimit të qytetarëve. T'i jap 100 euro sot, pas një muaji t'i jap edhe nja 100 euro, t'i jap 10 euro për këtë fëmijë, jo, jo. Familjet shqiptare në Kosovë nuk janë të sadakasë e të mëshirës.

Ky buxhet, të cilin ju po e kërkon sot, është prapë jozhvillimor, është instrument për të manipuluar më tutje me qytetarin, me vuajtjen dhe fukarallëkun e qytetarit. Këtu nuk ka vizion zhvillimor, asnjë kilovat nuk është shtuar i energjisë së rinovueshme për katër vjet, asnjë kilovat deri sot. Po flas për intervenimet e shtetit, nuk po flas për intervenimet e sektorit privat, asnjë! Asnjë rast i rëndë i krimit edhe korrupsionit që është premtuar nuk është mbërritur deri në fund në këtë katërvjeçar, asnjë i vetëm. Dhe, kjo e bën sigurisht të detyrueshëm në një moment që buxheti të aprovohet, sepse shteti nuk mund të dështojë për shkak të gabimeve dhe doktrinave të mykura komuniste të Albin Kurtit, absolutisht të mykura.

E, as për shkak të qëllimit servil të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje për t'i realizuar qëllimet individuale të tyre, sepse shteti është më i madh se ju, më i madh se të gjithë ne, sepse shteti është i qytetarëve, nuk është i rrenave dhe doktrinave të mykura, nuk është! Por, nuk mund të

ikni nga llogaridhënia, edhe nëse kjo duhet të ndodh një herë në vit kur kryeministri vjen prej manipulimeve të diasporës për të kërkuar aprovimin e buxhetit, megjithatë një herë në vit do të ballafaqoheni me llogaridhënie, jo ju, secili derisa kemi shtet demokratik, derisa kemi shtet parlamentar edhe derisa kemi qytetari aktive.

Nëse ju mendoni që duhet të gjithë të ikin në diasporë dhe t'i takoni atje për ta luajtur lojën e ndytë këtu, atëherë unë mendoj që edhe kësaj i vjen fundi një ditë. Manipulimi nuk është i përhershëm, demokracia është e përhershme, manipulimi nuk është i përhershëm, sepse njerëzit e kuptojnë, sepse njerëzit ecin e vozisin nëpër autostradat e pakryera, në arteriet e pakryera të rrugëve për Gjakovë, Podujevë, Gjiilan, Lipjan, Mitrovicë, të pakryera janë këto.

Dhe, sot katër vjet pas qytetari i Kosovës po ashtu është pa sigurim shëndetësor. Makinat kanë sigurim shëndetësor, por qytetari i Kosovës sot nuk ka sigurim shëndetësor! Polici i Kosovës nuk ka sigurim jetësor, ushtari i FSK-së nuk ka sigurim, zjarrfikësit nuk kanë sigurim jetësor, të gjithë ata, të cilët e rrezikojnë jetën e tyre për çdo ditë për interesin publik nuk kanë sigurim. Po kemi mbi 600 milionë euro të shpenzuara në sadaka...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ia shtoni një pjesë të kohës zotit Abazi.

HAKI ABAZI: Vetëm 1/10 e këtij buxheti të sadakasë po t'i vendosim në Fondin e Sigurimit Shëndetësor, sot do të flisim për tjera. Në fund, dy gjëra: u lavdëruan për çështjen e Trustit. Trusti është premtuar të kthehet këtu, edhe Fondi i Privatizimit që të investohen në Kosovë. As njëra e as tjetra s'kanë ndodhur. Dhe e fundit, ministrja e Punëve të Jashtme e ka izoluar Kosovën me budallallëkun e letrat që i ka shkruar kundër administratës amerikane. Kjo le ta mbajë bashkë me kryeministrin peshën e izolimit të Kosovës dhe qëndrimin antiperëndimor e antidemokratik duke bërë diplomaci me naivitet. Nga një shtet i cili është përkrahur nga e gjithë bota demokratike, sot jemi shteti që na anashkalon historia për shkak të naivitetit të këtyre njerëzve, të cilët s'kanë as vizion e as dinjitet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Tash ia kisha dhënë fjalën prej qeverisë dikujt.

Ia japim fjalën pra ministrit të Bujqësisë, na e ka kërkuar para një ore fjalën. Urdhëro!

MINISTRI FATON PEÇI: Faleminderit, zoti kryetar!

Sot jemi duke prezantuar Projektbuxhetin për vitin 2025 dhe të gjithë ata që deklarojnë se buxheti ka zero ndikim në bujqësi, më lejoni që t'u rikthej në kujtesë edhe deputetëve, por edhe opinionit disa shifra, të cilat janë të vërteta dhe të sakta, jo manipulative.

Buxheti për sektorin e bujqësisë për vitin 2021, i aprovuar në fund të vitit 2020, ka qenë 54 milionë euro. Ndërsa, borxhet e mbetura për fermerët nga viti 2020 kanë qenë 41 milionë euro. Kanë aprovuar buxhet 54 milionë euro, ku prej tyre 41 milionë euro kanë qenë borxhe. Ne sot jemi duke prezantuar projektin më të madh në histori për sektorin e bujqësisë, që është edhe përmbushje dhe zotim i dhënë publik, për shkak se kemi deklaruar se do të jetë 100 milionë euro buxheti për bujqësinë, 90 milionë euro është në buxhetin që sot do ta prezantojmë, e ku nga partneritetet ndërkombëtare vetëm buxheti me Qeverinë gjermane që është i ratifikuar në Kuvendin e Kosovës ka shifrën e plus 10,2 milionë euro shtesë buxhet, ndërsa nëse flasim për procesin e sistemit të ujitjes nga Komisioni Evropian, projekt i cili do të implementohet nga Banka Botërore, kemi 9,2 milionë euro, duke mos i përfshirë edhe shumë projekte të tjera që janë të sektorit të pylltarisë.

Ajo çka është shumë e rëndësishme është se ne po aprovojmë buxhet prej 90 milionë eurosh, e në anën tjetër në vitin 2022-2023 ne nuk i kemi mbetur borxh asnjë fermeri të Kosovës për gjithë të mbjellat që i kanë realizuar në terren, e si rezultat i kësaj e njëjta do të jetë edhe praktika e vitit 2024. U përmend mes tjerash nga deputeti Shala që është shumë e rëndësishme të diskutohet për çështjen e pronave. Po, është jashtëzakonisht e rëndësishme të diskutohet për çështjen e pronave. Ehe unë mendoj se çështjet që unë i kam ngritur, të cilat kanë marrë drejtim deri në një nivel, por jo të kënaqshëm, kur flasim për pronat e Institutit Bujqësor të Kosovës, unë mendoj që është skandal, korrupsioni dhe aferat më skandaloze në Kosovën e pasluftës.

Rikujtojmë që 22 aktakuza janë ngritur nga Prokuroria e Pejës për 22 individë për shkak se gjatë periudhës 2018-2020 kanë ndërtuar vila në pronën e Ministrisë së Bujqësisë në Stankaj të Pejës. Rikujtojmë se janë rikthyer 10 hektarë në tokë bujqësore në Qyshk të Pejës, të cilat më herët i ishin transferuar një pjesëtari të komunitetit serb, e për të cilët ai ka deklaruar se nuk ka qenë në dijeni dhe asnjëherë nuk ka qenë pronar i tokës, mirëpo e njoftuan se është pronar i një 10-hektarëshi në Qyshk të Pejës.

Ju rikujtoj se në rrugën magjistrale Prishtinë-Fushë Kosovë janë rikthyer nga Jovica 1 hektar e 34 arë, të cilat janë transferuar pronë e Ministrisë së Bujqësisë, e që janë çështje e pronës. Ju rikujtoj se në qendër të Prishtinës, në Ulpianë, qëndron turpi i mosveprimit të instancave të drejtësisë, ku prona e shtetit i është bartur individit dhe për të gjitha këto janë veprime të kësaj qeverie dhe timen si ministër që i kam ngritur dhe i kam sensibilizuar në të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë që duhet t'i adresojmë. Kur flasim për çështjen e buxhetit dhe të arriturave, është shumë e rëndësishme të theksohet se deri në fund të vitit përkrahja për sektorin e bujqësisë do të jetë rreth 300 milionë euro, e ku si rezultat i kësaj kanë përfituar 118 mijë përfitues vetëm në kategorinë e subvencioneve, e janë 1 mijë e 3 përfitues në kategorinë e granteve. E them vazhdimisht edhe në studio televizive, po e them edhe në foltoren e Kuvendit të Kosovës, për secilin përfitues nga 118 mijë të subvencioneve e 1 mijë e 3, le të tregojë dikush vetë zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë ose ndonjë instancë tjetër se kur është një rast i vetëm i ndërhyrjes ose

ushtrimit të ndikimit që unë e kam bërë. Nuk ekziston asnjë rast i vetëm, për shkak se përkrahja dhe përfitimi i fermerëve është vetëm mbi bazën e meritokracisë.

Kur flasim për tokën e punueshme, kemi parasysh që në vitin 2019, për shkak se nuk po dua të bëj krahasimin me periudhën paraprake, kur e kemi marrë mandatin se ka qenë koha e pandemisë, të mbjellat kanë qenë 81 517 hektarë, ndërsa në fund të vitit 2023 sipërfaqet janë rritur për 121 mijë hektarë, apo nëse e përkthejmë në nivel të statistikës, 49,23% janë rritur të mbjellat vetëm në kategorinë e drithërave. Lufta kundër krimit dhe korrupsionit ka pasur rezultate shumë të kënaqshme në shumë sektorë, por edhe shumë të tjerë, posaçërisht tek sektori i provës lënë për të dëshiruar, për shkak se përderisa unë kam ndjekur të gjitha rrugët ligjore për të rikthyer pronën në Ulpianë, sikurse ka ndodhur në sektorët e tjerë, brenda një afati 24 orë gjykata ka marrë masë të përkohshme dhe është më shumë se një vit që nuk po jep drejtim.

Kemi rritur nivelin e prodhimit, ta zëmë, nëse flasim për grurin në proporcion me numrin e banorëve dhe konsumin që duhet për kokë banori, ne kemi mbuluar nevojën për 102,72%. Në rast se, edhe në replikën e mëhershme po rikthej prapë në kujtesë, vetëm në nëntëmujorin e këtij viti vetëm për një produkt si rezultat i insentivës, përkrahjes dhe rritjes së subvencioneve, të cilët disa po e kanë kurajën dhe guximin të deklarojnë se efekti është zero, vetëm për grurin ne kemi importuar krahasuar me nëntëmujorin e vitit paraprak 8,1 milionë euro më pak në vlerë monetare, e 22.5 milionë euro në sasi kilogram për grurin.

Në nivel të partneriteteve ndërkombëtare, më gëzon fakti se kjo legjislaturë për herë të parë ka aprovuar marrëveshje ndërkombëtare si rezultat i partneritetit të shëndoshë që kjo qeveri dhe Ministria e Bujqësisë e ka pasur me partnerë ndërkombëtarë dhe kemi aprovuar marrëveshje ndërkombëtare në vlerë prej 20,2 milionë euro me Qeverinë gjermane, e cila tashmë ka filluar të implementohet dhe do të jetë tre vjet në proces të implementimit. 520 hektarë të certifikuar në prodhime organike vetëm gjatë periudhës në 2023, si rezultat i përkrahjes dhe rritjes së subvencionimit deri në 400%. 16,5 milionë euro është eksporti i produkteve organike, edhe kjo ekskluzivisht si rezultat i rritjes së përkrahjes.

Pas 10 vjetëve stagnim, kemi aprovuar Ligjin e ri për pyjet. Kemi hartuar planin kombëtar për pyllëzim dhe ripyllëzim që nga viti 2021 deri në vitin 2023 kemi arritur të mbjellim 1.5 milionë euro fidanë për tokat ose pronat, të cilat kanë qenë jo të mbuluara mjaftueshëm dhe mirë.

Në aspektin e eksporteve: janë rritur eksportet duke krahasuar vitin 2021, 2022 dhe 2023, rritja e eksportit të prodhimeve bujqësore është 93.54% në vlerën e mallrave të eksportuara. Nëse e krahasojmë me vetveten me vitin 2021 deri në vitin 2024 rritja e eksportit të produkteve bujqësore është për 60,03%. 184% është rritja e mbështetjes nga partneritetet ndërkombëtare, ku vlera monetare e përkrahjes nga këta partnerë është në 51 milionë euro, ose krahasuar me qeverinë aktuale do të thotë e cila ka pasur 18 milionë euro, prej të cilave shumica kanë qenë

kredi. 275,79 hektarë janë të mbjella me pemë arrore, manore dhe me pemishte. 103 stalla të reja moderne janë të ndërtuara në nivel vendi vetëm në dy vjetët e fundit, prej tyre 951 përfitues të granteve, mes tjerash edhe me kapacitete moderne për sektorin e energjisë, për shkak se kemi ngritur kapacitetet e këtyre fermave me 4 276 kilovatë.

Në sektorin e perimeve: vetëm në sektorin e perimeve janë 58 hektarë sera të reja të ndërtuara në dy vjetët e fundit. 70 studentë kanë marrë bursa në vlerë prej 2 mijë e 400 euro për vit si rezultat i insentivës tonë që ne kemi ndërmarrë në nivelin akademik të ndërlidhemi edhe më shumë në nivelin institucional dhe bartjen e përvijës teorike me atë praktike. 27% është rritja e aktiviteteve bujqësore krahasuar me vitin 2020-2023 në të gjitha veprimtaritë. Për herë të parë ne e kemi arritur që të subvencionojmë fermerët për naftën dhe plehërimin, duke mbuluar koston e akcizës për çdo fermer. Në vazhdimësi është ngritur çështja se fermeri dhe qytetari i rëndomtë nuk duhet të ketë koston e njëjtë të furnizimit me naftë dhe këtë për herë të parë e ka realizuar kjo qeveri, duke ofruar përkrahje prej 18,9 milionë euro subvencionim të naftës për fermerë dhe e njëjta është e buxhetuar edhe në këtë buxhet.

Rreth 33.8 milionë euro është subvencionimi i plehut, duke përfshirë plehërimin vjeshtor dhe pranveror. Gjithashtu, në aspektin të mbështetjes dhe digjitalizimit...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Saranda Bogujevci.)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni edhe një minutë që ta përmbyllë fjalën.

MINISTRI FATON PEÇI: Por të gjitha këto që i përmenda janë pjesë e vazhdimit të projekteve dhe përkrahjes financiare për sektorin e bujqësisë dhe jam i vetëdijshëm që niveli i rezultateve që i ka sektori i bujqësisë nuk mjaftojnë të përmbyllen për dhjetë minuta. Sido që të jetë, faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Jeta Statovci.

JETA STATOVCI: Përsëritje për të gjithë!

I nderuar kryetar Konjufca,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Si dhe të dashur qytetarë!

Pa dyshim që sot jemi mbledhur këtu për ta diskutuar Projektligjin për buxhetin e vitit 2025. Ky projektligj, pavarësisht të gjithave që u thanë, është një e vërtetë e vetme që është projektbuxheti

më i madh në historinë e vendit tonë, me një rritje pesëdhjetë për qind nga ajo se çka është gjetur në marrje të mandatit.

Është buxhet që reflekton kërkesat dhe aspiratat e secilit qytetar, si dhe secilit institucion. Nuk është buxhet për individët e as grupet e interesit, por është buxhet i qytetarit të Kosovës që synon përmirësimin e jetesës së përbashkët, si dhe zhvillimit ekonomik.

Në kuadër të këtij fjalim do të fokusohem kryesisht te pikat të cilat kanë të bëjnë me Ministrinë e Ekonomisë, si dhe me aspekte të tjera që ndërlidhin ndërmarrjet publike.

Kur po flasim sot për buxhetin e vitit të ardhshëm, vlen të përmendet që punëtorët e Telekomit vazhdojnë të përballen edhe me mungesë të pagave. Kjo jo për shkak se ndërmarrja nuk ia mjetet. Faktikisht, ndërmarrja është profitabile, po kjo është pasojë e marrëveshjeve të menaxhmenteve të kaluara. Pavarësisht sfidave, vështirësive e pengesave, kjo Qeveri arriti që Telekomin ta kthejë në ndërmarrje fitimprurëse, por marrëveshjet e dëmshme të ish-qeverive ende po ia gërryejnë themelet nga brenda.

Vlen të përmendet dhe assesi të mos harrohet që Telekomit për vetëm tre vjet, pra për vitet 2013-2016, i humbën dhe pati mundësi të humbura deri në vlerën tetëdhjetë milionë. Unë besoj që një ndërmarrjeje për t'ia humbur tetëdhjetë milionë për tre vjet, kërkon një talent të jashtëzakonshëm shkatërrues.

Po ashtu, i kemi kthyer në kompani fitimprurëse. Ne do të vazhdojmë të investojmë dhe të angazhohemi tutje në këtë aspekt. Ndërsa, të gjithë ata që sot na e bëjnë kritikën për ndarjet buxhetore, ishin pikërisht ata që sollën gjendje që shumicën e këtyre ndërmarrjeve t'i sjellin në prag të falimentimit buxhetor.

E qytetari i Kosovës e di shumë mirë këtë, sepse jo vetëm Telekomit, mirëpo edhe shumë ndërmarrje të tjera arritën të ringjallen, duke u kthyer në ndërmarrje profitabile stabile, falë politikave të sakta dhe të drejta. Ndërmarrjet publike aktualisht kanë shënuar një rritje të fitimit. Nga humbjet e thella, sot ndërmarrjet publike kanë fitim në vlerën 140 milionë euro që e karakterizon me menaxhim të drejtë gjatë periudhës 2021-2023. Kemi katërfishim të përfaqësimit të grave në bordet e ndërmarrjeve publike, duke përmirësuar qeverisjen dhe transparencën.

Gjithashtu, për vitin 2025 ka ndarje buxhetore njëzet milionë për këto ndërmarrje për t'i fuqizuar dhe zhvilluar tutje. Më saktë, tre milionë euro për ristrukturim dhe rivitalizimin e Trepçës, e cila ishte në mesin e ndërmarrjeve më të fuqishme, e cila pra përgjatë viteve të mëparshme u dëmtua aq shumë sa që përfundoi deri në fazën e mbijetesës. 7,8 milionë euro investime në kapacitetet

teknike të sektorit të ujërave. 5,9 milionë euro në ndërtimin e impianteve të ujërave të zeza, 2,7 milionë euro në ngritjen e kapaciteteve teknike për Hekurudhat e Kosovës.

Tutje, kjo Qeveri ka planifikuar si dhe investime të mëdha edhe për infrastrukturën kritike për ta mbështetur eficiencën energjetike, inovacionin dhe teknologjinë. Qeveria Kurti për projektet në raport me rritjen e eficiencës energjetike, investimet në infrastrukturën digjitale, si dhe investimet e tjera kapitale, parasheh një buxhet prej 44.2 milionë euro për vitin 2025.

Meqenëse në vendin tonë ndërtesat përbëjnë dyzet për qind të konsumit të energjisë, ka masa direkte që targetojnë rritjen e eficiencës përmes investimeve në eficiencë, e mbështetur me buxhet edhe nga ana e Ministrisë së Ekonomisë. Tutje, duke subvencionuar pajisjet eficiente derisa të arrihet një masë e konsiderueshme në raport me konsumin e energjisë, si dhe në raport me kalimin në energji eficiente, nga aspektet e tjera të cilat lidhen me digjitalizimin e shërbimeve publike.

Së bashku me projekte të caktuara, Ministria e Ekonomisë vazhdon tutje me një buxhet prej dy milionë euro për të bërë digjitalizimin në raport me shkollat e vendit, që qytetari, më saktësisht fëmijët tanë të kenë mundësi të mirë edukimi dhe të barabartë, si dhe qasjen në internet të lirë e shpeshherë edhe falas.

Projekte të ndryshme rajonale, të cilat targetojnë teknologjinë dhe inovacionin, më saktësisht me qendrat e ekselencës në Prizren dhe Gjiilan, e rrethana të tjera, të cilat e përmirësojnë gjendjen e qytetarit, e pa dyshim atëherë kur ka nevojë edhe në edukimin e hershëm. Ky projektbuxhet është një investim për të ardhmen e Kosovës dhe për mirëqenien e qytetarëve tanë.

Ju falënderoj për vëmendje dhe përkushtimin tuaj për të ardhmen tonë të përbashkët në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Rashit Qalaj.

RASHIT QALAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë!

Është fakt që sot kemi opinione të ndryshme dhe qëndrime të ndryshme e pozicionime të ndryshme, në lidhje me njërin ndër ligjet më të rëndësishme të vendit, Ligjit për buxhet.

Po ashtu është fakt që ne e arsyetojmë ose kritikojmë varësisht prej qëndrimeve politike që i kemi, mirëpo një gjë nuk duhet pranuar kurrë që opozita është pengesë për implementimin e buxhetit të Kosovës, se opozita është pengesë për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Dëgjuam nga diskutimet që pati edhe Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, edhe ministri i Financave, z. Hekuran Murati, të cilët diskutuan për problemet globale, për krizat globale, që edhe qëndrojnë, dhe për efektin e këtyre krizave edhe në vendin tonë.

Po ashtu, pjesa që unë nuk pajtohem absolutisht është akuza ndaj deputetëve të opozitës, të cilët thanë se po i dërgojnë ligjet në Kushtetuese dhe është fakt. Deputetët e partive opozitare i kanë dërguar shumicën absolute të ligjeve në Gjykatën Kushtetuese, për të vetmin qëllim, që të mbrojnë të drejtat e qytetarëve të Kosovës, që ta mbrojnë qytetarin e Kosovës nga kalimi i ligjeve, të cilët ne kemi konsideruar se dëmtojnë të drejtat e qytetarëve. Ne kemi llogaritur që janë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës. U pa nga vendimet që ka nxjerrë Gjykata Kushtetuese, që deputetët e partive opozitare kanë pasur të drejtë, për shkak se Gjykata Kushtetuese, si gardian i Kushtetutës së Kosovës, ka nxjerrë vendime të cilat kanë hedhur poshtë në tërësi ligje të ndryshme që kanë kaluar në këtë Parlament nga deputetët e opozitës.

Po ashtu, është e papranueshme që të akuzohen deputetët e opozitës për mospajtimin e kësaj Qeverie. Për mua, nuk më intereson fare se sa kjo mazhorancë, kjo Qeveri a i ka realizuar premtimet e saj që i ka pasur gjatë fushatës zgjedhore të mandatit të kaluar. Tekefundit, verdikthin do ta japë qytetari i Kosovës në zgjedhjet e ardhshme më 9 shkurt.

Për mua është me rëndësi të diskutojmë për buxhetin e Kosovës dhe për efektin që ka ky buxhet në rritjen ekonomike të vendit. Po e diskutojmë një buxhet që është mjaft i lartë, diçka mbi tre miliardë e gjashtëqind milionë. E keqja është që prapë në këtë buxhet janë paraparë shumë pak shpenzime kapitale, vetëm 25 për qind, ndërsa të gjitha shpenzimet e tjera janë shpenzime rrjedhëse, d.m.th. 72 për qind. Aty në subvencione e transfere mbi një miliard euro, apo 32 për qind, në mallra dhe shërbime të cilat janë rritur prej 14.8 për qind në raport me vitin 2024, në paga dhe mëditje 25 për qind e kështu me radhë.

Nëse e shikojmë planifikimin buxhetor që nga fillimi i mandatit të kësaj Qeverie, në raport me investimet kapitale, kemi parë që në vitin 2021 kanë qenë 18 për qind të buxhetit të planifikuar për investime kapitale, në vitin 2022, 16,6 për qind, në vitin 2023 - 19,4 për qind dhe në vitin 2024 - 25,9 për qind. Por, e keqja më e madhe është që edhe këto para, të cilat kanë qenë të planifikuara për investime kapitale, nuk janë realizuar. Pra, Qeveria ka arritur maksimalisht të realizojë afër dyzet për qind të planifikimeve që i ka pasur për shpenzime kapitale.

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

E dini të gjithë që efekti ku nuk ka investime kapitale në ekonomi është shumë i keq. Kur nuk ka para në qarkullim, kur nuk ka para në treg, si është efekti ekonomik? Sa ndikon në rritjen ekonomike?

Më herët dëgjova diskutime duke thënë se kjo Qeveri është në vazhdim të punimeve në autostradën Prishtinë-Gjilan, Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Mitrovicë, po ne e kemi një autostradë që është duke u punuar, është vetëm autostrada për Gjilan, e cila ka stagnuar dhe e cila as që pritet të kryhet në dy-tre vjetët e ardhshme. Atë që e kanë thënë, e kanë thënë, mirëpo realiteti është shumë keq.

Të nderuar deputetë,

Pavarësisht pozicioneve që i kemi në parti politike, kur ka një projekt a investim kapital të dobishëm për këtë vend, e shfrytëzojmë të gjithë dhe duhet t'i gëzohemi. Por, fatkeqësia është që nuk po kemi. Ndoshta edhe mund të krenohemi me disa rritje të pagave, me disa subvencione që u janë kategorive të ndryshme të qytetarëve, mirëpo pajtohemi plotësisht që efekti ekonomik i tyre është mjaft i vogël.

Nëse e shikojmë një çështje tjetër, nëse kemi investime kapitale, edhe realizimi diku shumë i vogël, as dyzet për qind për nëntëmuorin e këtij viti, ose më saktësisht, 36 për qind. Po të mos ishin tenderët njëburimorë, ku do të ishte investimi në projekte kapitale.

Kryeministri i vendit, z. Albin Kurti, më herët tha që në qeverisjen e këtij pushteti janë trajtuar të gjithë njëjtë dhe nuk janë krijuar grupe të interesit e nuk janë mbështetur grupe të interesit. Po ku ka mbështetje më të madhe të grupeve të interesit sesa në tenderë njëburimorë. Unë e kuptoj p.sh. në vitin 2020 kur e patëm kërcënimin ndaj njerëzimit, pandeminë, kur e patëm virusin që ende askush nuk e dinte si do të zhvillohej, e kuptoj edhe negocimin direkt, për shkak se ka qenë një e panjohur për të gjithë dhe as që duhet ta diskutojmë. Por, nuk mund ta kuptoj që me tenderë njëburimorë të blihet bari për fusha të futbollit. Absolutisht nuk mund ta kuptoj kurrë. Apo, vaji për automjetet e ndryshme të institucioneve e shumë gjëra të tjera.

Se ku jemi me projekte infrastrukturore, se ku jemi me investime kapitale, i kisha bërë një pyetje ministrit të Financave, meqenëse është nga Ferizaj. Në ish-qeverinë e kaluar, segmenti i rrugës prej fshatit Prelez deri në Fshatin e Vjetër ka qenë kontraktuar qysh atëherë, dhe është bërë përrurimi i fillimit të punimeve dhe s'e kemi asnjë hap të vetëm. Po ka qenë në të gjitha buxhetet e viteve të kaluara, edhe në vitin paraprak, po s'e kemi asnjë metër të rregulluar të asaj pjese të rrugës. E dini që njerëzit për çdo ditë kalojnë në atë pjesë të rrugës dhe për çdo mëngjes sa herë t'i bie rrota e makinës në gropë, besoj e dini çka thonë dhe dikë e nguc lemza.

Segmenti tjetër që e kam kolegun nga Lipjani këtu, segmenti nga dalja e Lipjanit deri te autostrada që është gërryer asfalti që dy vjet e gjysmë, ka qenë e paraparë edhe në buxhetin e vitit të kaluar, edhe në vitin paraprak, asnjë lopatë, asnjë veprim, asnjë punë deri më sot nuk është bërë.

Do të kalojmë pak te shkollat. Shkolla fillore “Emin Duraku” në Kaçanik, kemi folur me amendamentet e buxhetit të kaluar ka qenë të parapara një sasi e parave, as edhe një gozhdë nuk është bërë.

Cili është veprimi i Qeverisë? Ku janë investimet për komunat e vogla? Kryesorja, ministër i Financave, është folur këtu në Parlament, është folur në debate televizive për kontratën kolektive që komunat janë buzë katastrofës, që ata punëtorë të komunave s’do të arrijnë t’i sigurojnë as pagat. Paramendojeni një komunë të vogël siç është Hani i Elezit, ku i janë marrë të gjitha paratë nga personat të cilët implementojnë vendimet gjyqësore, pra nga përmbaruesit. Ku është dhe çka mund të bëjë kryetari i Komunës? E di që keni thënë që është vendim i gabuar. E di që keni thënë që është vendim joligjor. Po, pse nuk e anuluar? Pse nuk e dërguar në Kushtetuese? Mendoj që duhet gjithsesi të parashihet në buxhet që komunave tona t’u ndihmohet me para për sfidën më të madhe që e kanë sot e që është implementimi i kontratës kolektive dhe pasojat që i ka në buxhetet e kuvendeve komunale.

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Besian Mustafa.

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

I nderuar Kabinet qeveritar!

Që fatkeqësisht me mungesën tuaj këtu në këtë seancë keni treguar se me çfarë serioziteti e trajtoni buxhetin e vitit 2025, duke qenë të vetëdijshëm që nuk do të jeni më në kabinetin qeveritar vitin e ardhshëm. Në të kundërtën, do të ishit këtu për të përfaqësuar dhe për të prezantuar buxhetin për vitin e ardhshëm, se do të besonit që do të punonit në vitet e ardhshme si ministra. Andaj, nuk do ta komentoj buxhetin për vitin 2025. Është një buxhet për muajin janar dhe javën e parë të muajit shkurt, por po komentoj ato që u thanë këtu nga kabineti qeveritar deri tani rreth këtij buxheti.

Thanë që rryma ose energjia elektrike në Kosovë qenka sot më e lira në rajon. Por, harruan të cekin se e kanë gjetur edhe më të lirë kur kanë ardhur në pushtet, sepse kur ishin në opozitë, në fushatë thoshin ne duhet ta lirojmë rrymën, sepse është shumë më shtrenjtë. Në fakt, çka bënë në katër vjet në pushtet, është që e dyfishuan çmimin e energjisë elektrike.

U ankuan në Gjykatën Kushtetuese se po ua rrëzon ligjet antikushtetuese. Kur ishin në opozitë, deklarorin që ata që shkelin ligjin janë kriminelë, e ata që e shkelin Kushtetutën, janë superkriminelë. E vetë me dhjetë ligje e shkelën Kushtetutën mbi dhjetë herë.

Pra, në ato dëgjime e audioincizimet që janë bërë publike, e dëgjuam shafen e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes që tentonte të koordinohet me një kriminel të arratisur Radojçiqin,

për të çkapur fillimisht Gjykatën Kushtetuese e për ta rikapur në koordinim me Radojçiqin, sepse kjo Gjykatë Kushtetuese po ua rrëzon ligjet antikushtetuese, e me Radojçiqin me gjasë do ta respekton Kushtetutën e Republikës së Kosovës më mirë sesa tash.

Në stilin e tyre tipik të mashtrimit në pesëmbëdhjetë vjetët e kaluara, e cekën që inflacion mesatar mujor deri në shtator të këtij viti kanë qenë nga 1.9 për qind, e nuk e thanë asnjë fjalë për inflacionin e përgjithshëm, mbi 22 për qind brenda një viti, mbi qind për qind rritje e çmimeve në ushqimet elementare të një familjeje mesatare kosovare. Mbi qind për qind rritje të çmimit të energjisë elektrike. Këto nuk i cekën asnjëherë. Folën për diasporën me minuta e orë të tëra, harruan të tregojnë që për shkak të monopoleve që kanë instaluar vetë në aeroport, aviobiletat në aeroportin e Kosovës ose si destinacion Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, avibiletat janë tri herë më të shtrenjta se në çdo aeroport tjetër të Evropës. Me përjashtim të disa, jo të gjithëve, me përjashtim të disa funksionarëve të LVV-së, nuk ka qytetarë në Republikën e Kosovës që sot nuk jeton më keq financiarisht e ekonomikisht sesa para katër vjetësh.

Thanë që i kanë zvogëluar borxhet ose obligimet që i kanë ndaj kompanive private që i kryejnë ose i realizojnë investimet kapitale Qeverisë. Natyrisht që s'keni borxhe, s'keni prekur punë me dorë. Qysh të kesh borxh, kur s'ke punuar asgjë?

Harruan të tregojnë që kryeshefin e KEK-ut, pra prodhimit të energjisë elektrike, njeriu që publikisht u dëshmuua që ka marrë urdhra direkt në sinjal nga Dejana Mihali, se çka të veprojë e çka të mos veprojë, kur ta ndalë rrymën e kur ta lëshojë rrymën, harruan të tregojnë se e kanë të arrestuar për keqpërdorim të dhjetëra e dhjetëra milionë euro në tenderë e në tregti me energji elektrike.

Asnjë megavat të vetëm. Po shpallën atje ankande, nënshkruan kontrata pompoze e të tjera, po në katër vjet asnjë megavat kapacitet i ri i prodhimit të energjisë elektrike në territorin e Republikës së Kosovës, e qindra milionë euro të shpenzuara në blerjen e energjisë elektrike, ku përfitojnë vetëm disa njerëz. Ata që tregtojnë me energji. Ndërmjetësit që blejnë e shesin energji elektrike. Shih, rastësisht, këtë po e vendos në thonjëza, rastësisht tregtari i energjisë elektrike na paska qëlluar ish-anëtari i Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, i cili shpejt e shpejt iu dha një nënshtetësi dhe një pasaportë e Kosovës për ta bërë ambasador, e cili përfiton qindra miliona euro për energjinë elektrike ose tregtimin e energjisë elektrike.

2123 kontrata njëburimore, një telefonatë duke u dhënë tenderë me miliona euro. 280 milionë euro përmes 2123 kontratave njëburimore miqve të vet. Pesë milionë ti, dhjetë milionë ti, pesë ti, njëzet ti, dymbëdhjetë ti, shtatë ti. Pa i bërë publike hiç në format konkurrues. Veç një telefonatë ministri, këto para, ti këto para. Përshëndetje Sali Zyba mund ta marrësh fjalën.

Rrahën gjoks se u paskan blerë, thanë njerëzve u kemi blerë klima, për ta ulur shpenzimin e energjisë elektrike. Veç imagjinojeni diskonekt logjik, shkëputjen logjike. Tha u kemi blerë njerëzve klima t'i instalojnë në shtëpi, e ato harruan që përdorin energji elektrike. Si blen njeriu klimë, e pastaj e ul konsumin e energjisë elektrike. Mbi të gjitha, vetëm një Qeveri e majtë neomarksiste rrah gjoks se u blen njerëzve klima për t'u ngrohur e ftohur. Sepse, imagjino e kanë idenë e njëjtë si të Enver Hoxhës që ua jepte nga 200 gr. mish në javë duke pritur në rend aty nga tri orë të marrin 200 gr. mish edhe mburren që çka ka arritur Qeveria, po u blen klima.

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Shemsedin Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të vendit!

Vlera nominale e këtij buxheti në shikim të parë tregon një rritje që duhet përshëndetur. Por, pyetja është se a është i mjaftueshëm për zhvillimin e vendit. Nëse hyjmë në brendi del se ky buxhet nuk është zhvillimor dhe nuk është zgjidhje e problemeve të evidentuara në vend.

Zakonisht, këto buxhete kur hartohen, duhet të identifikojnë problemet e vendit.

Nënkryetare, a ka mundësi të krijoni ambient ta vazhdoj fjalën, a jo?

KRYESUESJA: Ju lutem, deputetë të respektojme deputetin Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: Buxheti ndërmjet dy leximeve e ka kuptimin e plotësimin, e shtimit, e rregullimit dhe në fund e aprovimit.

Unë e kam lexuar në tërësi, por do të fokusohem në dy lëmenj, në atë të arsimit dhe atë të shëndetësisë.

Këtu nga ana e kryeministrit Albin Kurti pak më herët u cek se këto dy lëmi janë lëmi prioritare në këtë buxhet, gjë që nuk shihet në raport me GDP-në. Do ta elaborojmë më vonë. Pse këto dy lëmi i kam përzgjedhur. Janë dy lëmitë më problematike të cilat i ka vendi dhe ku më së shumti është debatuar për to, dhe u jam përkushtuar.

Kam pritur që këto dy shqetësime të qytetarëve të vendit dhe të ndërkombëtarëve të jenë të adresuara në këtë buxhet. Ky buxhet nuk i adreson këto as për së afërmi.

Kjo Qeveri me pompozitet e ka proklamuar se këto dy fusha do të jetë prioritare. Le t'i kthehemi arsimit. Edhe pse në shikim të parë duket se kemi një rritje prej 3,25% krahasuar me vitin paraprak, edhe në arsim shuma e buxhetit të ndarë këtë vit është 3,5% e bruto produktit vendor, dhe kjo përqindje është e njëjta si në buxhetin e vitit paraprak.

Ndërsa, vendet e BE-së për vitin 2022 shpenzuan disa herë më shumë se Kosova në këtë matje. Për shembull, Islanda 7,1% të GDP-së e ndan për arsim, Suedia 6,3. Belgjika 6,3. Estonia 5,8, Danimarka 5,3. Ndërsa, mesatarja e investimeve në arsim në 27 vendet e Bashkimit Evropian është 4,7%.

A thua kaq mirë jemi në arsim ne që nuk kemi nevojë fare ta rrisim përqindjen e GDP-së në arsimin tonë? Ju rekomandoj vetëm, kthejuni rekomandimeve dhe rezultateve që i patëm në testin e fundit në PISA, dhe rekomandimeve që dalin nga Raporti i Progresit.

Me këtë buxhet në arsim do të vazhdojnë problemet e njëjta të evidentuara gjatë kësaj qeverisjeje, ikja e nxënësve jashtë vendit dhe jashtë sistemit publik, ikja e arsimtarëve, e besa-besë e shpërngulja e familjeve të tëra për të siguruar edukimin adekuat jashtë vendit.

MSA-ja rekomandon fonde për hulumtim në arsim të lartë edhe atë deri në vlerën 2% të GDP-së, ndërsa ne ende vazhdojmë ta mbajmë nivelin nën 0,7%. Ky anashkalim nuk është hera e parë që i bëhet, kjo ishte edhe në vitin paraprak.

Ky buxhet, jo që nuk premtion adresimin e problemeve të evidentuara në arsim, por përkundrazi, me këtë buxhet dhe me këtë shpërndarje presim përkeqësim të gjendjes dhe ikje të nxënësve dhe familjeve nga vendi. Qeveria që e ka prioritet arsimin ndanë mbi 6% të bruto-produktit për arsim.

Po, si është puna në shëndetësi. Edhe në shëndetësi pjesëmarrja e GDP-së është vetëm 3,4%, dhe si mund të konsiderohet prioritet me një pjesëmarrje të këtillë. Prej të dhënave të fundit që dalin nga shtetet e rajonit del se Serbia ndan 6,26% të GDP-së, Mali i Zi 6,4, Bosnja dhe Hercegovina 6,5. Pra, komplet shtetet e rajonit ndajnë dyfishin e buxhetit të cilin ne e kemi alokuar për vitin që vjen.

Ikja e personelit shëndetësor nga sektori publik në atë privat dhe ikja jashtë vendit, e dini se ka ndodhur për shkak të pagesës së pamjaftueshme dhe kushteve jo të mira në punë. Ju pyes të gjithë juve që jeni këtu të pranishëm, duke filluar nga kryeministri: a është i mjaftueshëm ky buxhet që të ndalet gjakderdhja e ikjes së stafit mjekësor jahte vendit?

Ky buxhet as për së afërmi nuk e garanton implementimin e sigurimeve shëndetësore pasi që shuma që parashihet është diku një rritje prej 1,2 milion, përkatësisht nga 8,8 sa ka qenë vitin e kaluar në 10 milionë këtë vit.

Po si është puna me SHSKUK-në. Ju e dini që në SHSKUK është rritur praktikisht gati qind për qind në vitin 2024 buxheti, mirëpo vazhduan problemet e njëjta. A mendoni që me 16 milionë që

i shtohen SHSKUK-së do të zgjidhen problemet të cilat kanë qenë prezent gjatë tërë kohës në vitin që lamë pas? Besoj që jo.

Pra, me këtë buxhet, ju garantoj se do të vazhdojnë problemet e njëjta. Problemi do të jetë prapë me listën e barnave. Prapë me listën e pritjes. Prapë me listën e pritjes. Prapë me ikjen e personelit jashtë shërbimeve publike dhe do të vazhdojnë gjërat të bëhen keq e më keq.

Sa mirë e kemi gjendjen në shëndetësi, vetëm duhet të shkojmë deri në Maqedoninë e Veriut dhe ta vizitohet Spitalin “Zhan Mitrev” ose “Sistina”. Shumica e atyre që presin për shërbime shëndetësor janë qytetarë të vendi tim, janë qytetarë të Kosovës.

Prandaj, ju bëj apel që mes këtyre dy leximeve të dyfishohet përqindja e GDP-së për arsim dhe për shëndetësi nëse dëshirojmë që sadopak të ndalim trendin e së keqes. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Tani e ka radhën ministrja Rozeta Hajdari.

MINISTRJA ROZETA HAJDARI: E nderuara nënkryetar e Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Kolegë ministra dhe të gjithë deputetë që jeni prezent këtu,

Unë dua të reflektoj pak për sektorin privat sa është përkrahur gjatë qeverisjes Kurti, sa kemi përkrahur financiarisht, por edhe përmes politikave për biznes të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues në vendin tonë.

Nëse marrë shembull vetëm vitin 2021 kur kemi marrë qeverisjen buxheti për Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ishte 8 milionë e 882 mijë euro dhe u rrit me rishikim të buxhetit në 42 milionë e 131 mijë euro. Pra, për gjithsej 243,95% rritje. E nëse e krahasojmë me vitin 2019, ishte buxheti për Ministrinë e Tregtisë, Industrisë në atë kohë 4,4 milionë euro, më fal, për projektet kapitale dhe për subvencione e transfere gjithsej 1,3 milion euro, por gjithsej totali i buxhetit ishte 12 667 000, që i bie katërfish më pak sesa në vitin 2021.

Dhe, për këtë vit, po ashtu kemi edhe rritje më shumë për përkrahjen e bizneseve në shpalosjen e potencialit të tyre për të eksportuar, por edhe për t'u përmirësuar si biznes i drejtë dhe rritje e konkurrencës së tyre.

Unë dua të njoftoj pak për brengat, për kritikën e padrejta që u drejtuar ndaj qeverisjes sonë, kur pikërisht për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes të drejtë, të adaptueshëm dhe konkurrues, ishte fare aspak i rregulluar ky sektor.

Ndërkaq, me politikën, me reformat e shumë pritura që ishin në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociim, ku me këtë rast me veprimet e para të qeverisjes sonë siguroam përafrimin

me acquis të BE-së dhe konventat ndërkombëtare përkatëse, duke plotësuar zbrazëtitrat në kornizën legjislativë me miratimin të 21 ligjeve dhe 40 akteve nënligjore në harmoni me parimet dhe standardet ndërkombëtare dhe direktivat e BE-së për përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, nxitjen, mbrojtjen e investimeve, përmirësimin e bilancit tregtar, mbrojtjen e konkurrencë, reformën, mbikëqyrjen e tregut, mbrojtjen e konsumatorit, fuqizimin e mbrojtjes së pronësisë industriale, zhvillimin e inovacionit dhe ndërmarrësisë dhe turizmin e qëndrueshëm.

Për herë të parë në Republikën e Kosovës ne hartuam dhe miratuam një Strategji të parë për zhvillim industrial dhe mbështetje të bizneseve për deri në vitet 2030 me vizion të qartë për të transformuar industrinë e Kosovës në një industri të integruar globalisht dhe që është në gjendje të prodhojë produkte me vlerë të lartë të shtuar dhe të ofrojë punësim të denjë.

Në harmoni me politikën industriale dhe objektivat e përcaktuara të përgjithshme dhe specifike në këtë Strategji, kemi mbështetur financiarisht rritjen e konkurrencës së 711 ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në vlerë prej 20 milionë eurosh.

Përmes skemave të granteve për avancim të teknologjisë me qëllim rritjen e prodhimit dhe rritjen e eksportit të produkteve vendore, certifikimin e produkteve, trajnimin, digjitalizimin e ndërmarrjeve dhe mbështetjen financiare për zejtarët dhe artizanët.

Kemi mbështetur edhe 450 biznese të tjera me 12,4 milionë euro në subvencionim të kredive investuese në kuadër të pakos së ringjalljes ekonomike. Mbështetje, po ashtu për 185 ndërmarrje start-up mikro të vogla të mesme në digjitalizim, certifikim dhe zhvillim të inovacionit në vlerë prej 2,2 milionë euro.

Mbështetje financiare në vlerë prej 3,2 milionë euro për ndërkombëtarizim të 392 bizneseve vendore me pjesëmarrjen e 51 panajreve ndërkombëtare për mallra, shërbime dhe aktivitete të turizmit, duke promovuar kështu afër 2 mijë produkte të mallrave, shërbimeve dhe aktiviteteve të tjera të turizmit.

Po ashtu për të siguruar edhe më shumë rritjen e konkurrueshmërisë së ndërmarrjeve tona siguroam që Kosova të jetë pjesë e njërit prej programeve më të mëdha të Bashkimit Evropian, Tregu i Përbashkët në vlerë prej 4,2 miliardë euro për mbështetje të bizneseve dhe organizatave për periudhën 2021-2027.

Ndërkaq, përmes Ministrisë së Financave mbështetem edhe Fondin Kosovar për Garanci Kreditore për të përkrahur ndërmarrjet tona eksportuese, ku për vetëm për dy vitet e fundit, 2023, 2024 me gjithsej 36 milionë euro, duke garantuar kështu 1 222 kredi të 1 074 ndërmarrjeve fillestare mikro të vogla dhe të mesme në vlerë prej 82 milionë euro.

Të nderuar deputetë që jeni prezent,

Unë ju njoftoj se bizneset tona janë në rritje e sipër në krahasim me periudhën paraprake të qeverisje të tjera, me gjithsej 41 mijë biznese të regjistruar për gjatë periudhës mars 2021, shtator 2024, ose kryesisht me 18% rritje më shumë biznese të regjistruara.

Por, edhe qarkullimi i bizneseve, siç u përmend më herët, ka 58% rritje gjatë vitit 2023 dhe afër dyfish rritje gjatë vitit 2024 me të ardhurat e tyre me gjithsej 22 milionë euro.

Për më shumë, të nderuar deputetë, ju njoftoj se edhe shumë parqe industriale ose zona ekonomike që ishin themeluar, por pa asnjë investim nga qeveritë e kaluara, ne me Ligjin e ri për parqet industriale dhe teknologjike kemi bërë një reformë në sjelljen në funksion, së pari ndërtimin, dhe sjelljen në funksion të parqeve industriale teknologjike me investimet kapitale në 3 vjet gjithsej 33 milionë euro, ku 20 milionë janë në proces të ndërtimit të këtyre parqeve që nuk ishin ndërtuar, por vetëm themeluar nga qeveritë e kaluara, dhe po ashtu në themelim të parqeve të reja në Republikën tonë.

Pra, kemi finalizuar ndërtimin e infrastrukturës fizike dhe sjelljen në funksion të Parkut Industrial në Viti, Parkut Industrial në Shirokë dhe Parkun Industrial në Vushtri me investime kapitale prej 1,3 milion euro.

Kemi vazhduar ndërtimin e infrastrukturës fizike për funksionalizim të tri parqeve industriale në Lipjan, Rahovec dhe në fillim të ndërtimit të Parkut Industrial në Mitrovicë me investimet kapitale prej 6,2 milionë euro nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe kemi themeluar dhe filluar ndërtimin e infrastrukturës fizike të Parkut Industrial në Podujevë me investime kapitale në vlerë 3,8 milionë euro.

Po ashtu kemi themeluar dhe filluar ndërtimin e infrastrukturës fizike të Parkut Industrial në Drenas, pra, Parku Industrial Drenas 2 me investime kapitale në vlerë prej 7 milionë euro nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe tani në shqyrtim të procesit dhe marrjes së pëlqimeve për themelim të Parkut Industrial në Bërnice, Prishtinë, Parkut Industrial në Gjakovë dhe parqeve të tjera industriale teknologjike.

Për më shumë, rritje të bashkëpunimit mes industrisë dhe akademisë, jemi duke themeluar dhe ndërtuar inkubatorë të biznesit në kuadër të Universitetit të Prishtinës dhe universiteteve të rajonit, si në rastin e Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka” që veçse kemi themeluar Parkun e Biznesit, dhe tani në tenderim të projektit kapital për ta ndërtuar këtë park. Por, edhe në proces të ndërtimit dhe sjelljes në funksion të inkubatorëve të tjerë industrial në këto universitete. Pra, kryesisht në profilet që janë në funksion të përmirësimit të profileve sipas nevojave të industrisë.

Është e rëndësishme të përmendi edhe për politikat e tjera që janë zhvilluar. Dihet se kur erdhëm në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nuk gjetëm asnjë politikë të zhvilluar, ose një Strategji për të shpalosur potencialin e sektorit privat.

Nuk gjetëm asnjë politikë të investimeve ose Strategji për mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e investimeve në Republikën e Kosovës, dhe as Strategji për politikë tregtare, Strategji me objektivat për të përkrahur sektorin privat për të rritur konkurrueshmërinë edhe eksportet, por as për turizmin.

Të gjitha këto politika që i zhvilluam gjatë këtij mandati qeverisës e sollëm Kosovën në një pasqyrë shumë të mirë në raportet ndërkombëtare kredibile, siç është raporti ndërkombëtar i Organizatës Botërore për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, OECD, kur Kosova paraqitet pozitivisht në 12 nga 50 dimensionet e politikave, duke e tejkaluar mesataren e gash të ekonomive të Ballkani Perëndimor në pesë dimensione të politikave.

Duke përjetuar, po ashtu rritjen më të madhe të rezultateve në fushën e politikave dhe të promovimit të investimeve, si dhe politikave të bujqësisë dhe turizmit gjersa pozicionohemi si lider rajonal në politikat tregtare dhe në ndërmarrjet shtetërore.

Po ashtu, raporti i fundit nga FDI Intelligence, mbështetur nga Financial Times e rendit Kosovën në vendin e dytë në Evropë e në zhvillim dhe të pestë në botë për tërheqjen e investimeve të huaja direkte në raport me bruto produktin vendor...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni një minutë që ta përfundojë fjalën. A doni ta përfundoni fjalën? Në rregull. Tani vazhdojmë me deputetët sipas radhës. Nga Lëvizja Vetëvendosje është Arbër Rexhaj. Regjia, ia mundësoni fjalën!

ARBËR REXHAJ: Përshëndetje i nderuar kryeministër i Kosovës, zoti Albin Kurti,

E nderuar nënkryetare e Kuvendit, Saranda Bogujevci,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Buxheti për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2025 është buxheti më i lartë ndonjëherë për këtë dikaster.

Buxheti i cili është në vlerë prej 207 940 243 euro do të jetë një mbështetje e jashtëzakonshme për forcimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të ushtrisë së Republikës së Kosovës.

Nga ky buxhet, pra nga 207 milionë euro, më shumë se gjysma do të jenë investime kapitale në blerjet të sistemeve moderne të armatimit dhe projekteve të tjera kapitale. Plot 113,9 milionë apo 54,80% të këtij buxheti do të jetë për investime kapitale.

Nëse e bëj një krahasim me vitin që e lamë pas, pra me vitin 2024, buxheti i ndarë për Ministrinë e Mbrojtjes ishte 153 milionë euro, ndërsa tani në këtë buxhet është 54.8 milionë euro më i lartë apo 33,15%. Ndërsa nëse e krahasojmë me projeksionet buxhetore për 2025-ën sipas Ligjit të këtij buxheti mbi ndarjet buxhetore, buxheti më i lartë për 51,7 milionë euro apo 33,15%, sepse sipas projeksioneve për vitin 2025 është paraparë buxhet prej 156,1 milionë euro.

Gjithashtu, vlen të theksohet se Ministria e Mbrojtjes ndodhet në fazën e dytë të përmbushjes së planit të përgjithshëm të tranzicionit dhe ky buxhet për këtë fazë është pakrahasimisht më i lartë sesa ia që ishte i paraparë.

Pra, sipas këtij plani, për vitin 2025 ishin paraparë të ndahen 110 milionë euro, ndërsa Qeveria Kurti ka ndarë 207,9 milionë euro, dyfish më shumë apo 100% më shumë sesa ishte e paraparë në atë plan. Kjo nuk do të thotë që ne nuk e respektojmë planin, por që në shumë aspekte e kemi të përshpejtuar realizimin e tij.

Buxheti i ndarë nga Qeveria e Kosovës do të jetë në funksion të plotë të përmbushjes së objektivave strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe direktivave të komandantit të FSK-së, e të cilat janë: menaxhimi, mirëqenia e burimeve njerëzor në FSK, aftësitë dhe kapacitetet për mbrojtje të territorit, aftësitë dhe kapacitetet për mbështetjen ushtarake për autoritetet civile, partneriteti dhe ndërveprueshmëria, edukimi dhe trajnimi, rekrutimi dhe integrimi në forcën rezervë.

Menaxhimi, ruajtja dhe zhvillimi i personelit të FSK-së do të jetë në fokus të veçantë për vitin e ardhshëm, duke siguruar që trupat tona të jenë të përgatitura, të trajnuara dhe të motivuar për të kryer detyrat sipas mandatit kushtetues.

Gjithashtu, do të vazhdohet edhe më tutje që të investohet në programet e edukimit, trajnimit dhe udhëheqjes për t'u përshtatur me ambientet e paparashikuara të sigurisë, ambient ky që është duke ndryshuar vazhdimisht.

Përgjatë vitit 2025 do të rritet gatishmëria operationale e ushtrisë sonë, duke përmbushur kapacitetet e plota operationale të regjimentit të këmbësorisë deri në fund të vitit, si dhe duke ngritur regjimentet e mbështetjes luftarake dhe elementet e mbështetjes me shërbime dhe qëndrueshmëri deri në vitin 2027.

Me buxhetin e vitit 2025 do të integrohen edhe kapacitete moderne për ngritjen e gatishmërisë për kryerjen e operacioneve të ndryshme luftarake. Njësia e aviacionit, pra sistemet e aviacionit

pa pilotë gjatë kësaj periudhe do të arrijnë kapacitete e saj të plota operationale, duke ia ofruar ushtrisë sonë kapacitetet për mbrojtje, si dhe për të kryer operatione nga ajri në distanca më të gjata.

Gjithashtu, gjatë vitit 2025 do të përmbushet faza e dytë e planit dhe po këtë vit fillon përmbushja e fazës së tretë dhe të fundit të këtij plani.

Disa të dhëna që mendoj që duhet parë edhe nga e kaluara dhe duhet krahasuar janë, e të cilat po i përmend në vijim. Që nga viti 2010 deri në vitin 2020, pra për 10 vjet për ushtrinë ishin ndarë 507 milionë euro. Nga viti 2021-2024 janë ndarë 643 milionë euro për ushtrinë, ndërsa, nëse i përfshijmë edhe ndarjet buxhetore për vitin 2025 që janë 208 milionë euro, atëherë kjo shifër shkon deri në 851 milionë euro për ushtri.

Blerje të armatimit për këto 4 vjet janë realizuar në vlerë prej 268 milionë kundrejt 3,6 milionë euro të cilat ishin realizuar nga qeveritë e kaluara.

Kur e morëm mandatin paga e ushtarit ishte 443 euro, ndërsa në mbyllje të mandatit paga e ushtarit rritet 726 euro, rritje prej 61%. Pagesa për rekrutët ishte 210 euro. Me Qeverinë Kurti tani është 350 euro. Rritje prej 60%.

Në buxhetin e vitit 2025 janë ndarë edhe mjete buxhetore për pagat e kuzhinierëve. 106 kuzhinierë janë në finalizim të rekrutimit si staf teknik. Dhe, numri total i të rekrutuarve në Forcën e Sigurisë së Kosovës gjatë periudhës 2021-2024 ka arritur në 2 271, duke e dyfishuar kështu pothuajse numrin total të ushtarëve të FSK-së. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Ariana Musliu-Shoshi.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, e nderuara kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot, ndërsa diskutojmë për buxhetin e katërt dhe të fundit të këtij mandatit qeverisës, është e domosdoshme të reflektojmë mbi standardin e jetesës së qytetarëve tan, e qytetarët e Kosovës sot ndjehen të zhgënjyer, të mashtruar e të varfëruar.

Me plot katër vjet qeverisje e 12 miliardë euro buxhet, në një demokraci funksionale Qeveria duhet të jetë një reflektim i përgjithshëm i interesave të shoqërisë që e drejton. Nëse këto interesa të pasqyruara përmes premtimeve dhe pritshmërive ndaj qytetarëve mbeten të papërmbushura, atëherë themeli i marrëdhënies në mes të Qeverisë dhe popullit është lëkundur. Pasi që e dëgjuam kryeministrin duke bërë një analizë përplot 25 vjet, pra që nga viti 2000, unë për

korrektësi dua të sjell në kujtesë të qytetarëve 21 zotime të rëndësishme, të cilat pavarësisht resurseve politike, fuqisë publike dhe resurseve që kishte kjo qeveri, kanë mbetur të perealizuara.

E para, u premtua themelimi i Fondit Sovran dhe Bankës Zhvillimore të Republikës së Kosovës. U premtua se do të shuhet Agjencia Kosovare e Privatizimit. Privatizimet kurrë më të larta nuk kanë qenë. U premtua se do të ketë furnizim me energji të vazhdueshme e të përbalueshme, por sot qytetarët paguajnë mbi 120% më shumë dhe kanë mungesë të furnizimit me rrymë 25 vjet pasluftës dhe kjo në kryeqytet të Republikës së Kosovës. U premtua të krijohet një administratë publike që nuk u kërkon ryshfet e që nuk ju vendosë haraç. Provat të futni frikën në asht të secilit punëtor në administratë publike, i nënçmuat, e qëllimi ishte të shndërrohen në servil të pushtetit. Nuk ia arritët. Premtuat fuqizim të bashkëpunimit me sindikata.

Nuk i merrni parasysh fare, nuk i pranoni as në takim, nuk e dëgjoni asnjë kërkesë e asnjë ankesë të tyre. Premtuat 12 muaj pushim të lehonisë dhe ai prindëror për të dy prindërit, nuk u realizua. Premtuat se nënat e papuna për gjashtë muajt e pushimit të lehonisë do të paguhen me pagën minimale 250 euro. Le që nuk u paguan, por sot kur ne po flasim, ende nuk e kanë pranuar as shtesën për muajin tetor e lëre më për muajin nëntor.

Premtuat se do të mbillni shprehi të punës, pra u premtua skema e punësimit të garantuar për 16 deri 18 vjeç, ku do t'u jepej mundësi e përfitimi të pagës dhe vendit të punës të garantuar nga shteti për një vit të plotë. Një mashtrim për rininë dhe një ëndërr e kot. Premtuat Tekno Park dhe hapësira për Startup 2 mijë grante në vit në vlerë totale 20 milionë euro të destinuar për qira dhe pajisje, kjo mbetet njëherë për njëherë vetëm një iluzion dhe mashtrim.

Premtuat mbështetje për qeverisjen vendore komunale, pra u premtua formimi i grantit të katërt për komuna, grant kryesisht për investime kapitale. Premtuat alokim mbi 600 milionë euro për komunat, sot komunat që nuk janë nën udhëheqjen e Lëvizjes Vetëvendosje, e që fatmirësisht janë në shumicë absolute, janë të ndëshkuara nga kjo qeveri. Ende nuk janë paguar as dëmet e plot bizneseve dhe familjeve, të cilat janë shkaktuar nga vërshimet.

Premtuat planin e sigurimit të banimit të përbalueshëm për çiftet e reja, gratë kryefamiljare, për shërbyesit publikë e arsimtarët, infermierët, policët, zjarrfikësit dhe administratë publike. Nuk u ndërtua asnjë ndërtesë deri sot. U premtua nga 50 euro për fëmijë nëse familja ka të ardhura më pak se 7 mijë euro në vit, nga 100 euro për fëmijë nëse familja ka të ardhura vjetore më pak se 6 mijë euro në vit, nga 150 euro për secilin fëmijë nëse familja të ardhurat vjetore ka më pak se 5 mijë euro.

Pra, kryeministër, matematika nuk po të funksionon, sot i marrin vetëm nga 20 euro e shumë nga fëmijët nuk janë furnizuar as me libra. U premtua se për fëmijët do të krijohen vende të mjaftueshme në çerdhe, duke ndërtuar 160 çerdhe në të gjithë vendin dhe duke ofruar shujta falas

për të gjithë nxënësit nga klasa e parë deri në klasën e pestë. Janë ndërtuar vetëm katër çerdhe. U premtua se për të moshuarit do t'i ndërtoni pesë shtëpi të tjera që do të kujdesen për ta, asnjë deri më sot. U premtua anëtarësimi i Kosovës në Fondin Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë dhe financimi i bujqësisë për çdo vit rreth 100 milionë euro. Është vetëm një mashtrim deri sot.

U premtua zhvillimi i Trepçës si hapi më i rëndësishëm për bashkimin e qytetit të Mitrovicës të ndarë në dy komuna. Sot minatorët i ngujoni në 700 metra nëntokë, i leni në grevë e i përjashtoni pa asnjë arsye çdo ditë nga puna, asnjë investim kapital. Premtuat edhe funksionalizimin e aeroportit të Gjakovës, siç po shihet avionët s'kanë të ndalur atje. Premtuat sigurime shëndetësore edhe 40 milionë euro rritje çdo vit të buxhetit për shëndetësi, ofendim, as barnat esenciale nuk janë të siguruara, qytetarët detyrohen të blejnë edhe barna, mbuloja për shtrat dhe shiringa.

Premtuat se do të rrisni numrin e qendrave dhe shërbimeve për gjendje të caktuar të autizmit, sindrom down e të tjera, asnjë hap më të voglin nuk e keni bërë, pavarësisht nevojës që këto familja kanë. Premtuat 15 milionë për projektet sportive, buxhet të veçantë për institucionet e artit e investime të mëdha nacionale, si ndërtimin e stadiumit, pishinës olimpike, opera dhe balet, përderisa për katër vite as wc publike nuk keni arritur të ndërtoni.

Premtuat rikthimin e Ministrisë së Integritit, anëtarësimin në Këshill të Evropës e NATO. Ministria e Integritit përfundoi në një zyre të vogël të Besnik Bislimi, e Kosova nën masa të BE-së dhe totalisht e izoluar. Pra, vetëm në këto 21 premtime pasqyrohet niveli i mashtrimit për katër vjet nga ky pushtet duke mos përmendur edhe shumë të tjera në planin qeverisës Kurti 2, të cilin sot nëse e kërkoni në internet, është e pamundur që ta gjeni, sepse e kanë fshirë.

Nuk duhet të fajësohen qytetarët tanë, sepse ju kanë besuar një herë. Por, tashmë janë të bindur që asnjë premtim, asnjë që u premtua nga ju nuk u realizua. U keqpërdorën rezervat shtetërore, energjia elektrike, kontratat njëburimore, diplomacia, çdo pore e shtetit, ndërsa u pasurua Kabineti qeveritar dhe partia në pushtet, pra në kurriz të qytetarit. Sot, pas katër vjetëve shkelen parimet e demokracisë, provohet t'i mbyllet goja kushdo që flet kundër këtij pushteti e nga krerët e shtetit është jashtëzakonisht e preferuar që të shkelin ligjet e Kushtetuta dhe presin që të mos ndëshkohen. Me buxhet të Kosovës e me vetura në ambasada të blera në këtë mandat qeverisës në vlerë më shumë se 12 milionë euro, Albini dhe Donika shëtisin poshtë e lartë mashtrojnë diasporën, bashkatdhetarët tanë, e keqpërdorin besimin e çdo qytetari të Kosovës brenda dhe jashtë.

Prandaj, krejt në fund qytetarë të dashur të Kosovës, e dashur diasporë, një gjë ju lutem shumë, pavarësisht që jeni mashtruar dhe, mos lejoni të mashtroheni sot e të mallkohet ky vend dhe e ardhmja jonë nesër. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë të Republikës së Kosovës!

Tanimë që sa orë po diskutojmë për buxhetin e Republikës së Kosovës, buxhet të cilin thjeshtë po mundohemi për ta arsyetuar, por nuk po kemi bazë dhe shifra që të arsyetohet ky buxhet i Republikës së Kosovës që shkon në favor të qytetarëve tanë.

Keni premtuar shumë dhe tani realizimi juaj është minimal. Keni premtuar 160 çerdhe dhe realizimi i tyre është minimal. Buxheti 114 milionë euro për katërvjeçarin e juaj është i planifikuar në këtë projekt buxhet. 130 milionë euro për energjinë në Veri. Domethënë, ju i keni dhënë 130 milionë euro për energjinë në Veri, sa milionë euro i keni dhënë ndërmarrjes KOSTT që të paguhet energjia në Veri, ndërsa kur keni ardhur në pushtet KOSTT-i ka qenë me performansë të shkëlqyeshme dhe me ardhjen e juaj në pushtet tani është me performansë të dobët dhe ju e subvenciononi KOSTT-in.

Ky buxhet më së paku është për qytetarët e Republikës së Kosovës. E keni vënë në funksion kompaninë “Elektrosever”, tani kjo kompani, të cilën ju e keni kundërshtuar sa keni qenë në opozitë, dhe tani në pozitë po funksiononi me kompaninë “Elektroseverit” dhe, edhe aty është rezultati minimal. Keni pritur rezultat të shkëlqyeshëm që të faturohen serbët në Veri me kompaninë “Elektroseverit”, por rezultati nuk është ashtu siç e keni pritur dhe ashtu siç duhet të jetë. Kemi pas formuar komision hetimor në këtë Parlament për rezervat shtetërore. Dhe, në komision nuk na keni lënë ta funksionalizojmë komisioni siç duhet me zhurma dhe me problematika që i keni bërë ju si pozitë në atë komision dhe tani ne nuk e dimë se a kanë ardhur ato rezerva shtetërore në Kosovë, ku kanë mbetur, ku është ai bedeli juaj që i ka kontraktuar rezervat shtetërore dhe thjesht nuk e dimë ku ka mbetur ky proces dhe normalisht që ne si deputetë jemi të interesuar të dimë dhe kjo pyetje shkon për ministrin me na shpjegua këtu publikisht se a kanë arritur rezervat shtetërore në republikën tonë.

Tani kemi folur për Martin Berishaj, ku ka tërhequr mjete në Beograd, në Kosovë dhe tani ende vazhdon të jetë ambasador juaji dhe e gjithë qeveria dhe Kabineti qeveritar e keni mbrojtur për keqpërdorimet që i ka bërë, por këtë rast besoj që prokuroria do ta japë fjalën e vet, por së paku nga ju si qeveri është dashur të shkarkohet nga pozita e ambasadorit dhe me këto tërheqje të milionave në Republikën e Kosovës dhe në Beograd të mos lejohet të jetë ende ambasador. Kam edhe disa çështje të tjera, të cilat dua t’i adresoj. Në kohën kur keni qenë në opozitë keni kundërshtuar truprojat, asistentë, Kabinetin e stërngarkuar me staf dhe tani sot koïncidova duke hyrë në Parlament, erdhi kryeministri me 20 truproja të veta këtu dhe absolut nuk e di prej kujt

po frikësohet dhe jam e interesuar të di se a paguhen ato truproja apo ata policë të nderuar që e ruajnë Kryeministrin e Kosovës.

Ju si Qeveri keni kundërshtuar gazin amerikan dhe tani ku e keni rezultatin për energji. Keni premtuar Fondin Sovran dhe Fondi Sovran është e vërtetë që është në Gjykatën Kushtetuese, por para se të shkojë në Gjykatën Kushtetuese, është dashur të analizoni mirë me ekspertët tuaj që të mos shkelet ligji dhe Fondi Sovran kur të vijë në Parlament, të votohet, të jetë funksional. Në këtë rast nuk e keni realizuar as Fondin Sovran. Keni premtuar shuarjen e AKP-së dhe për këto katër vjet AKP jo që nuk është shuar, po ka vazhduar vala e shitjeve në AKP vit pas viti. Domethënë ju tërë kohën në opozitë keni reaguar për shitjet e aseteve dhe tani keni vazhduar për katër vite çdo vit me shitjen e aseteve nga AKP-ja.

Ku janë investimet kapitale? Absolutisht investimet kapitale nuk janë të kënaqshme për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe tani ato investime kapitale jeni të obliguar t'i adresoni te komunat tona, te qytetarët tanë, sepse këto janë mjete të taksapaguesve tanë. Po harroni që jeni veç një menaxher apo menaxher të qeverisë, të këtij buxheti dhe ky buxhet është i qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Tani për shkak të minutave po mundohem të ngutem dhe kam një reagim apo një pyetje për ministren e Arsimit, nuk është këtu, një pyetje konkrete për të, sepse tani po del dhe fjalët i ka shumë të mëdha, por punët i ka shumë të vogla dhe duhet të tregojë se qysh e ka detyruar shefen e personelit në Qendrën e Studentëve të lëshojë vërtetim për Ekrem Hajdarin? Që nuk ka masë disiplinore në fuqi. Domethënë kjo është shkelje e ligjit dhe unë kam dokumente të sakta, të cilat i kam nxjerrë dhe për shkak se është një grua, nuk po dua këtu publikisht të them, por e lus prokurorinë të merret me këtë rast, sepse ministrja e Arsimit e ka detyruar shefen që t'i mbulojë këtë shkelje ligjore veçse për ta caktuar drejtor Ekrem Hajdarin.

Tjetër, ju mund të qeshni, është problemi juaj, sepse është edukata e familjes tuaj, nuk mund t'ju edukoj unë këtu, por unë po e them fjalën time çka dua të them. Përtej kësaj çka i ceka këtu në shkeljet e buxhetit, nuk mund ta anashkaloj realisht edhe Anamoravën dhe komunën prej nga vij unë, sepse dështimet në Anamoravë dhe investimet kapitale janë zero. Domethënë, po e përmend stadiumin e qytetit, është viti i katërt i qeverisë tuaj që 2-3 herë u rikthye tenderi këtë stadiumin e komunës së Gjilanit dhe tani klubet atje po vuajnë dhe kanë nevojë për një stadium dhe ende procedura juaj është duke vazhduar dhe në buxhetin tuaj ju e kishit planifikuar dhe nuk e di a kryhet deri në vitin 2027, domethënë deri në vitin 2027 i keni caktuar shifrat e këtij stadiumi.

Projektligji për ujërat e zeza, impiantin për ujërat e zeza e kemi votuar këtu në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Edhe ky impianti i ujërave të zeza është planifikuar deri në 2027, edhe pse ju e keni zvarritur për 2-3 vjet sa keni qenë në opozitë, nuk e keni votuar këtë marrëveshje për impiantin e ujërave të zeza, por edhe pasi që është votuar në qeverisjen e juaj katërvjeçare

domethënë impakti apo rezultati i kësaj është minimal dhe deri në vitin 2027 planifikohet buxheti për impiantin e ujërave të zeza.

Sa i përket Kampusit të Universitetit “Kadri Zeka”, secilën herë në këtë Kuvend të Republikës së Kosovës kam kërkuar, nga çfarëdo qeverie që ka qenë, që të ndërtohet Kampusi i Universitetit “Kadri Zeka” dhe në vitet 2025, 2026, 2027 keni planifikuar buxhet minimal, ku asnjë kioskë nuk ndërtohet me atë buxhet që e keni planifikuar për Universitetin “Kadri Zeka”. Rruga nacionale është filluar dhe absolutisht ka mbetur aty, qeverisja e LDK-së e ka bërë këtë projekt dhe ka ardhur dhe e ka përruar dhe tani me ardhjen e juaj në pushtet, rruga Gjilan – Prishtinë ka mbetur ashtu qysh e ka lënë Qeveria e kaluar, domethënë Qeveria e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe absolutisht asnjë hap nuk e keni bërë ju si qeveri dhe tani në rrugën Gjilan – Prishtinë ato biznese tanimë kanë mbetur të dëmtuara dhe normalisht që janë të pakënaqur, sepse Gjilani dhe Anamorava janë taksapagues të rregullt të buxhetit të Republikës së Kosovës. Kjo zvarritje është e papranueshme.

Sa i përket autostradës, keni premtuar që në vitin 2023 do të përfundojë autostrada e Gjilanit dhe tani besoj edhe ju vetë e dini se absolutisht këto punime janë duke u zvarritur dhe në buxhetin e planifikuar nga ju autostrada është e planifikuar në buxhetin për 2027-ën, domethënë edhe kjo është një dështim për katërvjeçarin tuaj dhe tani kur flasim për buxhetin, ne nuk jemi në gjendje me rregullua apo ju si qeveri nuk jeni në gjendje të rregulloni një urë realisht që e bashkon Gjilanin me Prishtinën.

Tërë kohën flisni për Urën e Ibrit, po edhe këtu edhe nëpër medime dhe gjithandej kam kërkuar që bashkoni Gjilanin edhe Prishtinën me një urë kaq pak kilometra dhe nuk jeni në gjendje ta rregulloni e të mos flasim për autostradë, për stadium, e për impiantin e ujërave të zeza. Domethënë, ju si qeveri Gjilanin e keni harruar dhe për juve po ju theksoj dhe po ju citoj që edhe Gjilani është pjesë e Republikës së Kosovës dhe Anamorave dhe ju duhet ta ktheni vëmendjen edhe andej.

KRYESUESJA: I kemi dy replika nga ministrja Hajdari dhe ministrja Rizvanolli.

MINISTRJA ROZETA HAJDARI: Meqë u ngrit pyetja lidhur me rezervën shtetërore nga deputetja Bunjaku, unë po ju njoftoj se janë disa ligje në fuqi që më detyrojnë që unë të mos shpalos asnjë detaj para teje për rezervën shtetërore. Është Ligji për rezervën shtetërore, nenet 9 dhe 10 që thotë “Programi vjetor dhe plani strategjik janë sekret dhe nuk shpalosen pra në diskutim të hapur në Kuvend”. Po ashtu, është edhe Rregullorja që është neni 35, i Rregullores së Kuvendit, ku thotë që komisionet mund të diskutojnë tema të hapura në Kuvend përveç në rastet kur kanë tema sekrete ose çështje esenciale të ndjeshme.

Të lutem, i lexon këto ligje, është edhe Ligji për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar si sekret, që po ashtu më parandalon të flas para jush dhe për më shumë ju jeni të njoftuar me procesin gjyqësor ndaj zyrtarëve të MINT, ku Gjykata e Apelit veçse ka konstatuar që nuk kanë vepër penale. Për më shumë jeni e njoftuar që sa keni lënë buxhet me vetë ministren e juaj Hykmete Bajrami, në vitin 2021 kur unë kam trashëguar atë ministri me buxhetin e rezervës shtetërore dhe tani atë buxhet siç e kam gjetur, pra e kemi rritur për 30-fish më shumë dhe duke realizuar atë plan të Qeverisë Hoti që kishte aprovuar një plan strategjik për rezervën shtetërore për pa siguruar buxhet, duke i thënë vetë ministrisë që të sigurojë buxhetin në mënyrën vetjake. Për më shumë unë nuk dua të citoj vendimet e Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme, por janë publike dhe ju mund t'i lexoni.

Faleminderit!

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputetja Bunjaku Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Zonja Hajdari, s'po di tash kush s'e kemi lexuar ligjin. Ligji nuk thotë për të mos pasur tender publik për rezervat shtetërore, por ligji thotë për të qenë sekret vendi ku ruhen rezervat shtetërore, e para.

E dyta, sa i përket gjykatës apo vendimit, të cilin e kanë lejuar gjykata që kanë thënë nuk duhet të mbahen në paraburgim, nuk i ka shpallur të pafajshëm, por ka thënë janë liruar prej paraburgimit. Kështu që gjema nenin, ligjin ku thotë që edhe tenderi duhet të jetë sekret për rezervat shtetërore, e jo veç vendi. Nëse mund të më sfidosh, urdhëro, gjeje ligjin, në cilin nen, cili ligj e thotë këtë.

KRYESUESJA: Vazhdojmë me deputetët, kundër-replikë ishte, e nderuar, kështu e përcakton Rregullorja. Tani në radhë është deputeti Enver Haliti.

ENVER HALITI: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Vetëm ta kemi parasysh që të gjitha partitë opozitare këtu prezentë në Kuvend nuk kalojnë shifrën, domethënë në numër njëshifror, do të thotë kaq ka interes për këtë temë kaq të rëndësishme që po debatojmë sot sa për dijeni.

Ndërsa, është e kuptueshme që buxheti që po miratojmë sot përkon edhe me vitin e ardhshëm zgjedhor që është. Edhe deri në njëfarë mase kuptohet edhe fjalimet e deputetëve të opozitës që janë fjalime elektorale duke u munduar që t'i minimizojnë sukseset e Qeverisë Kurti, mirëpo shifrat e tregojnë krejt të kundërtën dhe nuk keni mundësi as ju, as ne, as kurrkush nuk ka

mundësi që t'i ndërrojë këto shifra, për shkak se shifrat flasin vetë. Vetëm duhet t'iu referohemi shifrave zyrtare dhe tregojnë për sukseset e kësaj qeverie që po hyjmë në vitin e fundit.

Do të thotë, mbështetja e 711 bizneseve me 20.5 milionë euro, gjithashtu subvencionimi i kredive 450 biznese me 10.4 milionë euro, këto s'mund t'i ndërrojë kurrkush. 36 milionë euro për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore, 1 mijë e 222 kredi. Do të thotë, 1 mijë e 74 biznese që janë kredituar 82 milionë euro, të gjitha investime në teknologji dhe makineri. Mbështetje 392 biznese për pjesëmarrjen në 51 panairë ndërkombëtare, ku edhe liberalizimi i vizave ka mundësuar që bizneset në lehtë t'u qasen tregjeve ndërkombëtare dhe pjesëmarrja e tyre nuk ka qenë asnjëherë më madhe dhe më e suksesshme. Afro 9 mijë e 500 biznese janë përkrahur përmes skemës SuperPuna. Dritarja për investime të diasporës, kemi edhe përfituesin e parë që do të investojë 3 milionë euro nga mërgata, do të thotë përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.

Ministrja tha që është rritur numri i bizneseve, do të thotë vetëm sa për dijeni në këtë vit në vitin 2024 për këtë periudhë kohore janë diku 10 mijë e 145 biznese të reja. Ndërsa si shifër që vlen të ceket, është se në mesin e këtyre bizneseve kemi edhe 3 mijë e 718 biznese me pronarë të huaj që janë regjistruar gjatë kësaj qeverisje, gjatë Qeverisë Kurti 2. Do të thotë, është përmirësuar klima e investimeve, kemi biznese të reja, pronarë të huaj që vijnë dhe investojnë në Kosovë. Do të thotë vetëm në vitin 2024, gjatë kësaj periudhe kemi 800 biznese të reja me pronarë të huaj që janë regjistruar në Republikën e Kosovës dhe që kanë filluar biznesin.

Do të thotë janë diku 167 mikro-ndërmarrje të vogla, të mesme që kanë përfituar grante nga skema e granteve, ku kur ka filluar punën kjo qeveri, ky fond, kjo skemë ka qenë në shumën prej 500 mijë euro. Do të thotë, tani është 4.4 milionë euro kjo skemë e granteve për biznese të vogla mikro dhe të mesme. Do të thotë, dallimi është shumë i madh, nuk mund t'i mohojmë këto. Janë në proces edhe 185 ndërmarrje fillestare Startup, mikro dhe të vogla, për digjitalizim, certifikim në vlerë prej 2.2 milionë euro. Të gjitha këto janë përkrahje që nuk mund t'i anashkalojmë. Dyfishimi i eksporteve, dyfishimi i investimeve të huaja, qarkullimi i bizneseve do të thotë 58% nga 12,5 milionë euro në vitin 2019 kur ka qenë vit normal pa pandemi, pa luftë, pa krizë. D.m.th. kemi tani njëzet miliardë euro qarkullimin e biznesit, ku viti 2024 ka rritje të vazhdueshme, do ta tejkalojë që asnjëherë Kosova s'ka pasur kësi suksesi. D.t.th. investimet kapitale që e kanë gojën plot, kjo Qeveri ka arritur sukseset historike në shpenzimin e investime kapitale. Është arra më e fortë, që nuk mund të sulmohet kjo Qeveri për këtë punë, mirëpo po mundohen t'ua shpëllajnë trurin qytetarëve, duke e përmendur gjatë gjithë kohës që kjo Qeveri s'ka investuar në investime kapitale, po mendojnë që e gënjejnë qytetarin.

E them me përgjegjësi të plotë, nga raporte zyrtare, që viti 2023 është viti që ka thyer të gjitha rekordet e të gjitha viteve të qeverive të kaluara dhe kur kanë qenë edhe vite normale, pa kriza, pa ngritje çmimesh për ndërtime dhe është në vlerën 561 milionë euro. D.m.th. viti 2024 ka trend

23 për qind pozitiv që do ta krijojë, d.t.th. do ta shënojë një standard të ri, një rekord të ri sa u përket investimeve kapitale.

Gjithashtu vlen te ceket te investimet kapitale, Kosova për herë të parë në vitin 2025 po i ofrohet shifrës së buxhetit një miliard euro të planifikuara për investime kapitale. D.m.th. një miliard euro. Veç kthehuni prapa e këqyrni si kanë qenë këto shifra.

Unë e di që kjo Qeveri nuk mund të krahasohet me qeveritë e kaluara. Mirëpo, unë një krahasim do ta bëj me vetveten. Në Qeverinë Kurti 1, kur ka marrë pushtetin në vitet 2020 a 2021, sido që të thoni. D.m.th. shpenzimet kapitale kanë qenë 626 milionë euro në vitin 2021. D.t.th. tani kemi 930 milionë euro. D.m.th. po i mbërrijmë afër miliardëshit. Kemi kategorinë e mallrave dhe shërbimeve, ka qenë 313 milionë euro në vitin 2021, tani janë plus 222 milionë euro më shumë. Te kategoria paga, d.m.th. kanë qenë 652 milionë euro, i kemi plus 290 milionë euro shtesë në kategorinë e pagave. Te subvencione e transfere janë 1 miliard e 155 milionë, apo kemi shtesë prej plus 516,6 milionë euro. D.m.th. këto janë rezultatet. Ky është krahasim me vetveten. Këto shifra flasin për suksesin e kësaj Qeverie.

Kjo Qeveri ka sjellë edhe një standard të ri, për shkak se çdo investitor serioz, kriterin e parë, kushtin e parë që e shikon ose kërkon në një shtet që dëshiron të investojë, është stabiliteti politik. Kjo Qeveri ka sjellë një stabilitet politik. Është Qeveria e parë që e përfundon mandatin katërvjeçar pa skandale, pa korrupsion, me ngritje ekonomike. Të gjitha raportet ndërkombëtare në top-dhjetëshe e renditin Kosovën dhe ky është sukses që duhet t'i gëzohemi të gjithë.

Unë e kuptoj opozitën, mirëpo nuk e mirëkuptoj. Kështu që, autostrada më herët u përmendën disa. Vetëm ndaluni e mendoni, asnjëherë Lëvizja Vetëvendosje s'ka qenë kundër autostradave e ndërtimit të tyre, kemi qenë kundër vjedhjes, kemi qenë kundër hajnisë. Vetëm ndaluni dhe krahasoni çmimin e një kilometri autostradë që i ka kushtuar Kosovës me shtetet e rajonit dhe të Evropës. Unë vetëm një krahasim e bëra sa i përket autostradës për Shkup, "Arbër Xhaferi", diku trembëdhjetë milionë euro ka kushtuar një kilometër Kosovës për autostradën "Arbën Xhaferi" për Maqedoni. Ndërsa, nëse e marrim Danimarkën që është një shtet mjaft i zhvilluar në Evropë, është 5,9 milionë euro për një kilometër autostradë. Vetëm krahasojeni Danimarkën me Kosovën. Ose nuk po shkojmë në Danimarkë, po shkojmë në vende të rajonit. E njëjta kompani që ka ndërtuar në Kosovë autostradën e kombit dhe autostradën "Arbër Xhaferi", në shtetet e rajonit ka ndërtuar për shtatë milionë euro një kilometër autostradë me të njëjtin standard. Ju tani gjykojeni vetë. Lëvizja Vetëvendosje ka qenë kundër vjedhjes e kundër hajnisë, po kundër autostradave asnjëherë s'ka qenë, mirëpo çmimi është paguar dyfish. Gjithmonë do të jemi kundër kësaj hajnie klasike nga ministra që tanimë kemi edhe verdikt gjykate që janë të dënuar për keqpërdorim dhe korrupsion.

Tjetra, një gjë që opozita ta mashtrojë qytetarin. Thotë që ky është buxhet i përkohshëm tranzitor. Unë pajtohem se është buxhet njëvjeçar, se s'ka buxhet dyvjeçar e trevjeçar. Është normal, është për vitin 2025. Mirëpo, po të ishit ju aq serioz, që njëmend mendoni që do të qeverisni në mandatin e ardhshëm, pse s'e votoni një marrëveshje ndërkombëtare që është në vlerë prej nëntëdhjetë milionë euro me zero për qind interes, me mundësi shfrytëzimi afatgjatë me zero për qind interes? Nëse ju nesër do të jeni në Qeveri, ju do ta shpenzoni këtë buxhet nëntëdhjetë milionë euro. Po ju jeni qesharakë, ju e gënjeni vetveten dhe mundoheni ta gënjeni qytetarin, mirëpo nuk do t'ia arrini, për shkak se qytetarët e dinë, ju kanë parë, edhe një fjalë popullore thotë: “Po të mos ju njihja, ju kisha paguar shumë shtrenjtë”.

KRYESUESJA: Pasi që jua kam ngatërruar radhën, tani po ia jap fjalën ministres Rizvanolli dhe vazhdojmë me radhën e deputetëve.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Ju faleminderit!

Kam vendosur sot të mos përgjigjem derisa një e pavërtetë ose keqinterpretim të përsëritet së paku tri herë. Disa prej tyre e kanë ngritur deri shtatë herë deri tash.

Janë do çështje, së pari, të cilat duhet të vihen në kontekst, edhe të cilat duhet të qartësohen. P.sh. asnjë megavat nuk është shtuar gjatë një mandati, thatë. Po dua t'ju përkujtoj pak kontekst, që në 22 vjet që keni qeverisur janë shtuar 220 MW në total. Këto me ‘feed’-in tarifa administrative, pa konkurrencë, pa transparencë, me çmime të larta, me degradim të jashtëzakonshëm ambiental në rastin e hidrocentraleve. Përderisa për këtë mandat, në kushte të një krize të paprecedent energjetike, janë filluar 250 MW të kapaciteteve të burimeve të ripërtëritshme të energjisë. Është nënshkruar kontrata për parkun solar 100 MW, është në fazën e përgatitjes së tenderit parku solar prej 100 MW në KEK dhe në fazën e tenderimit 50 MW gjithashtu termike për ngrohjen qendrore në Prishtinë. 170 MW kapacitet bateri, në fazë të përgatitjes së tenderit. Përderisa, për 75 MW të tjerë nga era do të shpallet ankandi deri në fund të mandatit. D.m.th. dyfish më shumë kapacitete janë filluar projekte brenda një mandati sesa krejt njëzet e dy vjetët e kaluara gjatë të cilave keni qeverisur.

Diçka për çmimet. Nuk shkon java as dita pa dëgjuar një gënjeshtër në lidhje me çmimet, dyfish, trefish, çdo vit, dyqind për qind, 117 për qind, e të tjera.

E vërteta është 10,9 për qind për një familje mesatare katëranëtarëshe është rritur çmimi i energjisë elektrike në 2023, në krahasim me 2020, sipas të dhënave nga Eurostat.

Çmimi i energjisë elektrike është më i larti në rajon. Disa thonë është sa në Suedi çmimi i energjisë elektrike, në Holandë etj. E vërteta është se është më i liri në rajon dhe Evropë. Vetëm në rajon, tridhjetë për qind më i lartë është në Bosnjë e Hercegovinë, 44 për qind më i lartë në Mal të Zi, 51 për qind më i lartë në Serbi dhe 57 për qind në Maqedoninë e Veriut.

Keni premtuar ulje të çmimit. Është e pavërtetë. Ulja e çmimit të energjisë elektrike është përmendur në vitin 2016 në një kontekst ku ka pasur eksplodim në TC Kosova A dhe është rritur çmimi i energjisë elektrike, përkohësisht është dashur të rritet, përderisa nuk është ulur kurrë. Tash e kam marrë vesh që një arsye pse kishte qenë kjo, është që gjatë Qeverisë Isa Mustafa është vonuar në vitin 2016-2017 shpronësimi i minierës dhe dyzet milionë euro është rritur kosto e importit gjatë asaj periudhe. Kjo ndoshta ka qenë një prej arsyeve që s'ka arritur të ulët çmimi i energjisë elektrike, ndërsa tani gjatë qeverisjes sonë, në kuadër të një krize pa precedent, ku çmimi i importit është rritur deri gjashtëmbëdhjetëfish në krahasim me atë të viteve paraqera, kërkoni ulje të çmimit të energjisë elektrike.

Kriza sigurisht që nuk ka ardhur prej brenda, mirëpo sigurisht që disa vendime i kanë kontribuar që kriza të jetë më e vështirë për ne sesa që është dashur të jetë. Një prej këtyre kyçe është heqja e bllok-tarifës në 2017, pikërisht e iniciuar nga Grupi Parlamentar i LDK-së. Si rezultat i kësaj kishte eksploduar kërkesa për ngrohje për energji elektrike me kalidajë joeficiente si në asnjë vend tjetër të botës, duke na gjetur kështu në një situatë shumë më të keqe sesa që është dashur.

Tani, na akuzoni neve se po subvencionojmë klima inverter, që janë eficientë dhe e ulin deri 60-70 për qind konsumin e energjisë elektrike në krahasim me kalidajë që janë përdorur në kohën që keni qeverisur ju, dhe e shfrytëzoni këtë për të treguar se janë bërë politika të këqija.

Po jua përkujtoj edhe një herë, janë subvencionuar subvencionimi me energji elektrike dhe atë me pajisje eficientë është subvencionuar vetëm për familjet të cilat kanë qenë duke u ngrohur me energji elektrike në mënyrë joeficiente dhe jo për familjet e tjera. Ndoshta janë subvencionuar njëkohësisht edhe stufat me biomasë, kalidajë me biomasë, si dhe pompat termike.

Kur jemi te eksplodimi i konsumit, diçka tjetër që ka ndodhur përgjatë viteve të qeverisjes suaj, ka qenë eksplodimi i konsumit në pjesën veriore të vendit. Në vitin 2019 është rritur për 8.1 për qind konsumi në krahasim me vitin paraqer. Në vitin 2020 - 13,7 për qind, në vitin 2021 - 13 për qind. Kjo nuk ka qenë vetëm për ngrohje dhe nuk ka qenë vetëm për biznes atje. Ka qenë, sepse ka qenë duke lulëzuar krimi i organizuar, droga e kriptovalutat. Kur ka filluar Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Dogana e institucionet e tjera t'i luftojnë këto dukuri, kanë filluar të shihen rezultatet. Në vitin 2022, është ulur për 2,5 për qind konsumi, në vitin 2023 është ulur konsumi prapë për 13 për qind, ndërsa në janar-gusht të vitit 2024, pasi që është zgjidhur çështja e mospagesës së energjisë elektrike në katër komunat veriore, për herë të parë pas 24 vjetësh, konsumi është ulur për 35 për qind.

Po doni të flisni për sa është shpenzuar atje, sa është paguar atje? Po jua përkujtoj që pagesën e energjisë elektrike për komunat veriore nuk e kemi sjellë ne, madje as "Elektroseverin" nuk e kemi sjellë ne. E keni nënshkruar marrëveshjen në vitin 2013, mirëpo nuk keni qenë në gjendje ta realizoni. Sot, në vitin 2024, pagesa për energjinë elektrike në veri është zero euro, e paguar

prej qytetarëve të pjesës tjetër të Republikës së Kosovës, përderisa për 23 vjet të kaluara ka qenë 385 milionë euro. Kjo është diçka e jashtëzakonshme që mendoj që nuk përmendet mjaftueshëm.

Për investimet në efikasitet, sepse jo krejt investimet janë asfalt, me renovimin e 121 ndërtesave publike, kemi krijuar kushte më të mira për punonjësit, nxënësit, pacientët dhe sportistët, duke mundësuar një ambient më të rehatshëm e produktiv që kontribuon në përmirësimin e cilësisë, jetës e të punës. Duke përfshirë këtu 20 milionë euro investime në pesëmbëdhjetë ndërtesa spitalore, 76 shkolla e fakultete, katër salla të sporteve, 26 institucione administrative, me gjashtëdhjetë mijë përfitues dhe kursim të energjisë elektrike me 50-90 për qind. Këto vetëm nga Ministria e Ekonomisë, përderisa nga Fondi kosovar për efikasitet të energjisë është investuar edhe në tetëdhjetë ndërtesa të tjera.

KRYESUESJA: Kemi dy kundër-replika, nga deputetja Hykmete Bajrami dhe deputeti Besian Mustafa.

HYKMETE BAJRAMI: Ministre,

Prapë nuk iu referove asnjë raporti. Janë tri vendime të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Elektrike. Vendimi i parë është më 8 shkurt 2022, ku tarifa e lartë për të gjithë konsumatorët që shpenzojnë mbi 800 MW është ngritur 104 për qind dhe tarifa e ulët është ngritur 85 për qind.

Vendimin e dytë të ZRRE-së e ke ngritur 15 për qind për të gjithë shpenzuesit dhe e ke një vendim të tretë, në fund për një ulje 8 për qind për të gjithë shpenzuesit. Këto janë faktet. Kështu që, duhet referuar fakteve. Dhe është tepër e vërtetë që ke shkuar prej 3.5 në tarifën e ulët në shtatë, dhe prej shtatë në katërmëdhjetë. Këto janë fakte. Nuk po shpifim asgjë, të gjitha këto janë fakte. Merrini e publikoni vendimet e ZRRE-së, përndryshe i ke të publikuara, ne i kemi pasur të gjithë edhe këtu.

Sa i përket projektit të baterive për Millenium Cooperation Challenge, unë dhe ju duhet thënë faleminderit shumë Atifete Jahjagës, ish-Presidentes. Mos u mundoni ta shitni një punë, që është një meritë komplet e tjetërkujt, si meritë tuajën. A e di cila është merita jote? Që ke vendosur të mos e sjellësh gazin e lëngshëm amerikan në Kosovë, po në vend të saj, të bëni bateri pa rritur kapacitetet. D.m.th. doni të ruani energjinë elektrike të cilën nuk e blen. Edhe parku solar, i ke do kontrata, prapë qëndron argumenti i opozitës, i të gjithëve, që thanë që deri më tash nuk e ke rritur asnjë megavat kapacitetet. Nuk ke rritje të kapaciteteve.

Përndryshe, edhe njëherë po ta them, gjeji dokumentet dhe publikoji se qysh paska kushtuar energjia elektrike e veriut 320 milionë euro. Sepse, ajo që kemi ne, prej pasqyrave financiare të KOSTT është 2019 - 4,5 milionë, 2020 - 8,7.

KRYESUESJA: Zakonisht në replikë nuk e shtoj kohën, por po ta jap edhe një minutë, por atëherë duhet të jemi të barabartë edhe me të tjerët.

HYKMETE BAJRAMI. Në 2021, ministre, i ke 52,6 milionë, 2022 - 78 milionë dhe 2023 - 35,7 milionë. Edhe po, ne jemi ata që e kemi nënshkruar marrëveshjen, po nuk linit të zbatoheshin, e kur erdhët e patë që janë të mira dhe po i zbatoni vetë. Tash po thirrreni kinse po zbatoni sovranitet atje. Po në fakt, realiteti qëndron ndryshe, sepse as dhjetë për qind s'janë duke paguar, e KOSTT kur paguan, paguajnë qytetarët e Republikës së Kosovës, se KOSTT e ke futur në kredi dhe t'i ka paguar me interesa. Të kujt kanë qenë fitimet e KOSTT? D.m.th. KOSTT ka marrë interes, ka marrë kredi të ju dhe e ka kthyer atë kredi me interesa. Sot, gjendjen financiare të KOSTT e ke të mjerueshme, për shkak të këtyre humbjeve të mëdha, e ju po më flisni se si e keni luftuar informalitetin atje, përderisa konsumi të është rritur deri 78 milionë në vit. Prej 5.4 milionëve, 78 milionë. Këto janë faktet.

KRYESUESJA: Besian Mustafa, replikë!

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryesuese!

Ministre,

Je ekonomiste, nuk ke nevojë të flasësh kështu paushall. Ku janë kapacitetet e reja të energjisë elektrike që i ke ndërtuar për katër vjet? Ku janë? Përveç kontratave, vizioneve, projekteve, programeve, ideve etj. A mund të na tregosh sa megavatë kapacitete të reja të energjisë elektrike prodhohen në këto katër vjet? Ku janë ato, se s'po i sheh askush. Lëri letrat, në realitet, në terren, në realitetin tredimensional ku jetojmë ne, ku janë? S'e ke asnjë, ministre. Asnjë!

Keni deklaruar që energjinë elektrike është më e lira në rajon. A mund ta kundërshtosh që e keni gjetur edhe më të lirë kur keni ardhur para katër vjetësh? Edhe më lirë ka qenë, në periudhën e mandatit tuaj është shtrenjtuar energjia elektrike? E keni refuzuar kategorikisht, edhe kur keni qenë në opozitë, e i keni dështuar ato projekte kur keni ardhur në pushtet. Projektin Kosova e Re - Kosova C dhe gazin amerikan, LNG amerikane. I keni refuzuar dhe jeni thirrur në sukses për ato bateritë, që siç tha Hykmetja, janë meritë a projekt i Atifete Jahjaga, ish-presidentja e Republikës së Kosovës.

Po e përsëris atë edhe një herë që e tha Hykmetja, nëse marrëveshja për energjinë në veri të Republikës së Kosovës paska qenë kaq e dëmshme, pse po e zbatoni e nuk e sollët në Kuvend ta anuloni atë marrëveshje. Këtu është aprovuar, pse nuk e sollët këtu ta anuloni?

KRYESUESJA: Ministrja Rizvanolli, kundër-replikë.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Pse nuk e zbatuat ju atë marrëveshje që menduat që është kaq e mirë? Pse u deshën dhjetë vjet dhe pse u desh ne të vijmë për të mos paguar energjinë elektrike për qytetarët në komunat veriore? Dhe jo qytetarët, po bizneset në treg të zi, kriminelët?

Sa u përket megavatëve, po veç një pyetje mund ta bëjë deputet Mustafa, a e di sa kohë duhet për të ndërtuar kapacitete? A e ke idenë, qoftë për një park solar, qoftë për një kapacitet të erës, kudo në Evropë? A e ke idenë?

Sa i përket çmimit të energjisë elektrike, faleminderit shumë që i përmende të tri vendimet, meqenëse e para qe jo e saktë. E dini shumë mirë që nën-blokun 800 KW/h që janë shtatëdhjetë për qind të familjeve gjatë dimrit e diku nëntëdhjetë e ca të familjeve gjatë verës nuk është rritur fare në vitin 2022.

Në vitin 2023, e patët të saktë, edhe në vitin 2024 faleminderit që e cekët që ka pasur ulje, sepse zakonisht thoni që është rritur energjia elektrike tre vjet rend.

Sa i përket projektit dhe meritave të projektit. Po ju përkujtoj disa gjëra. E para në projektin Threshold, plani ka qenë të jetë së paku 250 milionë projekti. Ka qenë projekti Threshold vetëm pesëdhjetë milionë, sepse nuk kanë kaluar kriteret, sepse keni dështuar në kriteret e korrupsionit. Kjo është shumë e saktë dhe ka përfunduar projekti me një projekt shumë më të vogël në pjesën e eficiencës.

Sa i përket projektit të gazit, kurrë nuk e mësuat, apo nuk po doni ta mësoni, a ka qenë gaz i lëngshëm amerikan, a ka qenë nga Azerbajxhani? Cili ka qenë plani? Gaz amerikan...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni edhe një minutë ta përfundojë fjalën.

MINISTRJA ARTANE RIZVANOLLI: Kjo nuk është e saktë, po ju informoj.

A e di çka tjetër nuk është e saktë. Nuk është e saktë që ka pasur të financohet prej grantit. Ka qenë një projekt deri 500-600 milionë dollarë, varësisht nga opsioni, prej të cilave 120-180 milionë do të ishin grant. Ky është projekti siç ka qenë, përderisa projekti aktual, të cilin e kemi negociuar, ka pasur një investim prej 200 milionë dollarësh, vlerë e investimit kapital, në program prej 236.7 milionë eurove, prej të cilave dyqind milionë kanë qenë grant.

Sa i përket energjisë elektrike në veri, po më duhet t'ju them, për personat që flisni gjatë gjithë kohës, shpesh për këtë çështje, jeni mjaft të painformuar. Pavarësisht nivelit të faturimit në veri, çfarë është... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Për pesë vjet e keni kthyer këtë Kuvend në një skenë gënjeshtresh, fyerjesh e mashtrimesh.

Kuvendin e keni kthyer në arenë në të cilën poshtëroni qytetarët e Kosovës dhe këtë po e bëni për të qëndruar në pushtet. Ka kaq shumë për të folur, duke filluar nga infrastruktura rrugore, shkollat, rruga, uji i pijshëm, banesat për çifte të reja, shtëpitë për moshat e shtyra, çerdhet, shëndetësia, ushtria. Ka kaq shumë premtime të rreme, saqë edhe një seancë njëjavore, pandërprerë asnjëherë, nëse e thërrasim, nuk ia dalim dot të shpërfaqim të gjitha dështimet që i ka ky pushtet e kjo Qeveri.

Të gjitha këto anashkalime, abuzime buxhetore do t'i mbajmë para jush deri më 9 shkurt, sepse nuk e meritoni ndryshe. Do t'ju demaskojmë për çdo rrenë, për çdo mashtrim, për çdo vjedhje. Do t'ju maskojmë para opinionit publik dhe do t'ju lëmë ashtu siç jeni në të vërtetë.

Sot, nuk do t'i përsëris kolegët e mi dhe nuk do të ndalem të flas as me shifra e numra, sepse është e kot të flasësh me ju, se ju jeni ekspertë të mashtrimit.

Sot dua të ndalem te perceptimi i Albin Kurtit ndaj vetes së tij, te vetëlavdërimi i Albinut për veten e tij. Albini tha: "E kam nderin që po e çoj mandatin deri në fund". Nderin? O Albin, ti nuk ke nder. Ti nuk e di as çka është nderi. Ti nuk ke nder. Ti ke turp. Ti e ke mbajtur këtë shtet peng me zero zhvillim, me dialog në favor të Serbisë, me sanksione nga BE-ja, me ministra anikushtetues, me klientelizëm e familjarizim të institucionalizuar, me përçarje ekstreme e me diskriminim rajonal e me njëmijë e njëqind dështime të tjera. Një kryeministër që ka nder e arsye të shëndoshë, e dorëzon karrigen, nuk e dorëzon shtetin si ti, Albin. Pesë vjet në pushtet do të mbahen mend si pesë vjetët më të errëta të ngritjes së Kosovës shtet. Do të mbetesh në histori si një rrenacak destruktiv, antishtetëror, antikombëtar.

Prandaj, mësohu të jesh i përgjegjshëm.

KRYESUESJA: Kujdes fjalorin!

GANIMETE MUSLIU: Mos filozofo! Të mos filozofosh për nderin, sepse ti veç nder nuk ke. Ti je turpi i këtij vendi. Mbage dhe jeto me këtë fakt, se do të përcjellë gjeneratë pas gjenerate për dështimin që ia ke bërë këtij vendi. Për mashtrimin që ua ke bërë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe po vazhdon edhe sot t'ua bësh.

KRYESUESJA: Tani në radhë është Rrezarta Krasniqi.

RREZARTA KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Sot është thirrur kjo seancë për ta vazhduar një praktikë të stagnimit dhe regresit ekonomik.

Një praktikë e instaluar tash e 4 vjet. Një praktikë e hartimit të buxheteve që po e çon Kosovën në një rrugë pa kthim të stagnimit e regresit ekonomik. Buxhetet e propozuara nga kjo Qeveri që gjendjen e rëndë të qytetarëve tani mundohen ta rregullojnë me lëmosha, e jo me zhvillim e punësim.

Buxhetet e njëpasnjëshme, ku premtimet elektorale të fushatës së vitit 2021 vazhdojnë të përsëriten pa u realizuar asnjë. Është një mal i premtimeve e projekteve të porealizuara, të cilat nuk del kohë t'i listoj. Nuk ka shembull më të mirë që e pasqyron punën e kësaj Qeverie të paaftë sesa rasti me urën mbi liqenin e Badocit. Po flas për një urë të gjatë 35 metra. Kjo urë është mbyllur për qarkullim në muajin maj të vitit të kaluar. Pra, para 18 muajve. Një urë e një rëndësie të veçantë, sepse lidh kryeqytetin me Gjilanin dhe me Kamenicën dhe me vende të tjera.

Zëvendësministri Hysen Durmishi në maj të vitit 2023 pati thënë, po e citoj: “Ura është e gjatë 35 metra, me tri hapësira drite, si dhe me gjatësi të rrugës 7,5 m dhe me trotualet e elementet e tjera përcjellëse. Afati i përfundimit të kësaj ure është 125 ditë”. Pra, për një urë 35 metra dhe afati i përfundimit 125 ditë.

Sot, qytetarë të dashur, është data 11 nëntor 2024. Kanë kaluar mbi 18 muaj apo 550 ditë dhe kjo urë ende nuk është përfunduar. Është fjala për një urë 35 metra. Kjo është pasqyra më e mirë e punës së kësaj Qeverie. Kjo tregon se jeni të paaftë për qeverisje.

Sikur me këtë urë për katër vjet me radhë, katër buxhete sikur ky sot, 11 miliardë euro dhe s’keni asnjë investim të madh në vend.

Po i numëroj disa nga premtimet dhe projektet e tjera të papërbushura nga kjo Qeveri. 160 çerdhe, premtim i rrejshëm. Fondi Sovran, premtim i rrejshëm. Sigurimet shëndetësore, premtim i rrejshëm. Shuarja e AKP-së, premtim i rrejshëm. Vetingu, premtim i rrejshëm. Banesat sociale, premtim i rrejshëm. Ligji për punëtorët në sektorin privat, premtim i rrejshëm. Byroja për Konfiskimin e Pasurisë, premtim i rrejshëm. Aeroporti i Gjakovës, premtim i rrejshëm.

Përveç se s’keni bërë asgjë, ju i keni bërë edhe shumë dëm Kosovës. Kosova ka humbur 290 milionë, sepse jemi nën masë nga Bashkimi Evropian. I keni dhënë 278 milionë euro tenderë njëburimorë. 7 milionë donacion të BE-së për vaksina dhe më pas e keni futur Kosovën në kredi, sepse jeni detyruar t’ia ktheni BE-së, se keni qenë të paaftë për ta kryer këtë projekt.

E keni vonuar përfundimin e rrugës Prishtinë-Vushtri-Mitrovicë tash e katër vjet. Keni ardhur në pushtet dhe keni thënë që do të kryhet për 12 muaj. Ajo rrugë ende nuk është përfunduar. Është vetë këtu kryeministri që pati premtuar për rrugën Prishtinë-Podujevë që do ta kryejë në vitin 2022. Tash jemi në vitin 2024 dhe ajo rrugë ende s'ka përfunduar.

Sikur edhe në shumë fusha të tjera që e keni kufizuar lirinë dhe demokracinë, edhe me këtë buxhet në Kuvendin e Republikës së Kosovës keni vepruar njëjtë. Është hera e parë në historinë e Republikës së Kosovës kur nuk merret parasysh asnjë propozim i partive opozitare.

Qytetarët e Republikës së Kosovës na kanë votuar që t'i përfaqësojmë edhe duhet ta dini që buxheti nuk është as i Albin Kurtit, e as i Hekuran Muratit. Ky buxhet nuk ofron asnjë zhvillim, as perspektivë për qytetarët, prandaj pas datës 9 shkurt, Lidhja Demokratike e Kosovës do ta rishikojë këtë buxhet të regresit, të stagnimit dhe diskriminimit.

Lidhja Demokratike e Kosovës do ta kthejë në vend shpresën me projekte zhvillimore, jo me retorika boshe. Qytetarët më 9 shkurt do ta ndëshkojnë këtë Qeveri të paafte e të korruptuar dhe do të zgjedhin një rrugë tjetër, e ajo është rruga e re. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani fjalën e ka zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla-Schwarz.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA DONIKA GËRVALLA-SCHWARC:

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës sot paraqet para jush një Projektbuxhet ambicioz për vitin 2025.

Krahasuar me fillimin e mandatit tonë, ky buxhet shënon rritje nga 29 milionë në 49,4 milionë euro për vitin 2025. Kjo rritje e buxhetit mundëson financimin e qëndrueshëm të aktivitete të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, duke siguruar kështu përmbushjen e misionit të politikës së jashtme, fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar dhe një përfaqësim më të dinjitetshëm në organizata ndërkombëtare.

Projektbuxheti për vitin 2025 siguron rritjen e kapaciteteve njerëzore të shërbimit të jashtëm për të arritur përfaqësim dinjitoz të Kosovës dhe shërbime më cilësore ndaj qytetarëve tanë jashtë vendit. Siguron rritjen e aktiviteteve të misioneve diplomatike dhe konsullore, të cilat kanë për qëllim arritjen e objektivave shtetërore në politikën e jashtme.

Mundëson edhe shtrirje më dinamike të aktiviteteve në shtetet jonjohëse, por edhe në shtetet që e kanë njohur Republikën tonë, por me të cilat ende nuk kemi marrëdhënie diplomatike.

Ky Projektbuxhet fuqizon marrëdhëniet ekonomike me vendet e tjera, duke përfshirë ato mosnjohëse me qëllim të zhvillimit më të qëndrueshëm ekonomik, por edhe të konsolidimit të marrëdhënieve diplomatike përmes bashkëpunimit ekonomik.

Vazhdimin e blerjes së objekteve të ambasadave si prona të Republikës së Kosovës, duke dëshmuar kështu edhe seriozitet në marrëdhëniet tona të përhershme me qendrat kryesore diplomatike, por edhe duke racionalizuar shpenzimet e qirasë.

Sigurojmë një rritje të theksuar të subvencioneve për projekte me shoqërinë civile, duke mos përjashtuar këtu edhe programet e ndryshme që e lidhin mërgatën me Kosovën dhe fuqizojnë diplomacitë publike dhe ekonomike me vendet e tjera.

Siguron programe qeveritare, tashmë shumëvjeçare për angazhimin e të rinjve të kualifikuar nga mërgata në institucionet e shtetit. Programet për strehimin dhe mbështetjen e gazetarëve nga Ukraina dhe Afganistani, si dhe rritjen e bashkëpunimit me mërgatën në kontekstin e diplomacisë publike dhe ekonomike përmes fondit të impaktik në qendrat kryesore diplomatike të Kosovës, të cilat do të realizohen me aktorë dhe organizata me influencë edhe në mërgatë.

Të nderuar deputetë,

Gjatë qeverisjes 2021-2024, falë vendosmërisë dhe përkushtimit tonë kemi ndërmarrë hapa të rëndësishëm dhe kemi instaluar instrumente financiare të cilat kanë siguruar financim transparent dhe të qëndrueshëm të politikës së jashtme të Kosovës.

Kemi instaluar një sistem të avancuar të kontrollit për të rritur transparencën dhe llogaridhënien institucionale. Sot, misionet tona kanë buxhet të mjaftueshëm dhe arrijnë të përmbushin me sukses aktivitetet e tyre diplomatike. Për shembull, detyrimet e misioneve diplomatike të bartura kundërligjshëm nga viti në vit nga 2 milionë euro, i kemi reduktuar në vetëm 18 mijë euro.

Shpenzimet për mallra, bileta dhe akomodim janë optimizuar, dhe raporti i auditimit për ministrinë tonë është pa shkelje dhe pa vërejtje. Një arritje kjo që dëshmon përkushtimin tonë ndaj një menaxhimi të përgjegjshëm dhe efektiv të fondeve publike.

Nuk paguajmë më bileta luksi për zyrtarët apo për përfaqësues qeveritarë, dhe e kemi rregulluar bazën ligjore për shpenzimet e qirave të diplomatëve. Regjistrimi dhe digjitalizimi i asetëve shtetërore dhe shërbimeve të ndryshme janë, jo vetëm një tjetër arritje e rëndësishme për rritjen e kontrollit mbi asetet publike, por sigurojnë edhe transparencë të plotë dhe parandalojnë keqpërdorimin dhe keqmenaxhimin, dhe duke siguruar shpenzim të drejtë, të ndershëm dhe efikas të parasë publike.

KRYESUESJA: Tani në radhë është Milazim Salijaj. Po jua lejoj edhe pikat në emër të grupeve. Hykmete Bajrami e ka fjalën.

HYKMETE BAJRAMI: Ministre, faleminderit shumë!

Na njoftove për shpenzimin e buxhetit të kuadër të ministrisë tënde. Janë bërë sot këtu disa pyetje. Se kur flasim për shpenzim të buxhetit, shpenzimi i buxhetit nuk është qëllim në vete, janë rezultatet të cilat krijohen, objektivat të cilat arrihen me paratë, taksat dhe tatimet e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Na trego se çfarë të mirash i ka sjellë Gani Jakupi Republikës së Kosovës. Na trego sa njohje i ke sjellë për mandatin tënd 4-vjeçar. Na trego në sa organizata ndërkombëtare jemi anëtarësuar. Të lutem, këto na i trego! Përndryshe, vetëm mund të dalësh e t'u thuash qytetarëve që, faleminderit për tatimet që i keni paguar, por kemi dështuar në misionin tonë.

Partia me të cilët ti je ulur aty, këta e kanë kallë një Kosovë për një marrëveshje, e cila ka pasur brenda një moratorium që të mos kërkohet njohje. Ajo marrëveshje ka kaluar, një vit ka qenë. Një vit. Ka kaluar. Por, ne e kemi marrë një njohje në kuadër të asaj marrëveshjeve, njohjen prej Izraelit.

Ju që katër vjet asnjë njohje, asnjë anëtarësim s'ia keni sjellë Kosovës. Po na tregoni, i kemi shpenzuar paratë. Mirë bre, në rregull! A këtë e keni pasur qëllim, a? Të shpenzoni para. T'i mblihdni dhe t'i shpenzoni. Këtë tregoni.

KRYESUESJA: Nga Partia Demokratike e ka kërkuar replikën Ariana Musliu-Shoshi.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, e nderuara kryesuese!

Faleminderit ministre për prezantimin tuaj, sidoqoftë!

U fol për rritjen e kapaciteteve njerëzore në ambasada, po ashtu edhe në ministri. Më lejo të riinformoj dhe të rikonfirmoj që përplot katër vjet nuk ka ndërruar numri i të punësuarve. Pra, është 389. Dhe, ky është plani me të cilin e ke planifikuar që të vazhdosh edhe me këtë buxhet të cilin e ke prezantuar dhe unë e kam përpara.

U tha për rritje të aktiviteteve konsullore që është bërë rritje e buxhetit. Më trego sa është rritja e buxhetit të aktiviteteve konsullore, dhe përveç që ke formuar shtabe zgjedhore që janë në shërbim të Lëvizjes Vetëvendosje, përveç udhëtimeve të cilat i ke në baza javore bashkë me kryeministrin, me paratë e qytetarëve në diasporë, na trego cilat janë aktivitetet e tjera të cilat i ke zhvilluar për katër vjet dhe cilat janë ato të cilat je duke i planifikuar tani.

U tha nuk ka bileta luksi me Qeverinë tuaj. Më lejo të rikonfirmoj që janë 9 udhëtime të largëta që ju bashkë me Lizën, që është zëvendësministre, shkoni të dyja bashkë dhe jeni në eventet e njëjta pa asnjë rezultat. Asnjë rezultat! Asnjë njohje. Asnjë anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Edhe ajo që ishte në Këshill të Evropës, që ke ardhur plot herë pa asnjë mandat si ministre e Punëve të Jashtme në Asamble, ku është kryesisht punë e deputetëve dhe nuk është punë e ministres së Punëve të Jashtme, e në planin tuaj që ju do të duhej të triumfonit, e Kosovën ta anëtarësoni në Këshill të Evropës, nuk arrite as edhe një votë ta kesh nga një ministër që të flasë për Republikën e Kosovës. Pse nuk ka arritur të jetë agjendë të Komitetit të Ministrave në Këshill të Evropës?

Pra, na trego për dështimet, sepse e shoh që heziton të vish në Komisionin për Punë të Jashtme të raportosh për të gjitha planet e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Të na tregosh pse nuk e ke sjellë Ligjin për shërbyes të jashtëm, Ligjin për diasporën, Ligjin për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Plot tetë herë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Kundër-replikë, ministrja Gërvalla!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA DONIKA GËRVALLA-SCHWARC: Ok! Vetëm mos bërtitni, qetësohuni pak, se nuk është mirë për shëndet! Ta pini ndopak ujë edhe të mos bërtitni kaq shumë, se sinqerisht nuk është keq. Mos bërtit, se nuk luajmë nga vendi!

Shikoni! Unë ju kuptoj juve. Ju kuptoj shumë. E dini pse ju kuptoj? Sepse ju njoh shumë mirë. Ju njoh, jo veç këtu në Kuvend, por ju njoh edhe si pjesë e atyre qindra-mijërave shqiptarëve jashtë vendit, që kur jeni çuar dhe keni ardhur nëpër ato ambasada që i keni mbushur me janarë e me shokë e me familjarë, e me motra e vëllezër tuaj, keni ardhur dhe keni qëndruar veç me njerëzit me të cilët i keni bërë bizneset.

Keni paguar kah 500 mijë euro për libra e për gjëra, edhe nuk keni marrë guximin kurrë që të vini e të takoheni me neve që kemi qenë pjesë e komunitetit atje. Prandaj, unë fort mirë e kuptoj që ju çuditëni shumë, qysh mund kryeministri të çohet vullnetarisht të vijë edhe ta takojë mërgatën.

Qysh ky njeri nuk frikësohet të vijë e ta takojë vullnetarisht. Qysh ky njeri vjen e flet me ta. U përgjigjet pyetjeve të tyre. I dëgjon kritikën e tyre, edhe mundohet.

Shikoni! Ju është mirë, para se të flisni, të dëgjoni! Dëgjojeni me kujdes, sepse janë live tubimet që i kemi mbajtur. Nuk ka as në ton, as në përmbajtje asnjë gjë të fushatës. Fushata vjen janar. Edhe po, jo vetëm këtu në Kosovë, por do të shihemi bashkë edhe në diasporë, do të shihemi të fushatë. Ama atëherë do t'i kemi disa fjalë të tjera në fushatë. Ndërsa, tash detyrimi, mbi 250 takime janë zhvilluar në Kosovë edhe jashtë Kosovës me mërgatën.

Unë, e që juve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Milazim Salijaj.

MILAZIM SALIJAJ: Faleminderit, zonja nënkryetare!

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni fjalën deputetit.

MILAZIM SALIJAJ: Faleminderit, zonja nënkryetare!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

KRYESUESJA: Ju lutem, afrojeni mikrofonin! Nuk po dëgjohesh.

MILAZIM SALIJAJ: Do të flas shumë pak, kryesisht për mjedisin dhe ujërat. Ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike pa dyshim që do ta përfshijnë edhe vendin tonë. Duke u nisur nga ky fakt, është miratuar Agjenda për ndryshimet klimatike dhe Ligji për ndryshimet klimatike.

Për herë të parë në historinë e Kosovës jemi pjesë aktive e KOP 28 dhe KOP 28, institucione ndërkombëtare këto nga të cilat mund të kërkohen edhe investime.

Me qëllim të ruajtjes së ambientit, është ulur numri i deponive ilegale nga 2 800 në 800. Është krijuar task-forca e gjelbër me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe ruajtjen nga degradimi. Me ndryshimet ligjore, qeset e plastikës njëpërdorimshme gradualisht do të hiqen nga përdorimi, duke synuar uljen e mbeturinave nga plastika dhe ndotjen e mjedisit.

Sa i përket gjendjes së ujërave dhe mirëmbajtjes së lumenjve janë ndarë mbi 10 milionë euro investime për rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe pastrimin e tyre nga shumë mbeturina të deponuara përgjatë brigjeve të lumenjve dhe shtretërve të lumenjve.

Është aprovuar plani i menaxhimit të pellgut Drini i Bardhë, si dhe janë hartuar dhe nxjerrë në diskutim publik planet e menaxhimit për lumin Morava e Binçës dhe lumin Lepenc.

Është investuar në rrjetet e ujësjellësit dhe kolektorë, si dhe në ndërtimin e impianteve. Janë kryer studime dhe po fillon projektimi për digën e Dragaçinës, Pollatës, Kuçicës, Kamenicës-Desivojcës, si dhe diga e Firajës për të cilën digë Qeveria e Kosovës ka marrë vendim dhe caktuar lokacionin e saktë dhe përfundimtar të ndërtimit dhe shtrirjes së këtij liqeni artificial, i cili do të bëhet me ndërtimin dhe përfundimin e punëve në ndërtimin e kësaj dige.

Kosova ka një konfiguracion të përshtatshëm të terrenit, gati i ngjashëm me konfiguracionin e Zvicrës. Andaj, këtë konfiguracion të terrenit duhet ta shfrytëzojmë me qëllim të ndërtimit të digave të reja dhe mini-liqeneve artificiale për të vetmin qëllim për të siguruar rezervat ujore në rend të parë për pije, e mandej edhe për ujitje dhe nevoja të tjera.

Andaj, ne duhet të vazhdojmë, duke u nisur nga nevoja e strategjia e sigurimit të rezervave ujore në rend të parë për pije, e pastaj edhe për ujitjen e tokave bujqësore e shumë nevoja të tjera, duhet të vazhdojmë të planifikojmë dhe të identifikojmë lokacione të përshtatshme nëpër komuna të ndryshme të Kosovës me qëllim të kryerjes së studimit të fizibilitetit për ndërtimin e digave të reja dhe mini-liqeneve të reja artificiale për të vetmin qëllim që t'u përgjigjemi ndryshimeve klimatike dhe ngrohjes globale, e cila pa dyshim se do ta përfshijë edhe vendin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Në radhë është deputeti Hisen Berisha.

HISEN BERISHA: E nderuar kryesuese,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Nuk dola në foltore të debatoj për buxhetin që e ka planifikuar Qeveria Kurti 2 për vitin 2025. Edhe pse ka shumë hapësirë të debatohet zë për zë buxhetor, ngase rritja nga 3,3% në 3,6% përfshin veç një rritje prej 9%, apo për të qenë krejt i saktë 9,07%, e kjo nuk rrit mirëqenien e qytetarëve dhe as nuk e stimulon zhvillimin e vendit.

Pra, ky buxhet është brenda dogmës qeverisëse të kësaj klase politike, varfëroje qytetarin, pastaj sundoje. Kësaj ia kanë shtuar edhe një dogmë tjetër gjatë qeverisjes, frikësoje dhe izoloje, duke ia mbajtur si lëkurën e ujkut, thirrjet për sulmet nga Serbia, e që është pjesë e propagandës të regjimeve totalitare dhe komuniste.

Prandaj, dua t'ju them se nuk ka nevojë të debatohet për buxhetin e varfërisë të kësaj Qeverie, por ju si mazhorancë kaloheni në Kuvend. Votojeni drejtpërdrejt, sepse i keni votat e atyre që i keni mashtruar me premtime mashtruese, boshe, dhe me akuza të rrejshme të cilave tani po ua bëni reprizën.

Edhe nëse s'i keni, ju i gjeni votat me një thirrje, alo! I keni ata "zemljakat" që jua bëjnë votat.

Përndryshe, ne si opozitë dhe si PDK nuk kemi as çka të debatojmë rreth buxhetit të kaluar dhe as këtij që e keni sjellë si buxhet transit, ngase për pak ditë era e ndryshimit, ashtu siç ndodhi në Uashington, do të vijë edhe në Prishtinë, dhe buxheti do të përlllogaritet sipas programit qeverisës elektoral të Partisë Demokratike, përkatësisht të kandidatit për kryeministër, zotit Hamza.

Tani programi është në publik dhe mund të lexohet se si do të jetë dhe si do të ndodhë kthimi i dinjitetit për çdo kategori të qytetarëve, siç ka ndodhur edhe më përpara. Garant për këtë po jua kujtoj garancitë ose për këtë po jua kujtoj veç me një pyetje: e thoni një qeveri dhe një kryeministër që ka rritur paga përveç Partisë Demokratike, të Qeverisë së pavarësisë, kryeministrit Thaçi dhe ministrit të Financave të asaj bote, zotit Bedri Hamza.

Pra, tani po vjen Qeveria, e cila ka dhënë dhe ka dëshmuar se di, mundet dhe guxon të bëjë shtet, institucione, zhvillim dhe mirëqenie qytetare e të tjera. Kështu që, nuk do të komentojmë, e as nuk do të bëjmë amendamente besoj, sepse kjo është Qeveri që po e realizon atë që e kemi paralajmëruar, domethënë vetëfundosjen politike.

Mjafton ta analizojmë vetëm buxhetin për forca të armatosura për të parë dhe ta analizojmë ku e kemi lënë FSK-në në procesin e implementimit të tranzicionit në fakt në forca të armatosura, e t'i bëjmë një portret se ku është ajo sot. Pra, ku ka mbetur, dhe do të na portretizohet dëmi më i madh që ndonjëherë i është bërë kësaj force dhe zero investime në të gjitha segmentet që e bëjnë atë operacionale. Dhe, një grumbullim të objektivave infrastrukturore të fazës së parë dhe të dytë në fazën e fundit.

Nëse ne e kemi pasur simbolikë të të gjitha arriturave shtetërore krijimin e ushtrisë, kurse ky zotëria këtu prapa e ka marrë këtë forcë në stadin orientues për ta ngritur në stad të planifikuar. Dhe, çfarë ka bërë? E ka kthyer në ushtri me një set Bajraktarësh turq me kamera dhe e ka tërhequr nga IOWA dhe e ktheu në Stamboll, edhe pse edhe ata i kemi aleatë.

Rrinë të hapura konkurset dhe nuk aplikon numri i duhur për cilësi, duke i degraduar kushtet e shërbimit. Pra, në këtë fazë, sipas projektit, forcat e armatosura do të duhej të zhvilloheshin dhe të plotësohen kapacitetet fillestare operacionale, kurse ju këto veç i keni stagnuar. Stadin në të cilin e kemi lënë FSK-në ka qenë me ligj, të miratuar në Kuvend dhe i obligueshëm të zbatohet. Ju ose duhet ta zbatoni ose rrëzoheni me shumicën e votave dhe kthejuni projekteve tuaja revolucionare, të cilat tashmë i keni prezantuar. Shkatërrimi i FSK-së është edhe shkatërrim i Kosovës, prandaj që me ardhjen tuaj në pushtet u munduam t' ju tregojmë se me projektet për shërbim të detyrueshëm ushtarak dhe këtë të tanishmin për vetëqëndrueshmëri po e minoni projektin për një ushtri profesioniste me rrezikun që ta ndalni si proces.

A është bërë mjaftueshëm qoftë në fushën e stërvitjeve, qoftë logjistikës, apo edhe operacioneve? Janë pyetje që për shkak të kodit ushtarak që më karakterizon nuk do të jap drejtpërdrejtë përgjigjet. Pastaj, na tregoni jo sa para i keni ndarë për ushtrinë dhe për forcën, po sa janë realizuar ato në Forcë, nëse kanë qenë rritja prej 2,8% dhe ju keni deklaruar vazhdimisht trefishin që ka qenë mashtrim, na thoni sa janë realizuar ai buxhet që keni ndarë për Forcën. Jua kujtoj se kur kam shërbyer në Forcë minimumi i realizimit të buxhetit ka qenë 80%, po ashtu edhe në vitin zero njëjtë, dhe ua kemi të gatshme infrastrukturën formale që të vazhdoni pa

penguar në implementimin e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit. Por, në kohën tuaj me buxhetin 120 milionë, e 150 milionë, sa janë investimet në projekte kapitale, sa milionë ua keni tërhequr suficit sot kur po flas unë Forcës? Si ka mundësi të tërhiqen 10 milionë buxhet nga investimet kapitale prej një Force, e cila është në proces të zhvillimit të kapaciteteve?

Prandaj, mos na flisni për ato qepë e fasule që na keni bërë horë kësaj radhe dhe që e kanë bërë ministrat tuaj, ku e keni prishur edhe mirë ia keni bërë asaj kontrate faktikisht, por në mënyrë korrekte nuk keni vazhduar me zbatimin e Ligjit të prokurimit për t'ia dhënë tenderin operatorit më të lirë ekonomik të radhës. Po, provoni që projektin e vetëqëndrueshmërisë me atë logjikën staliniste “edhe bar do të hamë e do të qëndrojmë me forcat tona”, mirëpo e dini mirë se ka një analizë të ekspertëve amerikanë, të cilët nuk e sugjerojnë dhe nuk e mbështesin as projektin e vetëqëndrueshmërisë në asnjë sektor të logjistikës dhe as të ushqimit. Prandaj, edhe tendenca për t'i shpallur kontratat sekrete është po ashtu tendencë korruptive, sepse ju e dini se në Forcë ka blerje të klasifikuara që nënkupton përjashtim nga neni 3 i Ligjit të prokurimit.

Dhe, unë po e shoh se në këtë situatë dhe siç deklaruan s'di kujt ia kishin pas shkruar në fjalim, bile kam pritur që e lexon Enveri, po nejtë, po më duket se e keni ngatërruar çështjen e subvencionimit dhe granteve me buxhetin, e subvencionimet dhe grantet i keni pasur mjetet për vjedhje të buxhetit. Këto është mirë të na i sqaroni edhe dështimet në implementimin e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit, pse nuk i kemi deklaruar ende kapacitetet fillestare operacionale? Sepse jemi veç në fund të fazës së dytë dhe po hyjmë në fazën e tretë, kur do të krijohen edhe kapacitetet ajrore, garda nacionale dhe atëherë duhet t'i deklarojmë kapacitetet e plota operacionale. Si ka mundësi që shteti me të cilin kemi fulsom agreement, pra është fjala për Ajovent, të mos realizojë asnjë vizitë këtu dhe asnjë atje. Të vetmen vizitë që e kemi bërë deri tash janë ato në Turqi dhe u kthyem me një set dronësh me kamera, e po i bëni reklamë për t'u demonstruar armiqve tanë se sa dobët jemi kur flasim për sasi.

Të heqësh FSK-në nga Ajova dhe mbështetja amerikane dhe ta sjellësh në Stamboll, pa paragjykuar partneritetin me ta, me dronë Bajraktarë, ky është dëmi më i madh që mund t'ia bëni Republikës së Kosovës në aspektin kushtetues dhe Ligjit të Forcës. Ua kemi tërhequr diku 10 milionë euro dhe kjo është për shkak të pengesave që janë paraqitur në implementimin e projekteve dhe shpërfaq paaftësinë e menaxhimit që tanimë është shndërruar në dukuri.

Si e kemi situatën me burimet njerëzore? Sa kanë kërkuar buxhet ata dhe sa ju keni ofruar ju sot? Cila është diskrepanca mes kërkesës jo vetëm të burimeve njerëzore, por të gjithë segmenteve të tjerë në Forcë. Pra, edhe në logjistikë, edhe në mallra e shërbime, edhe në investime kapitale, edhe në shërbime logjistike e furnizime në fushën e operacioneve e tjera, ju keni ofruar buxhet për mbijetesë, por nuk e mbështet zhvillimin siç është në dinamikën e planit gjithëpërfshirës të tranzicionit. Na thoni se kujt i keni paguar, për shembull, kujdestaritë apo punën jashtë orarit, rrezikshmërinë, sigurimet shëndetësore e tjera. *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESJA: Regjia, ia mundësoni ta përfundojë fjalën.

HISEN BERISHA: Gjatë fjalëve që u thanë këtu, dëgjova gjëra të çuditshme, ndoshta ju jeni tani të preokupuar për të ndërtuar teoritë e mashtrimit për të gjitha ato premtimet që i keni bërë dhe që keni dështuar. Dëgjova se, për shembull, 100 doktorantë që studiojnë kanë përfituar bursa që po studiojnë në 500 universitete, ndoshta kjo lapsus lingua, pastaj përqindjen e zhvillimit ekonomik ishte i gjithi i tëri ishte me shifra dyshifrore, ndërsa Banka Botërore si institucioni më kredibil thotë kemi planifikuar 3,3, ka rënë në 2,8.

U fol për rritje të buxhetit për Forcën dhe u parafrazua plani gjithëpërfshirës i tranzicionit. Ministri që është këtu, është njëri ndër oficerët më të zotë atje, e di mirë se PGJT-ja, plani gjithëpërfshirës i tranzicionit është përfunduar në vitin 2015 dhe viti indeks ka qenë viti 2014. Përmes programit ... amerikan e kemi përcjellë lëvizjen...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: I kemi dy replika nga ministri dhe nga deputeti Enver Dugolli. A t'ia japim mundësinë ministrit të parit, tani kthehemi te ju? Mirë!

MINISTRI EJUP MAQEDONCI: Përshëndetje, e nderuar nënkryetare e Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Po filloj me pjesën që ka qenë më aktuale dhe të cilën e kam sqaruar disa herë gjatë muajve të fundit, veçanërisht gjatë ditëve të fundit, te çështja e vetëqëndrueshmërisë me ushqim.

Shpesh edhe nga shumë aktorë edhe nga deputeti Hiseni u tha tani që aspekti i ushqimit ka qenë problem dhe unë me të vërtetë vlerësoj që fatmirësisht ju jeni duke u ushqyer me lajme të rreme, mirëpo ushtarët po vazhdojnë të ushqehen me ushqim në tri shujtat dhe sot pikërisht 1 mijë ushtarakë që i kemi në Bobaj të Bokës për herë të parë kanë ngrënë biftek të klasit të parë, i cili është servuar pikërisht nga stafi i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe qëndrueshmëria nuk është koncept i Lindjes, është pikërisht koncept i Perëndimit, është koncept i çdo ushtrie moderne, e cila synon që varësinë nga operatorët ekonomikë ta transformojë në një kapacitet vetjak për të ngritur dhe përkrahur operacionalitetin e Forcave të Armatosura.

Kurse sa i përket Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, deputeti Berisha ka qenë i familjarizuar, siç kam qenë edhe unë dhe e dinë saktë që në vitin kur po flasim, por edhe për buxhetin 2025 sipas Planit të Tranzicionit kanë qenë të paraparë 100...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Mirë, kundër-replikë!

HISEN BERISHA: Tash është korrekte të na thuhet se ne nuk e kemi nxjerrë në shesh atë se ushtria është pa ushqim, e pa veshmbathje tash katër vjet e tjera, por kjo ka ardhur me letrën e vetë komandantit të Forcës, të preferuarit të zotit Kurti që po qesh, se unë s'mund t'i them zgërdhiet si ky Hashimit, pra zotit gjeneral Bashkim Jashari, në letrën që e ka bërë ai publike dhe tani dikush këtu nuk po e thotë të vërtetën.

Tjetër çka është me rëndësi, u përmend shifra 105 milionë, e sipas PGJT-së të hartuar në vitin 2015 edhe po flisni pas nëntë vjetësh për një shifër 207 milionë, domethënë të hartuar në vitin 2024. Jeni shumë jokorrekt dhe kjo formulë mashtrimi veç te Forca nuk ecën, se jemi këtu dhe fatmirësisht atje është asistenca e drejtpërdrejtë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Replikë, deputeti Enver Dugolli.

ENVER DUGOLLI: Faleminderit, nënkryetare!

Unë kisha planifikuar që mos ta marr fjalën për shkak se ne i kemi ndarë përgjegjësitë dhe si komision ia kemi besuar Arbërit që të flet për buxhetin, por dua të them që “fjalët e shumta janë fukarallëk”, thotë populli.

Hisen, ti e di fort mirë se ne e kemi marrë buxhetin për Forcën e Sigurisë së Kosovës me 67 milionë, sot buxheti i ri për 2025 është 208 milionë. Pra, nuk kemi nevojë të bëjmë fjalë se janë fukarallëk, pra shifrat flasin vetë. Dhe diçka tjetër, edhe një parafolës nga LDK-ja e tha, u shprehë se është i brengosur me shumën që Qeveria ka ndarë për FSK-në, ndërsa kur ishte ai kryeministër ishte 67 milionë, domethënë me kornizën afatmesme të shpenzimeve ai le që nuk i rriti, po i zvogëloi, domethënë i kish paraparë 7 milionë mangët. Prandaj, fjalët e shumta janë fukarallëk, ju duhet t'i gëzoni këtij investimi të Qeverisë Kurti për ushtrinë. Edhe diçka tjetër, e di Hisen se ndoshta ta marrin inati, PDK-ja e nuk të shtinë në listë, po ti jashtë kamerave gjithë thotë “për besë mirë e keni, por kur të dalë aty, po duhet diçka me thanë”, kjo është.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputeti Berisha. Regjia ia jepni mundësinë për kundër-replikë!

HISEN BERISHA: Buxheti është plan, është ligj dhe ndërtohet mbi kërkesat e agjencive që furnizohen me buxhet të shtetit. Pra, implementimi i projektit për Forcat e Armatosura ka filluar në vitin 2019 që ju e keni trashëguar një buxhet 60 milionësh, ai ka qenë një planifikim brenda kërkesave të institucionit të ushtrisë dhe të ministrisë.

Pra, ka qenë real, nuk ka mundur të jetë më i madh, sepse nuk ka pas implementim të këtij projekti. Kështu që nga viti 2019, çdo gjë e keni të planifikuar, kur të shtoni shkallën e inflacionit, rritjen e çmimeve, zhvillimet në aspektin e sigurisë, teknologjisë, dhe buxhetit që duhet ta kemi, atëherë jeni një buxhet shumë të vogël, veç sa për mbijetesë.

KRYESUESJA: Ministri Maqedonci e ka fjalën.

MINISTRI EJUP MAQEDONCI: Po e shtjelloj pak më detajisht çështjen e buxhetit, ashtu siç ka qenë i planifikuar përmes Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, për të cilin është votuar edhe në Kuvendin e Kosovës në atë kohë, si është ndarë nga qeveritë deri më tani prej vitit 2018 dhe ku jemi aktualisht.

Në vitin 2018 sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit ka qenë e paraparë që të jenë 54.4 milionë euro buxhet i FSK-së. Plus për çdo vit ka qenë e planifikuar që të rritet 5 milionë, në mënyrë që të zbus aspektin e inflacionit apo rrezikut të shtrenjtimit të çmimeve në tregun ndërkombëtar të sistemeve të armatimit. Pra, në vitin 2018, 54,4 ka qenë sipas PGJT-së, nga Qeveria atëherë janë ndarë 53,6 milionë. Nuk është konsideruar fare 5 milionëshi shtesë. Në vitin 2019, 60,9 milionë kanë qenë të parapara sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit, 58,6 janë ndarë nga Qeveria në atë kohë, duke mos llogaritur këtu edhe 5 milionë që është dashur të ndahet më pastaj. Në vitin 2020, 68,5 milionë kanë qenë të planifikuara sipas PGJT-së, 69,2 janë ndarë. Në buxhetin e trashëguar nga kryeministri Hoti në vitin 2021, 81 milionë kanë qenë të planifikuara sipas PGJT-së, vetëm 67,3 janë ndarë nga Qeveria në atë kohë dhe Qeveria Kurti i ka shtuar 28 milionë për ta rritur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Regjia, ju lutem, e ndani kohën për dhjetë minuta, ishte fjalim ose prezantim i buxhetit nga ministri.

MINISTRI EJUP MAQEDONCI: Në vitin 2022, 83,4 kanë qenë sipas PGJT-së, 102 janë ndarë nga Qeveria, plus 50 milionë janë ndarë si buxhet shtesë në fund të vitit. Në vitin 2023, 87 milionë kanë qenë të parapara sipas PGJT-së, 123 milionë janë ndarë nga Qeveria, kurse janë dhënë buxhet shtesë edhe 80 milionë të tjera që kanë ngritur buxhetin e përgjithshëm mbi 2%, apo 204 milionë. Të gjitha këto janë realizuar, është realizuar 100% buxheti i planifikuar dhe është realizuar 80% buxheti shtesë.

Në vitin 2024 kanë qenë të parapara 153 milionë, tani jemi afër 200 milionë dhe do të realizohen të gjitha me kohë, kurse në vitin 2025 janë planifikuar 208 milionë që nënkupton është përgjysmë më shumë se që do të duhej të kishte buxheti i vitit 2028. Pra, pas katër vjetëve do të duhej të ishte gjysma e buxhetit aktual, i cili është dhënë nga qeveria jonë. Dhe, kjo e gjitha ka

mundësuar që nga viti 2021 deri më tash të bëjmë investime kapitale, kryesisht në blerje të sistemeve të armatimit dhe infrastrukturë në vlerë prej 268 milionë euro, apo 6 mijë për qind më shumë se në periudhën 2019-2021. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Hisen Berisha ka kërkuar replikë në kuadër të diskutimit të ministrit. E keni fjalën!

HISEN BERISHA: Kështu, është e vërtetë, po dua të besoj në shifrat, se nuk arrita ta gjej shpejt planin, se ato janë shifrat e planifikuara për zhvillimin e Forcës sipas viteve në një plan dhjetëvjeçar. Dhe është e vërtetë se rritja ka qenë çdo vit 5% dhe qëllimi ka qenë të mos ngarkohet buxhetin e shtetit në asnjërin nga vitet. Dhe është më se e vërtetë se ky planifikim dhe ky parashikim i mundësive të inflacionit, ndryshimeve, të rreziqeve, teknologjisë e tjera është bërë në vitin 2015 me vit indeks 14-ën, dhe me program *FOKIS* është përcjellë në vazhdimësi kjo deri kur keni ardhur në qeveri ju.

Mirëpo, është një e vërtetë e madhe që po krahasoni një ndryshim drastik të rrethanave që lyp një buxhet tepër më të madh se sa e keni planifikuar ju, me një buxhet të planifikuar si parashikim në vitin 2015. Prandaj, nuk është për mburrje nëse i referoheni buxhetit sipas planit dhe buxhetit që duhet ta keni ju sot këtu. Unë mendoj se pasqyrimin më të mirë të gjendjes çfarë e kemi sot në Forcë, ministër, në daç shoku im kolonel, e po e dëshmon vdekja e Limon Musliut, ra prej skelës dje dhe vdiq, a e di pse?

Duke punuar jashtë orarit të sigurojë pak më shumë para ta mbajë familjen, për shkak të kushteve të rënda dhe pagave të ulëta që janë sot në Forcë, e që janë mjeruese, ti e di mirë që deri në 2019 ne kemi pasur pagat më dinjitoze krahasuar me Serbinë, Malin e Zi, Shqipërinë e vendet përreth. Sot jemi më të varfrit sa i përket pagave dhe gjendjes, pa dashur të hyj në çështjet e blerjeve dhe asaj sloganit të madh që e keni bërë se po blejmë armatime. Nëse flasim për sasi, duhet të na vijë turp dhe po e jepni një mesazh jo të mirë edhe atyre që s'na shohin me sy të mirë, edhe pse unë po rezervohem për shkak të kodit t'i them detajet, unë mendoj se këtë duhet ta keni në konsideratë për ta konsoliduar buxhetin i cili e mbështet avancimin e Forcës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Tani në radhë e ka fjalën deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Kryeministër,

Është tepër e rëndësishme të theksohet se ky është viti i katërt i ligjit vjetor për ndarjet buxhetore, por ajo çka kemi parë në këtë qeveri ose në këtë mandat qeveritar, të themi, me ide të varfra, por edhe me mendësi të varfër e sigurisht që sot po na dalin edhe me rezultate të varfra.

Qeveria që është proklamuar si e majtë na ka rezultuar jo me ide të majta, por e qasshme për oligarkët dhe e qasshme ose në mbamendje për tenderët e shumë sekretë ose njëburimor. Shifrat variojnë në miliona e keqpërdorimet, abuzimet dyshohen që janë tepër të mëdha. Një qeveri që mbi 12 miliardë i ka pasur në shfrytëzim, ndërsa po shkojnë me mbamendje me projektin më të madh kapital urën e Saradranit, atëherë cili do të jetë premtimi që ky projekt buxhet do të jetë i realizueshëm në vitet e ardhshme. Në vazhdimësi është thënë që po keni keq planifikim, në vazhdimësi e keni mbrojtur që ka shpërndarje të mira të hyrave buxhetore, ne e kemi thënë që po shpërndani lëmshë për qytetarët, sigurisht në aspektin politik dyshohet për blerje të votës, e në vend të zhvillimit dhe punësimit të qëndrueshëm na ka ndodhur migrimi i shpeshtë ose jeni shndërruar në sponsorizuesit kryesorë për ikjen e qytetarëve nga vendi.

Kur propozon buxhet të dobët, sigurisht po shihet që edhe realizimi është i dobët. Kryeministri ka munguar gjatë, por nuk ka dhënë përgjigje për keqpërdorimet në KEK. E ka mbrojtur Nagip Krasniqin, pastaj është arrestuar Nagip Krasniqi. I ka mbrojtur rezervat shtetërore, është arrestuar edhe Ridvani, i ka mbrojtur ambalazhuesit e ujit, është arrestuar edhe Naser Hafizi. Domethënë, këta janë keqpërdoruesit më të mëdhenj të buxhetit, të cilët kanë pasur mbikëqyrës ministrat e linjës dhe sigurisht të sponsorizuara ose më mirë të them të fotografuar shpesh edhe me kryeministrin, në fat apo në fatkeqësi. Martini sigurisht edhe ai pjesë e proceseve hetimore, por pa dhënë verdiktin në fjalën e vetë drejtësia, as ne nuk po e zgjasim më shumë. Andaj, ky është buxheti, shifrat janë në dispozicion, rezultatet mungojnë. Kur shifrat tentohen të manipulohen dhe kamuflohen në rezultate, të cilat nuk kanë lënë gjurmë te qytetarët e vendit, edhe shpresa që ky buxhet të jetë në shërbim të qytetarit është tepër i mangët.

E mira është që nëntë shkurti po afrohet dhe ky buxhet do të rishikohet, sigurisht edhe implementimi dhe rezultatet do të rriten dhe skandalet do të zvogëlohen. Faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është Besnik Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Qytetarë të Kosovës!

Në sesionin e paradites fola në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës të ngre çështje që kanë qenë për ne çështjet më të rëndësishme politike, po më vjen mirë që kryeministri është këtu, e paska marrë malli se prej 24 majit, siç e dini, s'ka qenë Parlament,

dhe më 24 maj kur na ka dështuar debati për tre vjet Qeveri, atëherë ka qenë herën e fundit për tema, të tjerat kanë qenë seanca solemne.

Edhe është mirë t'i dëgjojmë, po njëkohësisht edhe t'i trajtojmë do tema para se të miratohet buxheti dhe mundësisht, e di që disa amendamente nuk merren parasysh, po disa që janë të rëndësishme, të kihet kujdes.

Po nis me temat të cilat unë tash i kam edhe me interes profesional, po që në esencë janë probleme politike që kisha dashur t'i ngre. Ku është sot pushtet lokal në Kosovë? Pyetja e parë që duhet t'i drejtohet Kryeministrit. Për mua është shumë me interes funksionimi i komunës, për shkak se komunat janë ato që e bëjnë jetën.

Në qoftë se e shohim buxhetin, shohim që në vitin 2025, buxheti i nivelit qendror është parashikuar të arrijë në 2 757 707 331 euro, që i bie 77 për qind të buxhetit total. Vetëm 22,3 për qind e buxhetit që duhet të shkojë në investime në komuna, aty ku bëhet jeta, shkon në komuna.

Po vazhdoj tutje me komuna dhe po e sjell para vëmendjes së kolegëve të deputetëve të Qeverisë, kërkesën e Asociacionit të Komunave të Kosovës për ta trajtuar një çështje që është duke u bërë kanceri i krejt komunave të Kosovës, çështja e kontratave kolektive për vitin 2025. Në letrën që Asociacioni i ka dërguar Qeverisë së Kosovës, respektivisht kryeministrit të Kosovës, kërkon që në buxhetin e vitit 2025 të trajtohen 122 milionë euro, për shkak se këto para do të bien në barrën e komunave të Kosovës, në barrën dhe në dëmin e komunave të Kosovës, për shkak se paratë që do të duhej të investoheshin në investime kapitale gjithandej komunave, do të merren nga investimet kapitale dhe në të njëjtën kohë do të jepen për të zbatuar kontratën kolektive për vitin 2025.

E kam një pyetje konkrete rreth çështjes së kontratës kolektive. A do të bëni ndonjë hap? Ministri Murati qenka këtu, të dalë pak më serioz të flasë, jo politikisht, çka do të bëni, si do ta trajtoni kërkesën e të gjitha komunave të Kosovës, duke përfshirë edhe komunat që janë të Vetëvendosjes me çështjen e kontratës kolektive për vitin 2025? Pra, 122 milionë euro më pak do të ketë investime në komunat e Kosovës, në qoftë se nuk e bën një zgjidhje Qeveria e Kosovës.

Tani, pak po shkoj veç e veç. Kryeministri i Kosovës më 9 tetor të vitit 2024, e ka marrë një letër prej kryetarit të Rahovecit, i cili është një kryetar shumë punëtor dhe shumë i vyeshëm, i cili ka një kërkesë për Qeverinë që Rahoveci të bëhet zonë e veçantë bujqësore, duke e ditur që krejt angazhimi i këtij qyteti, i fermerëve atje është në këtë temë.

Paramendojeni, prej asaj dite, nuk ka marrë asnjë përgjigje prej Kryeministrit. Paraprakisht, Qeverisë i është drejtuar po ashtu edhe më 19 maj të vitit 2023, në raport me të njëjtën kërkesë. Kurrë s'ka marrë përgjigje.

Tash, çështja është te dy komisionet, edhe deputetja Pacolli që është këtu kryetare e Komisionit për Mjedis dhe Adnani nuk qenka këtu, që është Komisioni për Legjislacion, për ta trajtuar këtë temë, për shkak se nuk ka pasur përgjigje. Në qoftë se, secila Qeveri së paku nëse do ta ketë një qëndrim, duhet ta bëjë publike. Z. Latifi është një njeri që merr vesh, në qoftë se nuk doni ta bëni, edhe nuk doni të veproni në këtë kërkesë, atëherë do ta nisim ne prej Kuvendit.

Një çështje tjetër për ministren e Tregtisë, a bën të na tregoj ministrja e Tregtisë çka ka ndodhur më konkretisht pak me zonat ekonomike të Kosovës? a bën ta di pse zona ekonomike e Podujevës, pse nuk po ndodh? A bën të na tregoni, për katër vite ka qenë premtim elektoral i kësaj Qeverie që në portën kryesore ekonomike tokësore të Kosovës, që është Merdar në Podujevë, të bëhet një zonë ekonomike e cila është premtuar edhe në aspektin elektoral, po ka qenë edhe premtim i kryetarit të Podujevës, z. Bulliqi. Çka keni bërë? Katër vjet, dymbëdhjetë miliardë euro? Vjet për vjet, duke u munduar ta adresojmë këtë çështje. liburni nuk qenka këtu.

Paramendo, Grupi Parlamentar i Aleancës e ka kërkuar sa i përket Podujevës një amendament që tri vjet, që dy vjet e kërkojmë, në fshatin Buricë në Podujevë është një vend, një rrugë 1,2 km ku ka qenë baza kryesore e UÇK-së, e kemi lypur ta bëjmë, a ka mundësi 1,2 km asfalt ta shtroni. Aq s'kanë bërë. Ne d.m.th. një kërkesë ka qenë e nënshkruar prej meje si shef i Grupit Parlamentar, që tri herë nuk janë në gjendje 1,2 km t'i vendosë Ministria e Infrastrukturës. Mos të flas për rrugën e cila për hir të vërtetës është përmirësuar në një kohë, mirëpo nuk pritet të përfundojë as këtë vit, e nuk besoj as vitin e ardhshëm duke e parë buxhetin.

Po ndalem pak te Gjakova. Si Kryeministër e di ministri yt, ju si Qeveri, qysh mund t'ia mësyni Gjakovës në takime e vizita që herën e fundit do ta promovojë një gjykatë, e ia ke lënë pesë milionë euro, e rruga e urat nuk janë askund të financuara. Çka do t'ju thuash këtyre qytetarëve të Gjakovës e të asaj ane? Të mos flasim për rrugën që shkon për Pejë, e cila kur po e marrim atë rrugë, nesër e kemi një tubim në Klinë si parti, më duhet të shkojë, është torturë ta marrësh atë rrugë.

E fundit, jo për nga rëndësia, po që e mendoj është shumë e rëndësishme, lidhet drejtpërdrejt me portfolion e ministres së Punëve të Jashtme.

Të nderuar deputetë,

Nuk jam duke folur as politikisht, as me emocion, po këta e dinë më mirë se ne, edhe se ju, Kosova nuk i ka punët mirë në raport me lobimin, me prezantimin e tregimit të Kosovës. E drejta e Kosovës, tregimi për Kosovën është e drejta jonë. Besomëni, kudo që shkojmë, dele e zezë

jemi. Qeveria që e përfaqëson, populli në Kosovë, jemi në sanksione. Çka keni bërë? Çfarë lobimi keni bërë pas Banjskës? Sulmi më terrorist i evidentuar në raporte, që besoj i keni parë ju, se në qoftë se na kanë rënë neve në dorë t'i lexojmë raportet e bashkësisë ndërkombëtare, shihet qartë lidhja e Serbisë me Banjskën. Çka keni bërë? A keni bërë ndonjë veprim? A keni pasur ndonjë aktivitet? A keni pasur ndonjë ngjarje ku i kishe vendosur terroristët, takim Banjska, të bëhet një në Bruksel, një në Londër, një në Uashington, një në Nju Jork. A nuk keni mundur ta bëni këtë, a duhet t'ju mësojmë? Pse nuk keni shkuar t'i vizitoni qendrat kryesore, t'i tregoni fotografitë, të qitet çka ka ndodhur? A e kuptoni që falë dështimit të kësaj diplomacie, ne jemi pikë e zezë.

Unë e di që muajt e fundit e shihni këtë farë çështje si pak para zgjedhjeve. Nuk e kam pak para zgjedhjeve. Ju them me përgjegjësi të plotë. Unë kam qenë bashkërisht me kryetarin Haradinaj në Pentagon, State Departament, Kongres, Senat, ka problem. Nuk është tregimi i Kosovës i cenuar. Që është e nevojshme, unë jua jap, nuk e kam problem, se këtu një ministër kurrë njëherë as kolegët e mi një fjalë miradije nuk e flasin për çka është bërë, del ministri Murati thotë që njëzet vjet s'kanë bërë asgjë. Unë s'e kam problem ta them se jam ndier krenar, jam ndier shumë mirë kur kam hyrë në Konsullatën e Republikës së Kosovës, që e kanë blerë në Strasburg. Aferim, hallall ju qoftë!

Nuk e kam problem unë ta pranoj, po ku ta pranoj ty që s'ke qenë në gjendje prej 24 shtatorit mos ta bësh një konferencë të thuhet ky është sulmi i Banjskës, ky e ka bërë, ky është rreziku, e Serbia nuk është në sanksione, e ne jemi në sanksione. Këtë s'keni mundur ta bëni. E nuk po flas për lobimin në Amerikë. D.t.th. totalisht jemi joprezent, e tash e kemi një administratë të re, për të cilën duhet punuar shumë ta ndërtojmë një marrëdhënie. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Do të vazhdojmë me deputetët sipas radhës. Tani në radhë është Arijeta Rexhepi.

ARIJETA REXHEPI: I nderuar kryeministër!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Mandati i Qeverisë Kurti është mandat i transformimit për sportin në Republikën e Kosovës. Janë realizuar shumë investime në ndërtimin dhe modernizimin e infrastrukturës sportive gjithandej Republikës, është trefishuar buxheti për mbështetjen direkte të federatave, klubeve e sportistëve. Janë programe të veçanta për shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve. Është bërë reformë më e thellë ligjore dhe institucionale dhe tanimë në fund vendin po e bëjmë me një strategji zhvillimore për sportin.

Gjatë këtij mandati, Kosovës ia siguroam të drejtën e organizimit të Lojërave Mesdhetare Prishtina 2030, ngjarja më e madhe multisportive ndërkombëtare në historinë e vendit, e cila jo

vetëm që do të ndikojë në ngritjen dhe zhvillimin e infrastrukturës sportive, po do të ketë rëndësi të veçantë në ngritjen e ekonomisë dhe turizmit, si dhe përmirësimin e imazhit ndërkombëtar për Kosovën.

Pra dy vitesh ka nisur zbatimin e planit pesëvjeçar për konsolidimin e infrastrukturës së futbollit. Deri tani, kemi investuar në stadiumet e Prishtinës, Mitrovicës, Gjakovës, Shtimes, Malishevës, Lipjanit, Hogoshtit dhe në fushat ndihmëse në shumë lokacione. Aktualisht, në procedurë të prokurimit janë katër stadione, dy të reja dhe dy renovime të tërësishme.

Në buxhetin e ri kemi ndarë nga nëntëmbëdhjetë milionë euro për stadiumin e Pejës dhe Ferizajt, trembëdhjetë milionë euro për stadiumin e Prizrenit dhe pesë milionë euro për stadiumin e Vushtrrisë.

Për vazhdimin e punimeve në stadiumin e Drenasit kemi ndarë 4.5 milionë euro, ndërsa stadiumet e reja të Suharekës dhe Rahovecit janë në fazë të projektimit.

Për ndërtimin e stadiumit nacional të Kosovës, aktualisht jemi duke negociuar kredi ndërkombëtare dhe synojmë nisjen e punimeve gjatë vitit 2025. Buxheti i ri nuk lë anash as sportet e tjera. Disa nga projektet tona kapitale të mëdha janë zgjerimi i Qendrës Nacionale të Xhudos në Pejë me gjashtë milionë euro. Stadiumi i atletikës në Kamenicë me 3,5 milionë euro. Pishina gjysmoolimpike në Podujevë me katër milionë euro. Palestra multifunksionale në Prishtinë me 3,5 milionë euro. Pastaj palestra e gjimnastikës në Fushë Kosovë, palestra e xhudos në qendrat rajonale, terrenet e mbyllura të tenisit në Prizren, pishinat gjysmoolimpike në Deçan dhe shumë të tjera.

Vitin e ardhshëm nis edhe hartimi i projektit për qendrën akuatike të Kosovës në një kompleks të pishinave olimpike. Jemi duke negociuar për kredi ndërkombëtare edhe për dy investime me rëndësi të veçantë për Lojërat Mesdhetare, divitalizimi i Pallatit të Rinisë në Prishtinë dhe Qendra e Studentëve në Prishtinë që shndërrohet në Fshatin Mesdhetar 2030.

Me buxhetin e ri janë krijuar të gjitha parakushtet që gjatë mandatit të ardhshëm, Kosova të shndërrohet në lider rajonal për infrastrukturë sportive. Me këtë orientim zhvillimor edhe do t'i shërbejmë më mirë rinisë sonë dhe talentin sportiv, edhe do të përmbushim detyrat tona në raport me organizimin e Lojërave Mesdhetare.

Në buxhetin e ri, përveç prioritizimit të investimeve në infrastrukturën sportive, do të ketë mbështetje të rritur edhe për federatat, klubet dhe sportistët e Kosovës. Derisa po vazhdojmë konsolidimin e Agjencisë Antidoping, vitin e ardhshëm do të themelohet edhe Agjencia e Sportit si mekanizëm ekzekutiv që parashihet me Ligjin e ri për sportin. Gjithashtu, do të vazhdohet

mbështetja serioze për programet e veçanta si: supersportistët, Kosova - shtet i xhudos dhe sporti në shkolla.

Të nderuar deputetë,

Përveç investimeve në infrastrukturë që kemi bërë këtë mandat, do të vazhdojmë edhe në mandatin e ardhshëm. Mbështetje e rëndësishme i është dhënë dhe do t'i jepet edhe subvencionimit të sportit, sepse ne mendojmë se sporti nuk është vetëm infrastrukturë, nuk është vetëm stadium ose sallë, por sporti mbi të gjitha është përmbajtje, është aktivitet, është organizim, është komunitet, është edukim, është zhvillim.

Prandaj, përmes mbështetjes së sportit, synojmë vetëm të krijojmë infrastrukturë të qëndrueshme, por edhe të nxisim të rinjtë dhe të rejat në vlerë, disiplinë dhe energji pozitive, e cila përveç si përfaqësim dhe promovim i shteteve e klubeve tona, si në organizim rajonal dhe ndërkombëtar, kontribuon që të kemi shoqëri aktive të shëndetshme, të qëndrueshme dhe prosperuese.

Të nderuar deputetë,

Buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vitin 2025 është 86.4 milionë euro. Prej tyre, vetëm për investimet kapitale në sport janë 22 milionë euro. Ndërsa, për subvencionimet që shkojnë në mbështetje direkt për sportistë, federatë dhe klubet sportiv janë rreth gjashtë milionë euro.

Buxheti për sportin për vitin 2025, ashtu siç ishte në secilin buxhet të hartuar nga ne deri më tash, ka qenë gjithëpërfshirës për të gjitha komunat, pa dallim partia a politike. Prandaj, si të tillë ju ftoj bashkërisht ta votojmë. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Tani në radhë është deputeti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesuese e Kuvendit!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar media,

Kabinet qeveritar,

Sot po diskutojmë për Ligjin e buxhetit për vitin 2025, i cili konsiderohet edhe nga qytetarët po edhe nga ne dhe është ndër ligjet më të veçanta, që secili qytetar, secila shoqëri, secila kategori e shoqërisë pret që me këtë ligj t'i ndryshojë jeta për mirë dhe t'i lehtësohet jeta në aktivitete që i kanë në institucionet gjegjëse apo edhe në familje.

Duke folur deputetja paraprake, u fokusua kryesisht për buxhetin që është në rini, kulturë dhe sport. Në të njëjtën kohë, e shikova edhe një herë buxhetin, e kam lexuar buxhetin paraprakisht,

nga institucionet që pritet ulje më të madhe të kenë në kuadër të buxhetit, është Ministria e Ekonomisë, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Në të njëjtën kohë, u thanë disa projekte që fatkeqësisht janë projekte të gjitha të keqmenaxhuara dhe Auditorit të gjitha stadiumet që u përmendën i ka qitur që nuk janë menaxhuar mirë, ka vonesa në ekzekutim të tyre, nuk janë kryer punë dhe kryesisht janë projekte që nuk lidhen me këtë Qeveri, kanë filluar më herët, edhe kjo Qeveri është munduar të negociojë me kompani, t'i shkëpusë kontratat, me një pjesë ndoshta është edhe në procedura gjyqësore për pronën, por megjithatë jemi ku jemi, stadiumet nuk ekzistojnë edhe pas katër vitesh që po flasim tani këtu në fund të mandatit të Qeverisë.

U tha këtu që është një buxhet 3.5 miliardë ose nëntë për qind më i lartë se i vitit të kaluar. Është normal që të hyrat janë kryesisht prej tatimeve dhe prej Doganës, dhe është rritur baza e çmimeve. Në të njëjtën kohë kemi pasur raste që ndoshta është bërë edhe presion prej inspektorëve të caktuar që t'i rëndojnë njëjtë bizneset që të mbledhin sa më shumë buxhet. Megjithatë, është politikë e Qeverisë.

Kryeministri tha i kemi prioritet arsimin, shëndetësi, por edhe infrastrukturën e mbrojtjen. Nuk u fol shumë këtu, qenka edhe ministrja e Drejtësisë, është mirë të shihet, është në prioritet drejtësia, a është në prioritet kemi institucione të profesioneve të tjera që kanë problem edhe me buxhetin, kanë problem edhe me zyrat, kanë probleme të ndryshme që mendoj që duhet të fokusohet Ministria, në këtë rast ministrja përkatëse për t'i përkrahur. Nuk po flas për Prokurorinë e gjykata që nuk pashë ndonjë rritje të buxhetit për rritjen e numrit të gjyqtarëve e të prokurorëve, për rritjen e pagave të tyre dhe nuk pashë ndonjë buxhet të bashkëpunëtorët profesionalë të cilët e kryejnë një punë mund të them më shumë a gati sa një gjyqtar e prokuror.

Po mundohem të ndalem te këto prioritetet që i tha Kryeministri. Si prioritet që ishte ndër prioritetet e para, arsimi e shëndetësia, ishin këto të dyja. Po ndalem, është ministri i Shëndetësisë këtu. Ministër, si mund të jetë prioritet shëndetësia, ku ende vazhdon të kemi lista të pritjes edhe te koronarografia, edhe te CT-ja edhe te rezonanca, kemi probleme me barna esenciale, me furnizim me barna esenciale. Pacientët tanë bredhin rrugëve të shteteve fqinje apo edhe Turqi e më larg, kur kanë një sëmundje të nivelit që ndoshta nuk mund t'u përgjigjen këto, nuk kemi një modernizim të institucioneve.

Unë nuk dua të ndalem në komunat e tjera, kam komunikim me qytetarët e krejt komunave, por po ndalem në Gjakovë. Është një kërkesë e moçme për juve, për të ndërtuar objektin e dializës. E dini që ka shumë pacientë me dializë në komunën e Gjakovës. Vetëm këtë kohë kanë kërkuar dikur rreth 137 pacientë shërbim, që vijnë edhe prej pjesës veriore të Shqipërisë dhe nuk ka pasur dhe nuk e pashë edhe tani që është paraparë të ndërtohet objekti i tyre. Është njëra prej regjioneve Gjakova që e thashë që i shërben me shëndetësi edhe Shqipërisë në atë pjesën veriore.

Është i vetmi regjion që ende nuk ka rezonancë. D.m.th. nuk e di pse nuk ka mundur ende të ketë një rezonancë aty.

Sa i përket, për këtë është mirë të na shpjegojë, që me këtë buxhet a parashihet të kemi një rezonancë në Gjakovë apo nuk mund të ketë.

Sa i përket mbrojtjes, qenka ministri i mbrojtjes këtu. Ne e kemi diskutuar, thatë jeni shërbyer me lajme të rrejshme. Ne ato lajme i kemi marrë, e kemi parë një letër të gjeneralit që e udhëheq ushtrinë, i kemi parë diskutimet që janë bërë në bazë të përgjimeve ndërmjet sekretarit, ministrit, zv.ministrit. Janë dy kompani, kush ta marrë tenderin për furnizim. Unë nuk përfaqësoj askënd këtu, janë organet kompetente që duhet të merren me këtë, por ka qenë evidente mungesa e furnizimit me ushqim dhe është mirë të na shpjegoni pse ka qenë ky problem. Ju e thatë në vija të trasha, por problemi ekziston, se s'mund t'i kem tre zëra, një zë gjenerali, një zë zv.ministri, një zë ju besa dhe një zë sekretari. Nuk po flas, se kemi problem ndoshta për shkaqe të burokracisë apo të Organit Shqyrtues të Prokurimit me furnizim me uniforma, me furnizim me çizme ka pasur vonesa aty.

Ne kemi komunikim me ushtarë, sikur ju keni komunikim ju, po ju e keni edhe në atë vijën zyrtare, sepse jeni ministër i dikasterit përkatës. Është mirë ta shikojmë a është me të vërtetë prioritet ushtria. Ne mund të flasim këtu tërë ditën, por rezultatet po na mungojnë.

Te arsimi, u tha prioritet. Unë nuk po flas për numrin e çerdheve, e tha ministrja në vija të trasha se nuk kemi mundur për shkak të shpronësimeve, bashkëpunimit me komuna. Unë mendoj që nëse ekziston vullneti, çerdhet kanë mundur të jenë funksionale. Nuk kam parë ndonjë reformë në arsim, nuk kam parë ndonjë modernizim, nuk kam parë një shkollë që ka një tabelë digjitale. Ne po flasim për vitin 2025, ende nxënëset tona punojnë me tabela siç jemi mësuar ne me shkumës dhe me të njëjtën formë.

Nuk po flasim për paga, janë të mjerueshme, nuk janë paga të mjaftueshme me këtë rritje të çmimit për mësimdhënësit. Kanë problem komunat me kontratë kolektive. Nuk e kemi parë Qeverinë që e ka një qëndrim të qartë çka do të ndodhë me zbatimin e kontratës kolektive. A do të zbatohet kontrata kolektive apo nuk zbatohet? Ata, secili mësimdhënës që i drejtohet organeve kompetente është e saktë që i nxjerr mjetet e veta nga buxheti i Republikës së Kosovës, sepse janë mjete të tyre.

U tha edhe infrastruktura është prioritet. Nuk e di, kur shkoni nëpër qytete, a i shikoni në çfarë gjendje është infrastruktura. Po flas për rrugët. Për Gjilanin, u bë si serial që katër vjet nuk arritën ta lëshojnë një autostradë ta fusin në funksion. Podujeva gjithashtu ende nuk hyri në funksion, Mitrovica gjithashtu, Peja gjithashtu. Po flas, për Gjakovë e thanë edhe kolegët paraprakë, është në gjendje të mjerueshme rruga. Është edhe e rrezikshme për qytetarët tanë në

kohën në të cilën po hyjmë tani, jemi afër dimrit dhe p.sh. te ura e Meqës atje as nuk ka sinjale të mjaftueshme të komunikacionit. Mendoj që duhet të merren veprime konkrete. Ka pasur insistime nga deputetët, kanë bërë edhe deklarime para një a dy vite, po gjendja fatkeqësisht në terren nuk ka ndryshuar.

Po e shoh që po shkojnë minutat dhe ky buxhet është kalimtar. Ndoshta do të ishte e udhës që të gjitha subjektet politike të diskutojnë për një buxhet dy-tre-mujorësh se të gjitha rrugët të çojnë te një Qeveri e re e Kosovës, se kjo Qeveri po e shihet se e ka çuar bajrakun, me dëshirë a pa dëshirë, po të gjithë sektorët kanë dështuar.

Kjo ministrja e Jashtme dhe Diasporës, foli e tha e njoh shumë mirë. E unë mendoj që ty më së miri të kishte pas njohur Isa Mustafa. Për Zotin më së miri prej krejt njerëzve në Kosovë të ka njohur Isa Mustafa. Ti përveç që nuk ke ditur të qeverisësh, ke keqpërdorur me buxhetin. Nuk ke arritur asnjë sukses në diplomaci. E ke degraduar diplomacinë.

Nuk kemi asnjë anëtarësim në ndonjë organizatë kredibile ndërkombëtare. Nuk kemi asnjë njohje. Nuk kemi forcim të asnjë ure me shtete të tjera. Të gjitha shtetet po bisedojnë e po krijojnë kontakte edhe po llojnë me Qeverinë e re amerikane atje, ju as në telefon s'keni arritur as ju as shefi juaj të bëni deri tani.

Nuk po flas për keqpërdorim. Nuk po flas për atë që i keni paguar edhe librat e këtij super këshilltari tuaj, Ganiut. Ia keni paguar librat në Shtutgard. Keni paguar mobilie pa qenë udhëzimi në fuqi hiç, një vit prapa retroaktiv.

Kemi shumë shkelje të cilat i keni...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Zoti Beqa, të lutem përfundoje fjalën!

HAJDAR BEQA: Kjo ministrja i ka ditët e fundit, duke e udhëhequr një dikaster që ka dështuar fatkeqësisht. Fatkeqësia e kësaj Qeverie është që s'ka bërë kurrëgjë për qytetarët, e është keq për vendin edhe për Kosovën.

Ndërkaq, fatmirësia është që kjo Qeveri po shkon, por po shkon kryeulur e jo me arrogancën qysh ka hyrë në fillim. Ndërkaq, ministrja për këto keqpërdorime se po thotë janë shumë, atëherë do të flasë te prokurori, po shpesh po ndodh po thotë jam jashtë, nuk jam në Kosovë dhe po ikë prokurorit, por mund t'i ikë një herë, dy herë, tri herë. Por, duhet të barazohesh me shtetin. Faleminderit! Qytetarë të nderuar, shihemi në buxhetin e ardhshëm me Qeverinë e re.

KRYESUESJA: Para se t'jua jap fjalën deputetëve në radhë, vetëm dua që t'i uroj mirëseardhje Mimosës. Qoftë e kaluar! Uroj që ka kaluar gjithçka me kaq.

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.)

KRYETARI: Mirë se erdhe, kryetare! Shëndet!

Tash kemi mbetur të Vetëvendosja. Deputeti Burim Meta e ka fjalën. Aha, LDK-a? Kush ka folur? Nëse ka folur PDK-ja pak më përpara. PDK-ja foli a? Atëherë, Lidhja Demokratike. Kush e merr fjalën. Arben Gashi, kryetari i grupit.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ajo çka u diskutua këtu sot ishte fund e krye retrospektivë. Çka ishte interesat është se opozita me bindje se është buxhet i përkohshëm, sepse do t'i duhet një qeverie tjetër ta aprovojë një buxhet tjetër për të qeverisur vendin. Por, të bindur ishin edhe deputetët e pushtetit dhe ministrat të cilët u morën me retrospektivë.

Të gjithë u morën me atë se çfarë ka ndodhur në katër vjet që shkuan dhe askush nuk e kishte bindjen në vetëdijen dhe në ndërdijen e tyre se do të ketë një qeverisje të ardhme nga Lëvizja Vetëvendosje. Dhe, të gjithë me diskutimet e tyre folën se çka ka ndodhur në këto katër vjet, dhe e përbashkëta e asaj çka ka ndodhur në këto katër vjet, është dështimi.

Dështimi në ekonomi. Dështimi në reforma. Dështimi në sundim të ligjit. Dështimi në politikën e jashtme. Dështimi në politikën e brendshme. Dështimi në mirëqenie sociale, dhe të gjithë këto të përbashkëta ishin ato që e karakterizojnë këtë Qeveri.

Por, ne si deputetë të këtij Kuvendi duhet të shohim se edhe çka ka ky ligj. Nëse e marrim dhe e shohim tekstuale të këtij ligji, dalin probleme. Probleme juridike dhe kushtetuese.

Me këtë ligj tentohet të ndërtohet një precedent i rrezikshëm dhe antikushtetues, ndryshimi i një ligji tjetër, ndryshimi i Ligjit të pagave në sektorin publik. Kur vet Ligji për pagat në sektorin publik, në mënyrë eksplicite e thotë: "Qeveria me Ligjin e buxhetit e përcakton vlerën e koeficientit të pagave". Pra, thotë që është 110 euro, me Ligjin e buxhetit mund të ndryshohet vlera e koeficientit.

Çka bëjnë këta. E ndryshojnë koeficientin si të tillë, që është e pamundur të ndryshohet me Ligjin për buxhetin, sepse këtë atribut nuk ia jep ligji bazik. Tentohet të rritet për 0,5% koeficienti, 0,5 koeficienti, ose gjysmë koeficienti, por për të ndodhur kjo, duhet të merret nisma për plotësim-ndryshimin e Ligjit për zyrtarët publikë.

E njëjta metodologji përdoret edhe për tatimin në pronën e paluajtshme. Tentohet që me Ligjin për buxhetin, i cili është një ligj i karakterit të kufizuar në kohë. Pra, Ligji i buxhetit është një ligj i cili ka kohëzgjatje njëvjeçare. Vlen prej 1 janarit të një viti kalendarik deri më 31 dhjetor.

Tentohet të ndryshohen këto dy ligje, dhe kjo është shkelje kushtetuese. Pra, mentaliteti i shkeljes së ligjeve dhe i Kushtetutës vazhdon të jetë dominues në këtë Qeveri dhe qeverisje. Dhe, paaftësia për të kuptuar se si funksionin sistemi pas 5 vjetësh në qeverisje, është e tmerrshme.

Pra, i kanë 5 vjet në qeverisje dhe nuk e kuptojnë se si funksionon sistemi. Dhe, dalin e ankohen këtu, pse e i dërguat ju 10 apo 15 ligje në Gjykatë Kushtetuese. Sepse ju i keni bërë antikushtetuese. Te Ligji për pagat në sektorin publik, ju e keni bërë, ju e keni shkruar, ju e keni aprovuar dhe vet prapë po ankoheni ju, pse s'po ju lejon ligji ta bëni atë punë. Ju e keni bërë atë ligj.

Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme ju e keni shkruar. Ju e keni aprovuar dhe prapë po ju del problem. Ju del problem, sepse ju nuk mbërrini ta kuptoni se si funksionon një sistem juridik. Përgjegjësia dhe hierarkia juridike janë të tilla që janë të ndërtuara në atë formë që duhet të jenë të ekuilibruara dhe të mos ketë mundësi të ndërhyrjes arbitrare.

Ndërhyrja arbitrare nëpërmjet ligjeve të tjera, është e dëmshme dhe e rrezikshme. Krijohet një precedent, i cili do të japë pasoja negative afatgjate.

Prandaj, të nderuar kolegë, mashtrimi për mbi 80 mijë zyrtarë të sektorit publik është i papranueshëm. Mashtrimi për secilin qytetar të Kosovës që ka pronë të paluajtshme është i papranueshëm. Dhe, ndërtimi i një sistemi i cili është konfliktuoz, pra, normat juridike të karakterit të përkohshëm si Ligji për buxhetin t'i mbivendosen disa ligjeve është problematik dhe rrezikshmëri afatgjate.

Prandaj, duke i marrë parasysh krejt këto elemente, këto përshkruhen në mentalitetin qeverisës. Në mënyrën se si mendon dhe funksionin kjo Qeveri. Mënyrën se si ky kryeministër dhe këta ministra e shohin sistemin qeverisës në Kosovë. Pra, vetë e shkruajnë ligjin. Vetë e sjellin në Kuvend. Vetë e aprovojnë. Nuk pranojnë asnjë amendament që të përmirësohet ligji dhe në fund vetë çohen e shkelin dhe ankohen pse po e dërgoni ligjin në Gjykatë Kushtetuese. Çka t'ju bëjmë juve? Kur nuk e pranoni këshillën. Nuk e pranoni paralajmërimin. Nuk pranoni arsyetimin dhe dëshironi që në mënyrë absolute t'i jepni zgjidhje sipas interesave tuaja politike.

Prandaj, të nderuar kolegë deputetë, e mira e kësaj pune është që pas 5 viteve në qeverisje, qytetarët e Kosovës e dinë se kush jeni ju. Pas 5 viteve në qeverisje, është Qeveria më e paaftë në historinë e Kosovës. Është Qeveria e cila pas 5 viteve qeverisje nuk ka se çka thotë. Nuk ka se si të arsyetohet. Nuk ka se çka të prezantojë. Nuk ka se çka përfaqëson.

Është një Qeveri së cilës i kanë ikur rreth 300 mijë qytetarë. Është një Qeveri e cila është nën sanksione ndërkombëtare. Është një Qeveri e cila nuk ka komunikim me partnerët ndërkombëtarë. Është një Qeveri e cila nuk ka komunikim dhe lidhje me qytetarët e vet. Është një Qeveri e cila nuk jep shpresë për qytetarët e vet. Është një Qeveri e cila nuk përçon asnjë sinjal pozitiv për zhvillimet në këtë vend.

Prandaj, ne po hyjmë në fazën kur qytetarët e Kosovës po reflektojnë. Qytetarët e Kosovës së shpejti do të zgjedhin dhe qytetarët e Kosovës së shpejti do të vendosin. Vendimi i tyre do të jetë ndëshkim për juve. Ndëshkim për keqqeverisjen. Ndëshkim për aferat në sektorin e energjisë elektrike. Ndëshkim për aferat me rezervate shtetërore. Ndëshkim për aferat në KEK. Ndëshkim për dyfishimin e çmimit të energjisë elektrike.

Ndëshkim për rritjen e kostos së jetesës. Ndëshkim për sanksionet ndërkombëtare. Ndëshkim për sjelljen tuaj të papërgjegjshme. Ndëshkim për çdo veprim dhe mosveprim të kryeministrit Albin Kurti. Pra, ndëshkimi dhe mallkimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës do t'ju ndjek deri më datë 9 shkurt, kur ata do të vendosin kundër jush. Faleminderit!

KRYETARI: Sipas pajtueshmërisë së grupit parlamentar, kalojmë vetëm edhe te grupet e tjera. Me radhë për të folur është Eliza Hoxha.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, kryetar!

Si e para, më vjen mirë që sot e kemi komplet edhe Qeverinë edhe mazhorancën këtu pas një kohe të gjatë. Po flasim për një buxhet, i cili mund të duket historik. Mund të quhet histori. Mund të jetë më i lartë. Dhe pse jo, duhet të jetë më i lartë çdo vit, por që në fakt është goxha jozhvillimor, dhe do ta elaboroj lidhur me këtë.

Ky buxhet siç duket është më i lartë sivjet, por sa e lartëson dhe e përparon jetën e qytetarëve të Kosovës, besoj që kjo është pyetja thelbësore që duhet t'ia bëjmë vetes dhe ta elaborojmë tutje së bashku.

Për katër vjet Qeveri, këtë Qeveri e ka karakterizuar një gjë, në kuptimin e buxhetit të Kosovës. Shtylla e subvencioneve ka qenë shtylla me më së shumti para, diçka që nuk e ka karakterizuar asnjë qeveri të kaluar.

Pra, para për të shpërndarë për të blerë paqen sociale, por jo para për investime, zhvillim dhe kapital që rrjedh, ku njerëzit mund të punojnë, të zhvillohen dhe të realizojnë veten, idenë e tyre dhe integritetin e tyre, bazuar në shërbimet që i ofrojnë dhe bazuar në një marrëdhënie të rregullt që duhet të mendohet, të ndërtohet çdo vit e më shumë, e që është marrëdhënia shtet-biznes-qytetar.

Prandaj, ky lloj buxheti i prezantuar këtu sot vazhdon dhe mbetet buxhet që e forcon pozicionin e shtetit dhe qytetarin e kthen në një qytetar të varur, ë nënshtruar, i trajtuar me lëmoshë, pa dinjitet e pa integritet. Edhe rritja simbolike e pagave si akt, por pa ndikim përmbajtjesor e kuptimplotë për qytetarët e Kosovës flet për këtë lloj mënyre të mendimit qeveritar.

Shkeljet të cilat Ligji për buxhetin i sjellë sivjet, në këtë rast në raport me Ligjin e pagave, e po jua kujtoj edhe vitin e kaluar në raport me grantin e komunave, nuk janë të rastësishme, janë të qëllimshme për ta kurthuar Kuvendin dhe jetën tonë politike.

Në anën tjetër, duke qenë dikush që agjenda gjinore më ka interesuar edhe kur nuk kam qenë këtu, por edhe këtu me Grupin e Grave Deputete dhe në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, kam nevojë të theksoj diçka sa i përket realizimit të agjendës gjinore, në këtë rast më shumë me theks te realizimi dhe fuqizimi i grave.

Kjo Qeveri vjen me 67% të votës së gruas. E kam përmendur sa e sa herë. Përderisa përveç lëmoshave për fëmijët 10 e 20 euro, ose tek e tuk për nënat lehona, nuk ka bërë asnjë hap para në aspektin e të drejtës bazë që është e drejta e strehimit me premtimin e thënë tash e katër vjet me radhë për njësitë e banimit të përbalueshëm. Asnjë gjë nuk është realizuar në këtë drejtim.

Pjesa tjetër që është po ashtu e drejtë themelore njerëzore që është qasja në punë. Është për t'u përshëndetur rritja e numrit të bursave për vajzat e reja në çfarëdolloj profesioni, por në anën tjetër, ato vajza, ato gra të realizuara në kuptimin e edukimit profesional, nëse nuk kanë parakushte për të mbështetur zhvillimin e karrierës së tyre, kjo është gjë e kotë.

Dhe, kur jemi këtu, dua të ndalem te çerdhet, ku janë premtuar 160 sosh, e që deri sot nuk e di a kanë arritur në 10% të realizimit të tyre. Qysh të punësohen gratë kur nuk kanë ku t'i çojnë fëmijët e tyre.

Si të zhvillohet reja e çifteve të reja nëse nuk ka njësi të reja të strehimit të përbalueshëm. Po ashtu, shumica e çerdheve të parapara në buxhet janë paraparë në komuna të vogla apo edhe në fshatra që nuk është asgjë e keqe, por aty ku është presioni më i madh dhe kërkesa më e theksuar ato mungojnë.

Pra, nuk është marrë parasysh as migrimi i brendshëm, as lindshmëria, as kërkesa e nevoja, e as gjeografia se ku është ky presion dhe kjo kërkesë më e koncentruar.

Do t'i elaboroj vetëm disa nga çerdhet që i kam parë në buxhet. Për shembull, ka çerdhe që kanë figuruar edhe në vitin 2024 me zero buxhet, e tani i gjejmë me buxhet për vitin 2026, jo për vitin 2025, por për vitin 2026.

Ka nja 7-8 çerdhe që është bartja e mjeteve nga viti 2024 deri në vitin 2025, ndërsa ka plot projekte që janë të menduara vetëm në vitin 2026. Pra, në vitin 2024 kanë pasur zero buxhet, në 2025-ën zero buxhet, ndërsa buxhetohen vetëm për vitin 2026. Dhe, kjo nuk është vetëm në këtë vit të buxhetit, kjo ka ndodhur edhe në buxhetin e vitit 2023 për vitin 2024.

Anomalia tjetër është sa mund të kushtojë një çerdhe. Për shembull, një çerdhe e menduar të ndërtohet në Graçanicë, e cila është e buxhetuar në vitin 2025 ka vetëm 25 mijë euro buxhet, përderisa për kuzhinë-aneks të një çerdheje në Podujevë janë 190 mijë euro buxhet.

Në anën tjetër, meqenëse përkas te Komisioni për Arsim dhe Kulturë do të ndalem te mënyra se si janë buxhetuar me vite radhazi dhe ku kanë shkuar paratë e buxhetit të Kosovës në sektorin e kulturës nga Ministria e Kulturës, ku 70% e investimeve nëse i merr dhe i shikon nëpër zëra buxhetorë, kanë shkuar në Komunën e Prizrenit, dhe kjo nuk është rastësi.

Nuk është rastësi. Kjo është përgatitje e terrenit të një ministri, i cili nesër synon sigurisht të garojë për atë komunë. Pra, është përdorim apo keqpërdorim i pushtetit në nivelin qendror për agjendën e tij personale politike në të ardhmen.

E kur jemi këtu, jua kujtoj se mijëra kontrata njëburimore janë dhënë nga kjo ministri pikërisht në emër të emergjencave, duke abuzuar me Ligjin e prokurimit publik, neni 35, pa qenë të tilla, sepse restaurimi dhe konservimi, e kam thënë edhe këtu disa herë, nuk janë procese emergjente, por janë procese të rregullta trashëgimore dhe investive.

Në anën tjetër, teatri rri i mbyllur. Për nja dy vjet artistët funksionojnë dikur tjetër. Tek tash është rrethuar dhe ka filluar diçka të bëhet në fund të mandatit. Teatri i ri që ka qenë në buxhet disa vjet radhazi as që ka filluar. As që ka filluar. Opera dhe baleti po ashtu. Salla koncertale po ashtu. Muzeu i Burgut, përveç një ekspozite sa për të thënë, nuk është bërë asnjë investim më shumë.

Të rinjtë, meqë përkasin prapë te komisioni ku unë veproj me ca kolegë të mi edhe nga mazhoranca edhe nga opozita. Platforma super puna nëse e mendon si të tillë, mund të përshëndetet. Për çfarë super pune flasim nëse ata rinj angazhohen gjashtë muaj dhe pastaj çka? Çka pastaj?

Kryeministri i thërret në zyre, se thotë ju punësoj të gjithëve me një akt të tij final, pa procedura të prokurimit publik ose konkurseve.

U fol për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për raportet e dëmtuara me aleatët ndërkombëtarë. U theksua aspekti i atashëve ekonomikë, rëndësia e tyre dhe atashetë ushtarakë e policorë, por unë do të ndalem te diplomacia kulturore.

Në vitin 2020, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë bërë marrëveshje për të nisur punën për shkallën e shërbimit për atashetë kulturorë. Ministrija Gërvalla nuk e ka bërë asnjë hap në këtë drejtim.

Mund të na flasë për milionat të cilat ia ka dhënë mikes së saj dhe zëvendësministres, zonjës Liza dhe... por, dëmet që i ka shkaktuar kjo ministri, ne sot e dimë që Kosova është nën sanksione.

Si përfundim edhe mund të lavdëroheni me buxhetin, sepse është më i madh se vitin e kaluar, edhe mund ta quani historik, por ama në histori do të mbeten që Kosovën e keni sanksionuar. Kosovën e keni izoluar, e Kosovën e keni kurthuar aq shumë sa që këtu mund t'i lavdërim vetëm marrëzisë.

KRYETARI: I kërkoj falje Burim Metës se e kalova. Ashtu m'u duk që grupi parlamentar është pajtuar për një version tjetër. Ia japim fjalën atij.

BURIM META: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Po, sot me të vërtet po flasim për buxhetin më të pasur të Republikës së Kosovës. Më lejoni që t'i kemi dy qasje të miat, njëën nga një kërkesë për pasurim të listës esenciale të barnave nga Ministria e Shëndetësisë dhe gjithashtu, edhe një moskonsideratë të këtij buxheti nga kërkesat e Zyrës së Presidentes, ku sipas Kushtetutës së Kosovës, presidenti i Republikës është kreu i shtetit, e njëkohësisht përfaqësuesi më i lartë shtetëror brenda e jashtë.

Dhjetëra kompetenca shtetërore, përfshirë udhëheqjen e politikës së jashtme, roli i Komandantes Supreme të ushtrisë, sigurimi i funksionimit kushtetues të të gjitha institucioneve të tjera nënkupton se Kosova ka nevojë për një institucion presidencial që ka pavarësi buxhetore dhe mundësi që të funksionojë e t'i kryej detyrat pa pengesa buxhetore.

Madje, disa aktgjykime të Gjykatës Kushtetuese tashmë kanë etabluar parimit e institucionit të pavarur kushtetues, ku Presidenca, Kuvendi, Gjykata Kushtetuese, Avokati i Popullit, e disa institucione të tjera kanë pavarësi buxhetore dhe Qeveria nëpërmjet ligjit, duke ua cenuar kërkesat buxhetore ua cenon edhe parimin e ndarjes së pushteteve të parapara me Kushtetutë.

E kundërta ka ndodhur me propozimin e Ligjit të buxhetit të vitit 2025, kërkesat e presidentes të cilat janë për qëllim të një funksionimi në përputhje me Kushtetutën dhe interesat shtetërore, janë refuzuar.

Po i përmend disa shembuj. Së pari, Presidenca ka të miratuar Rregulloren e funksionimit të brendshëm e cila i parasheh 8 departamente dhe 138 punëtorë. Përkundër kërkesave të përditshme, Presidencës i mohohet buxheti për të paguar punëtorët e paraparë me Rregulloren.

Kjo gjë ka ndodhur në veçanti sivjet. Paramendojeni departamentin më të rëndësishëm, Departamenti për Marrëdhënie Ndërkombëtare e Siguri i ka zero të punësuar, sepse Ministria e Financave nuk ndan buxhet për ta. Mund t'i hyni fund e krye buxhetit të propozuar dhe më tregoni a ka diku, qoftë edhe në nivel qendror apo lokal, një institucion të vetëm ku në tërë departamentin ka zero të punësuar.

Ky refuzim për ta lejuar Presidencën të funksionojë si duhet duke mohuar buxhetin për stafin e kreut të shtetit nuk ka asnjë rezon shtetëror. Së dyti, në përputhje me Kushtetutën, Presidentja udhëheq politikën e jashtme dhe besoj të gjithë pajtohemi që këtë po e bën në përputhje të plotë dhe me interesa shtetërore. Një prej sukseseve më të mëdha që ajo ka hapur dyert e Kosovës ka qenë angazhimi i Presidentes në agjendën për gratë, paqen e sigurinë, sukses ky që është përmendur edhe në hapje të Samitit nga Sekretari i Shtetit, e po ashtu së fundi u përmend edhe në Raportin e Progresit për Kosovën. Si rezultat i këtij angazhimi, Departamenti Amerikan i Shtetit ka përzgjedhur Kosovën si të vetmin vend në Evropë ku është hapur Qendra e Ekselencës për Gratë, Paqen e Sigurinë dhe përkundër kërkesave të Presidentes, a e dini sa janë ndarë për organizatat e forumit ndërkombëtar për paqe? Zero dhe gjithashtu zero janë ndarë për Qendrën e Ekselencës.

Pra, nuk besoj që dikush është i interesuar që ta bllokojë angazhimin e Kosovës në këtë fushë dhe t'ia mbyllë dyert Kosovës se përndryshe nuk do të ndahej zero buxhet.

Së treti ka një neglizhim total të kërkesave të Këshillit Konsultativ për Komunitete, një trup kushtetues që vepron në kuadër të Presidencës. Prej vitesh buxheti që aprovohet për të është më i vogël se nevojat vjetore për funksionim dhe kryerjen e detyrave bazike. Rikujtoj se Këshilli Konsultativ për Komunitetet në kuadër të Presidencës është organ më gjithëpërfshirës në vend, me kontributin dhe angazhimin e të cilit është avancuar dhe fuqizuar dukshëm dosja e Kosovës në aplikimin në Këshillin e Evropës.

Por, edhe sikur kjo mos të qëndronte, po flasim për një trup që ka fuqizuar ndër vite komunitetet pakicë në vendin tonë. Dhe, këtij Trupi të Presidencës nuk i është miratuar as buxhet i mjaftueshëm për paga, ndërkaq nëse e krahasoni me Zyrën për Komunitete në Kryeministri, e cila as nuk është trup kushtetues, por derisa buxheti total i Këshillit Konsultativ në Presidencë është 139 mijë euro, buxheti total i kësaj zyre në ZKM është 644 mijë euro.

Së katërti, Presidenca është i vetmi institucion që nuk vepron në ndërtesën e vet, por vazhdon të jetë mysafire në Kuvend me zyra që nuk plotësojnë as kushtet bazike. A e njihni ndonjë vend

tjetër në rajon apo botë ku Presidenca nuk e ka ndërtesën e vet? Një numër i madh i punëtorëve në Presidencë punojnë në kushte të tmerrshme, një numër tjetër nuk kanë zyra fare, e dokumentet kanë rrezik të prishen nga lagështia, sepse mbahen në bodrume dhe gjithashtu shumë takime në zyra nuk mund të mbahen nga kundërmimi, por qeveria ka refuzuar edhe të bëhen renovime bazike në zyrat ekzistuese, e as nuk paraqet buxhet për ndonjë ndërtesë për Presidencën, e përkundër kërkesave të vazhdueshme as nuk ka ofruar opsione se në cilën nga ndërtesat ekzistuese që janë në menaxhim të ministrisë së linjës do të mund të vendosej eventualisht Presidenca.

Objekti i Presidencës është pothuajse çdoherë ndalesa e parë e çdo delegacioni të lartë ndërkombëtar, kur vizitohet Kosova. Është pasqyrë dhe imazh i parë i Kosovës, prandaj kjo nuk është vetëm e dëshirueshme, por absolutisht e nevojshme, për të thënë troç, edhe imediate. Buxheti i aprovuar në Zyrën e Presidencës së Republikës së Kosovës për vitin 2025 është pak më shumë se 4 milionë euro. Totali i buxhetit të ndarë për institucionin më të lartë në vend është i barabartë me buxhetin e ndarë në asfaltimin e ndonjë rruge dytësore atje diku në Kosovë.

Për shembull, krahasojmë këtë buxhet me disa prej institucioneve të tjera. Për shembull, Ministria e Zhvillimit Rajonal ka buxhet, i është ndarë buxhet rreth 70 milionë euro, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës 49.5 milionë, Ministria e Bujqësisë 90.5 milionë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, 259 milionë, Ministria e Kulturës rreth 86.3 milionë. Ndërkohë, që Presidencës i thonë se arsyeja për zvogëlimin e buxhetit për investime kapitale është se të gjithëve iu janë zvogëluar investimet kapitale për këtë vit.

Për Ministrinë e Kulturës, e Bujqësisë, e Punëve të Jashtme ka rritje përafërsisht nga 1 milion euro. Për Ministrinë e Mjedisit diku rreth 15 milionë, e shumëfish për Zyrën e Kryeministrit në krahasim me vitin 2024. Përderisa neve si deputetë na janë marrë parasysh shumë kërkesa për futje të projekteve milionëshe në buxhet, shumica dërmuese e kërkesave të Presidencës janë refuzuar. Shtrohet pyetja: në interes të kujt është pengimi i punës së Presidencës së vendit, si kreut të shtetit tonë? Pra, flasim për përfaqësim dinjitet dhe integritet. Kjo qasje refuzuese ndaj kërkesave të Presidentes, përkundër faktit që aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese qartë parashohin pavarësinë buxhetore të këtij institucioni, janë sfidë për kushtetutshmërinë në vend, si dhe për interesat shtetërore.

Një realitet i tillë mund të jetë vetëm në dobi të atyre, të cilët e luftojnë nga jashtë ditë pas dite, por kurrsesi në dobi të askujt nga ne këtu në këtë sallë, në këtë ndërtesë dhe në këtë vend.

Gjithashtu, më lejoni që në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dua të ndalem te një çështje që prek drejtpërdrejt jetën e shumë grave në Kosovë. Në Klinikën e Onkologjisë po rritet dita ditës numri i pacienteve që përballen me kancer të gjirit. Kjo sëmundje kërkon një trajtim të kujdesshëm dhe mbështetje të veçantë në mënyrë që gratë të kenë shpresë dhe mundësi për një jetë më të mirë. Ky rrugëtim në vetvete është jashtëzakonisht i vështirë emocionalisht jo vetëm

për gratë, por për të gjithë, edhe familjen. Mirëpo kjo barrë bëhet më e rëndë kur i shtohet kostoja e lartë e trajtimit, të cilën shumica e familjeve nuk mund ta përballojnë.

Me akt të veçantë do të propozojmë që lista esenciale e barnave të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë të pasurohet edhe me një numër të madh të medikamenteve që vijnë nga kërkesat e profesionistëve, sepse ky investim nuk është thjesht masë financiare, është një zotim yni për të përmbushur obligimin kushtetues dhe ligjor ndaj këtyre grave dhe familjeve dhe do të jetë një hap i domosdoshëm për të siguruar shërbime shëndetësore në Kosovë.

Të dashur kolegë, është e rëndësishme që të kemi infrastrukturë të mirë dhe atë e kemi, më shumë mjete për projekte, po mallra dhe shërbime po, por asnjë nga këto nuk matet me jetën e një nëne që nuk ka edhe kohë të presë për trajtimin e sëmundjes së saj.

KRYETARI: Tash ia japim fjalën deputetes Floretë Zejnullahu, te kartela e Mërgim Lushtakut. Ju lutem, regjia mikrofonit është pikërisht te ulësja e Mërgimit.

FLORETË ZEJNULLAHU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Kjo është hera e katërt që diskutojmë buxhetin e shtetit në këtë mandat të kësaj qeverie, të skandaleve edhe dështimeve të përditshme.

Për fat të keq sërish diskutojmë një buxhet që nuk është hartuar për të mirën e popullit, por për përfitime të ngushta politike dhe mbushje të xhepave të grupeve të afërta me pushtetin.

Ky buxhet është veç një instrument për vjedhje të orkestruar prej Albin Kurtit e Dejana Mihalit, një buxhet që në vend se të mbështetë qytetarët, do të shërbejë si mjet për fushatë manipulative, duke thyer njëkohësisht qytetarët që kanë zgjedhur të jetojnë dhe të kontribuojnë në vendin e tyre. Po kjo nuk është befasuese, sepse ky njeri i ka quajtur edhe “analfabet” popullin e Kosovës.

Sot ne po flasim për një buxhet që është larg zhvillimit ekonomik, një buxhet që nuk bazohet në rritje të inflacionit, pra në rritje të çmimeve, të atyre çmimeve të cilat rriten sa herë që shkojnë në market për të blerë produktet ushqimore për familje.

Ky nuk është buxhet për rritje të qëndrueshme ekonomike që mbështet mirëqenien e qytetarëve, ky është buxhet për të pasuruar Albin Kurtin, i cili ka vendosur madje që edhe vajzën e tij ta rrisë jashtë Kosovës, sepse interesi i Kosovës nuk ka qenë asnjëherë prioritet për të. Ky buxhet nuk përmban ambicie zhvillimore, nuk u përgjigjet premtimeve elektorale dhe është i shkëputur totalisht nga kërkesat konkrete të qytetarëve.

Të dashur qytetarë,

Shëndetësia nuk është dhe nuk ka qenë asnjëherë prioritet i kësaj qeverie. Ajo ka qenë çdoherë në harresë. Po përballeni me mungesë të barnave, pajisjeve dhe me kushte të pamjaftueshme për pacientët dhe stafin mjekësor, me lista të gjata të pritjes, nuk ka ende sigurime shëndetësore, nuk ka funksionalizim të SISH-it, me këtë buxhet nuk nënkuptohet trajtim i dinjitetshëm për mjekun, kirurgun, infermierin, farmacistin, me një fjalë me këtë buxhet nuk i motivoni asnjërin nga ta që të qëndrojnë në Kosovë, por i detyroni të largohen nga ky vend. E çka më duhet pritur prej një kryeministri, i cili deklaroi se patriotët e punëtorët më të mëdhenj nuk janë në Kosovë, por vetëm në diasporë.

Të dashur qytetarë,

Meqenëse vij nga rajoni i Llapit, s'mund të kaloj pa e përmendur se ky buxhet përfaqëson një tjetër mashtrim për qytetarët e Podujevës. Mungesa e ujit të pijshëm dhe problemet me ujësjellësin në qytet dhe fshatrat e Llapit janë dëshmi e planifikimit të dobët dhe mungesë e investimeve.

Për katër vjet i keni mashtruar qytetarët atje dhe ende asnjë hap konkret për ta rregulluar furnizimin me ujë të pijshëm në Podujevë, kur dihet sipas studimeve të fizibilitetit të kryer se rrjeti i ujësjellësit në Podujevë ka nevojë për rehabilitim, për investime në zëvendësim të rrjetit të stërvjetruar të ujësjellësit, sepse për shkak të gypave të vjetër ka humbje deri në 70% të ujit dhe me këto sanime do të mund të furnizohej jo vetëm qyteti, por edhe të shtrihej rrjeti i ujësjellësit edhe në fshatrat të cilat kanë mungesë.

Të mos flasim pastaj për rrugën Podujevë - Prishtinë, sepse ka qenë premtimi juaj që do të përfundojë brenda vitit 2022, mirëpo ende nuk ka asgjë dhe ajo rrugë as për së afërmi nuk është duke përfunduar. Gjatë këtij mandati qeverisës 2021-2024, kjo mazhorancë ka menaxhuar më shumë se 12 miliardë euro, po ku janë rezultatet? Cilat janë projektet konkrete të realizuara nga kjo qeveri që i shohim sot? Asnjë, sepse ato janë të padukshme. Ky buxhet nuk parasheh as përkrahje për veteranët, kjo Qeveri i ka përjashtuar ata nga paga minimale. Nuk ka siguruar as proteza për invalidët, i ka lënë ushtarët e FSK-së pa ushqim, madje nuk ka ofruar as mbështetjen e duhur për krerët e UÇK-së që gjykohen ende në Hagë, pasi kemi të bëjmë me një qeveri që është më e afërt me interesat e Serbisë se sa me vlerat e luftës tonë për liri.

Për këto arsye dhe shumë të tjera ne nuk do ta votojmë këtë buxhet, ky është një buxhet që varfëron dhe nuk sjell as mirëqenie, as zhvillim për qytetarët e Republikës së Kosovës. Kosova ka nevojë për një qeveri që planifikon me seriozitet dhe përkushtim, që investon në sektorët e nevojshëm dhe që ka në fokus mirëqenien e popullit të Kosovës. Kosova mundet më mirë, sepse qytetarët e Kosovës meritojnë më mirë.

KRYETARI: Blerta Deliu-Kodra flet, është deputetja e fundit.

BLERTA DELIU-KODRA: Të nderuar kolegë deputetë,
Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës!

Para pak orësh me kolegët e mi deputetë nga Partia Demokratike e Kosovës ishim në Likoc për t'i dhënë lamtumirën e fundit ushtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Liman Musliu, pjesëtar aktual i Forcës së Sigurisë së Kosovës, i cili humbi jetën tragjikisht në rrethana të rënda, si shumë kolegë të tij të institucioneve të Kosovës, të cilët për t'i mbajtur familjet e tyre sot janë të detyruar të gjejnë një punë të dytë. Prandaj, sot është ulur dinjiteti i ushtarit të FSK-së. Prandaj, sot është ulur dinjiteti i policit të Kosovës, prandaj sot kemi sfida me minatorin, kemi sfida me përfaqësues të institucioneve më kredibile në vend, të cilët me këto paga të padinjitetshme detyrohen të dalin e të kërkojnë alternativa të dyta për t'i mbajtur familjet e tyre.

Kryeministri doli, në të kundërtën unë do të kisha një pyetje për të, por meqë është jashtë sallës, besoj që do të kthehet e t'u japë përgjigje disa prej shqetësimeve, të cilat duhet të fliten sot në këtë sallë, kur po diskutohet njëri prej diskutimeve më të rëndësishme të shtetit të Kosovës, që është buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2025. Kur këto sfida janë të mëdha, kur sot kemi braktisje të vendeve të punës nga institucione të rëndësishme, kur sot inflacioni është i rritur, kur sot qytetarët e Republikës përballen me shtrenjtim të energjisë elektrike në dyqind për qind, kur tatimi në pronë është i rritur në atë masë sa bëhet i papërballueshëm, natyrisht që arroganca e këtij pushteti flet për buxhet të ëndrrave, buxhet historik, sepse mospërfillja është ajo e cila i ka goditur këtë Qeveri, që po godet çdo ditë në jetën e secilit qytetar të Kosovës.

Prandaj, edhe paraprakisht çfarë dëgjuam, ne s'po flasim për projekte zhvillimore, po flasim për ndarje të buxhetit të luksit të Presidencës, e lukse të tjera, të cilat duhet të ndahen për buxhetin e Qeverisë. Sepse, nëse e shihni, pagat janë rritur më së shumti për zyrtarët qeveritarë. Më së shumti këta të cilët kanë vënë gishtin se do të jenë gardianë të buxhetit të shtetit, kanë vendosur që të pasurohen për veten e tyre.

Kryeministri na foli dhe na flet ca kohë për premtimet, në fakt Kryeministri nuk na foli për planin e tij dhe premtimet e tij të cilat i kishte dhënë për mandatin katërvjeçar. Ai na foli për shifra për buxhet, ose siç e tha një koleg këtu, "fjalët e shumta qenkan varfëri". E në fakt, krejt çka ka ky Kryeministër është varfërim i qytetarëve të Kosovës e asnjë projekt të rëndësishëm zhvillimor.

Asnjë fjalë sot nuk u tha as për 160 çerdhe të cilat u premtuan, as për shujtat e nxënësve, as për digjitalizimin nëpër shkolla, as për banimin e përballueshëm për mësimdhënës. Nuk u fol asnjë fjalë e vetme për sigurimet shëndetësore, për qytetarët e Kosovës të cilët sot në mungesë të trajtimit, detyrohen që të largohen nga Kosova për të gjetur shërim në kushte të rënda dhe të papërballueshme. Pra, dështim në ekonomi, dështim në sundim të ligjit, mirëqenie sociale, dështim në arsim, dështim në politikë të jashtme.

Në vend që sot të flitet për njohje të reja, përforcim të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, Qeveria e mazhoranca e ka hallin sesi të rregullohen disa zyra atje në Presidencë, se si Qeveria të ndajë buxhet më shumë për presidencën dhe për konferenca të ndryshme, e në fakt shihni sot brenda QKUK-së pacientët të cilët vuajnë për medikamente, shihni sot punëtorët e institucioneve të Republikës së Kosovës, të cilët dalin nëpër rrugë për të kërkuar transport nga qytetarët e rëndomtë dhe shihni se çfarë gjendje kjo Qeveri e quajtur si Qeveri e shpresës e ka sjellë Kosovën.

Pra, buxheti gjatë këtij mandati katërvjeçar, u tha se paska qenë 11.4 miliardë euro. Pa ma thoni kolegë deputetë, cili paska qenë ndikimi i këtij buxheti në ekonomi? Çfarë ka ndryshuar në ekonominë e vendit sot me këtë buxhet të proklamuar për katër vjet për Qeverinë e shpresës? A ka ndonjë ndryshim substancial, pra që mund të flitet sot?

E dëgjova pak më herët krahasimin që e bëri ministri Murati për shumën e projekteve kapitale të qeverive të kaluara. Unë nuk jam e sigurt nëse ministri Murati e mban mend se si ishte Kosova në aspektin infrastrukturor vite më parë. Kosova, e cila i ka 1400 fshatra, që në kohën në të cilën po flet ministri Murati, kanë qenë në lloç, kanë qenë pa kanalizime, pa ujësjellës, pa kushte elementare për jetesë, nxënës pa shkolla, nxënës në kontejner, Kosovë e cila ka pasur mungesa, skamje e varfëri të jashtëzakonshme. Hiç unë s'po flas sot për rrugët nacionale dhe dy autostradat të cilat i paska realizuar qeveritë paraprake. Pra, ju përfaqësues të Qeverisë nuk keni as guxim e besa nuk keni as qëllim që të ideoni projekte të mëdha.

Prandaj, ky buxhet është buxhet i lëmoshës, prandaj ky buxhet është buxhet i skemave sociale, sepse ndryshe nuk mund të premtohen rritje të pagave në fund të mandatit katërvjeçar. Nuk mund të pritët rritje të pagave në fund të mandatit katërvjeçar. Po zonjë, ju qesheni atje, sepse nuk ju turpëron fakti që njerëzit sot kanë mungesë të gjërave ekzistenciale. Sot, qytetarët e Kosovës vuajnë për gjërat më ekzistenciale. Sot, raportet ndërkombëtare fatkeqësisht flasin për Kosovën si vendin më të varfër dhe ju sot qesheni, sepse nuk turpëroheni prej votës që e keni marrë, nuk ju vjen keq prej premtimeve të cilat i keni dhënë qytetarëve të Kosovës. Përqeshja e përçmimi dhe natyrisht kjo gjendje e cila shihet në këtë Kuvend, ku nuk keni madje as guxim të deklaroni për votën të cilën jua kanë dhënë qytetarët e Kosovës, flet se ku e keni sjellë vendin.

Unë jam e bindur se 9 shkurti do të jetë rezonim ndryshe i qytetarëve të Kosovës, edhe i mërgatës, edhe i qytetarëve të cilët sot ndihen të braktisur, edhe i kësaj mazhorance, e cila s'ka guxim të dalë përtej Kryeministrit, këtyre ministrave e ta thotë një fjalë të vetme për votuesin e saj. Prandaj, jam e bindur që 9 shkurti do të jetë demonstrim për të dëshmuar që premtimet të cilat ua keni dhënë qytetarëve, gënjeshtat që i ka bërë kjo Qeveri do ta marrë edhe vendimin final që do t'i jetë për t'i dhënë fund njëherë e mirë kësaj Kosove të izoluar, kësaj Kosove nën sanksione, kësaj Kosove e cila minatorin, mësimdhënësin, pjesëtarin e FSK-së, policin e Kosovës, administratën e shteti, komunat i ka lënë në lëmoshë. Sepse, në fund të ditës, janë

kompromiset, janë pazaret, janë aferat korruptive, janë kontratat njëburimore të cilat kjo Qeveri i ka bërë me sekserë e asnjëri prej kolegëve sot nuk e ka guximin të dalë e ta thotë një fjalë të vetme. Duhet të keni përgjegjësi ndaj atyre njerëzve që ju kanë votuar në atë masë aq të madhe. Fundja, do të shihemi më 9 shkurt.

KRYETARI: Zoti Meta, a ke kërkuar një replikë më duket? Urdhëro!

BURIM META: Znj. Deliu e ka dëshmuar ndër vite që nuk merr vesh në interesin shtetëror si prioritet. Këtë nuk e pres nga ajo. Për këtë çështje, edhe e vlerën si luks. D.t.th. ajo dhe partia e saj ndër vite kanë dëshmuar që shteti apo edhe pozicionet kur i kanë udhëhequr në Presidencë, nuk e kanë pasur qëllimin kryesor apo prioritetin prezantimin identitar të shtetit të Kosovës.

KRYETARI: Një kundër-replikë, znj. Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kolegun tim, z. Karameta, për të cilin kam respekt, e kam dëgjuar shumë pak të flasë në këtë seancë. Prandaj, unë nuk befasohem që në kohën kur bëhen ndarjet buxhetore, ai të jetë i zëshëm, sepse nuk dëgjova për diçka substanciale.

Në fund të ditës, politika e jashtme e udhëhequr nga znj. Osmani dhe nga kjo Qeveri matet me njohje. Më thoni ju mua sa njohje për këtë mandat katërvjeçar i kanë ardhur Kosovës? Sa anëtarësime në organizata ndërkombëtare i kanë ardhur Kosovës në mandatin e kësaj qeverisje? Të prapakthehemi të shohim në kohën e Qeverisë së Hashim Thaçit, Kosova është forcuar më së shumti ndërkombëtarisht, është njohur më së shumti nga shtete të rëndësishme, është fuqizuar në aspektin e fuqizimit si shtet edhe në anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Pra, kur s'kemi mundësi që të flasim për rezultate konkrete.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Edhe një minutë, le ta përfundojë.

BLERTA DELIU-KODRA: Kur mungojnë rezultatet konkrete, unë pres që ne të flasim për zyra e lukse.

Të nderuar kolegë deputetë, s'ka asnjë rezultat të vetëm që kjo Qeveri mund ta numërojë.

KRYETARI: Vazhdojmë tash! Do ta votojmë buxhetin.

Të nderuar deputetë,

Përgatituni për të votuar! Po e hedh në votim Projektligjin për ndarjet buxhetore për vitin 2025.

Përgatituni për votim! Votojmë tash!

Regjia, votojmë tash!

59 deputetë votuan për buxhetin. Zero kundër, dy abstenime dhe 61 vota në total.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

Kërkojmë nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e tjera sipas fushave përkatëse që ta shqyrtojnë dhe pastaj të na e paraqesin.

Ke një kërkesë tjetër? Urdhëro z. Armend Muja në emër të grupit të mazhorancës.

ARMEND MUJA: I nderuar kryetar!

Jemi duke dashur ta paraqesim një mocion procedural për shmangie nga afatet e Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025.

Propozimi është që amendamentet në Projektligjin për ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 të mund t'i adresohen Komisionit Funkcional deri në orën 13:00 të datës 13 nëntor 2024. Komisionet parlamentare deri në orën 12:00 të datës 15 nëntor 2024 të shqyrtojnë Projektligjin në fjalë dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit Funkcional. Komisioni Funkcional deri në orën 16:00 të datës 18 nëntor duhet të shqyrtojë Projektligjin për ndarjet buxhetore 2025 dhe raportin përfundimtar me rekomandime ia paraqet seancës plenare.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndarjet buxhetore 2025 të bëhet në seancën e datës 21 nëntor 2024, duke filluar nga ora 10:00. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni! Për procedurë janë paraqitur grupet parlamentare. Kryetari i Grupit të LDK-së, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ky propozim është i çuditshëm. Nuk po e kuptoj pse është kjo urgjencë. D.t.th. brenda dy ditësh po kërkohet që të dërgohen amendamentet e propozimet nga deputetët, dhe brenda dhjetë ditësh të mbyllet i tërë procesi i miratimit në lexim të dytë të Projektligjit për ndarjet buxhetore kur ka kohë ka deri më 22 dhjetor në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Cila është urgjenca? Pse nuk duhet t'u jepet deputetëve kohë që ata të konsultohen me bazën, të shohin se cilat janë propozimet, të shohin cilat janë nevojat, dhe ato të shndërrohen në amendamente? Pse duhet veç dy ditë? Çka është urgjenca?

Kryeministër, mos qesh! Trego se cila është urgjenca, se ti u ke thënë këtyre që ta bëjnë urgjent. Qysh? Po, dil kallëzo se cila është urgjenca, sepse buxheti vlen prej 1 janarit të vitit të ardhshëm. S'e di çka po të ngutet. Sa qeshesh e lëshon fjalë prej vendit, dil kallëzo!

Dil kallëzo, thuaj ka urgjencë, po nis një luftë, hajde ta aprovojmë buxhetin. Dil kallëzo, mos u çaravesh aty prej vendit. Mos u çaravesh, se je kryeministër i vendit.

KRYETARI: Kujdes fjalorin, deputet!

ARBEN GASHI: Janë fjalë që i ka thënë ky vetë kur ka qenë në opozitë. Po ia përsëris. A po të kujtohen Albin Kurti i ulur këtu, duke i thënë kryeministrit pse po çaraveshesh. Veç po ia përsëris fjalët e tij. Veç po ia përsëris fjalët. Dil kallëzo se cila është urgjenca që të shtyhet buxheti për dy ditë. Pse duhet të bëhet me dy ditë, një muaj e gjysmë para kohe? Pse? Këtë tregoje dhe jemi në rregull.

KRYTEARI: Po, por dhjetë ditë i ka krejt cikli.

ARBEN GASHI: Një kryeministër i përgjegjshëm nuk vepron kështu. Del dhe kallëzon. Kemi nevojë ta bëjmë, në rregull. E arsyeton, ecim tutje. Dy ditë t'u lihen deputetëve për amendamente. Dy ditë! Nëse do t'i sjellësh! Ani-ani, veç veproni kështu. Nëse do t'i sjellësh. A, vigjilent. Shihe-shihe!

T'i lini afatet ligjore. Buxheti fillon të zbatohet prej 1 janarit, sot është 11 nëntor. Pse duhet më 13 nëntor të mbyllet? Kjo është, pse duhet të mbyllet më 13 nëntor? Kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Besnik Tahiri, pastaj edhe ju PDK-ja.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Nuk ka asnjë logjikë. Absolutisht nuk ka asnjë logjikë që sonde në fakt, të na vijë një kërkesë prej kryetarit të Komisionit për Buxhet që të gjithë deputetët t'i kenë vetëm dy ditë t'i komentojnë, të amedamentojnë mbi një buxhet që është miratuar tash me 59 deputetë.

E shtroi... 59 ishin pro, 2 abstenime. Ashtu e pashë. Ajo ishte fotografia, 59 për, 2 abstenime. Pra, s'keni shumicë parlamentare. Është më korrekt, është shumë korrekte të dilet e të thuhet, jemi në presion se mos po na ikën ndonjë deputet. Jemi në presion se nuk i kemi numrat. Dhe, jo të jepet argumentim e urgjencë kur s'kemi kurrfarë urgjence.

Sot është 11 nëntor, nesër është 12, pasnesër është 13. Dy ditë i kanë vetëm deputetët, ndërsa buxheti, siç e dini, trajtohet në të gjitha komisionet funksionale. Ju lutem!

Kjo është totalisht e papranueshme. Është kundër standardi demokratik. Është kundër krejt parimeve dhe programeve që i ka paraqitur Lëvizja Vetëvendosje. Dhe, kjo nuk ka nevojë, Arben, që të na e sqarohet hiç. Hiç s'ka nevojë kryeministri ta sqarojë, se po dihet.

61 numra këta i kanë, 59 në fakt, dhe po tuten nëse ndonjëri po ikën. Këtu është problemi krejt. Kurrëgjë s'ka problem të thuhet kjo. Absolutisht. Është totalisht jokorrekte në pikë të natës të na jepen dy ditë afat, dhe unë mendoj që opozita duhet ta diskutojë dhe ta bojkotojë pjesëmarrjen për shkak që në këtë masë nënkupton që ne nuk mund ta aplikojmë asnjë amendament. Absolutisht asnjë amendament.

KRYETARI: Mërgim Lushtaku, në emër të Grupit të PDK-së.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryetar!

Realisht nëse e pyetni veten pse ka dështim kaq të madh të implementimit të buxhetit, është pikërisht kjo nguti që e kemi parë në Kuvendin e Kosovës këto vite që ka udhëhequr Vetëvendosja me mazhorancën, edhe në Kuvend, edhe në Qeverinë e vendit.

Sigurisht që kemi një implementim pastaj të dobët edhe në investime kapitale, edhe në skandalet tuaja të përditshme me të gjithë sektorët e vendit, dhe sigurisht e keni krijuar mazhorancën apo kolegët deputetë për keqardhje, vetëm në makineri të votave, e assesi të ngritjes së zërit në Kuvendin e Kosovës.

Besoj që deputetët, dikush prej qytetarëve të Kosovës, i ka votuar. Dhe, sigurisht që kanë edhe kërkesa të ndryshme që t'i paraqesin në pjesën e buxhetit për vitin 2025.

Përveç deputetëve, edhe komunat e Kosovës i kanë kërkesat e tyre. Përveç komunave, kanë edhe institucionet e tjera. E di që kryeministri e lëkund kokën dhe kundërshton në këtë pjesë, sepse në funksionimin e Vetëvendosjes kemi një sistem diktatoriale, ku të gjithë kanë të drejtë të flasin, por vetëm Albin Kurti vendos, sepse e kaq diturinë e madhe sa që me arrogancë e tejkalon demokracinë.

KRYETARI: Arsyetimi më i logjikshëm po ma merr mendja duhet të jetë, më mirë herët se vonë. Përtej kësaj s'po di çka të them. Sa më herët, më mirë. Nëse s'pajtoheni që më herët më mirë, mund ta shprehni me votë.

Po e hedhim në votim. Vetëm grupet. S'mund ta hedhim drejtpërdrejt. Duhet t'ua japim deputetëve procedurën e amendamenteve. E hedhim në votim, vetëm duhet ta kuptojmë se sa deputetë jemi të pranishëm. Duhet ta dimë numrin e saktë, sepse kjo shkon me 2/3.

S'po shkojmë me elektronikë, se 61 i ka mazhoranca, plus... Votojmë me elektronikë për prani, votojmë tash! Jo, logjikisht thashë se mos po doni ta llogaritni veten, se më vështirë e ka të kalojë ajo. Ani, faleminderit për këtë përkujdesje ndaj arkivit!

Të pranishëm janë 62 deputetë. Tash e votojmë këtë kërkesë, është mocion për shmangie të afateve të Rregullores. Votojmë tash!

60 deputetë votuan për, kundër asnjë, 1 abstenim ishte. Kështu që, Kuvendi e miraton edhe këtë mocion. Afatet i keni. Prandaj, buxheti trajtohet sipas tyre. Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*